



Behar\* e Blerim\*\*,

*Si lufta për liri që e shpague gjakun e dëshmorit me hyjnizim; si munda për dije-kulturë, që e shpague veprën e krijuesit me përjetësim, ashtu edhe investimi vullnetar, që pavdekëson vlera, e shpague dhuruesin me kënaqësi shpirti e fisnikërim, prandaj përgëzojmë dhe falënderojmë sponsorizuesit për financimin e çdo libri cilësor.*

Autori

*/\* Behar Mehmeti, Miçigen, SHBA dhe \*\*Blerim Veselaj, Zurich, Zvicër/*

## **Përmbajtja**

- Të dhëna biobibliografike për autorin, 9  
PASKAJORJA, NË FOKUS RRUGËZGJIDHJEJE APO? (NË VEND TË PARATHËNIES), 11  
Hyrje, 17
- I. A SHIHET NDONJË NDRYSHIM QËNDRIMI RRETH INTEGRIMIT TË PASKAJORES ME+ PJESORE NË SHQIPEN STANDARDE?, 23
  - II. A KA FAKTE QË E VËNË NË DYSHIM ZËVENDËSIMIN E PLOTË TË NOCIONIT TË PASKAJORES SË SHQIPES ME LIDHORE DHE ME PASKAJOREN E DYTË?, 29
    - 1)Raporti lidhore / paskajore e mirëfilltë, 30
    - 2)Raporti paskajore e dytë / paskajore e mirëfilltë, 32
    - 3)Disa meditime rreth këtyre raporteve, 32
  - III. A KA KUNDËRTHËNIE SERIOZE ME REALITETIN NË RAPORTIN E PROPOZIM-ZËVENDËSIMIT TË PASKAJORES SË MIRËFILLTË ME PASKAJOREN E DYTË?, 39
  - IV. A ËSHTË E DREJTË QË SHPREHJET ME VLERË ME PASKAJOREN ME ME TË JENË TË REKOMANDUESHME VETËM PËR GEGËRISHTEN, POR JO EDHE PËR SHQIPEN STANDARDE?, 59
  - V. A KA ARSYE TË HESHTET EDHE MË FUNKSIONI PËRFAQËSUES I FORMËS SË PASKAJORES ME + PJESORE E SHKURTËR?, 73
  - VI. NË CILËT TIPA TË FOLJEVE PJESORJA E SHKURTËR (EDHE SI GJYMTYRË E PASKAJORES) DHE NË CILËT AJO E LETRARËZUARA KANË MË TEPËR PËRPARËSI PËR FORMIMIN E EMRAVE TË VEPRUESIT?, 81
    - 1)Pjesorja e shkurtër në funksion fjalëformues, 82
    - 2) Pjesorja e zgjeruar në funksion fjalëformues, 83
    - a) Skema e raportit pjesore e paskajores me + pjesore si temë prodhuese dhe emri i vepruesit sipas tipave të foljeve., 84
    - b) Paskajorja dhe rregullat përmbledhëse të formimit të emrave të vepruesit në shqipen e sotme letrare., 86

VII. SA PRIRET EVOLUTIVISHT SHKURTIMI I PJSORES SË LETRARISHTES NË RAPORT ME SHTYTËSIT PËRKATËS TË NJË VEPRIMI TË TILLË?, 91

1. Raporti i pjesores së shkurtër ndaj pjesores së letrarishtes ashtu edhe e ndaj pjesoreve të zgjeruara të gegërishtes, 91
2. Involvimi i pjesores në sistemin fjalëndërtues, 93
- 2.1. Involvimi i pjesores në fjalëformim, 93
- 2.2. Involvimi i pjesores në kohëformim, 95
- 2.3. Involvimi i pjesores në formëformim, 98
3. Format infinitivale dhe paskajorja, 100

VIII. CILAT JANË DISA NGA VEÇORITË SPECIFIKE TË PASKAJORES SË MIRËFILLTË NË GJUHËN SHQIPE?, 105

IX. A ËSHTË PJSORJA E SHKURTËR NJË SIÇELËS MAGJIK POTENCIAL, VEÇ TJERASH, EDHE PËR ZGJIDHJEN E PASKAJORES ME ME NË SHQIPEN STANDARDE?, 122

- A) Cilat janë faktet kryesore për ekzistimin e pjesores së shkurtër në shqipen letrare dhe ligjërimore?, 122
- B) Disa fakte dëshmuese që pjesorja e shkurtër del e stimuluar nga kujtesa dhe nga dukuria e evolimit gjuhësor, 126
- C) Prireja e theksuar evolutive mbetet të ndiqet, 135
- Ç) Një lajthitje tipike në interpretim e shkaktuar nga mënjanimi arbitrar i pjesores së shkurtër nga norma letrare, 137
- D) Si kontatim përfundimtar, 139

X. DEL, APO JO, I PAKUPTIMSHËM INJORIMI DHE SAKRIFI KIMI I MËTEJSHËM PASKAJORES NGA NDONJË VETË-MOHUES GEGËRISHTFOLËS?, 141

- Përnbyllje, 167
1. Rreth qëndrimit të gjuhëtarëve, 167
  2. Përgjigjet shkurt në pyetjet e shtruara në krerët përkatës, 168
  3. Përsiatje rreth dobisë së inkuadrimit të paskajores me + pjesore në standard, 172
  4. Përfundim, 175
- Literatura, 179



Të dhëna bio-bibliografike për autorin:

I. Nuhi (Muharrem) Veselaj u lind në fshatin Reçan të Therandës (ish-Suharekës) më 20.VIII.1933. Shkollën fillore (me semimaturë) e kreu në Suharekë (1948). Shkollën normale (katërvjeçare) e mbaroi në Gjakovë, ku maturoi më 30.VI.1952. Provimin shtetëror profesional e dha më 3.IX.1959 në Prizren. Shkollën e lartë përkatësisht Shkollën I të Fakultetit Filozofik të

Prishtinës - Dega e gjuhës dhe e letërsisë shqipe e kreu më 23.IX.1963, ndërsa Fakultetin Filozofik të Prishtinës - Dega gjuhë dhe letërsi shqipe më 23.IX.1965. Ndoqi studimet pasuniversitare dhe më 3.IV.1980 mori gradën: magjistrë i shkencave filologjike, ndërsa tezën e doktoratës e mbrojti më 24.XII.1992.

Jeton në Prishtinë. Është anëtar i Shoqatës Mbarëkombëtare të Shkrimtarëve për Fëmijë dhe të Rinj me qëndrë në Tiranë si dhe anëtar i Lidhjes së shkrimtarëve të Kosovës.

Nuhiu qysh i ri, që nga viti 1951 ishte i organizuar në Lëvizjen për çlirimin dhe bashkimin e tokave shqiptare. Në vitin 1952 u burgos për veprimtari të tillë, por moszbulim provash nga ai u dënua vetëm 3 vjet. Pasi doli nga burgu, ndonëse, me vështirësi, arriti të punësohej në arsim që e kishte ideal veprimësie. Disa herë pati ndërprerje të dhunshme nga marrëdhënie e punës: Mushisht (Suharekë) 1952, Suharekë 1956, Grejëçk (Suharekë) 1957, Ferizaj 1962, Tankosiq (Ferizaj) 1963, Prishtinë 1972, 1973, kur me motive politike u ndalua puna në arsim e organizata shoqërore- shtetërore. Pas një kohe si i papunë u detyrua të punësohej në ndërmarrjen për ndërtimin e rrugëve *A Partizanski put* të Beogradit - dega në Prishtinë, prej nga kaloi në AUzinën e amortizatorëve të Prishtinës, si përktihës. Edhe prej andej më 1991 e larguan, andaj u detyrua me dalë në pension të parakohshëm.

Edhe pse, pothuajse ishte përherë nën mbikëqyrje ai me punë të palodhshme dhe me qëndrim konstruktiv e parimor, përkundër pengesave e përndëjqëjeve, arriti të korë sukses, goftë në jetën arsimore e shoqërore- politike, goftë në veprimtarinë letrare e shkencore. Edhe gjatë Luftës së fundit, ai dhe familja e tij nuk ishin pasivë, përkundrazi kryen punë delikate e me rrezik. Në shtëpinë e tij në Prishtinë, muaj të tërë, janë shëruar ushtarë të plagosur të UÇK-së. Është e vërtetë, se kur filluan bombardimet e NATO-s shtëpia e tij që objekt sulmi me bombë nga paramilitarët serbë. Disa herë i është rafaluar servisi, garazhi si dhe muret e shtëpisë. Si mbarë popullata gjatë ekzodit të madh edhe Nuhiu u detyrua të shpërngulet drejt Maqedonisë, mirëpo, në zonën neutrale në Gllaboçicë (në vend që të shfrytëzonte rastin për të vizituar vajzën në SHBA si dhe djalë e vajzë në Zvicër me familjet e tyre që s'i kishte parë me dhjeta vite, pasi, përkundër tentimeve, atij i që ndaluar dalja jashtë Jugosllavisë), ky pasi e

bekon djalin, me të cilin ishin bashkë, që t = i bashkohet UÇK-së, duke i hyrë rrezikut kthehet në Prishtinë, ku ka dhënë ndihmesën e vet në mënyrë të ndryshme deri në çastin kur çlirimtarët i priti dhe përshëndeti me ndonjë libër të tij, por edhe me një material modest byroteknik, i cili përbëhet nga disa artikujve, trajtesave e vështrimeve të hotuara) ka të përgatitur për shtyp disa vëllime, ndër të cilat edhe disertacionin e magjistraturës si dhe atë të doktoratës. Gjithnjë qëndron në pritje të sponsorizuesve eventualë vullnetmirë.

II. Nuhiu është marrë me shkrime që në bankat e shkollës së mesme, po për arsye, që tashmë dihen, edhe për shkak të përmbajtjes, s=ka mundur të botojë të gjitha dorëshkrimet. Përveç prozë e poezi në revista e gazeta të ndryshme publikoi edhe punime shkencore nga fusha e gjuhësisë. Deri tashmi botoi këto vepra:

### 1. Nga fusha e letërsisë:

1. Miklime (vjersha për fëmijë), *Rilindja*, Prishtinë 1967), (ribotim) 1997;
2. Rrezet e ylbera (vjersha për fëmijë), *Rilindja*, Prishtinë, 1971), (ribotim) 1997;
3. Me buzëz në gaz (vjersha për fëmijë), *Iliriku*, Prishtinë 1997;
4. Fletë ditari rreth një motmotari (vjersha), *Iliriku*, Prishtinë 1997;
5. Trimoshi (tregime për fëmijë dhe të rinj), *Iliriku*, Prishtinë 1997;
6. Cace e hope djaloshare (poezi), *Iliriku*, Prishtinë 1997;
7. Shkrime nëpër mjegullnajë (refleksje poetike e mendimore), *Iliriku*, Prishtinë 1997;
8. Mësimë nëpër pësime (shfaqje teatrore), *Iliriku*, Prishtinë 1998
9. Gërricje në damarët e djalërisë (tregime), *Rozafa*, Prishtinë 1998;
10. Buleza të përshenjura, (vjersha kushtuar stinës rinore), *Rilindja*, Prishtinë 2000;
11. Ther me pupël (vjersha humoristike), *Rilindja*, Prishtinë 2000.

### 2. Nga fusha e gjuhësisë:

1. Çështje të shqipes standarde në fushë të leksikut dhe të fjalëformimit I, *Rilindja* 1997;
2. Paskajorja, çështje e shqipes standarde, Dardania sacra, Prishtinë 2000;
3. Foljet më -O - në gjuhën shqipe, Dardania sacra, Prishtinë 2002,
4. Paskajorja dhe standardizimi i gjuhës shqipe, Prishtinë, 2006.

Pritet që nga penda e këtyj autori mjaft të frytshëm të shohin dritën e shtypit edhe vepra të tjera në dorëshkrim, gofite nga fusha letrare-artistike, gofite, sidomos, nga ajo shkencore-gjuhësore, ngase (përveç mbi 100 artikujve, trajtesave e vështrimeve të hotuara) ka të përgatitur për shtyp disa vëllime, ndër të cilat edhe disertacionin e magjistraturës si dhe atë të doktoratës. Gjithnjë qëndron në pritje të sponsorizuesve eventualë vullnetmirë.

Prishtinë, mars 2006

## PASKAJORJA NË FOKUS RRUGËZGJIDHJEJE APO? (në vend të parathënies)

Në kumtesën e publikuar me rastin e themelimit të *Komisionit për çështje të shqipes standarde të ASHAK-ut*, më 26.06.2004 (Prishtinë), ndër të tjera në një pikë të veçantë të saj, thuhet se “*në procesin e evolucionit të gjuhës standarde është reale të pritet që ndonjë element i varietetit gegë të silltet gradualisht në nivel të normës, nëpërmjet përdorimit në funksion të një varianti të lirë*”, dhe për t’u kuptuar që kemi të bëjmë, në radhë të parë ose ekskluzivisht, me *paskajoren me + pjesore të gjuhës shqipe* mbi bazë të gegërishtes letrare, që ka mbetur ende si dallimi më i madh ndërmjet shqipes standarde, në njërën anë dhe të gegërishtes, në anën tjetër, del e nevojshme, domosdo të njihen lexuesit e të interesuarit me referimet dhe diskutimet që iu bënë kësaj forme në Konferencën shkencore *Shqipja standarde dhe shoqëria shqiptare sot*, mbajtur në Tiranë, më 11-12 nëntor 2002, me rastin e 30 vjetorit të Kongresit të Drejtshkrimit (1972). Mbasi nuk dihet se kjo sekuençë teksti, e nënkuptuar si “tezë punc” ose si një pikë e programit orientues e synues e Komisionit të Prishtinës, siç pritej, u bë, apo jo, pjesë integrale e programit të Këshillit Ndërkadamik për Gjuhën Shqipe, themeluar në Tiranë, më 27.10.2004, apo ende do të vazhdohet me debate të stërzgjatura pa zgjidhje konkrete të çështjes në fjalë, duke mos lejuar “*me u prekë*” në normën e tashme të shqipes letrare as “*eksperimenti laboratorik*” lidhur me “*përjashtimin e infinitivit(!)*”, siç thuhet në revistën ARS (maj '05, botimi i Tiranës), sepse në kumtesën e atij Këshilli nuk jepet qartë një konstrukt i tillë, ne, në këtë vështrim, meqenëse jemi, si me thënë, sadokudo, në rrjedhë të kësaj teme të hapur problemore, po gjejmë shkas, që në një farë mënyre, të njohim masën e gjerë intelektuale e në veçanti të interesuarit rreth kësaj çështjeje, e cila ka kohë që ndodhet në proces diskutimi, por që doli në fokus, sidomos në atë Konferencë.

Ç’është e vërteta, ne, duke mos qenë vëzhgues pasiv rreth problemit në fjalë, i përkasim atij grupi të gjuhëtarëve dhe intelektualëve, të cilët ndjejnë ose në



një farë dore e kanë të perceptuar mungesën e paskajores si një mangësi strukturore të standartit të sotëm, siç e thekson me vend studiuesi A. Vehbiu (Shih: Java, 1.07.'05, f. 18), ngase me shkrimet a me reagimet tona të mëparshme, kemi kërkuar inkuadrimin sa më parë të paskajores me + pjesore, si një rast të veçantë, në normën standarde, me bindjen që e kishim atëherë, që e kemi edhe sot, se kjo alternativë është më e urtë dhe më frytdhënëse se çdo zgjidhje tjetër. Një veprim i tillë, pra, do të ndihmonte jashtëzakonisht shumë për mbarëvajtjen e shqipes standarde, tash dhe në të ardhmen. Qëndrimin tonë rreth kësaj çështjeje e patëm cekur së pari në Konferencën shkencore *Shqipja standarde dhe bota shqiptare* (Tiranë, nëntor 1992), pastaj, lidhur me të, mendimin tonë e patëm shprehur në një pikë të veçantë në kuadër të punimit *Përsosja e shqipes standarde faktor integrues në jetën tonë kombëtare*, të botuar së pari në revistën *Koha të Prishtinës* (1996), por që e pa dritën e shtypit edhe gjetë si në një përmbledhje të ASHAK-ut (*Letërsia shqipe dhe gjuha letrare* 1998 f. 277 - 286), por edhe në librin tonë *Çështje të shqipes standarde në fushë të leksikut dhe të fjalëformimit I* (1997), ku përfundonim se "me përsosjen e normës së shqipes letrare dhe me përplotësimin e formave të caktuara të bazës së saj, të të gjitha niveleve, siç është edhe paskajorja me + pjesore, njëzimi i shqipes standarde do të jetë ndëgjegjësisht edhe më i pranueshëm, politikisht më i përfaqësueshëm e kombëtarisht edhe më i integrueshëm, shprehje kjo, e cila, me qëllim, do të përsëritet, nga fundi, në dy-tri raste edhe në këtë punim. Ndërkohë arsyetim më të gjerë pikërisht rreth nevojës për rehabilitimin e kësaj forme e patëm dhënë në punimin tonë: *Paskajorja - çështje e shqipes standarde* (2000), ku përfundonim me bindjen se *me një veprim të tillë, d.m.th., me integrimin e paskajores me + pjesore, gjuha standarde kombëtare e njësar do të pasurohet, do të fitonte shumë ... , kërkesë kjo, që nuk mbeti pa jehonë pozitive në qarqe të caktuara. Veç kësaj, këtë temë e patëm rieczur edhe në paraqitje të tjera, ndër të cilat po e dallojmë këtu pikën 7 të trajtesës "Përpunimi i normës letrare kusht për kristalizimin e mëtejshëm të shqipes standarde kombëtare", të cilën do ta riprodhojmë në Hyrje të këtij punimi. Edhe punimi në fjalë që botuar në disa burime, si me thënë, me një frymë, si: të gazeta *Rilindja* ('01), *Dardania sacra* '01, *Seminari*.20/'01, *Studime* (ASHAK 2002), dhe si rrjedhojë e krejt kësaj paraqitjeje, siç është thënë nga njerëz kompetentë, doli se edhe faktet e ndjeshme, që çështja e paskajores me + pjesore të risillej domosdo në tryezën e diskutimeve serioze, siç ishte edhe *Konferenca shkencore e sipërcekur*. Ne,*

në atë pikë të punimit, si dhe në punimet e tjera nga standardologët kompetentë normëvënës të gjuhës shqipe shprehimisht, veç tjerash, patëm kërkuar që t'i mundësohej përdorimi a konkurrimi i lirë kësaj forme, brenda normës së shqipes letrare. Mirëpo, meqenëse çështja e paskajores ende nuk është hequr nga tryeza e diskutimit ose ende nuk është rekomanduar zgjidhja e plotë e saj me shkrim, ne, edhe në këtë punim tonin që e titulluam *Paskajorja dhe standardizimi i gjuhës shqipe* i rikthehemi po kësaj teme. Edhe ky punim është, në të vërtetë, vazhdim i mendimeve dhe i kërkesave tona të shprehura në punimet e mëparshme, sidomos në ato të sipërcekurat. Të vihet re se këtu, në këtë paraqitje tonën, me qëllim për të arritur efekt më të madh, jo vetëm nëntitullin në *vend të parathënies: Paskajorja në fokus rrugëzgjidhjeje apo?*, që e vumë me pikëpyetje, por me pikëpyetje i kemi vënë edhe 10 titujt e krerëve gjegjësis që përmban ky punim:

1. A shihet ndonjë ndryshim qëndrimi rreth integritit të paskajores me + pjesore në shqipen standarde?
  2. A ka fakte që e vënë në dyshim zëvendësimin e plotë të nocionit të paskajores së shqipes me lidhore dhe me paskajoren e dytë?
  3. A ka kundërthënie serioze ndaj realitetit në raportin e propozim-zëvendësimit të paskajores së mirëfilltë me paskajoren e dytë?
  4. A është e drejtë që shprehet me vlerë me paskajoren me **me** të jenë të rekomandueshme vetëm për gëgërishtin, por jo edhe për shqipen standarde?
  5. A ka arsye të heshtet edhe më funksioni përfaqësues i formës së paskajores me + pjesore të shkurtër?
  6. Në cilët tipa të foljeve pjesorja e shkurtër (edhe si gjymtyrë e paskajores) dhe në cilët ajo e letrarëzuara kanë më tepër përparësi për formimin e emrave të vepruesit?
  7. A priret evolutivisht shkurtimi i pjesores së letrarishtes në raport me shtytësit përkatës të një veprimi të tillë?
  8. Cilat janë disa nga veçoritë karakteristike të paskajores së mirëfilltë në gjuhën shqipe?
  9. A është pjesorja e shkurtër një siçelës magjik potencial, veç tjerash, edhe për zgjidhjen e paskajores me **me**?
  10. Del, apo jo, i pakuptimshëm injorimi dhe sakrificimi i mëtejshëm i paskajores nga ndonjë vetëmohues gëgërishtfolës?
- Siç po shihet, nga formulimi i temës si dhe i titujve të krerëve përkatës, nënkuptohet, se çështja e paskajores me + pjesore mund të thuhet se është edhe afor edhe paksa larg zgjidhjes përfundimtare institucionalisht. Si duket, ende

ka pengesa, jo nga pikëpamja teorike e praktike, sa nga mendimet, mbase taktike ose vërtet mbeturinore (!) të ndonjë gjuhëtari a politikani në vende kyçe. Sidoqoftë, kjo çështje nuk e ka gjetur ende përligjijen e duhur institucionalisht, ndonëse nuk duket se ka të ngecur në rrugë pa krye, prandaj në këtë kontekst, siç e cekëm, del edhe synimi i punimit tonë, që me anë të përgjigjeve në pyetjet e sipërshtuara, t'i jepet shtysë e duhur zgjidhjes përfundimtare kësaj çështjeje madhore për gjuhën letrare shqipe, zgjidhje e nevojshme kjo për mbarëvajtjen e mëtejshme të normës së shqipes standarde të njësuar.

Sido që të jetë, shpresojmë se edhe ky reagim yni do të mirëkuptohet edhe nga standardologët e gjuhës sonë, të cilët në shqyrtimet e tyre temën rreth përfshirjes së paskajores me + pjesore në normën e shqipes standarde s' po mund ta heqin ende nga rendi i ditës. Ky punim yni, kurrsesi s' bën të cilësohet si një pamflet a si brinin qëllimkeq ndaj standardit të sotëm të selitur mbi bazë të vendimeve të Kongresit të Drejtshkrimit 1972, por duhet kuptuar si një vërejtje-kërkesë e ligjshme për konsolidimin dhe përsosjen e asaj norme edhe me lëndë të re ose të lënë nën hije atëherë, siç është paskajorja e mirëfilltë e gjuhës sonë. Në këtë mënyrë, ne kemi bindjen se norma e standardit të sotëm dhe të nesërëm do të jetë edhe më e kompletuar, ngase duke përfshirë në gjirin e vet të gjitha vlerat relevante të dialekteve kryesore kjo normë, vërtet, do ta meritonte emërtimin: *Drejtshkrimi i shqipes standarde*.

Duke kërkuar ndjesë e mirëkuptim, qoftë për ndonjë lëshim, qoftë për ndonjë qëndrim të guximshëm ose për ndonjë përsëritje jo të domosdoshme, ngase për hir të aktualitetit dorëshkrimin nuk e kemi lënë *me fjetë* sa duhet, kemi një lutje-porosi për lexuesit e nderuar, që, nëse duan me pasë një pasqyrim më të plotë rreth çështjes që po trajtohet këtu, patjetër, paraprakisht, ndërkohë ose më pastaj, ta lexojnë (konsultojnë) librin *Paskajorja çështje e shqipe standarde* (Prishtinë 2000) si edhe punimet e tjera tona që rrahin këtë temë, ngase ky punim që paraqitet para lexuesve tani, në të vërtetë, mund të konsiderohet si vazhdim a përforcim i argumenteve që janë trajtuar më përpara në ato punime prej nesh, por edhe nga të tjerët. Do të dëshironim, siç kemi bindjen, që, në të ardhmen e afërt, përpjekja jonë rreth kësaj teme, të mbetet në hije të kontributeve që presim t'i japin specialistët e fushave të caktuara të gjuhësisë sonë, ngase do ta kenë këtë rrugëzgjidhje më të rrahur dhe më të trasuar për ta ndriçuar dhe shpënë më tej dhe së këtejmi edhe më të lehtë se që e kishim ne edhe për ta shprehur. Nuk është fjala, tanimë, vetëm për ta riinkuadrur në normën standarde *paskajoren me + pjesore*, por edhe për ta

përcjellë e vëzhguar më tej jetën e saj normale në kuadër të shqipes standarde. ku me meritë besojmë se do ta ketë vendin që i përket.

Fundi i fundit, nëse me paraqitjet e mëparshme kemi arritur ta japim ndihmesën tonë që paskajorja të fitojë të drejtën me u përdorë si variant i lirë. siç u theksua në Konferencën në fjalë, me këtë vështrim-kërkesë tonën synojmë që ai status i së drejtës së përdorimit të lirë, së paku, të sforcohet me një konkluzion me shkrim institucional, i cili ende mungon, andaj përkrahim mendimin e prof. Emil Lafes dhe të prof. Enver Hysës, të cilët janë shprehur që **paskajores** është e udhës t'i kushtohet një simpozium a tubim i veçantë shkencor dhe kështu ky problem të zgjidhet, njëherë e përgjithmonë, si duhet.

Për botimin e këtij libri dhe cilësinë e tij përmbajtësore falënderoj në mënyrë të veçantë prof. dr. Abdullah Zymerin, ortologun veteran të njohur Mehmet Gjevorin dhe prof. dr. Fadil Rakën, të cilët më dhanë kurajo për ta përfunduar dhe botuar këtë punim.

Prishtinë, shkurt 2006

Autori

## Hyrje

Ka kohë që po flitet e po shkruhet, diku-diku, në mënyrë alarmante, se pas demokratizimit të shoqërisë shqiptare përgjithësisht në dhjetëvjetëshat e fundit, gjuha shqipe është në krizë. Ne, do të thoshim se gjuha në përgjithësi nuk është aq në krizë sa kanë rënë në krizë disa gjuhëtarë të caktuar me ndikim, të cilët, vërtet, gjuhën letrare e konsiderojnë në krizë, edhe për gjëra që nuk duhet, ngase normën e saj ende po e shohin si një dogmë dhe po vonohem a nuk po përpiqen, mjaftueshëm, për përmirësimin, këndelljen e përsosjen e saj, në përputhje me kushtet e rrethanat e reja të krijuara në këtë periudhë në hapësirën mbarekombëtare dhe përgjithësisht edhe në atë ndërkombëtare. Nuk po përpiqen, pra, sa duhet, për **t'ia rinuar** cilësisht tri shtyllat themelore standardit të saj, siç janë: **drejtshkrimi, gramatika dhe fjalori normativ**. Kur themi kështu, kemi parasysh jo trysinë që po i bëhet shqipes nga gjuhët e huaja, madje as nga mosgjeturia a lajthitjet e shkaktuara nga kuadrot e caktuara me kulturë gjuhësore jo të dëshirueshme, të punësuar, qoftë në masmedia e vende kyçe të administratës publike, qoftë në institucione të caktuara profesionale, por për kritikën që po i bëhen shqipes letrare pse në këtë fazë ecjeje, duke u shfrytëzuar një klimë paksa më të lirë, më liberale, në krahasim me disa dhjetëvjetësha të kaluar, në raste të caktuara, po i rikthehen në përdorim disa trajta të gegërishtes, të cilësuar ende pa arsye madhore, si shkelje të normës letrare. Me fjalë të tjera, po thuhet nga ndonjë gjuhëtar se norma e sotme gjuhës letrare shqipe është zhytur në krizë të thellë shqetësuese, vetëm pse kanë filluar të ridalin në përdorim, veç tjerash, edhe shkrime e forma të caktuara të dialektit të gegërishtes, siç është konkretisht edhe paskajorja e mirëfilltë *me + pjesore*(!).

Është e vërtetë se tani, në kuadër të kodit të gjuhës shqipe mbarekombëtare, në tërësi, po del më sheshazi në sprovë norma në fuqi e *gjuhës së sotme letrare shqipe* e kanalizuar me dhjeta vjet më përpara, por e kodifikuar në bazë të vendimeve të Kongresit të Drejtshkrimit (1972). Gjithsesi të mirat që ka sjellë ai njësim norme s'mund të mohohen, por në këtë kontekst nuk mund të mohohet a të mos vihet në dukje edhe ndonjë lëshim që, tani, gjithsesi, del



gjithnjë e më i tejdukshëm dhe kërkon rishikim. Këtu kemi parasysh, pra, edhe mungesën e *paskajores shqipe me + pjesore*, e cila ende ka mbetur jashtë standardit, jo për fajin se i munguaka gjuhës shqipe, por për mospërfilljen e saj nga disa qarqe politikogjuhësore normëvënëse, me ndikim, të asaj periudhe, me gjuhëtarët në krye, por që ende gjëllojnë me koncepte, se kinse një formë e tillë nuk iu dashka letrarishtes së sotme(!), me arsyetimin jo bindës, vetëm pse, sipas tyre, kjo formë i munguaka një dialekti, toskërishtes(!). Aq më me për habi del fakti, kur ndonjëri prej tyre edhe tani mekanikisht e mbron një qëndrim të tillë jo me argumente, por me hiperformalitete se gjoja nuk bëka assesi të preken temat tabu, siç është edhe *norma e shqipes së sotme letrare kombëtare e sanksionuar në Kongresin e Drejtshkrimit (1972)*. Si duket, personat e tillë nuk janë bindur ende plotësisht në koncept-parim, se *shqipe standarde mbarëkombëtare me normë të qëndrueshme*, nuk ka as nuk mund të ketë, pa u marrë parasysh ose pa u bërë inkuadrimi në standard i të gjitha vlerave kryesore të dialekteve të shqipes, siç është edhe *paskajoria me + pjesore*, e cila i plotëson, madje edhe i tejkalon kriteret për t'u futur në normë. Nuk është fjala vetëm për kriterin e përfaqësimit të dialektit më të përhapur gegë, por edhe për vlera të tjera shumëdimensionale si përfaqësuese e denjë me mandat realisht të fituar sinkronikisht e diakronikisht në kuadër të sistemit foljor të gjuhës shqipe.

Gëzon fakti se kjo formë, është fjala për *paskajoren me + pjesore*, e cila, edhe pse ende nën hije, qëndronte paksa si çështje e hapur edhe më përpara, tani, doli në fokus a në qendër të vëmendjes, më mirë se asnjëherë më parë, në Konferencën shkencore "Shqipja standarde dhe shoqëria shqiptare sot" që u organizua në Tiranë, më 11-12 nëntor 2002, me rastin 30 vjetorit të Kongresit të Drejtshkrimit (1972), ngase, me të vërtetë, ky problem i pajzgjidhur imponohet domos së herë që merret në shyrtrim mbarëvajtja e normës së shqipes standarde.

Në këtë kontekst, shikuar me tërë ndërlikueshmërinë që e shoqëron, paskajoria ka qenë objekt diskutimi nga gjuhëtarët e intelektualët tanë edhe më parë, siç u tha, por jo, me sa dimë, në përmasat e sotme, siç ndodhi, pra, në Konferencën shkencore të lartpërmendur, ku u prek, qoftë drejtpërdrejt qoftë tërthorazi nga afro 20 gjuhëtarë tanë më në zë dhe ku rrodhën edhe ide të reja rreth zgjidhjes së problemit në fjalë. Megjithatë rreth zgjidhjes përfundimtare të këtij problemi gjuhëtarët tanë, si duket, ende nuk janë të një mendjeje. Pa vënë kufi të prerë, mund të dallohen aktualisht pesë opinione ose pesë grupime gjuhëtarësh dhe intelektualësh, të cilët, lidhur me zgjidhjen përfundimtare të kësaj çështjeje, sot për sot, mund të thuhet se kanë pikëpamje të ndryshme, duke u nisur nga ato më të kundërtat deri tek ato më të përafërtat.

Grupin e parë e përbëjnë disa gjuhëtarë dikur uniformë, tash, gjithnjë më të pak të në numër, të cilët ende e mbrojnë qëndrimin se paskajoria me + pjesore, si formë e panevojshme dialektore (gege) duhet zhdukur nga përdorimi jo vetëm në shqipen letrare, por në gjuhën shqipe përgjithësisht, deri edhe në sferën letraro-artistike etj. Gjuhëtarët e këtij grupi kishin mendimin, siç mund ta kenë edhe sot, se nocionet e saj plotësohen tërësisht nga lidhorja(!), prandaj edhe nëse ndeshet ndonjë gjë me vlerë në shprehjet e caktuara me këtë element, ta quajmë, të fosilizuuar(!), ajo shprehje me vlerë, sipas tyre, mund të *konvertohet* a të përshtatet, edhe dosido, në normën letrare në fuqi, por jo të përdoret si e tillë me paskajore në standard. Pra, kërkohet atëherë dhe dëshirohet edhe sot, sipas këtij grupi, që paskajoria gege të shpallet, si me thënë, e paqenë për standardin. Shtrohet pyetja, sa mund të themi se një qëndrim i tillë ishte veprim *alla partizançe*, le të vlerësohet. Por është e vërtetë se gjykimi i tillë dilte shumë i fuqizuar me dekada dhe shoqërohej me një propagandë mjaft të fortë, saqë, pasojat po ndihen deri edhe në ditët e sotme, ngase edhe sot disa gjuhëtarë, jo pa emër, paraqiten me qëndrime të ngulitura normëkomaduese "zhgraduese" lidhur me këtë pikë. Duke i dalë në mbrojtje të pambrojturës, kur është fjala te zëvendësimi i plotë i koncepteve të paskajores me lidhore, ata, gjuhëtarët e tillë, i bëjnë shërbim jo të mirë edhe reputacionit të vet.

Grupin e dytë e përbëjnë ata gjuhëtarë, të cilët nuk e mohojnë përdorimin e paskajores me + pjesore në dialektin e arealit verior, por mbesin në pozita mbrojtëse të normës në fuqi pa të. Gjuhëtarët e tillë edhe sot mendojnë se mënjanimi a mospërfshirja e saj në standard ishte e drejtë. Sipas tyre nocionet e paskajores, veç lidhores formalisht e realisht mbulohej edhe me të ashtuquajturën *paskajore e dytë* (tipi me për të...), andaj edhe tani nuk e shohin të nevojshme për ta përfshirë atë formë dialektore(!) në normën standarde, por nuk janë as kundër përdorimit të saj në gegërishte si nënstandard.

Grupi i tretë dallon nga i pari, si edhe nga i dyti, ngase përkrahësit e këtij grupi, pa e mohuar mundësinë e zëvendësimit të konceptit të kësaj forme *me lidhore* e me *paskajoren e dytë*, njohin edhe trajta e forma të tjera zëvendësuese. Këta, duke dalë më realistë në njohjen e vlerave faktike të paskajores së mirëfilltë, nuk janë kundër përdorimit të paskajores me + pjesore në nënfusha të caktuara semantike, pra, edhe në shkrime që ndjekin standardin, por mendojnë ende se një formë e tillë duhet të përdoret si *variant i lirë*, d.m.th., pa e përfshirë, hë për hë, në planëzimin gjuhësor, me arsyetimin, gjoja se, ajo nuk ka edhe përdorim të mjaftueshëm a shtrirje të gjerë në ligjërimin standard (!) dhe ia lënë kohës që ajo ta bëjë punën e saj. Pra, nuk janë as për përjashtimin e saj nga përdorimi, por as për futjen e menjëhershme të saj në standard.



Grupi i katërt, dallon nga i treti, ngase ky grup që karakterizohet nga "guximi bashkuar me kompetencën shkencore", siç do të thoshte prof. E. Çabej, zgjidhjen e paskajores me + pjesore e sheh në inkuadrimin e drejtpërdrejtë të saj në standard, madje, sipas tyre, sa më parë aq më mirë. Gjuhëtarët e intelektualët e këtij grupi kanë marrë guximin që praktikisht ta fusin në veprim përdorimin e formës së tillë në shkrimet e tyre që ndjekin standardin sa herë që lejon konteksti. Konkretisht, sipas tyre, paskajorja me + pjesore e shkurtër, duhet të përdoret pa ngurrim, kur tumir konteksti, në këto nënfusha semantike, siç janë: *përfaqësimi, thëniet frazeologjike, sfera letraro-artistike dhe sinonimia*, nënfusha semantike këto, të cilat, në të vërtetë janë të pakontestueshme, sipas kriterëve pragmatike, logjike, stilistike e strukturore. Pra, veprimtarët e këtij grupi, janë për futjen e menjëhershme të paskajores në standard, si rast të veçantë, d.m.th., pa e ndërlikuar domosdo me paradigmat e sistemit foljor të ish-shqipes letrare mbi bazë të gegërishtes ose të gegërishtes së sotme ligjërimore. Ky grup, për nëfushat semantike të sipërcekura, këtë formë e cilëson si fakt-provë me elemente të domosdosë edhe për standardin, prandaj, sipas tyre, s'ka logjikë të quhet ende kjo formë si një element dialektor dhe të mbetet i anashkalluar edhe më tutje, sepse pikërisht kjo formë është shumë vepruese e prodhuese në fjalëndërtimin standard (fjalëformim, kohëformim e formëformim) dhe ndeshet e shtrirë faktikisht, në më se 3/4 a 80% e bashkësisë shqipfolëse, por që njihet dhe njihet, si me thënë, realisht, qind për qind, jo vetëm nga intelektualët, por nga të gjitha shtresat shoqërore në të gjitha trojet shqipfolëse, edhe në viset më të skajshme jugore.

Grupi i pestë i gjuhëtarëve dhe intelektualëve, zgjidhjen e çështjes së paskajores me + pjesore, duke e parë si fakt të domosdoshëm për standardin, e fusin në përdorim lirshëm, madje pa e ndarë nga sintagmat e paradigmat e sistemit foljor të gegërishtes dhe në këtë mënyrë, duke e marrë si shkas pikërisht mungesën e paskajores me + pjesore në normën e shqipes së sotme letrare, cysin, jo pa efekt, ringjalljen e normës standarde mbi bazë të ish-gegërishtes letrare, ku paskajorja, siç dihet, zinte vend kyç, madje konsiderohej, jo pa të drejtë, si një shyllë kurrizore e asaj strukture.

Sidoqoftë, në vazhde të kësaj që u tha, për të qenë paraqitja jonë më e perceptueshme dhe më në nivel shkencor, në këtë punim tonin, që e titulloam: **Paskajorja dhe standardizimi i gjuhës shqipe**, e shohim të arsyeshme që paraprakisht të riprodhojmë këtu vetëm pikën 7 nga punimi ynë i mëparshëm, me titull "Përpunimi i normës letrare kusht për kristalizimin e mëtejshëm të shqipes standarde kombëtare" (2001), që e cekëm në Parathënie të këtij

punimi, ku nga faktorët kompetentë të shqipes standarde patëm kërkuar shprehimisht:

"Të shikohet edhe çështja e (ri)integritit (rehabilitimit) të paskajores shqipe me + pjesore, në shqipen standarde si rast i veçantë, për nënfusha të caktuara semantike, në të cilat edhe është duke u përdorur, siç janë: a) përfaqësimi, b) shprehjet frazeologjike të një abstraksioni të lartë, c) sfera letraro-artistike dhe ç) sinonimia - duke shtuar se - ndonëse ka ende ndonjë paqartësi e keqkuptim tek individët e caktuar, mund të themi se gëzon fakti që kjo çështje ka rënë në dorë të qarqeve kompetente të shqipes standarde dhe ka filluar të vlerësohet gjithnjë e më drejt. Në të vërtetë, - theksonim aty - po të shikohet pragmatikisht e logjikisht përdorimi i saj për tri nënfushat e para semantike, as që del i diskutueshëm, ngase e para i takon stilit shkencor, e dyta dhe e treta stileve funksionale që lidhen edhe me tipizime, ndërsa nënpika e katërt mund të jetë e diskutueshme pjesërisht. Themi pjesërisht, sepse sipas gjuhësisë bashkëkohore konkurrenca në sinonimi nuk mund t'i mohohet asnjë realie të gjallë foljesore. Meqenëse forma e tillë është duke u përdorur dhe, siç është konstatuar, prirja e zgjerimit të saj vërehet aktualisht edhe në viset më të skajshme të arealit jugor, mbetet të jepet mendimi se cila nga trajtat e pjesores lypset parapëlqyer: trajta e ish-shqipes letrare mbi bazë të gegërishtes, e cila ka mbështetje në sistemin fjalëformues apo trajta e letrarishtes së sotme, e cila ka bazë të fortë në sistemin paradigmor të foljeve të shtjelluara dhe të pashtjelluara analitike. Ç'është e drejta, (sqaronim aty) *te foljet e tipit me marrë, me vjelë, me dhënë, më lënë, me rastin e integritit nuk paraqitet kurrfarë problemi*, ndërsa te trajtat e tjera po, si p.sh.: me matë a me matur, me mbajtë a me mbajtur, me pasë a me pasur, me derdhë a me derdhur, me bë a me bërë, me la a me larë, me ble a me blerë, me fshi a me fshirë, me fry a me fryrë, me shue a me shuar, me thye a me thyer, me pëlqye a me pëlqyer, me shkru a me shkruar, me punue a me punuar. (Duke përfunduar me bindjen) Nëse u mundësohet një konkurrencë e lirë trajtave në fjalë, kjo çështje shpejt mund të kanalizohet si duhet pa krijuar farë problemi."

Pra, sa kishim të drejtë dhe sa ishim realist në konstatimet dhe kërkesat tona, jo vetëm në shkrimin e fundit, të cilat i përkrahim forcimisht edhe tani, dhe sa

mund të konsiderohen të realizuara e të zbatueshme ato, le ta vlerësojnë lexuesit dhe të interesuarit, pasi të njihen, veç tjerash, edhe me disa nga dëshmitë që i shkëputëm kryesisht nga referimet e diskutimet e caktuara të studiuesve tanë (akademikë) më në zë, të cilët e prekën këtë çështje në veçanti, në Konferencën shkencore të sipërcekur, material ky i botuar me të njëjtin titull në Tiranë (2003) që, ne, disa prej atyre fakteve, ndonëse fragmentarisht e diku-diku të shogëruara me ndonjë parafrazim tonin, do t'i citojmë në vazhdim, në titujt përkatës (sipas krerëve të këtij punim), duke u përpjekur me dhënë përgjigje për këto çështje:

1) A shihet ndonjë ndryshim qëndrimi i faktorëve të caktuar normëvënës rreth integritit të kësaj forme në shqipen standarde?

2) A ka fakte që e vënë në dyshim zëvendësimin e plotë të nocionit të paskajores së shqipes me lidhore dhe me paskajoren e dytë?

3) A ka kundërtënie serioze ndaj realitetit në raportin e propozim-zëvendësimit të paskajores së mirëfilltë me paskajoren e dytë?

4) A është e drejtë që shprehjet me vlerë me formën e paskajores me **me**, të jenë të rekomandueshme vetëm për *gegërishten*, por jo edhe për shqipen standarde?

5) A ka arsye të heshtet edhe më, pa të drejtë, funksioni përfaqësues i paskajores me + pjesore të shkurtër?

6) Në cilët tipa të foljeve paskajorja me + pjesore e shkurtër (edhe si gjymtyrë e paskajores) dhe në cilët ajo e letrarëzuara kanë më tepër përparësi për formimin e emrave të vepruesit?

7) A priret evolucionisht shkurtimi i pjesores së letrarishtes në raport me shtytesit përkatës të një veprimi të tillë?

8) Cilat janë disa nga veçoritë specifike të paskajores së mirëfilltë në gjuhën shqipe?

9) A është pjesorja e shkurtër një *sicelës magjik potencial*, veç tjerash, edhe për zgjidhjen e paskajores me **me**?

10) Del, apo jo, i pakuptimshëm injorimi dhe sakrificimi i mëtejshëm i paskajores nga ndonjë vetëmohues gegërishtfolës?

Kemi bindjen se, pa dyshim, përpjekja e përgëndrimi ynë në përgjigjen e çështjeve të lartpërmendura gjatë analizës së këtij punimi, do të ndihmojë jo vetëm në njohjen më të mirë e të plotë të problemit të diskutueshëm rreth paskajores me + pjesore, por do të shërbejë edhe një sishytsë e mirë për zgjidhjen përfundimtare me inkuadrim dhe pa zvarritje të kësaj forme në shqipen standarde.

I

## A SHIHET NDONJË NDRYSHIM QËNDRIMI RRETH INTEGRIMIT TË PASKAJORES ME + PJSORE NË SHQIPEN STANDARDE?

Është krejt e pritshme dhe e logjikshme që në kohë dhe rrethana të caktuara, në bazë të fakteve të reja, njeriu të ndryshojë a të modifikojë qëndrimin e mëparshëm rreth një çështjeje të caktuar, mirëpo a ka ndodhur kështu, apo jo, të një pjesë e gjuhëtarëve tanë me influencë, lidhur me paskajoren me + pjesore, nuk është lehtë të konstatohet. Megjithatë ndryshime a modifikime qëndrimesh ka. Sidoqoftë, tema e paskajores si çështje problemore ishte e pranishme edhe më përpara, por disi doli më ballaballas se asnjëherë më parë në Konferencën shkencore në fjalë (2002), ngase tani, siç e thotë prof. Jorgo Bulo në fjalën e hapjes së Konferencës: “30 vjet (nga Kongresi i Drejtshkrimit) janë të njafuëshme edhe për të vënë gishtin në problemet e normës që ka nxjerrë praktika e përdorimit të shqipes standarde në të gjitha pikat e veprimtarisë kulturore, zyrtare e shoqërore dhe për të bërë plotësimet e saktësimet që dikton realiteti i sotëm shoqëror”. Pa mëdyshje, edhe pse nuk ceket nga referuesi, në këtë *realitet shoqëror*, si çështje e pazgjidhur drejt, kuptohet se bën pjesë edhe paskajorja e gjuhës shqipe e mënjauar nga norma letrare më përpara, por mbeti e papërfillur edhe në atë Kongres dhe pas tij. Në të vërtetë, atëherë, në atë tubim, gjithsesi historik, në pyetjen e prof. J. Ferrarit (Shih: *Kongresi i drejtshkrimit*, f. 156): “Për mënyrën paskajore (...), pse nuk ruhen të dyja format me + (pjesore) e për të + (pjesore)? - nuk u dha kurrfarë përgjigjeje, por nga Ylli Resuli, vetëm sa u zu në gojë, kalimthi se paskajorja si njëra nga karakteristikat e përgjithshme të gegërishtes, siç thotë ai, “nuk do të përmendet” (Aty f. 579), gjë që jep për t’u kuptuar se kjo formë, si njëra nga karakteristikat e përgjithshme të gegërishtes dhe vetë gegërishtja letrare tashmë kishte kohë që ishte e injoruar, ndërsa Jorgji Gjinari, me noftim-arsyetimin e tij, po në atë tubim, bën me dije, se “në sistemin morfologjik të gjuhës letrare nuk ka hyrë trajta e paskajores së dialektit verior, por dihet se lidhorja është



një trajtë që ekziston në të dy dialektet - duke shtuar të vërtetën: "edhe pse jo me një masë të njëjtë përdorimi" (Aty, f. 151). Me fjalë të tjera, çështja e paskajores në atë Kongres nuk u trajtua si duhet, ndërsa tani pas 30 e sa vjetësh në këtë Konferencë (2002), paskajorja rikthehet në fokus të interesimit të afro 20 gjuhëtarëve, qoftë drejtpërdrejt, qoftë tërthorazi. Tani jo vetëm nuk përsëriten konstatimet si ai i A. Dodit se "në morfologji **zhdukja** e paskajores dhe zëvendësimi i saj me lidhoren nuk tregon varfërimin e gjuhës (Shih "Studime 4 '97 të ASHAK-ut, f. 72), por as gjykimi i Sh. Demirajt se "Shqipja standarde (kryesisht me anë të trajtave të lidhores) ka mundësi të shprehë fare natyrshtë më gjitha funksionet sintaksore karakteristike për paskajoren", nuk del më i pranueshëm pa ndonjë rezervë, ngase tani aspekti gjithpërfshirës në normë i të gjitha vlerave të të dy dialekteve që ka gjuha shqipe mbarëkombëtare si tërësi, me të gjitha nuancat kuptimore e stilistike, intuitivisht del në plan të parë si koncept jo i anashkaluar, jo i mbyllur, por del i hapur dhe rrah pak më me forcë sesa rrihte 30 e sa vjet përpara. Pikërisht kjo është arsyeja që ndoshta edhe prof. Sh. Demiraj të nënvizojë, me vend dhe më lirshëm, se jo vetëm nuk është "që të ndalohet **krejt** përdorimi i paskajores së tipit **me punue** ...", por është edhe për diçka më tepër, d.m.th., paskajorja duhet të jetë e lirë të përdoret, si në familje, ashtu edhe në letërsinë artistike etj., dhe njëherazi duhet t'i kushtohet më shumë vend edhe në gramatikat shkencore. Si duket, edhe ky tani pajtohet a shprehet më lirshëm që t'i kushtohet kësaj forme më shumë vëmendje dhe t'i jepet më shumë vend, jo vetëm në shkencë, por në ligjërim masiv etj., duke shtuar **sisloganin**: **Pastaj vetë koha le ta tregojë nëse një formë e tillë do të jetë e nevojshme të përfshihet në shqipen standarde**. Me fjalë të tjera, edhe ky, pasi e di se "i vetmi ndryshim i rëndësishëm midis dy dialekteve **tona në rrafshin gramatikor është mungesa e paskajores perifrastike e tipit **me punue** në dialektin jugor**", duhet të zgjidhet, duke ia lënë fjalën kohës në të ardhmen, i bashkohet grupit tjetër, që mendon pak më ndryshe, të cilit, siç do të shohim, i prin prof. Emil Lafe.

Në të vërtetë, prof. E. Lafe, në referimin e vet nuk e mohon qëndrimin e tij të mëparshëm "që në strukturën gramatikore të shqipes standarde të integrohet shkallë-shkallë paskajorja me + pjesore nuk ka asgjë për t'u shqetësuar, as nga pikëpamja teorike, as nga pikëpamja praktike, subjektivisht do të përkrahja këtë dhe shfaqet e një përdorimi të tillë nuk do t'i gjykoja të qortueshme" (Seminari 19 2001 f. 296), por tani arsyetohet me shpjegimin për **prolongim**, si të themi, me një stil paksa diplomatiko-skofiaresk se "integrimi i tillë menjëherë nuk mund të bëhet, sepse paskajorja me + pjesore ende nuk ka

24

përdorim të mjaftueshëm në strukturën e shqipes standarde, por, ndërkohë, mund të bëhet, nëse nga ligjërimi standard imponohet një formë e tillë," sepse siç qe shprehur edhe më përpara "gramatikanët nuk mund t'i imponojnë ose t'i shartojnë gjuhës elemente strukturore, **edhe kur këto mendohet se janë të nevojshme(!)**. Ata vetëm e përshkruajnë dhe e mbarështojnë brumin gramatikor të gjuhës, por këtë brumë e mbrun përdorimi, jo gramatikanët" (Shih *Gjuha shqipe* 1-2 2001 f. 23), megjithatë, ky ka mendimin se më e lehtëpranueshme për normën e sotme do të ishte trajta me + pjesore e **toskëzuar**. Po i këtij mendimi është edhe prof. E. Hysa, i cili, si të thuash, siguron se paskajoren do ta inkuadrojë përdorimi dhe gjuhëtarët do ta bëjnë pastaj kodifikimin. Prof. Seit Mansaku, në paraqitjen e tij është edhe më i qartë dhe i prerë. Ai, veç tjerash, konstaton: "Sidoqoftë, mendoj se tani për tani çështja e paskajores nuk mund të jetë një problem i planifikimit gjuhësor, as për ta nxitur, as për ta penguar përdorimin e saj. Le t'ia lëmë kohës ta bëjë punën e saj. Ndërtimet me paskajore ushtrojnë ndikimin e tyre mbi ndërtimet analoge të standardit jo vetëm përmes kontaktesh me variantin verior brenda shqipes, por edhe përmes kontaktesh me gjuhë të tjera që e kanë formën e paskajores, si frëngjishtja, italishtja etj. Do të thojë se shtrirja e standardit dhe kufizimi në përdorim i varianteve të tjera jostandarde, mund të vijnë në mënyrë të natyrshme jo aq me politika të caktuara kufizuese ndaj këtyre të fundit, por me politika praktike që rrisin prestigjin kulturor të gjuhës standarde nëpërmjet gjerimit e pasurimit të saj, duke u lëvruar nga mjeshtrit e fjalës, nëpërmjet forcimit të shkollës dhe të ngritjes së kulturës gjuhësore qytetare dhe të rritjes së kujdesit të shoqërisë për zbatimin e normave të gjuhës standarde" (Aty f. 117).

Disi më gjerësisht dhe më realisht se tek të tjerët çështja e paskajores shtrohet në referimin e prof. R. Ismajlit. Ky, duke e pasur në koncept se "zgjidhja e paskajores përbën pikën më kontestuese" në raportin *gegërishte / shqipe standarde*", tani, veç tjerash sqaron: "Megenëse kjo paskajore në letërsinë e shkruar gegërisht me sintaksën e saj komplekse, është përdorur shumë shpesh për të shprehur ndërtime abstrakte dhe megenëse në gjuhët e tjera i përgjigjet një paskajoreje, ajo është bërë njëfarë dore simbol i lëvrimit dhe i plotnisë së variantit standard gegë". Ky referues inkuadrin e saj në standard, si tipar të rëndësishëm të shqipes, e sheh të mundshëm: "në atë mënyrë, që në tipa të caktuar ndërtimesh sintaksore, të lejohet kombinimi infinitival i tipit me me:

a) duke ruajtur të plotë formën e pjesores geqe vetëm në ato funksione, ndërsa të mbiemrat formën aktuale të standardit;

b) duke kërkuar rrugë të tjera përmes formave të ndërmjetme të pjesores së shkurtër (si ardhë), por prapë me forma aktuale të mbiemrave;

c) duke ruajtur trajtën me prejardhje toske të pjesores, për të krijuar kështu paralelizëm të plotë me privativin;

ç) është e mundshme edhe zgjidhja përmes lejimit të variacionit vetëm në tipe sintaksore infinitivale, për ata që e ndiejnë nevojën për të”.

Në vazhdim prof. R. Ismajli thekson se “sado që tashmë kemi krijuar një shprehje dhe një imazh për format e shqipes standarde pa paskajoren me me (...), nuk është e pamundshme të kërkojmë kombinime dhe zgjidhje të dobishme, qoftë edhe vetëm për t’i mbyllur burimet e pakënaqësive dhe të ankesave. Parimi i kompromisit dhe i kombinimit të elementeve të ndryshme strukturore me burim nga dy variantet e mëparshme letrare në shqipen standarde (...), tashmë ekzistojnë dhe kombinimet e tilla jo vetëm që nuk kanë shkaktuar vështirësi, po, përkundrazi, e kanë begatuar standardin - dhe përfundon-. Nëse kemi vullnet të mirë për këtë, mund të gjenden edhe rrugë. Mendoj se në këtë mënyrë shqipja standarde vetëm i zgjeron hapësirat dhe mundësitë sintaksore e stilistike”.

Në përkrahje të mendimeve të prof. R. Ismajlit shkon edhe diskutimi i prof. B. Bokshit, i cili shprehet se “A do të vendoset infinitivi i gëgërshites në standard, si çështje, nuk duhet konsideruar si kthim mbrrapa. Ashtu, si edhe u tha, ajo duhet konsideruar si diçka që mund të vijë, si diçka që mund të imponohet nga varianti i folur, nga varianti gëgë. Por mendoj se pengesa për t’u pranuar në normë e për t’u përgjithësuar përdorimi i infinitivit me me, është në planin e shenjave e jo të përmbajtjes, jo të funksioneve. Nuk pajtohem me mendimin që u tha këtu (mbase nga Demiraj, Çeliku N.V.) se e pengon sintaksa dhe na dalin përsëri funksionesh. Ne e dimë sa funksional është infinitivi i me në pa. Kjo është një shprehje e pashkëputshme nga gëgërshjtja dhe këtë duhet ta marrim parasysh, prandaj varianti gëgë i të folurit, varianti i folur, më duket se do të imponojë me kohë se nuk është në kundërshtim me sistemin e gjuhës, për arsye se edhe një pjesë e tokërishtes e ka të shkurtër pjesoren. Kujtoj se me shkurtimin e pjesores së krijuar me temë në bashkëtingëllore (kam timin e paskajores me me”.

Njëri nga ata që e cek indirekt këtë çështje është studiuesi i mirënjohur hungarez, albanologu, Ishtvan Shyc, i cili shprehet mjaft qartë se thesari mijavjeçar (shqipja, me të e kuptojmë edhe paskajoren si vlerë) duhet të ruhët si sytë e ballit dhe lidhur me zgjidhjen në fjalë tregon një shembull paksa analog. Në vitin 1958 A. Xhuvani i paska pasë folur për dukurinë e përfimit të emrave të tipit këpucebërës, librarshitës, që sipas tij nuk i përgjigjeshin natyrës së shqipes ndaj trajtave: bërës këpucebës, shitës librash, që ai i parapëlqente. “Këto kujtime po i përmend - thekson studiuesi - vetëm sa për të treguar forcën organike, mund të them atavike të shqipes, me të cilën ajo, pa ndërhyrje nga jashtë, i ka zgjidhur problemet e tilla në rrugën e zhvillimit të saj”.

Sidoqoftë, nga këto referime e diskutime fitohet sadopak përshtypja, pse mbizotëroi mendimi që zgjidhja më e mirë për këtë formë është që ajo të jetë e lirë në përdorim, por hëpërhë mos të jetë objekt i planifikimit konkret, ngase, si duket, ende nuk ishte arritur mirëkuptimi i duhur nga të gjithë faktorët relevantë, sepse ende kishte probleme, jo vetëm në përzgjedhjen e trajtës së pjesores së paskajores së mirëfilltë, por edhe në konceptimin e çështjes nga grupi i parë dhe i dytë, me ta del i përzier edhe ndonjë gëgërshifolës, si andej si këndej, të cilët, si me thënë, me qëndrimin e tyre konzervues me ngjyrim poltrono-servilizmi, fanatikisht e ruajnë dhe militarisht e mbrojnë normën e praktikuar në fuqi pa këtë formë. Megjithatë, prof. Tomor Osmani, mbase edhe ky tue besue në forcën atavike të gjuhës shqipe, sheh një rreze depërtese drejt zgjidhjes. Ky, veç tjerash, e vlerëson drejt qëndrimin e disa kolegëve të tij, kur thoit se “pozitiv është fakti se studiuesit kanë filluar të mendojnë për këtë formë. Sot ka forca të tilla shkencore që këtë problem ta zgjidhin, duke gjetur rrugë më të mundshme që edhe kjo të përfshihet në sistemin foljor të shqipes, si element i domosdoshëm dhe dobiprurës për vetë pasurimin e sistemit foljor të gjuhës sonë, për funksionet e shumta që mbulon ajo dhe për vetë nevojat e praktikës gjuhësore të shqipes”.

Si përfundim të këtij kreu, mund të thuhet se, edhe pse kohësisht pati vonesë të pajustificueshme, çështja e paskajores në këtë Konferencë është shtruar drejt dhe, si me thënë, jep shpresë për ecje të mbarë drejt rrugëzgjidhjes, ngase nuk mungoi diskutimi në favor të përdorimit të paskajores njëherë si varianti i lirë, e pastaj mund të jetë edhe si objekt i planëzimit normëzues. Por edhe këtu, në këtë tubim nuk u bë mjaftueshëm rreth kësaj çështjeje, sepse në fund mungoi konkluzioni institucional me shkrim së paku, lidhur me këtë përdorim “të lirë”.



Prandaj rreth zgjidhjes përfundimtare të kësaj pike, për dikë, ende *nevralgjike*(!), të normës standarde, mund të thuhet se mbesin mjaft çështje të paqarta e ngurrime të panevojshme. Nuk është fjala, vetëm rreth konkurrencës së saj me forma të tjera sinonimike, që tash për tash, normativisht, ato janë të vetme të favorizuara, por edhe rreth nënfushave semantike që mbulon ajo, rreth funksionit përfaqësues të saj, rreth konceptimit të arsyeshmërisë lidhur me inkuadrimin e kësaj formë në standard si element i dëshirueshëm, i nevojshëm ose i domosdoshëm, si dhe rreth përparësisë së trajtave të caktuara, lidhur me inkuadrimin konkret në shqipen standarde, segmente këto që do të preken, vende-vende, mjaft hollësisht në kërretë vijues të këtij punimi.

## II

## A KA FAKTE QË E VËNË NË DYSHIM ZËVENDËSIMIN E PLOTË TË NOCIONIT TË PASKAJORES SË GJUHËS SHQIPE ME LIDHORE DHE ME PASKAJOREN E DYTË?

Si argumente kryesore refuzuese rreth mosinkuadrimit të paskajores me + pjesore në normën standarde, që datojnë nga fundi i viteve '40-a të shekullit që lamë pas, por që përsëriten vazhdimisht deri tani, veçohen, pos konstatimit se një formë e tillë i mungon bazës së përzgjedhur si normë letrare (toskërishtes), edhe këto dy fakte: e para, është **lidhorja** (format e lidhores) dhe e dyta, është **paskajorja e dytë** ose togu: *për + emri i njëjshëm foljor asnjansës (tipi për të + pjesore ose për + gerundi)* dhe që të dyja këto fakte arsyetohen me përparësinë e dukshme se e zëvendësojnë atë dhe kanë shtrirje në të dy dialektet. Në të vërtetë, këto dy argumente, duke pasur *përhapje* në të dy dialektet: toskërishte e gegërishte, për çudi, ndonëse ishin *sinonime të pjesshme*, u konsideruan absolutisht të *vetëmjaftueshme dhe fuqiplota për mbulimin e paskajores së mirëfilltë*. Kështu, paskajorja me + pjesore, e cila pandehej se ishte karakteristikë vetëm e disa të folmeve të gegërishtes(!), sipas konstatimeve që mbizotëronin në këtë periudhë, 50-60 vjeçare, *grykohet* mos me u marrë fare në konsideratë në të ashtuquajturën *shqipe e sotme letrare* (të njësuar). Mirëpo, pikërisht kjo *vetëmjaftueshmëri*, jo shtrirja, nga një lagje e mirë gjuhëtarësh e intelektualësh, del e diskutueshme, madje, sipas mendimit të disave, koha tregoi se gjykimi i tillë i *vetëmjaftueshmërisë* nuk ishte fort i bazuar, ishte jo i thelluar, ishte sipërfaqësor dhe joplotësisht i saktë, madje, mund të quhet edhe jo krejtësisht i pagabueshëm(!). Kjo bindje arsyetohet me faktin se përkundër euforisë rreth përqaimit dhe propagandimit të pandërprerë institucional 50-60 vjeçar, jo vetëm për ta zëvendësuar, por edhe për ta *zhdukur* atë, *paskajorja e mirëfilltë e gjuhës shqipe*, e ashtuquajtur "gege" mbeti se mbeti aktive në arenën e konkurrencës (drejtpërdrejt ose tërthorazi) dhe tani kjo formë, siç dëshmon edhe pika e shkëputur prej nesh nga teksti i kumtesës së lartcituuar nga ASHA e Kosovës, realisht, po fiton dita-ditës terren drejt

reabilitimit të saj, njëherë për një herë, së paku si *variant i lirë* ose pjesërisht si *element i nevojshëm* për ndonjë nënfushë semantike, por pritet, që së shpejti, të bëhet edhe reabilitimi i plotë i saj.

A dihet mjaftueshëm *pse-ja* e një qëndrueshmërie të tillë të paskajores apo jo?

Pa hyrë në shkaqe jashtëgjuhësore dhe pa i përjashtuar ato, do ta zbërthejmë, paksa, këtë çështje, duke e trajtuar:

së pari, raportin *lidhore / paskajore e mirëfilltë*,

së dyti, raportin *paskajore e mirëfilltë / paskajore e dytë* (për + gerund!) dhe së treti, do t'i përmendim edhe disa meditime rreth këtyre raporteve.

### 1) Raporti lidhore / paskajore e mirëfilltë

Është e vërtetë se gegërishtja e kishte *lidhoren e mirëfilltë* si edhe toskërishtja, me kuptimet e caktuara modale, me të cilat tregohet një *veprim* *an një gjendje që dëshirohet, që mund ose duhet të kryhet a të ndodhë, pasi lidhet me një tjetër* (Shih FSHS f. 684), por gegërishtja e kishte të formëzuar plus edhe *paskajoren e mirëfilltë* edhe për kuptime të tjera, jo ekskluzivisht modale, që këtë të fundit toskërishtja pandehej se nuk i kishte, prandaj edhe duhej ta mbulonte me sforcimin plotësues të zgjerimit të fushës kuptimore të lidhores ose edhe me ndonjë formë tjetër, duke pasur për gjedhe, me gjasë, greqishten e re. Kjo është arsyeja që toskërishtja konceptin e paskajores së gegërishtes, si me thënë, edhe jashtë kuptimit modal, ia ngarkonte lidhores me dyfishim kuptimi (Shih: Rrahim Përçuku, *Konferenca shkencore*, 2002 (2003), f. 448). Po kështu ndodhi edhe kur toskërishtja, më drejt, kur shqipja zyrtare mbi bazë të saj, me disa plotësime, jo të gjitha parësore, e cila që pagëzuar si *shqipe e sotme letrare e njësuar*, pas vitit 1944, andaj qëllimi ishte që, duke ia zgjeruar kuptimin lidhores edhe me plus konceptin e paskajores, ose duke e *paskajorezuar*, ndonjë trajtë të caktuar të lidhores, si veta e dytë njëjës etj., ajo do të mbizotësohe. Po, pikërisht, këtu, mendojmë ne, e ka vendin paralajmërimi i ndërkohshëm i doajenit të gjuhësisë sonë, prof. Selman Rizës, i cili, lidhur me procesin e tillë të zëvendësimit, thekson: "*Edhe me të vërtetë paskajorja është një mënyrë foljore, si të thuash kaq e rehatshme në krahasim me lidhoren saqë mënjanimi i saj me të mirë në trajtën e lidhores është i pabesueshëm pa ndonjë nevojë shumë serioze*" (Shih. S. Riza, *Vepra* 4, f. 54). Prandaj, ç'është e vërteta, me gjithë rekomandimin zyrtar, madje edhe të pranimit dhe për-

pjesëve të vetëdijshme vetmohuese të rretheve të caktuara gegërishtfolëse. lidhorja e pajisur, pra, edhe me funksionin plotësues polisemik, ta quajmë, paksa, jo plotësisht modal të paskajores, nuk mundi me mbulue mjaftueshëm nocionin e paskajores së mirëfilltë të shumica absolute e gegërishtfolësve. Pra, jo pse nuk deshën ata (sidomos elita pjesëmarrëse në normëvënien e të tjerë), por për arsye se patën vështirësi, ngase koncepti i paskajores i shenjëzuar me formën e paskajores me *me*, si mjet i veçantë praktik ishte ravijëzuar "*rehatshëm*" aq thellë në shtratin e strukturës së vet sa që s'mund të dilte dot nga kutijat e asaj strukture të sistemit vetjak ligjërorim, të formëzuar fort, për t'ua lëshuar vendin qelizave një forme tjetër me vlerë më të dobët për ta. Kjo ndodhi, jo vetëm për shkak se çdo polisemi, siç dihet, mban në vete njëfarë homonimie, por edhe për arsye se koncepti i paskajores ishte më i gjerë dhe njëherazi, po kjo formë a mënyrë e të shprehurit, fundi i fundit, i takonte kodit të përgjithshëm sinonimik morfosintaksor të së njëjtës gjuhë kombëtare dhe ai element nuk ishte pa traditë përdorimi dhe pa vlera të forta semantike, të cilat s'mund të mbuloheshin tërësisht me lidhoren, edhe pse kjo (lidhorja) kishte prani në atë sistem ligjërorim, por që, në të vërtetë, ishte e destinuar për nënfusha të tjera, si të thuash, anësore semantike, në krahasim me konceptet e paskajores. Në të vërtetë, këto dy forma, ndryshonin nga njëra-tjetra edhe nga përmbajtja, por sidomos edhe për nga forma e jashtme. Kur themi kështu, ndër të tjera, kemi parasysh *kuptimin konkret modal të mundshmërisë etj. të lidhores e formave të saj*, ndaj kuptimit të një abstraksioni të lartë dhe përfaqësimit të paskajores, si dhe anën formale të barasvlerësve, në njërin anë, paskajoren me + pjesore si trajtë statike, ndaj formave relativisht të shumta të lidhores, në anën tjetër, të cilat ndryshojnë sipas kohëve, numrit, vetave, por edhe modifikimit.

Pra, këtu qëndron, për mendimin tonë njëra prej arsyeve të forta pse planëzimi për heqjen a zhdukjen e paskajores me zëvendësimin e saj me lidhore, mund të thuhet se doli i pazbatueshëm, për mos me thënë, doli i dështuar, në masë të gjerë.

Sido që të jetë, paskajorja mbeti si një problem i pazgjidhur, në përgjithësi, deri sot e gjithë ditën. Ajo nuk e la keq toskërishten (në kuptim të ngushtë), por e la jo mirë ose e përjashtoi tërësinë e shqipës letrare (standarde) të njësuar mbarëkombëtare, ku e ka, domosdo, hisen e vet edhe gegërishtja me paskajoren e saj karakteristike.

## 2) Raporti paskajore e dytë / paskajore e mirëfilltë

Edhe rasti i raportit *paskajore e dytë / paskajore e mirëfilltë* mund të shpjegohet po në këtë mënyrë. Edhe paskajorja e dytë, siç e argumentojnë gjuhëtarët tanë më të njohur, deri tani nuk mundi ta zëvendësonte plotësisht paskajoren e mirëfilltë në asnjë nënfushë semantike karakteristike, me gjithë favorizimin e nënkuptuar që pati dhe ka në mënyrë institucionale në këtë periudhë 40-50 vjeçare. Është e vërtetë, se kjo formë (paskajorja e dytë) shtrihet në të dy dialektet dhe jo aq për koncepte a destinime të tjera sa për koncepte qëllimore që paraprin vetë treguesi parafjalor i saj, siç është: pjesëza *për*.

Dihet e vërteta se shtrirja e saj në gegërishtë është penguar nga paskajorja normale karakteristike, por edhe në toskërishtë, siç do të shpjegohet më poshtë, përveç lidhore e kanë penguar edhe disa forma të tjera. Kështu, forma e paskajores së dytë, të cilën disa gjuhëtarë nuk e quajnë fare paskajore, po formë të pashtjelluar të një tipi të veçantë, në asnjërin dialekt nuk pati zhvillim të pavarur normal, aq më tepër si një paskajore e mirëfilltë.

## 3) Disa meditime rreth këtyre raporteve

Ja edhe disa meditime rreth veçorive të kësaj forme (paskajores së dytë), por edhe të lidhore, në ndonjë rast, në raport me paskajoren e mirëfilltë:

1. Kur kemi parasysh faktin se paskajorja e dytë supozohet se u përfutua në viset jugore, me gjasë, si shkak-pasojë ndaj ndikimit të greqishtes, e cila në atë periudhë të hershme, jo vetëm e kishte në proces e sipër zhdukjen e formës a të formave të paskajores së vet, por do të ketë ndikuar edhe në ato skaje të të gjithës fqinje në takim (në toskërishten si pjesë e shqipës). Andaj supozohet se sipaskajorja (paskajorja e dytë) e shpifur me *për të...*, tani e mbi bazë të një *emri të paranyjësuar* të tipit me *për të...*, sepse tashti në shqipë historianët e gjuhës (Besim Bokshi), edhe pse arriti të shtrihet, paksa, edhe në u zmbrops, pikërisht, nga trajta e paskajores së mirëfilltë që tashmë ishte e ngulitur fort në strukturën e shtratis të vet. Në këto rrethana paskajorja e dytë mbeti jo zëvendësuese e paskajores së mirëfilltë, po, ta quajmë kështu me

kushtëzim, mbeti si trajtë sinonimike ose mbeti si formë ndihmëse për koncepte të caktuara sinonimike infinitivale, sidomos në fjalitë qëllimore. Sidoqoftë, kjo formë, në përgjithësi, deri më sot, mbeti nën hijen e paskajores së mirëfilltë në trevat e Gegërisë dhe, njëherazi, nën hijen e lidhore në viset jugore.

2. Për të treguar se paskajorja e dytë në vitet e '50-a, të shekullit që lamë pas, nuk kishte aq hapësirë të gjerë përdorimi, por nuk ishte edhe pa nënfushë të caktuar specifike semantike, po paraqitim përkufizimin e përmbajtjes, siç është shënuar në *Fjalorin e gjuhës shqipe* (1954), kur bëhet fjalë për funksionet e parafjalës PËR. Aty (pika 14) thuhet se kjo parafjalë, d.m.th. *pjesëza për* "formon paskajoren e dytë në fjalitë qëllimore: *do të vete në pazar për të blerë zarzavate*. Pra, siç po shihet, fusha kuptimore që mbulonte *paskajorja e dytë* aspak nuk i afrohet fushës a nënfushave semantike që mbulon e mbulon *paskajorja e mirëfilltë*, siç e theksonte prof. A. Xhuvani (Shih Vepra I, Tiranë 1980, f.326) dhe të tjerë, siç do të theksohet, paksa, më poshtë edhe në këtë punim.

3. Që paskajorja e dytë ende nuk mund ta zëvendësojë aktualisht në mënyrë normale paskajoren e mirëfilltë, e faktëzohet, prof. M. Çeliku në një studim të tij (Shih: *Format e pashtjelluara të foljes në gjuhën e sotme shqipe*, Tiranë, 2000), dhe për këtë meriton respekt, vëritet, të veçantë. Prof. Çeliku, lidhur me raportin paskajore e dytë/ paskajore e mirëfilltë, kur përmend nja 7 shembuj karakteristikë të fjalive me paskajoren e dytë, si:

- 1) Është vështirë *për ta ngritur* në art këtë realitet.
- 2) Është *për t'u çduitur* kjo punë.
- 3) I mbetet vetëm *për ta rregulluar* çatinë.
- 4) Është *për t'u theksuar* se në dy ndërmarjet treguesit financiarë janë realizuar.
- 5) Janë vetëm *për të prishur* punë;
- 6) Ndihmonte *për të fshehur* çdo gjurmë.
- 7) Për të folur, foli.

jep këto tri konstatime me interes, për çka tërheqim vëmendjen edhe ne: e para "këto pak raste(...)", - thotë ai, - nuk na japim mundësi për të njohur togun e tipit *për të bërë*, në çdo rast, si paskajore në gjuhën e sotme letrare shqipe (Aty f.53),

e dyta, këto raste, - shton ai, edhe - "*janë të dyshimta në vështrimin normativ*" dhe

e treta, - gjithnjë sipas konstatimit të tij, - këto raste janë "*lary në qeni si paskajore të pavarura* në funksion fjalie" (Po aty edhe f. 91).



Po të bëhet krahasimi i kallëzuesve përkatës i shembujve të mësipërm me versionet barasvlerëse të kallëzuesve me paskajore të mirëfilltë, si:

- 1) Është vështirë me e ngritë në art këtë realitet.
- 2) Është (për) me u çuditë kjo punë.
- 3) I mbetet (për) me e rregullue çatinë.
- 4) Është (për) me u theksue se në dy ndërmarrje treguesit financiarë janë realizuar.
- 5) Janë vetëm për me prishë punë.
- 6) Ndihmonte për me fshehë çdo gjurmë.
- 7) Me folë, foli.

atëherë konstatimet e prof. Çeliku do të dilnin edhe më të përkapshme dhe më të kuptueshme për lexuesit e interesuar.

4. Po në këtë kontekst, pra, siç e thamë, kur kemi parasysh, edhe lidhoren edhe paskajoren e dytë, del e domosdoshme të ceket edhe një fakt tjetër me rëndësi. Dihet mirëfillt, siç e kanë vënë në pah A. Xhuvani, Sh Demiraj e të tjerë dhe sidomos prof. Çeliku, se të gjitha funksionet e paskajores ndër të cilat edhe funksioni kryefjalor, kallëzuesor, atë të kundrinorit të drejtë, madje të një kryegjymtyre të një fjalitë të pavarur, si dhe në raste edhe funksioni i përcaktorit, i rrethanorit, e i segmenteve të tjera, duke kursyer kështu, po ashtu në raste, edhe trajtat gerundiale (në kallëzore më shumë se në rrjedhore), pjesoren e foljeve modale ose të paskajores së vjetër sintetike, të emrave prejfoljorë prapashtesorë, të përcjellores, kushtores, urdhërores etj., nuk mund të zëvendësoheshin as vetëm me lidhoren, as vetëm me paskajoren e dytë, madje as me të dyja bashkë, por me një sinonimi më të gjerë, me të cilën ajo, paskajorja e mirëfilltë, si atëherë edhe sot, bashkëjeton në mënyrë të harmonishme, duke pasur parasysh diversitetet me të cilat mund të ballafaqohet çdo dukuri.

5. Ndërsa paskajorja e tipit "për të bërë" - shkruan sintaksologu ynë, Agim Spahiu - nuk përdoret në disa nga fjalitë e pavarura pyetëse e urdhërore, në disa nga fjalitë me nënrenditje si në kryefjalore, kundrinore, kushtore e lejore, paskajorja e gegërishtes (me + pjesore) del mjaft e dendur, jo vetëm në këto lloje të fjalitë, por edhe në konstruktet e njalla të tjera (edhe në fjalitë kallëzuesore, përcaktore, qëllimore, krahasore, mënyrlore, rrjedhimore) dhe përfundon: Këto ndërtime sintaksore me trajtat të pashtjelluara të gegërishtes asesi nuk mund të zëvendësohen me paskajoren e tipit "për të bërë". Përgjuhësisht mund të zëvendësohen me trajtat e lidhore, por atëherë marrin nuanca të tjera modale (Shih: Letërsia shqipe dhe gjuha letrare, f. 264-265).

Po shtojmë këtë rast se nuanca modale kanë si rrjedhojë gjithandaj edhe nuanca semantike.

6. Edhe më i prerë e praktik ishte T. Kolgjini lidhur me raportin lidhore / paskajore, kur theksonte se "ndryshe përkthehet në një gjuhë të huej, b.f., fraza gegënisht: *Asht ma mirë me vdekun me nder se me jetue me turp*, ndryshe përkthehet ajo në toskënisht: *Është më mirë të vdesësh me nder se të jetosh me turp* (Java, 2.02.'02 f.27). Fjala është për barasvlerësit: **me vdekun** (vdekur) ndaj **të vdesësh** dhe **me jetue** (jetuar) ndaj **të jetosh** e jo për fjalë të tjera. Ndërsa paskajorja e dytë as që vjen fare në konsideratë si trajtë normale në konstruktet e tilla. Edhe profesoresha *Shukrane Gërmizaj*, e cek një ballafaqim të tillë të infinitivit (mbase edhe të gerundit) të anglishtes me lidhoren e shqipes (!), kur citon se "*mbetet që nga përkthimi i fjalëve... përmes shqipes të gjendet infinitivi, që nuk është punë aspak e lehtë*" (Seminari 21/2, f. 366). Po kësaj natyre i përket edhe konstatimi i prof. K. Topallit, i cili kur flet për ndikimin e gjuhëve të huaja në sistemin foljor konstaton se "*vihet re sidomos në përkthimin e trajtës së paskajores, që në shqipen standarde, për mungesë të kësaj trajte, zëvendësohet me lidhore... Po jo në të gjitha rastet trajta e paskajores (së gjuhës së huaj, e cila ka barasvlerësi relative a mjaft të plotë me paskajoren e mirëfilltë të shqipes N.V.) mund të përkthehet me lidhoren, pasi kjo varet nga kuptimi leksikor i foljes paraprise..."* (Shih: *Gjuha shqipe 1/2005, f. 14*). Edhe më i prerë në gjykim del studiuesi Abdyl Sula, i cili pasi konstaton se "*funksionet e paskajores së gegërishtes nuk përmbushen plotësisht nga lidhorja dhe paskajorja standarde e tipit për të punuar*" - shton bindshëm se - "*rëndësia e veçantë e paskajores së gegërishtes del në pah edhe gjatë përkthimit të foljeve nga gjuhët e tjera, që kanë paskajore të ngjashme me të, mbasi asnjë mënyrë a trajtë tjetër foljore e shqipes nuk u përgjigjet barasvlerëshëm atyre*" (Shih: *Gjuha shqipe 1/2005, f. 76*).

Me fjalë të tjera, është e vërtetë se paskajorja e mirëfilltë paraqitet në kohëhapësirë si një formë e konsoliduar brenda sistemit të shqipes mbarekombëtare me identitet e prestigj të formuar që ndryshon jo pak nga trajta barasvlerëse e lidhore, sidomos lidhur me normën pragmatike dhe atë stilistike, prandaj edhe kërkesa për legalizimin e saj në normën standarde nuk është e pabazuar, ngase me një veprim të tillë do të lehtësohej edhe raportimi brenda gjuhësor i shqipes, por edhe në marrëdhëniet shqipe/gjuhë e huaj.

7. Edhe Prof. S. Mansaku, lidhur me paskajoren e mirëfilltë, e përmend një dukuri të tillë, por nga një aspekt tjetër, por që zgjon shumë interes. Sipas tij paskajorja e mirëfilltë, edhe pse e përjashtuar nga norma e letrarishes së sotme



ose e mbetur jashtë shprehjes shkrimore, kryen, si me thënë, në qetësi, veprime funksionale të caktuara me rëndësi, të cilat s'mund të mohohen dot. Ja si e shpjegon autori këtë dukuri: "Për shkak të *sinonimisë funksionale sintaksore të formave të paskajores gegë me format e lidhores dhe pjesërisht edhe me format e paskajores së tipit për të punuar nga ana sintaksore paskajorja gegë vijon të jetë e pranishme me ndikim të saj në zgjerimin e përdorimit dhe të funksioneve sintaksore të lidhores e të paskajores së tipit për të punuar...* (Shih: *Seminari* 21/1 f. 324), dhe për këtë i jep disa shembuj që ne, e pamë të arsyeshme, pasi që e konsiderojmë këtë fakt me shumë interes për temën tonë dhe për shkencën, po ata shembuj a ndonjë tjetër të ngjashëm me ta, t'i riprekim paksa më vëmendshëm, duke i merenduar, sipas skemës së mëposhme, në këtë katër rubrika:

1. lidhorja e shpifur me ndikim nga paskajorja (ndonëse e pashprehur me zë, por nga ravijëzimi strukturor),
2. lidhorja e normëzuar,
3. paskajorja e mirëfilltë dhe
4. paskajorja e dytë.

1	2	3	4
filloi të flaste	filloi të fliste	filloi me folë	filloi për të folur?!
dështa të shkaj	dështa të shkajja	dështoi me shkue	dështa për të shkuar?!
kërkoj të punojë	kërkoj të punonte	kërkoj me punue	kërkoj për të punuar?
shkoi të blejë	shkoi të blinte	shkoi me ble	shkoi për të blerë
para se të nisët	para se të nisje	para se me u nisë	para se për t'u nisur!
donte të dijë	donte të dinte	donte me ditë	donte për të ditur! etj.
dëshiroi të dalë	dëshiroi të dilte	dëshiroi me dalë	dëshiroi për të dalë?
i takon të shkojë	i takon të shkonte	i takon me shkue	i takon për të shkuar?!
(të shkont)			

Sido që të jetë, mjafton rasti i lejimit në përdorim, qoftë edhe si variant i lirë, i paskajores së mirëfilltë, në letërsi ose në sfera të tjera, si nënstandard, për me e frenue, jo pa efekt, *prirjen* e një dukurie të tillë si të lidhores së shpifur jo të qortueshme, por jo aq të lavdërueshme (rubrika 1), ashtu edhe të paskajores së dytë (rubrika 4, e cila, në raste, del fort e paqëndrueshme dhe e qortueshme).

Na merr mendja se për t'u kursyer standardi nga këto dy forma të diskutueshme, nga rubrika 1 dhe sidomos nga rubrika 4, gjithësi të shpifura, edhe për shkak të ndalesës së paskajores së mirëfilltë që ishte bërë, si të thuash, në

mënyrë institucionale, shtrohet pyetja: a s'është më e udhës që paskajorja, e cila realisht ekziston, ta rikthejë vendin e vet të merituar në standard? Një mungesë e tillë sa pati rrjedhojë të dëmshme, apo jo, dhe në çfarë përmasash, le të vlerësohet më me gjakftohtësi. Kemi bindjen se rikthimi i paskajores në këtë lojë standardi do ta sillte patjetër gjuhën tonë në binarë edhe më normalë.

8. Që as lidhorja dhe as paskajorja e dytë, madje as të dyja bashkë nuk mund ta zëvendësonin dhe as tani nuk mund ta zëvendësojnë nocionin e paskajores së gjuhës shqipe do të mjaftohemi, këtë rast, vetëm me theksimin e faktit se funksioni përfaqësor i paskajores sinonimisht, siç dihet, mbulohet me vetën e parë të njëjësit të dëftores (jo të lidhores) dhe, gjithashtu, pothuajse, të gjitha idiomat a shprehjet frazeologjike me paskajore i kanë përgjegjësit e vet sinonimike në dëftore. Përveç kësaj të vërtete të padiskutueshme, dihet, madje, se nocioni i paskajores sinonimisht del i mbuluar edhe me forma e mënyra të tjera të sistemit foljor, por edhe me elemente edhe të sistemit emëror. Me fjalë të tjera, kuptimi leksikor i paskajores del shumë i gjerë dhe mund të cilësohet si një "aftësi e fituar historikisht në veprimtarinë gjuhësore e shoqërore", siç e thotë në parim, fort me vend, për një rast tjetër, prof. Jani Thomaj, pikëpamje lypsen hulumtime të mëtejshme, ndonëse edhe këto që u thanë janë fakte të pamohueshme në dobi të rehabilitimit të paskajores.

9. Ç'është e vërteta, edhe pse shqipja letrare, në njëfarë mënyre, e njeh si paskajore formën me **për të...** (Shih edhe te *Gjuha letrare shqipe për të gjithë* f. 152, madje siç del edhe në burime të tjera normëzuese, ashtu si edhe në tekstin: *Gramatika praktike e gjuhës shqipe*, Tiranë 1998, f. 210 se *Gerundi i rasës kallëzore ka kaluar në disa ndërtime në paskajore të tipit me për të...* (për + gerund: *për të dëgjuar, për të vlerësuar, për të pasë a për të pasur*), që ndërlihet me konstatimet e dhëna në pikën 3, të këtij kreu etj, asesi nuk është mirë që trajta e paskajores së dytë të shënohet si barsvlerës i plotë ndaj paskajores së gjuhëve të huaja, sepse faktikisht nuk qëndron, ngase vetëm paskajorja me + pjesore ka barsvlerësi të plotë me trajtat përkatëse të gjuhëve të huaja. Pa paskajoren e mirëfilltë, nuk dimë shqipfolësi si mund ta mësojë e kuptojë lehtë gjuhën esperanto, e cila ka vetëm paskajoren si fjalë bazë? Pra, në raste të tilla përfaqësimi a sqarimi është më mirë që krahas njëjësit të dëftores, të shënohet trajta e vërtete me + pjesorja si p.sh.: *dëgjoj me dëgjeue = serb. slusam slushati; vlerësoj me vlerësue = serb. procenim proceniti; kam, me pasë = serb. imam imati etj.* (edhe pse ende konsiderohet jashtë norme) me sa të shënohet barsvlerësi *me për të...* (për të dëgjuar, për të vlerësuar, për të

pasur), sepse këto raste "ndërtimi" nuk kanë bazë reale të qëndrojnë si barasvlerës të vërtetë për konceptet në fjalë (Shih lidhur me këtë edhe te Paskajorja... f. 63).

Meqenëse, qoftë për nocionin përfaqësues, qoftë për nocione e finesa të tjera të paskajores së mirëfilltë në krahasim me forma e mënyra të tjera të shprehjes, siç u tha, ka vend të bëhen punime të veçanta dhe ç'është e drejta, paksa ndonjë çështje të kësaj natyre do të përmendet a do të trajtohet e sqarohet, sadokudo, edhe në vazhdim të punimit tonë, kërkojmë me dashamirësi nga lexuesi i nderuar që pa e shqëputur interesimin për sa u tha më sipër të kalojë vëmendjen në krerët vijues të këtij punimi.

### III

#### A KA KUNDËRTHËNIE SERIOZE NDAJ REALITETIT NË RAPORTIN E PROPOZIM-ZËVENDËSIMIT TË PASKAJORES SË MIRËFILLTË ME PASKAJOREN E DYTË?

Në kontekst të asaj që u shtrua në kreun e mëparshëm, është e natyrshme që gjuhëtarët e formuar dhe të informuar mirë gjuhësisht, duke u bindur se zëvendësimi i nocionit të paskajores me lidhore si dhe me formën e paskajores së dytë nuk ishte i mjaftueshëm dhe, në anën tjetër, të zënë ngushtë nga forca e propagandës urdhëruese institucionale e shndërruar në tabu, se paskajorja e gegërishtes assesi s'bën të rehabilitohet, ngase, prishka tërë harmoninë e ndërtesës së normës së përbashkët letrare mbi bazë të toskërishtes(!), mbetën disi të zhgënjyer, pa rrugë zgjidhjeje për këtë pikë dhe, si me thënë, këtë *brengë* disa e mbyllnin a e ndrydhnin në vetvete e disa u detyruan me kërkue mënyra e rrugë se si të mbulohehin ato zbrazëti, së paku për koncepte të caktuara. Në këso rrethanash dikush u mjaftua vetëm me ndonjë kritikë a ankesë sa për të thënë, dikush tjetër u pajtua që si kompensim të përqafohet përpjekja për zgjerimin kuptimor të trajtave të caktuara të lidhore, gjëgjësisht të paskajores së dytë ose ngarkimi polisemantik i formave të dëftores, kushtores, përcjellores etj. Megjithatë, përkundër përpjekjeve të sapocëkura, çështja e paskajores mbeti si një ndër çështjet më të ndjeshme të pazgjidhura në raportin *gjuhë letrare e njësuar / gegërishte*, që pohohej edhe nga shkencëtarët më eminentë. Pra, ky problem që s'mund të futej më nën rrogos, gjithnjë e më tepër impononte zgjidhje. Në këtë kompleks hullish, pas një konsultimi edhe me prof. A. Kostallarin, doli edhe kërkesa jonë që kjo çështje të zgjidhej me rehabilitimin e paskajores, si rast i veçantë, për nënfusha të caktuara semantike, pa e ndërlidhur domosdo me paradigmat e sistemit foljor të gegërishtes. Zgjidhje kjo që duket se del më e pranueshme se alternativat e tjera. Në të vërtetë, propozimi ynë, pas botimit të parashtrësve përkatëse, pati jehonë mjaft pozitive, d.m.th. pati përkrahës, siç vazhdon të ketë edhe sot. Këtë e dëshmon edhe trajtimi i kësaj çështjeje në Konferencën e larpërmendur (2002)

si dhe propozim - zgjidhja e ofruar si ide e përkrahur nga ASHA e Kosovës, që ajo mund përdorej pa u penguar, por, hë për hë, si *variant i lirë*, siç u pa në kreun I të këtij punimi, që ishte në përputhje edhe me propozimin tonë. Megjithatë, lidhur me zbatimin konkret të saj u shpreh edhe ndonjë rezervë, gjë që dëshmohej ndoshta edhe me faktin se në atë konferencë nuk doji konkluzioni përkatës me shkrim rreth kësaj çështjeje delikate. Megjithatë, me sa dimë, lidhur me propozimin tonë nuk pati haptazi kundërshtime a kontaktime nënvlerësuese. Në këso rrethanash doji edhe reagimi i prof. Mehmet Çelikut, i cili tash së voni në një artikull të tij (Shih: *Gjuha shqipe* 1-2, 2001) e mori në vlerësim punimin tonë, të cilin përgjithësisht e vlerësoi si punim serioz, por sipas tij, edhe pse nuk kundërshton nënfushat semantike, ku përdorimi i paskajores del i pakontestueshëm, megjithatë ai, si *zgjidhje më të mirë nuk parapëlqen rikthimin e trajtave të paskajores me + pjesore në standard*, siç propozonim ne, *por, në vend të saj kërkon sforcimin paskajores së dytë*. Kjo alternativë për sforcimin e paskajores së dytë edhe pse u përsërit, më vonë, po prej tij edhe në Konferencën shkencore 2002, me sa dimë, haptazi nuk pati aq përkrahës, përkundrazi nuk shpëtoi edhe pa ndonjë kritikë. Meqenëse nuk e dimë arsyen e vërtetë, pse, profesori i nderuar, mori atë guxim që t'ia mohojë të drejtën për konkurrencë lojale *paskajores me + pjesore*, e cila, sot e kësaj dite, qëndron si realie e gjallë dhe aktive e gjuhës shqipe, na mbetet të supozojmë se ndoshta këtë e ka bërë për ndonjë qëllim taktik, mbase e ka bërë në ndonjë rast shkrimi a zhgënjimi, ndoshta ka parë ndonjë rrezik jashtëgjuhësor të natyrës politike me rrjedhoja të jashtëzakonshme a ku me ditje se pse(!). Sido që të jetë, një veprim i tillë i tij, paksa, na befason. Ishte pak një si punë që nuk e pritnim prej tij, sepse vlerat e paskajores, ç'është e vërteta, më mirë se shumë studiues të tjerë, i nje dhe i ka vënë në pah dhe nuk i ka mohuar në asnjë rast, vetë ai?! Ç'është e drejta, e themi këtë me keqardhje, faktet konkrete, shikuar thellësisht e sipërfaqësisht, që i shpreh, profesori i nderuar, si arsytetime *kundër* në reagimin e fundit, mund të themi me plot gojë, nuk janë aspak bindëse, dalin shumë të diskutueshme dhe me plot kundërtënie ndaj mendimeve të tij të mëparshme, prandaj ne në radhë të parë e cilësuam si taktëzim, ngase u shkon për hir atij grupi gjuhëtarësh që ende si njet mbrojtës kundërtënie e tilla karakterizohen si shumë transparente që mund të vërehen istët, por edhe nga dashamirësit Josugestionues të rëndomtë të gjuhës shqipe dhe ja përse:

1) Kur një palë e konsiderueshme, studiuesh e intelektualësh, mendojnë se për vlerat që ka dhe për funksionet e shumta që ka kryer dhe kryen *paskajorja*, duhet gjetur mënyrën më të përshtatshme se si me e inkuadruar atë në normën standarde, ngase *ajo, si veçori morfo-sintaksore e gegërishtes (me drejt e gjuhës shqipe), nuk mund të kalojë aq lehtë në muze*, siç e tha, tash së voni, prof. S. Mansaku, prof. M. Çeliku del si rasti i vetmuar pengues edhe në atë tubim. Ky në vend që të ndihmonte procesin e inkuadrimin, siç pritej, ngase kishte material të bollshëm të akumuluar në favor, shprehet për të kundërtën(!), madje duke e zgjedhur si zëvendësim të saj një formë pa tipare të mjaftueshme infinitivale, thuse nuk është ai Mehmet Çeliku, i cili pikërisht për ndriçimin e kësaj pike të diskutueshme të gjuhës sonë, ka dhënë ndihmesë jo të vogël, për admirim. Ja disa nga ndihmesat e tij:

- Ishte vetë ai, që përkrahu fuqimisht formimet e emrave të vepruesit më -S *mbi temë të pjesores geqe*, tipi *sulmues jo sulmonjës*, e cila në të vërtetë është *pjesorja e shkurtër e paskajores me me: me sulmue (Shih Norma dhe kultura e gjuhës letrare kombëtare I, Tiranë 1973, f. 149)*;

-që konstatonte se letrarishnja e sotme **nuk ka paskajore**, dhe *do të ishte mirë ta kishte që t'u përgjigjej paskajoreve të gjuhëve të huaja*;

-që e njehe gegërishten letrare si nënstandard dhe kërkoi që letrarishnja e sotme të begatohej me elemente geqe, duke theksuar se *duhen rishqyrtuar kujtijtë e normës në kuptimin që elemente të nevojshme të gegërishtes letrare para pak vitesh tabu të gjejnë vendin që u takon në standard* (f.106);

-që ishte për një qëndrim tjetër ndaj formave të pashjtelluara të gegërishtes, (f.122);

-që konstatonte bindshëm se paskajorja e gegërishtes me tiparet që ka qëndron si barasvlerës i plotë ndaj infinitivit të gjuhëve të tjera;

-që formën për + gerund (paskajoren dytësore) e konstatonte të paarrirë për zëvendësimin e plotë të paskajores parësore, siç u pa edhe në kreun e mëparshëm të këtij punimi;

-që inkuadrimin e paskajores geqe në standard nuk e quante *vështrësi të pakapërcyeshme*;

-që dhe edhe konstatime të tjera me vlerë që ndonjëra prej tyre do të jetë e theksuar si faktologji e dorës së parë në dobi të paskajores me + pjesore gjatë analizës edhe në këtë punim;

-që kërkonte deri edhe atë, që *shqiptimi i gjuhës letrare (kujto pjesoren e shkurtë) të anojë nga gegërishtja letrare etj. etj.* (Shih: M. Çeliku, *Çështje të shqipes standarde*, Tiranë 2000), por që tani, si të ishte i afektuar nga si diçka



e papritur, si diçka e rastit, pozicionohet, për mospërfilljen a *zhdukjen nga standardi* të simbolit të gegërishtes letrare, duke menduar se kështu i *kontribuaka ruajtjes e sforcimit* të normës së njësuar të shqipes letrare kombëtare?!

2) Mendimi i tillë është kundërtëhënës se duke i njohur cilësitë e paskajores, që i shënon vetë mendimshprehësi, si një "*gur themeli në sistemin gramatikor të çdo gjuhe*, pra edhe të shqipes, si një *formë me funksionalitet të jashtëzakonshëm* etj., paradoksalisht këmbëngul që *pikërisht për këtë arsye nuk duhet të përfshihet në normën standarde*, madje aq më tepër duhet *përfshatuar nga përpjekja* për një inkuadrim të tillë(!), edhe pse profesori e di se *shqipe standarde të qëndrueshme s'mund të ketë, pa u përfshirë në të vlerat më të domosdoshme të kodit të përgjithshëm të gjuhës shqipe si tërësi, pra, edhe vlerat e pambuluara nga gegërishtja, siç është koncepti a forma e paskajores*.

3) Prof. M. Çeliku del paradoksal gjithashtu me kushtëzimin se, "po të futet paskajorja e gegërishtes në standard, atëherë do të futen edhe të paktën edhe *dyzet struktura* me këtë paskajore, e cila është në përputhje me paskajoren e shumë gjuhëve të tjera evropiane dhe si rrjedhojë do të krijohet një paralelizëm i jashtëzakonshëm strukturash dhe do ta kthente gjuhën në një gjendje si ajo para Kongresit të Drejtshkrimit" (1972)! Nuk dimë përse profesorin e mundon gjithë ky shqetësim, kur, siç dihet, asnjë pikë e drejtshkrimit, të miratuar në Kongresin e Drejtshkrimit e më pas, nuk ka me u prekë fare për të keq nga inkuadrimi i tillë, ngase paskajorja nuk i takon sferës së drejtshkrimit, po ajo i takon kryesisht fushës së gramatikës (semantikës, frazeologjisë e më gjerë), për të cilën prof. A. Kostallari, po në atë Kongres pati theksuar në referimin e tij se "*studimet e thelluara në fushën e morfologjisë* (kupto edhe të sintaksës, semantikës etj.) *ende nuk kanë filluar*", pohim ky që jep për të kuptuar se edhe në atë Kongres, ashtu si edhe në konferencat e mëparshme e të mëvonshme politiko-gjuhësore, mund të ketë pasur ngutësi a anashkalime të paarsyeshme rreth zgjidhjeve të çështjeve morfo-sintaksore të shqipes letrare, mbase aty mund të ketë pasur *firë* edhe lidhur me anashkalimin e paskajores?! Dihet se, zgjidhja e problemeve si kjo bëhet më së miri në ballafaqim të drejtpërdrejtë në kushte të barabarta me format paralele, pra, edhe brenda normës standarde në konkurrencë lojale e jo me përjashtime e anashkalime arbitrare ose me përpjekje për të mbrojtur të pambrojturën.

4) Edhe vetë fakti *dyzet e sa struktura me paskajore*, që i pohon autori, zgjon kërshtërinë, por edhe shtron çështjen, së pari, nëse kanë vlera e funksionalitet at *dyzet struktura*, siç i pohon vetë ai, atëherë ato, lë që s'mund të heshten dot, po as që bën të futen nën plaf a të fshihen, madje me marrë logjikisht ato

si vlera edhe s'mund të jenë të dëmshme për shqipen standarde, në kuptimin e drejtë që ka standardi dhe së dyti, si mund ta kthejnë gjendjen para 1972-shit, (ndoshta më drejt para '52-shit edhe më përpara, kur paskajorja u injorua, siç u tha, mbase *alla partizançe*!), bashkë me gegërishten N. V.), kur dihet se për gjuhën shqipe, tani standarde, çojnë pak peshë *dyzet struktura*, kur ajo ka me qindra e qindra struktura, qoftë të përbashkëta ndër dialektore, qoftë të formëzuara dhe të favorizuara nga vetë sistemi vetjak *sui generis* i saj. Siç dihet ky sistem i shqipes standarde sot nuk paraqitet aq i brishtë, i cili është gjithnjë në zhvillim e sipër, andaj shtrohet pyetja: Si e tillë a s'paska mundësi letrarish-tja t'i fusë nën ombrellën e vet ato fakte dhe t'i vlerësojë me vërtetësi dhe, fundi i fundit, të përthithë vlerat e nevojshme edhe nga këto struktura karakteristike!?

5) Në të vërtetë, nëse vlerat e tilla në raport me barasvlerës të gjuhëve të tjera më të zhvilluara dalin si korresponduese të mjaftueshme dhe të sukseshme, atëherë kjo, s'dimë pse të mos cilësohet si gjë pozitive, ngase kjo tregon forcën e vitalitetin e pasurisë së gjuhës sonë, por të pashfrytëzuar deri tani për shkak të mospërfshirjes së paskajores në standard?! Sidoqoftë, kërkohet dritë sqarimi më e madhe rreth këtij problemi.

6) Në anën tjetër sa i përket raportit të brendshëm *dyzet strukturat*, të cilat janë të gjuhës shqipe e jo të një gjuhe të huaj(!), mund të thuhet se ato sinonimisht nuk mund të jenë assesi të dëmshme dhe sa i përket kësaj kundërtëhënieje mjafton reagimi mjaft bindës i prof. Enver Hysës, i cili, aty për aty (në Konferencë), për shqetësimin që shpreh prof. Mehmet Çeliku, thotë: "*Nuk duhet të kemi frikë nga këto vlera. S'besoj se do të ishte i rrezikshëm përdorimi i formave sinonimike, sepse struktura të tilla ka plot në gjuhën shqipe, mendoj se nuk do të krijohet një mishmash në gjuhën shqipe, por një larmi më e madhe shprehjeje*". Prandaj, do të shtonim ne, del i diskutueshëm mendimi i M. Çelikut, pse mohon përdorimin e shprehjeve sinonimike me paskajoren me + pjesore, të cilat, në punime të tjera, në një farë mënyre, vetë i parapëlqente dhe i rekomandonte.

7) Është afër mendsh, se paraqitja e tillë e prof. Çelikut, po të shikohet sipërfaqësisht, del konfuze edhe nga një aspekt tjetër. Funksioni përfaqësues njëtrajtësh i veçantë që i mungon paskajores së dytë, madje edhe lidhores, pragmatikisht, logjikisht e stilistikisht është e pamundur t'i mohohet paskajores me + pjesore, e cila, duke qenë se ishte realie e gjallë në të kaluarën dhe si e tillë ndeshet edhe në përdorim të përditshëm edhe sot e gjithë ditën, assesi s'mund t'i mohohet as e drejta konkurruese si në të tashmen, ashtu edhe në të



ardhmen, sepse, është një e vërtetë që e ka nxjerrë dhe e nxjerr në shesh vetë praktika, siç e pranon edhe vetë autori, kur bën fjalë për punimin tonë rreth kërkesës për inkuadrimin e paskajores. Ai këtë rast, shprehet tekstualisht kështu: Me sa duket një kërkesë të tillë e ka nxjerrë në pah aktualisht edhe veje praktika e përditshme (Shih: *Gjuha shqipe* 1-2, 2002, f. 78); prandaj, s' duhet nënvlerësuar pikërisht kjo praktikë e përditshmerisë, ngase këtë rast, do të thoshim, *praktika paraprind dhe shërben si kundërvënëse e fortë ndaj asaj teorie jo të përkryer logjike, e cila e përjashtoi paskajoren dhe, në të vërtetë, kjo praktikë e përditshmerisë e bën të paqenë, të paqëndrueshme atë ndalesë*. Dhe pikërisht për këtë konstatim ka meritë, jo të vogël, autori, andaj edhe tërë *synim-argumentin* e prof. Çeliku ne, si me thënë, kemi të drejtë ta kuptojmë në thelb nga këndi i kuptimit të tërthorë.

8) Profesor M. Çeliku me gjykimin rreth pasivizimit të mëtejshëm të paskajores së pavarur që ne s' dimë sa mund ta cilësojmë si hamendje e rastësishme e tij apo ndryshe, (në qofsha i gabuar! N. V), *por* nuk dimë, gjithashtu, sa del bindës e jo kundërtënës me vetveten, aq më tepër tashti, kur formës së tillë që qëndron e fortë në *gegërishten e ringjallur* (term i Xh. Lloshit), për ringjalljen e së cilës ishte me fakte edhe prof. M. Çeliku, pritet t'i kthehet vendi që i takon në kuadër të shqipes standarde mbarëkombëtare. Sidoqoftë, kemi bindjen, se paskajoria, sipas të gjitha ligjeve gjuhësore, pragmatike e logjike e të tjera, tashmë mund të konsiderohet se e ka të fituar vizën, së paku, *për përdorim si variant i lirë*, siç doli nga diskutimet e autoriteteve tona më të shquara gjuhësore në Konferencën në fjalë. Nuk dimë, pra, qëndrimin e vërtetë të profesorit të nderuar, por dimë, siç e di mirë edhe ai, se paskajoria është një mjet i përshtatshëm për të gjitha shtresat e *gjera sociale të bashkësisë sonë shqipfolëse*, duke filluar që nga gjuha e familjes deri në gjuhën e shkencës; andaj nuk do të jetë larg mendsh që ajo të jetë e *lejuar nga nevoja*, madje edhe *zyrtarisht që të përdoret* në të gjitha fushat e nënfushat semantike, ku paraqitet e nevojshme, prej kah, siç po thuhet nga një numër jo i vogël i gjuhëtarëve me emër, që përjashtuar arbitrarisht.

9) Krahasimi a konstatimi që i bën prof. M. Çeliku, këtij problemi të shqipes me problemet e disa gjuhëve ballkanike si greqishtja e re, rumanishtja etj. që e kanë humbur një formë të tillë, siç e theksojnë edhe Sh. Demiraj e F. Altinari (Shih: *Seminari* 2/1/ f. 184-186), gjuhë këto të cilat e kanë pasur paskajoren (ose shumë trajta paskajore) si greqishtja e vjetër që kishte 11 sosh, sipas Demirajt (Shih: *Gramatika historike e gjuhës shqipe*, Prishtinë 1988, f. 1006), por që e kanë zëvendësuar me lidhore, para qindra vjetësh, dhe se tani mund

të kenë problem rreth zgjidhjes a gjetjes për nevojë të një paskajoreje të re (!), s' dimë sa ka vend të vlejë edhe për shqipen?! Në të vërtetë, shqipes, s' mund t'i mohohet dot e vërteta, ngase shqipja e ka paskajoren, madje si element të njërit nga dy dialektet kryesore. Së këtejmi, mund të thuhet, se edhe letrarishtja e sotme, realisht, e ka, andaj dhe duhet ta legalizojë një trajtë të tillë, duke e bërë legjitime në gjirin e vet, ngase ajo del e formëzuar me të gjitha vetitë e paskajoreve të mirëfillta të gjuhëve të tjera, siç e pohon edhe vetë prof. Çeliku, e ajo është **me + pjesorja**. Po e përsërisim pyetjen: atëherë a nuk është më e drejtë që të shfrytëzohet kjo trajtë e gatshme me futjen a rifutjen e saj në normën standarde, sesa të pritet të zhvillohet një trajtë *e ashtuquajtur e re: për + gerundi*, edhe pse e lindur para 3-4 shekujsh (!) a ku me ditë se kur, por që ka mbetur e pazhvilluar xhuxhumake si paskajore e pavarur për arsye shumë objektive në të dy dialektet?

10) Prof. M. Çeliku, del kundërtënës edhe me vetë kërkesën për (ri)lindjen a gjallërimin e paskajores *dytësore* ose *për + gerund* (term i tij) në shqipen e sotme letrare (toskërishten), kur dihet se zhvillimi i saj në paskajore të mirëfilltë, siç e thekson prof. B. Bokshi, në toskërishten fillimisht mund të jetë *penguar nga prania e paskajores më të lashtë e tipit me + emër prejpsoror i panyjshëm* (Shih, *Pjesorja ... f. 168*), ndërsa tani, në kohën tonë në gegërishten (gjuhën shqipe) atë e pengon e do ta pengojë, siç e dimë të gjithë me siguri, prania e paskajores së mirëfilltë **me + pjesore**, por edhe në toskërishten e kanë penguar dhe e pengojnë, veç lidhores, edhe disa forma të tjera. Prof. M. Çeliku, doravet, shpjegonte: *Forma për të larë nuk ka mundur të zhvillohet në paskajore normale të pavarur gjatë kësaj periudhe* (3 - 4 qind vjeçare e këndeje N. V.), ngase tipin **për të larë** e kundërshton jo vetëm ruajtja e kuptimit leksikor të përbërësit të parë (**për** - parafjalë që tregon qëllim N.V), jo vetëm ngjashmëria shumë e madhe dhe e shumanshme e ndërtimit gerundial të shqipes me ndërtimet gjegjëse të gjuhëve të tjera, por edhe ekzistenca në gjuhën shqipe e ashtuquajtura forma të veçanta të pashjtelluara: *me të ardhur, një të ardhur dhe së ardhuri*. Po të pranohej **me kompromis** togu **për të larë** si paskajore **në çdo rast**, atëherë do të mbeteshin jashtë sistemit të dhënat: **me të bërë, një të bërë, së bëri**, të cilat nuk do të kategorizoheshin dot në mënyrë të kënaqshme e përfundimtare (Shih: *Mehmet Çeliku, Format e pashjtelluara të foljes në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2000 f. 55). Ja, pra, së këtejmi, kur dihet se strukturat e tilla penguese ende janë të gjalla e vepruese aktualisht në shqipen standarde. Shih për këtë edhe te *Gramatika praktike... (Tiranë, 1998, f. 209)*, ku është bashkautor edhe prof. M. Çeliku, del edhe më qartë kundërtënësia e tillë, prandaj

s' dimë pse autori në fjalë insistoi në një element të tillë, siç e quan ai *paskajore të re në lindje e sipër*, kur nuk dihet mirë ajo a do të ketë lindje normale, a do të ketë rritje të mbarë dhe s' dihet se kur do të madhohet dhe të pajiset me funksionet e paskajores së mirëfilltë (për 12 e sa funksionet e saj) dhe ta zëvendësojë atë pa probleme, kur dihet se kjo (paskajorja e mirëfilltë), në kushte normale vullnetarisht nuk do t'ia lëshonte, kurrën e kurrës, vendin e vet një trajte tjetër shemër(?)!

11) I diskutueshëm del edhe mendimi tjetër i prof. Çelikut, kur gjykon se “*është më e udhës që paskajorja e re e tipit për të larë, pronë e gjithë shqipes, të arrijë me kohë të marrë funksionet e tjera e kryesore të paskajores, duke u gramatikalizuar me tej për të kaluar në mënyrë të natyrshme në një paskajore të vërtetë*, çka, me të vërtetë, për ata që njohin ecurinë e shqipes standarde është prognozim i guximshëm dhe si i tillë fort i diskutueshëm. Siç e pamë në kreun e mëparshëm, edhe nga vetë autori dolën vlerësime jo në dobi të formës së tipit me *për të...* për t'u cilësuar si paskajore e mirëfilltë. Është e vërtetë, se kjo formë, në një farë mënyre, nuk është e panjohur për të dy dialektet, por ajo në toskërishte mbetet nën hije të formave të lidhore që është *mënyrë më e natyrshme*, ndërsa në gegërishte qëndron nën hijen e paskajores së mirëfilltë, e cila, po ashtu, është *mënyrë më e natyrshme* e shprehjes, prandaj një formë e tillë (paskajorja e dytë), si me thënë, edhe pse nuk është pa efekt, del jo e fortë në të dy dialektet dhe, siç u tha më sipër, koha nuk pret dhe as që ka nevojë me pritje, që ajo të arrijë, të rritet e të madhohet, sa të mundet me e përfshi tërë konceptin e paskajores së pavarur në tërë truallin shqipfolës, për me e nxjerrë nga përdorimi a për me zhdukë trajtën e mirëfilltë(?)!

12) Edhe më i diskutueshëm del fakti tjetër, kur prof. M. Çeliku, duke e parë letrarishten e sotme, si të thuash, të ndarë, ndoshta, krejtësisht nga gegërishtja *nenstandarde*, si të ishte gegërishtja gjuhë e huaj(!!!), këmbëngul, gjoja se “*rruga e integrimit të paskajores geqe në standard është më e vështirë për t'u pranuar, sepse është e panatyrshme dhe për një të tretën e kombit ajo është e panjohur*, arsyetim ky, mund të thuhet, tejet pa mbulesë, nëse nuk ka ndonjë interpretim tjetër më të zbutur. Sidoqoftë, për gjuhëtarët, intelektualët, deri edhe për njerëzit e thjeshtë shqipfolës, ka shumë argumente që e dëshmojnë të kundërtën, ja disa:

a) Si mund të quhet një trajtë e vështirë dhe e panatyrshme, kur atë, siç e pranon, pra, vetë autori, e kanë në sistemin e tyre të gjallë ligjërimor, më se 2/3 e bashkësisë shqipfolëse? Fundja si mund të quhet e panjohur ose pak e njohur ajo, kur dihet se atë formë e njohin domosdo dhe natyrshëm, ashtu siç e njohin

realisht e natyrshëm edhe sot, jo vetëm 2/3 ose 3/4, sipas prof. F. Rakës (*Seminari 21/1 f. 170*), por atë e njohin, pothuaj, mbarë truall shqipfolës, jo vetëm ai intelektual, por edhe të tjerë, qind për qind, ngase ajo ishte trajtë e njohur zyrtarisht, për afro 50 vjet, deri në vitet '70 të shekullit që lamë pas.

b) Që e kanë njohur, pikërisht paskajoren me + pjesore (geqe ose atë hibride), domosdo, edhe toskërishtfolësit në të kaluarën e largët dhe jo të largët, nuk ka kurrfarë mëdysheje. Kjo së paku dokumentohet lehtë, siç e thekson M. Elezi, jo vetëm në *disa këngë të vjetra beratase e korçare*, por dëshmohet edhe që nga shkrimet e N. Frakullës e këndje, por, aq më tepër, ajo do të jetë njohur nga gjuha e rilindësve tanë të njohur me origjinë nga Jugu, si Naimi, A. Z. Çajupi, J. Vreto, Faik Konica, Asdreni, M. Grameno e të tjerë.

Sa për ilustrim po i sjellim disa shembuj që i ndeshim në veprat e Naim Frashërit. E kemi fjalën për paskajoren e mirëfilltë geqe, e më pak për hibridizuesen: *me qenë (aq të pakë), për me marrë, më ardh(ë), me ju bamun, për me u dukë, me qenë (gjallë), për mos me dalë; mos me mbeturë, (dini) me vrarë, për me prurë dhe me mos mbeturë*. Ndërsa A. Z. Çajupi, i cili që në vitin 1898, parashihte se “*me bashkuarë shkronjatë* (e alfabetit latin në shqipe N. V.) *mezëtoret e zetoret në një rregull të premëtë* “ do të bashkoheshin edhe *idhetë e ndjemënë në vëllazërinë e gjithë shqiptarëve* dhe kështu do të bëhej edhe “*bashkimi e njëmëzimi i gjuhës në të folur e në të shkruarë...*” (Shih A. Çajupi, *Vepra 5, Rilindja, Prishtinë 1983 f. 88-89*, në veprat e tij, përveç të sipërcëkurës *me bashkuarë*, përdori këto trajta të paskajores së mirëfilltë: *du(h)et me ditë, me tretë (kot), me qenë (se s' dimë not), me qenë (djellë e vapë), do me thënë (me një fjalë), me na dhënë, me leçitë, ka me pëlqye, me fitue (bukën), me dërgue, për me dhënë, për me u mbledhë, me themelue, me i dalë (për zot), mundem me pasur dhe me mos pasurë*. I kemi në dijeni, pak a shumë, shembujt nga veprat e Faik Konicës, i njohur për “toskërishten e tij elegante”, i cili vetëm në tregimin “Dr Gjilpëra”..(Shih: *Vepra 1, Prishtinë 1995*), e ka përdorur afro 30 herë paskajoren geqe, të Jani Vretos, i cili në veprën “*Mirëvetia*” përdori këto trajta të paskajores: *duhej me qenë i ndalë, me punue, me ba, me qenë si gjë pashpirt, mos me qenë as të mirë as të drejtë...., ka me dalë, me ditun, s' po mundem me thënë, për mos me u mërguar puna, për me mundur etj.* (Shih: Dr Idriz Ajeti, *Studime...III, Prishtinë 1985, f. 36*) e sidomos të Asdrenit dhe të Mihal Gramenos, prandaj nuk po e rëndojmë tekstin me shembuj të tillë (Shih për këtë edhe të *Paskajorja...* f.140-141), pra gjithësi, ndonëse në përmasa mbase jo aq të mëdha, paskajorja e shqipes *njihej* domosdo, gjithandej, pra,



qoftë nëpërmjet krijimeve letrare, qoftë nga ato publicistike e të tjera të vejtë  
toskërishtfolëse të kohës.

c) Po e cekim edhe një fakt tjetër. E patëm pyetur veteranin e arsimit të ne,  
tani të ndjerë, Nexhip Habibajn, i cili bashkë me toskërishten e lindur gjirokas-  
trite e përdorte normalisht paskajoren *gege*, se mos, vallë, këtë formë e kishte  
të përvetësuar nga ne kosovarët? Ai na u përgjigj se këtë *mënyrë* (paskajoren  
me + pjesore) e kishte që nga "vendlindja", më drejt nga **plotorja** (= shkolla  
fillore e periudhës së Pavarësisë) dhe e ka përdorur vazhdimisht në mënyrë të  
natyrshme. Pa dyshim, ne, deklarimin e veteranit të nderuar e pranojmë si të  
vërtetë absolute, ngase në atë kohë shqipja letrare e kishte një formë të tillë në  
përdorim, ta quajmë, zyrtar, ngase ajo edhe paraprakisht dilte e konsoliduar  
edhe e legjitimuar edhe në gramatika. Mjafton të sjellim një shembull nga  
*Gramatika e I. Permetit* (1917), i cili i njihje toskërishtes paskajoren me +  
pjesore. Ja një shembull nga gramatika e tij ku përdoren të dyja trajtat:  
*Përmbiemër* (= sot Mbiemër N.V.) *quhet ajo pjesë e ligjëratës që i vihet emrit  
për të skanjuar e për me kallzuar më mirë cilësiën e veçoriën e tij* (Aty f.  
61). Po kështu formën e paskajores e ndeshim, pothuaj, në të gjitha gramatikat  
e asaj kohe si të D. Sheperit (1927), i cili e njuh dhe e përdor, si me thënë  
paskajoren normalisht. Ja një shembull: *Është të folurit dhe shkrimi i gjuhës  
që cakton rregullat (...) po kjo nuk do me thënë se gramatika nuk i ndihmon  
kërij zhvillimi*. Siç dihet I. D. Sheperi, ishte për njësimin e letrarishtes, qoftë si  
*toskërishte e gegëzuar*, qoftë si *gegërishte e toskëzuar*, d.m.th. pa e përjashtuar  
vlerat e asnjërit dialekt. Pastaj paskajoren e ndeshim domosdo në gramatikat  
e kohës të A. Xhuvanit, të Osman Myderrizit etj.; prandaj Dh. Shuteriqi kishte  
plotësisht të drejtë, kur insistonte në vitin 1952 që të inkuadronte në *normën e  
gjuhës së some letrare* edhe këtë formë (si element, së paku të veçantë, të  
përvetësuar nga toskërishtja), e cila përdorej gjithandej, madje, sipas R. Ismajlit  
edhe prof. E. Çabej ishte për *gjuhën unike me bazë toskërishten, por me  
elemente të rëndësishme të gegërishtes, si p.sh. infinitivi* (Shih *Studime* 5,6,7  
/2000, f. 207), mirëpo, siç është thënë, politikani letrar, S. Malëshova, me  
ndonjë tjetër, sigurisht pa arsyetime bindëse, por me *qendrim alla parti-  
zançe(!)*, ngase nuk ishin gjuhëtarë me firmë, nuk u pajtuan, andaj  
kërkesë-propozimi i prof. Dh. Shuteriqit, madje bashkë me trajtat e toskëzuara,  
si: *me bërë, me pirë me lënë* që u anuluan atëherë nuk pati kush t'i çanulonte,  
deri në ditët tona?!

c) Që forma e tillë njihet aktualisht edhe nga njerëzit më të thjeshtë  
gjitthandej nga *Toskëria*, e kemi vërtetuar edhe personalisht në pranverën e vitit  
48

2000, me rastin e vizitës që i bëmë Permetit e disa viseve të tjera të Jugut me  
një grup veteranësh të arsimit nga Theranda, për të falenderuar gjithandej për  
mikëpritjen e treguar gjatë strehimit të popullatës së Therandës e të tjerëve gjatë  
Luftës së Kosovës, kur popullsia jonë që dëbuar nga trojet e veta nga soldateska  
e Millosheviçit. Është e vërtetë se gjatë asaj vizite patëm raste të dëgjonim nga  
goja e mjaft njerëzve, t'i quajmë, *të thjeshtë jugorë*, përdorimin e *paskajores  
me me*, të cilët jo vetëm në bisedim të lirë me ne, por në ndonjë rast, edhe në  
biseda ndërmjet tyre e përdorin ndonjë rast atë formë. Këtë e kemi vërejtur,  
qoftë në kafene, shëtitje të lirë, e gjithandej dhe sidomos në shëtitoren e qytetit  
të Permetit, mirëpo, për ne, ishte shumë e papritur dhe befasesue, kur një trajtë  
të tillë e dëgjuam në Frashër. Kur arritëm atje, pasi e mori vesh *kryevendari* se  
kush jemi, na tha: *Ju me ardhë ardhët, mirë se ardhët, por...* (E kishte hallin  
se shtëpia-muze në atë kohë ende nuk ishte rehabilituar plotësisht, jo vetëm  
për shkak të dhëmbit të kohës, por edhe nga dëmtimet e atyre viteve që  
ndodhën, mjerisht, edhe në ato cepe të Shqipërisë). Po e cek edhe një rast tjetër.  
Ndërkohë rastisi që edhe të vendi turistik *Syri i Kaltër* të takonim nxënës të një  
shkollë të Tepelenës që në bisedë me ne e përdorin (mbase jo aq spontanisht)  
ndonjë rast edhe paskajoren, sigurisht jo pse drejtoresha e shkollës ishte  
shkodrane ose pse evokonin përshtypjet nga takimi me kosovarët (e vegjël)  
gjatë ekzilit të tyre, e ku ta dimë, po sidoqoftë jepej përshtypja se nuk e kishin  
qarë të huaj formën e tillë(!). Po përfundoj edhe me befasinë tjetër. Në Lushnjë,  
ku bujtëm, bashkëshortët, mikëpritësit tanë shumë të nderuar (Dh. e B.), që të  
dy jugorë, çunin e tyre e porositën që të shkojë në dyqan *me ble* (gjëra  
ushqimore) *për t'i gostitur miqt!* Me fjalë të tjera, qoftë nga shkolla e hershme,  
qoftë nga lidhjet miqësore e martesore, qoftë nga lëvizjet miqësore, qoftë nga  
transferimi i kuadrove veri-jug e anasjelltas në kohën e monizimit e më vonë,  
që s'kanë kufizim as sot, qoftë për shkaqe të tjera e ku ta dimë ne, mund të  
themi, me plot gojën, se paskajorja, qoftë spontanisht, qoftë sporadikisht, nuk  
ishte e panjohur nga masa e gjerë toskërishtfolëse, por ajo, si duket, qëndron,  
si me thënë, pengesë vetëm në nënvetëdijen e ndonjë kabinetlliu, si andej si  
këndej, që mbase nga *ankthi i luftave ideopolitike ndërpartiake për pushtet* ose  
i mbyllur nën "*ingranazhin e rregullave të mësuara a të kuptuara si dogmë*"  
nuk ka mundur, nuk ka dashur ose nuk ka pasur guxim, mbase edhe aftësi të  
vërejtë lëvizjet e tilla brenda realitetit tonë shoqëror e gjuhësor.

S'kemi se si të mos pajtohemi me Arben Kallamatën, i cili, pa cekur luftën  
politike të ditës për karrige e pushtet, tani në epokën e komunikimeve bashkë-  
kohore me anë të telekomunikacionit, radios, e sidomos televizorit dhe të



lëvizjeve të caktuara migruese: veri – jug, lindje - perëndim e anasjelltas, që nuk reshten kurrë si dhe në këtë kohë të këmbimeve të lira kulturore e të shkëmbimeve afariste etj., konstaton: “Nëse përshkojmë një rrugëtim përgjate vendit, nga jugu në veri e anasjelltas, fshat pas fshati, krahinë pas krahinë, bindemi se diferenca në gjuhë janë pothuaj të papërfillshme (Shih: Java, 17.01.'05, f.9), andaj këtë konstatim të tij duhet ta besojmë e po të duan edhe le ta vërtetojnë edhe refuzuesit e paskajores me + pjesore, të cilën fare natyrshëm, më shpesh a më rrallë, mund ta ndeshim kudo, veç shkriemeve zyrtare të tyre(!).

d) Është e vërtetë se me paskajoren në gojë ndërkohë na vinin e po vijjnë edhe mjaft kuadro të larta intelektualësh nga institucionet e caktuara të Shqipërisë si Bedri Dedja, Jup Kastrioti, David Luka, Zhani Ciko etj., që jo vetëm në stilin bisedor, por edhe në intervista e paraqitje publike e përdorin atë formë. Këtë rast, jo pa qëllim, po e cekim intervistën e prof. Mehmet Çelikut, bashkë me prof. Kolec Topallin, të cilët në verën e vitit 2000 ia patën dhënë radios *Kosova e lirë* të Prishtinës, kur që të dy nuk e kursyen paskajoren e natyrshme me + pjesore. Andaj është pak e habiutshme pse dikush po bëhet tani vetëmohues pa kurrfarë nevojë. Çështjet e tilla nuk zgjidhen dot me vetëmohim, por me pohimin e së vërtetës. Pohimi i së vërtetës *me kultivimin e ndryshimeve* ndihmon gjithësi në zgjidhjen më të mirë të problemeve të kësaj natyre.

dh) E kemi vënë re se paskajoren me + pjesore e kanë përdorur e po e përdorin, por jo aq spontanisht përherë, në paraqitje publike edhe udhëheqës të dalluar të pushtetit shqiptar me origjinë nga jugu. Nuk e kam fjalën më për pushtetarët e dikurshëm: Enver Hoxhën, Mehmet Shehun e ndonjë shok a kundërshtar të tyre të asaj kohe, që vazhdonin ta përdorin pa hezitim paskajoren edhe pas Kongresit të Drejtshkrimit, por për disa udhëheqës të mëvonshëm si p.sh.: ish-kryeministrin Bashkim Fino e kujtojmë me “simethëniën” e tij karakteristike, ish-presidentin R. Mejdani, i cili tash së voni (*Gjuha shqipe* 3/2005, f. 6) është shprehur haptas dhe me gjithë mend se *gjuha jonë letrare “në kushtet e sotme të hapjes, lirisë e komunikimit masiv në hapësirat shqiptare mund dhe duhet të gjejë pasurime të reja nga gegërishtja”, në një ligjëratë që e pati mbajtur në Prishtinë e përdori 4 herë paskajoren me + pjesore. Edhe presidenti i tashëm A. Mojsiu, me rastin e emnimit (nominimit) të tij si president i Republikës në një intervistë të shkurtër dhënë radios *Dojçe vele* (më 24.06.'02, ora 17.07) e përdori dy herë paskajoren: *si me thënë dhe kisha me thënë*. Edhe më me mjeshhtëri kohët e fundit e ka përdorur paskajoren*

50

kryeministri disavjeçar, tani në dorëheqje, Fatos Nano, i cili në Kukës (më 12.02.'05) shprehimisht ka thënë: “*Nuk duhet me qenë euforikë, por duke qenë realistë duhet me qenë keiforikë, duke punuar si KFOR-i*” Thamë me mjeshhtëri, sepse po të përdorte shprehjen me lidhore *nuk duhet të jeni...* (Ishte fjala për plogshiti në punë N. V.), patjetër do të prekte të pranishmit, dhe po të përdorte *nuk duhet të jemi ...* patjetër do të prekte edhe veten. Ja pra ky është njëri nga konceptet që nuk mbulohet dot me forma të tjera, por vetëm e vetëm me paskajoren me + pjesore (Shih raste të ngjashme edhe te libri *Paskajorja...*, f. 66). Ndërkaq, edhe ish-kryeministri Ilir Meta, tani politikan popullist, më 14.05.'05 e përmbylli fjalimin parazgjedhor të tij, në qendër të Tiranës, me fjalë-shprehjen lapidare: *O sa mirë me qenë shqiptar!* (Shih: gazeta “*Zëri*”, 16.05.'05, f.11)

e) Pa hyrë në faktin se a kishte apo jo toskërishtja e lashtë *paskajore me me* (sipas prof. A. Xhuvanit po), ose ndonjë tjetër, të cilën, siç supozohet, do ta ketë mënjeluar, duke i shkuar pas greqishtes së re, mund të themi se shqipja e dokumentuar gegërisht gjithësi e ka pasur dhe tani formën analitike me + pjesore e ruan të formëzuar me tamam, sot e gjithë ditën. Mund të pandehim se toskërishtfolësit si atëherë si tashit patjetër, duke pasur lidhje organike etnike-gjuhësore si rezultat i migrimeve e marrëdhënieve martesore-familjare, ekonomike, tregtare, ushtarake, kulturore, shpirtërore e gjithfarëshe, siç kanë edhe sot me gegët, do ta kenë njohur, prandaj, si atëherë edhe sot, do të mund të jenë *infektuar(!), së paku, në raste nga një formë e tillë(!)*.

ë) Indikativ është fakti se tek arbëreshët e Italisë në gjuhën e tyre *toske-arbëreshe* ndeshet një formë e tillë pikërisht ajo e tipit me + pjesore, si të themi, e përdorur normalisht në mjaft raste. Siç e theksonte prof. Jup Kastrioti, atë e ndeshim jo vetëm te De Rada e Santori, po edhe te Zef Serembe, Gavril Dara i Riu, Zef Skiroi - Plaku etj., siç janë shprehjet: *me u ljarë, me ljarë; vjen me rarë, vjen me thënë etj.* Madje Zef Skiroi, sipas I. Fortinos i zëvendëson format me lidhore me format e paskajores geqe, si: *sa të fliste I për me folun, të shikoj / me shikue etj.* Madje edhe Verio Ujko (krijues edhe pas Kongresit të Drejtshkrimit) bazën *toske-arbëreshe*, siç e dëshmon po I. Fortino, e pasuron me forma të gegërishtes, siç është infinitivi: *me pandehë, me thënë, me gjejë, me qarë*. Prof. Tomor Osmani, në veprën e De Radës, nuk ndesh vetëm paskajoren e ndërtuar me foramtin me + pjesore të toskërishtes si: *me vatur, me i thënë, me i njohur*, por edhe mbiemrin e sajuar nga forma e paskajores: *i meardhur i meardhuri*, fenomen ky që bashkë me një toponim **Mendreq Mendreqi** (vend ku i ndreqnin lundrat në Ulqin) (Shih H. Ulqinaku Glosar,

51

Prishtinë 2003, f.86), japin me kuptue se një formë e tillë do të ketë qenë e rrejtshme aq thellë në kohëhapësirë të përdorimit në ato mese, sa që të ketë për rrejtshme sajime të tilla, siç u cek mbiemri i *meardhur* i *meardhuri* si dhe toponimi *Mendreq Mendreqi*. Me fjalë të tjera, jo vetëm toskëria që e ka njohur dhe e njeh paskajoren dhe asesi nuk e ka të huaj, por as arbëreshët nuk kishin as nuk e kanë të panjohur as atëherë as sot.

Në kontekst të kësaj që u tha deri këtu, prof. Mehmet Çeliku, mbase, duhet ta ketë në djeni edhe të vërtetën, apo jo, të studiuesit nga Gjirokastra, **Muharrem Jakupi**, i cili në Konferencën (2002) theksoi se "*Gjuha shqipe në këta 10-15 vjetët e fundit ka bërë ndoshta një cikël të plotë transfuzioni e ka hyrë ndoshta në të tjerë cikla të tillë: ajo tashmë ka ndryshuar rrënjësisht dhe e gjithë kjo nën hundën e normës, të kuptuar si dogmë*". Sidoqoftë, ndryshime ka, edhe do të ketë, por a ka pësuar *transfuzion cikli* për shkak të kuptimit dogmatik të normës, nuk mund ta dimë, por gjithsesi dihet, siç e thekson prof. R. Qosja se "*në saje të konceptit të gjuhës standarde të hapur bëhet e mundshme që ndikimi i kundërnormës të vihet në shërbim të normës, që ndikimi afatshkurtër shpërbërës të bëhet ndikim afatgjatë qëndrueshmërie*" (Aty f. 41), ngase, siç e thotë edhe prof. Shefki Sejdiu, "*Standardizimi është proces që vazhdon si shkak i veprimeve dhe kundërveprimeve a përpjekjeve për t'u futur ose për të mbetur në sistem, andaj disa elemente janë shumë rezistente, siç është sidomos rasti i paskajores*", element ky, do të shtonim ne, që patjetër kërkon zgjidhje, ngase, pa zgjidhjen e tij, si duhet, nuk do të mund të hiqet si pikë e rendit të ditës paskajoria në shyrtrimet serioze rreth mbarëvajtjes së normës së shqipes standarde.

Nga kreyt kjo që u tha në këtë krye të punimit tonë, kuptohet se paraqitja për këtë çështje e prof. Çelikut, e parë sipërfaqësisht, vërtet, del e siërmëbushur me kundërthënie, megjithatë, ne nuk duam dhe nuk mund ta quajmë të gabueshëm qëndrimin e tij, ngase duam ta kuptojmë, më tepër, siç e cekëm më sipër, si një qëndrim taktik, ngase na duket se ai përdor njëfarë demagogjie për të arritur, sigurisht, një diçka më të madhe. Mbase jo aq për ta pajtuar vetveten sa për të mos u grindur me shokët e vet aleatë të luftës për njëzimim e shqipes letrare(!) dhe në njëfarë mënyre t'ua kujtojë atyre të vërtetën që e ngacmon dhe të cilën ata ta pranojnë në mënyrë të qetë, pa kundërshtime me nga një aspekt tjetër. Ai, fundi i fundit edhe ka të drejtë të vazhdojë me i dalë në mbrojtje normës letrare në fuqi, si shumë të tjerë, ngase ashtu ishte

"*edukuar*" një brez i tërë veprimtarësh vetëmohues. Fundja, kjo normë edhe tani qëndron ende nën mbrojtje institucionale. Të kuptohemi, edhe ne, personalisht, nuk jemi kundër mbrojtjes së asaj norme, por jemi për vërtetësinë dhe përsosjen, madje edhe për korigjimin e saj në pika të caktuara.

Sidoqoftë, kur kemi parasysh edhe kontributin e madh që ka dhënë prof. M. Çeliku edhe në rrethana të sistemit monist, për shkencën e gjuhës shqipe, atëherë, duhet të jemi më tolerues ndaj kundërthënive të tij. Madje edhe këtë rast, veç atyre që u përmendën si anë pozitive brenda kundërthënive, ne mendojmë se mund të cilësohen të ngërthyera me elemente pozitive edhe këto dy fakte:

e para, ka të bëjë me *trysninë aktuale të shprehjeve me paskajoren e dytë* (për + gerund), sidomos në qarqe të caktuara në Shqipëri, e cila si duket është ende në ofensivë dhe

e dyta, lidhet me sugjestionimin e jashtëm si botëkuptim që vjen nga e kaluara si kundërmim i vazhdimit të politikës përcarëse në shkallë kombëtare, që valonte e përvëlonte jo fort moti dhe që ende valon e përvëlton në çaste, sa që, një politikë e tillë del e reflektuar në gjykimin e autorit të nderuar dhe e kolegëve të tij, jo nga qejfi, po nga deri.

Tashti t' i zbrërthojmë paksa këto dy fakte pozitive që dalin të vetëkuptueshme nga reagimi i prof. Çelikut:

1. Është e vërtetë, siç del nga veprimi i autorit, se nga akumulimi i materialit (koncepteve të pashprehura) për shkak të ndalesës institucionale të formës së paskajores së mirëfilltë për një periudhë relativisht të gjatë, 50-60 vjeçare, e shoqëruar me një propagandë të vazhdueshme me elemente verbërtuese, po ashtu institucionale, dhe duke mos pasur mundësi që ato shfrime konceptesh të shprehesh botërisht në letrarishite me mënyra të tjera, tek individët e caktuar gegërishtfolës e të tjerë, është gjë e natyrshe që kjo energji konceptesh gjuhësore e akumuluar të shkarkohej a të shpërthente në formën e ofruar (të lejuar) asociacionisht më të afërt të saj, d.m.th. të shprehet me paskajoren e dytë: për të + pjesore. Shtrohet pyetja, po ky shkarkim që fillimisht ishte, si me thënë, shpërthim prej zori, ndërkohe ka kaluar, apo jo, sugjestionimisht, vërtet, në prirje aq të fortë dhe në çfarë përmasash, le të vlerësohet, ngase nga reagimi me shkrim i prof. M. Çelikut, çështja nuk del aq e qartë. Pra, le të vlerësohet, por jo vetëm në raport me konceptet e paskajores së mirëfilltë, por edhe në raport me lidhoren, sepse, me sa dëgjojmë, në ligjërimin zyrtar, sidomos në Shqipëri të Mesme e gjithandej, paskajoria e dytë në ligjërimin zyrtar, duket se ende është në ofensivë. Na shkon mendja se një trysni e tillë



ka kaluar në sfidë të ndjeshme edhe ndaj formave të lidhore (!), prandaj është mirë që kjo dukuri, e pandehim të kufizuar, të vlerësohet më në hollësi. Po, sigurisht, pengesë më të madhe a zbrapje të turrit për moszhvillimin e formës për të + pjesore në paskajore normale, do të paraqiste rikthimi pa pengesa i paskajores së mirëfilltë me + pjesore në arenën e ligjërimit standard, formë kjo, e cila tërthorazi e pengon edhe sot atë zhvillim të bujshëm të paskajores së dytë. Prandaj, vërtet, nuk mund ta dimë arsyen, pse aq shumë e ekspozoi tani po këtë formë, profesor Çeliku, të cilën e njez ende të paarrirë si paskajore, në vend që ta përfillte paskajoren e mirëfilltë të arrirë a *parësoren*, siç e quan ai?!

Edhe nga konstatimet e sipërcekura të prof. Çelikut shtrojnë nevojën që të hulumtohet dhe të vlerësohet, pra, sa ishte dhe sa është pozitiv e sa negativ procesi që luhet e luhet ende, duke lënë nën hije a jashtë norme paskajoren e mirëfilltë (gege), por e pranishme faktikisht në vetëdijshëm e vetëdijshëm si sendëzim i paartikulluar brenda procesit të ligjërimit të folësit a të folësve të caktuar brenda ligjërimit standard, fakt ky i pohuar edhe nga prof. Seit Mansaku, siç u përmend në kreun e mëparshëm.

2. Anë tjetër me elemente pozitive të autorit mund të cekim edhe faktin se ky, ndonjëse mbetet, formalisht, veprimtar besnik me fjalë i normës së shqipes së sotme letrare mbi bazë të toskërishtes (!), faktikisht, del se nuk pajtohet vërbërisht me plotinë e shpallur lidhur me atë normë, ngase nuk pajtohet për zhdukjen e paskajores gege, sepse paskajoren e mirëfilltë e lë të paprekur në gëgërishtë (si nënstandard letrar), dhe njëherazi e pranon se mungesa e saj në normë, faktikisht, lë keq diçka, prandaj është kategorik që konceptet e paskajores, sidomos ato të pambuluara, domosdo duhet të mbulohej, qoftë edhe me paskajoren e dytë, *në lindje e sipër*, siç e thotë vetë ai. Me fjalë të tjera, duke dhënë me kuptue, në njërin anë se ende qëndron *ihtar i disiplinuar i normës në fuqi*, sikurse shumë gjuhëtarë uniformistë, të cilët në mënyrë euforike iu kishin përshatuar me hir e me pahir atmosferës para e pas Kongresit të Drejtshkrimit, edhe ky, pajtohet për shpërfilljen e paskajores së mirëfilltë (gege), por, në anën tjetër, duke qenë i vetëdijshëm se me anashkalimin e paskajores kanë mbetur një mori konceptesh të paplotësuar, i zënë ngushtë, mes dy zjarresh, kërkon zgjidhje të sforcimi i paskajores së dytë, siç u cek më sipër. Në situatë të tilla të paqartë nuk ishte dhe nuk është vetëm prof. Çeliku, të tentohet me u rifutë paskajoria në standard, atëherë, si të shprehemi figuratëvërisht, makina e përkryer lëvizëse e letrarishitë (!), sipas tyre, ku është futur tërë norma letrare, po u kthyea *rikuere*, tërë ambalazhi me stacionin altopar-

lant propagandistik, lidhur fort në shpinë të asaj makine, do të shprejshje a do të çakordohej tërësisht e tmerrësisht?! Me fjalë të tjera, dalka logjika se sakrifikimi i paskajores paska qenë *kërkesë hyjnore* si kusht për *njësimin e shqipes letrare e kombëtare* dhe pikë?! Sigurisht konstatimet e tilla nuk dalin fare të qëndrueshme, sipas asnjë logjike as të atëherëshme as të sotme, kur kemi parasysh *shqipen letrare* si tërësi. Sidoqoftë, pasi propozimi me fjalë i prof. M. Çelikut del në mbrojtje të atij ambalazhi, ku, siç u tha, edhe paskajoria e dytë, ishte lidhur mirë me zinxhirë propagande në shpinën e asaj makine, mund të themi se ai kishte arsye më fort taktike se të përnjëmendta për mospërfilljen e paskajores së mirëfilltë dhe sforcimin e paskajores së dytë. Kështu themi se profesori e dinte fare mirë, siç e cek edhe vetë, se paskajoria e dytë ishte themi e ende e pa arrirë dhe këtë *paarrirje*, e ndjen thellë, madje e lidh me fije të trasha të rezervës në palcën e ndërgegjes së vet, ngase kërkesë-propozimin e tij e përfundon me këto fjalë: *"Mendimet që parashtruan janë përpjekje për zgjidhjen e një çështjeje themelore të sistemit gramatikor të shqipes së sotme, përpjekje për zgjidhjen e problemit ndoshta më të vështirë të shqipes standarde në ditët tona. Në të ardhmen vetë koha do ta thotë fjalën përfundimtare."*

Të vihet re se propozimin e tij e quan *përpjekje* dhe zgjidhjen *përfundimtare* ia lë *kohës*, çka na jep për të kuptuar se tek ai më tepër ka ndikuar ndonjë motiv jashtëgjuhësor i rastit sesa logjika brenda gjuhësore. Dihet se botëkuptimi te çdo njeri nuk formëzohet lehtë, madje njëherazi dhe as që mund të bëhet me lehtësi rehabilitimi përkatës për koncepte të caktuara. Sidoqoftë, pra, del pozitiv fakti se prof. M. Çeliku *grykon drejt kur konceptin e paskajores së mirëfilltë nuk e quan të mbuluar plotësisht as me lidhoren, as me paskajoren e dytë në gjendjen e sotme, andaj e thërrret në ndihmë kohën* si dhe e prognozoi fuqizimin e një forme edhe pse e di se ajo është ende e paarrirë. Rreth motivimit a shkakut pse prof. M. Çeliku u mbështet aq fort në një formë të *paarrirë* mund të jepen lloj-lloj supozimesh. Ne, në këtë kontekst, nuk po përsërisim supozimet tona që u thanë më sipër, por lidhur me realitetin, siç po na servohet momentalisht, po e shkëpusim vetëm një mendim tonin, krejtësisht anësor. Asesi nuk do të dëshironim që dijetarët e kalibrit të prof. M. Çelikut të mbesin viktimë nën dhëmbëzorët e proçkave të makinerisë politike propagandistike të një periudhe të caktuar, fushatë kjo, e cila pati jehonë domosdo edhe në politikën gjuhësore, me kohëzgjatje, mjerisht, ende jo të përfunduar. Kuptohet, pa nënçmuar jehonën pozitive në fushë të normës standarde që pati propaganda e asaj kohe, sot për sot, duhen marrë me rezervë mjaft gjëra e ndërpropaganda në bie fjala: *Nëse preket sadopak baza tokse ose rifutë diçka*



gege në normën e shqipes letrare kombëtare të miratuar në Kongresin e Drejtshkrimi (1972), do të vihej në luhajë edhe uniteti kombëtar (!).

E keqja del edhe më e madhe kur këtë gjendje po e shfrytëzojnë jo për të mirë edhe elita e klasës politike e kohës në Shqipëri, por edhe më gjerë. Kastat e caktuara pushtetkërkuese e pushtetmbajtëse (terma të A. Baletës, shih *Bota sot*, 07.12.'05, f. 11), po e shfrytëzojnë dhe mund ta shfrytëzojnë edhe më tej edhe këtë temë për të nxitur dallimet midis Gegërisë e Toskërisë, ngase kur kemi parasysh të vërtetën se paskajorja ka shtrirje jo vetëm, që nga rrjedhat poshtë Shkumbinit e gjithnjë më në Veri brenda kufirit të Shqipërisë së sotme administrative, por edhe në Kosovë, Luginën e Preshevës në Serbi e gjithandë, viset shqiptare të Malit të Zi dhe në Maqedoninë Perëndimore, d.m.th., jashtë kufijve të shtetit amë, ngase është një pemë hyjnore shumë frytëdhënëse e gjuhës së masës mbi 5-6 milionshe, atëherë, për një shtresë të pafomuar fanatike, me lehtësi mund të nxitet droja, gjoja, nga ekspansioni revanshist i gegërishtes me paskajoren karakteristike në dëm të toskërishtes (simbol uniteti) dhe kështu gjuha e sotme standarde e njëzuar mbi bazë të saj do të vihej në rrezik(!).

Mjerisht, siç e thekson analitikani Fatos Lubonja: "Ende në jetën politike reja e konfliktit veri-jug, e cila herë zbehet e herë zymtohet në qiellin e psikikës së shqiptarëve i ka veshur kosovarët (gegë, kupto edhe trevat e tjera të sapocekura), veçanërisht në mendjen e jugorëve me hijen e frikshme të aleatit të revanshizmit verior" (Shih, *Zëri*, Prishtinë, f. 13.05.'95, f. 52), që për ne, besoj edhe për intelektualët edhe studiuesit toskërishtfolës mendjekshtëllë, një druatje e tillë del absurde. Për mendimin tonë arsytimi se Kosova (gege) nëse dëshiron, kryenvete, le ta fusë paskajoren ose le ta rikthejë normën e ish gegërishtes, por Shqipërinë tokse me gegët e saj që i janë nënshtruar tashmë natyrshëm letrarishtes së sotme mbi bazë të toskërishtes, le ta lerë të qetë, është një solution shumë i gabuar dhe shumë secesionist, dhe si i tillë shumë i papranueshëm, ngase shkon në dëm të idealit për bashkimin shpirtëror kombëtar e më gjerë dhe në të gjitha fushat e jetës. Sidoqoftë, zënkat, mënitë a moskuptimet e thella mes shqiptarësh, si punë drejt, për të cilat, si do të thoshin hi je teza në ditët pa rreze dhe në netët pa hënë. Gjithsesi përherë duhet pasur parasysh interesin e përgjithshëm mbarëkombëtar që këtë rast, me inkuadrimin e paskajores, përputhet interesi individual me interesin e përgjithshëm. Në këtë i cili veç tjerash, lidhur me injorimin e gegërishtes, thekson: *Të vihem në lëvizje ta ndryshuar, përmirësuar, plotësuar (standardin e shqipes), ngase kjo nuk*

është (as nuk duhet të jetë) mision vetëm i veriorëve. Mungesat janë të gjuhës shqipe, jo të banorëve të njërës apo të tjetrës trevë. Për më tepër përpjekjet si revansh (vetëm nga gegët N. V.) mund të kthehen në një aventurë të rrezikshme dhe me pasoja". Po kështu lypsen mirëkuptuar jo vetëm fjalët e prof. Ali Dhrimos të shprehura në atë Konferencë se "gjuhën letrare e presin plotësisht, përfikësimet e modifikimet të mëtejshme" (f. 207), por edhe ato të prof. Miço Samares, i cili thekson se: *Detyra e shqiptarëve është sot të ndihmojnë së bashku për zhvillimin përsosjen e mëtejshme, nga ana strukturore, të gjuhës letrare të njëzuar për ta bërë atë sa më të aftë që ajo të kryejë sa më mirë funksionet e saj shoqërore në të mirë të kombit të tyre* (Shih "50 vjet studime albanologjike", 2004, f. 105). Po kësaj natyre i përket edhe mendimi i studiueses Shefkije Islamaj, kur thekson se "gjuhët (standarde) nuk bëhen të zhvilluara vetvetishëm, por me politika gjuhësore e me planifikim gjuhësor, me diskutime, rivështrime, korrigjime e plotësime, që marrin për bazë situatën aktuale gjuhësore dhe që nuk e lënë anash rëndësinë e integritimit gjuhësor në rrafsh kombëtar" (Shih: Shekulli, 29.11.2005).

Pra, edhe kërkesa jonë ka po këtë synim: plotësimet, përfiksimit dhe modifikimet e mëtejshme, duke përfshirë edhe ato **strukturore**, duhet të bëhen në mënyrë institucionale nga qarqet intelektuale mbarëkombëtare.

Fundja, **druajtja nga revanzhizmi** dhe i shokëve të luftës intelektuale sigurisht nuk është vetëm shqetësimi i prof. M. Çelikut, por ishte e pranishme edhe në thënie të matura e skofiareske edhe të standardologëve të tjerë të Qendrës. Prof. E. Lafe, b.f. që në vitin 2000, kur e pranoi dhe e gjykoj të dyeshme, kërkesën tonë, për ta hedhur si *ide në qarkullim inkuadrimit e paskajores gege në shqipen standarde*, theksonte, se kjo mund të bëhet vetëm **pas një pune të gjatë përgatitore** (Shih: Sokol Shamata, *Koha për kulturë*, 23.09.'00 f. 2), edhe pse siç do të theksonte edhe më vonë prof. E. Lafe "standardi nuk mund të mbetet i pandryshueshëm në elemente që nuk e kanë arritur qëndrueshmërinë e plotë, që janë në rrugën e zhvillimit ose që përbëjnë dukuri të reja. Prandaj këtu ka vend për saktësimet e përmirësime të mëtejshme" (Shih: Recensionin për librin e Q. Muratit, *Standardi gjuhësor dhe kultura e gjuhës*, IA Prishtinë, 2004, 368).

S'do mend, të gjitha gjasat e rrugëzgjdhjes çojnë, jo në mohimin a ndrydhjen e përdorimit të paskajores së mirëfilltë me + pjesore, po në doli të inkuadrimit të saj në standard, ngase siç thuhet ne zhargonin e ekonomistëve: ky element ofrohet si mall i gatshëm, si para *kesh*, për të zgjidhur çështje të mëdha jetike për normën standarde. S'do mend se kjo formë që munda me i përballur presionit institucional politik e gjuhësor *dirigjist* 50-60 vjeçar, tani

kur s'do të ketë më presione të tilla, nuk ka nevojë as të pasivizohet as të zëvendësohet vullnetarisht me ndonjë formë tjetër, sidomos tani, kur gjerat po kundrohen realisht, sepse, siç e thotë E Sedaj: "aktualisht është bërë kreu i zakonshme të përdoret paskajorja analitike me **me**: me punue dhe kujtoj asnjë lektor nuk do ta korrigjonte më këtë trajtë të preferuar edhe në gjuhën letrare" (Shih: E. Sedaj, *Gjuha arbmore* 2001 f. 336) ose siç e thotë ortologu ynë veteran, Mehmet Gjevori: "bëjnë mirë ata redaktorë e lektorë që nëpër gazeta e shkrime të tjera, kur rrethanat lejojnë, që këtë paskajore nuk po e korrigjojnë, ngase kjo është edhe një mënyrë presioni me rrugë që qaraq e caktuara të normës standarde të kenë parasysh zgjidhjen së më shprejt dhe drejt të kësaj çështjeje madhore për gjuhën tonë standarde" (Shih: *Koha ditore*, 11. 09. 2005, f. 11).

Siç u tha më lart standardologët tanë, ashtu edhe prof. M. Çeliku, detyrohen të jenë të matur, madje edhe të pranojnë paksa të rëshqasin edhe në lajthitje të lehta(!), vetëm e vetëm për të zbutur sadokudo rrjedhojat e ish-politikës moniste edhe lidhur me gjuhën letrare, andaj edhe doli arsyetimi (*sislogan*) se për inkuadrimin zyrtar të paskajores duhet pritur, ngase gjoja ajo ende nuk paska përdorim të mjaftueshëm në letrarishite etj., edhe pse dihet fakti se gjuhëtarët standardistë nuk duhet të jenë vetëm regjistruues pasivë të dukurive, por ata, jo vetëm për çështje të diskutueshme, por edhe për të tjera, duhet të tregohen më mendjemprehtë e më të guximshëm, kështu që në bazë të fakteve të pamohueshme dhe prirjeve që vërejnë, duhet të japin edhe propozimet e sugjerimet e caktuara rreth përsosjes së standardit, pastaj, ata, si profesionistë që janë, nuk duhet me ngecë domosdo vetëm si arsyetues të zvarritjeve, por duhet të jenë aktivë edhe si sendërues të normëvënies me perspektivë të qartë. Në proceset e zhvillimit historik dhe në punën e përcaktimit të normës dhe të kristalizimit të gjuhës letrare - thekson, prof. I. Ajeti, faktor gjithëherë i rëndësishëm është ndikimi subjektiv (Shih: *Studime ...III*, f. 50), prandaj ky ndikim subjektiv u takon, në radhë të parë, pikërisht gjuhëtarëve standardistë, planëzues të standardit gjuhësor.

Sidoqoftë, rreth zëvendësimit të paskajores së mirëfilltë, qoftë me format e lidhore, qoftë me paskajoren e dytë, mbesin ende kundërthënie që lypsen sqaruar e interpretuar me kujdes të shtuar, por, patjetër, duhet pasur parasysh për mos me ia mohue të drejtën e pajetërsueshme, të padiskutueshme dhe të pamohueshme, paskajores me + pjesore për konkurrencë të lirë, prandaj, koncepti i formësuar doktrinarisht tash disa dekada, duhet të ndryshojë në të mirë të realitetit objektiv dhe perspektivës së mbarë të shqipes standarde.

#### IV

### A ËSHTË E DREJTË QË SHPREHJET ME VLERË ME PASKAJOREN ME **ME**, TË JENË TË REKOMANDUESHME VETËM PËR GEGËRISHTEN, POR JO EDHE PËR SHQIPEN STANDARDE?

Në vijim të kontekstit del e nevojshme të qitet në dritë më mirë, jo vetëm shtrirja funksionale sinkronike brendagjuhësore e paskajores me + pjesore, për nënfusha të ndryshme semantike, por edhe shtrirja gjeografike e saj, e parë në kohëhapësirë të mbarë truallit shqipfolës. Ky fakt në burimet tona normëzuese të deritashme, në një farë mënyre, duket se del paksa i minimizuar. Një dukuri e tillë minimizimi që kishte zënë fill më përpara, shihet qartë edhe nga krahasimi i përkufizimit të funksioneve të pjesëzave përkatëse **ME** e **PËR** lidhur me paskajoren në përfaqje të lëndës së *Fjalorit të gjuhës shqipe* (1954) ndaj *Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe* (1980).

Ndërsa në FGJSH (1954) thuhet: parafjala **ME formon paskajoren** dhe për këtë jepen shembujt: *me qenë, do me thënë, me shkue* (Aty f. 302), në FGJSSH thuhet pjesëza **ME: Përdoret zakonisht në të folmet e Veriut për të formuar një nga trajtat e paskajores** dhe për këtë jepen këta shembuj: *me qenë, me marrë, me dalë* (Aty f. 1004). Po ashtu, ndërsa në FGJSH (1954) thuhet se parafjala **PËR formon paskajoren e dytë në fjalitë qëllimore** dhe lidhur me këtë jepet shembulli: *Do të vete ne pazar për të blerë zarzavate* (Aty f. 393), në FGJSSH (1980) për këtë pjesëz thuhet: **Përdoret për të formuar paskajoren e foljeve** dhe për ilustrim jepen këta shembuj: *Shkuam për të punuar. Ishin të vendosur për të luftuar. Kemi të gjitha kushtet për t'u mbrojtur*.

Siç po shihet, dallimi i përkufizimeve, sipas burimit përkatës, nuk është i vogël. Për mendimin tonë saktësia e nocionit që shprehet në FGJSH (1954) është më e përkrahshme edhe aktualisht, sepse vërtet pjesëza **me, formon paskajoren** (nënkuptohet të mirëfilltën) dhe pjesëza **për formon paskajoren e dytë në fjalitë qëllimore** (kryesisht), ndërsa përkufizimet në FGJSSH dalin të diskutueshme, sepse mund të sjellin keqkuptime, ngase paskajorja me +



pjesore nuk ka shtrirje vetëm në *disa të folme veriore*, por ka përhapje më të gjerë, madje edhe konstatimi tjetër se pjesëza për përdoret për të formuar *paskajoren e foljeve* mund të krijojë keqkuptim, ngase forma e tillë nuk e ka zhvillimin e duhur për të përfaqësuar nocionin e paskajores së mirëfilltë të gjuhës shqipe, po kryesisht përfaqëson fjalitë qëllimore. Sidoqoftë, me sforcimin e paskajores së dytë dhe me minimizimin e paskajores së mirëfilltë mbesin gjëra të diskutueshme. Së këtejmi, po të shikohet sipërfaqësisht, po sipas kësaj logjike, edhe konstatimi i prof. Sh. Demirajt se “*forma me punue ndeshet pothuaj vetëm në të folmet veriore*” (Shih: *Gramatika historike...f.*, 657 etj.) gjithashtu del i diskutueshëm. Në fakt, një gjykim i tillë, mbase mund të arsyetohet vetëm, nëse është menduar për ndonjë variant të formës shkrimore e shqiptimore të paskajores në një trevë të caktuar, e ku ta dimë(!), përndryshe nuk përkon me realitetin. Gjithsesi, lypset sqaruar fakti se paskajorja me **me**, së pari del disa variantesh dhe së dyti, ka shtrirje mjaft të gjerë gjeografike, kalon edhe Shkumbinin gjithandej nga jugu, pa e vënë në dyshim përhapjen e saj në Shqipërinë e Mesme dhe atë të Veriut etj. Përkishtë lidhur me këtë keqkuptim a paqartësi rreth shtrirjes në kohëhapësirën e trullit shqipfolës të kësaj forme, prof. Imri Badallaj tërheq vërejtjen se “*paskajorja ka shtrirje të dendur në të folmet kalimtare, në ato të Shqipërisë së Mesme dhe jo vetëm në gegërishten veriore, siç mendojnë disa nga gjuhëtarët e sotëm* (Shih *Seminari* /19, f. 401). Kur është fjala lidhur me variante, dihet se, veç trajtës së shkurtër: me mbarsë zero *me punue* ose me prapshitesën inovuese -Ë *me matë*, forma e tillë me+pjesore, mund të ndeshet edhe në trajta të tjera të zgjeruara ose të ndryshuara (të cingëruara), si: *me punuem me punueman, me punuen me punuenan, me punuë, me punu, por edhe me punua dhe me punuar a me punuarë; me matun me maten me matunë, me mat, me matur, me maturë* e kështu me radhë, d.m.th., edhe me pjesoren e letrarishtes së sotme, përkatësisht të toskërishtes, çështje këto që do të sqarohen, paksa, më poshtë, po në këtë punim

Gjithashtu edhe shtrirja funksionale brenda gjuhësore e paskajores, qoftë ajo e tipit me **për të** ..., qoftë (sidomos) ajo **me + pjesore**, sepse në burimet tona studimore edhe me interes normëzues, ende nuk ka dalë e theksuar sa ishte dhe sa është në realitet kjo shtrirje, siç janë, b.f., thëniet idiomatike frazeologjike të një abstraksioni të lartë, shprehjet karakteristike me vlerë nga sfera letraro-artistike të pajisura me paskajore, thëniet e ndërmjetme etj., të cilat si të tilla mund të cilësohen si kategori të veçanta, pra edhe si shprehje të ngurosurra. Madje shprehjet e caktuara, mund të kenë përdorim të

mëvetësishtëm, në rrethana të caktuara, por mund të jenë të pranishme pa përjashtim, në çdo cep të trullit shqipfolës. Në këtë kontekst, pa u thelluar në këto çështje, veç e veç, po theksojmë faktin se zgjon interes të veçantë, forma formale dialektore (e jashtme) e paskajores **me + pjesore** e shtrirë, qoftë në trajtën e shkurtër, qoftë në trajtën e zgjeruar ose atë të cinguar të pjesores (variantesh të ndryshme). Themi kështu sepse në bazë të formës së caktuar mund të caktohet edhe burimi vendor i trajtë-formës përkatëse, p.sh. *me punuen* (ndeshet në të folme të Kosovës), *me punua* (në Rugovë e disa vise të Malësisë së Madhe), *me punuem*. (në të folme të Shqipërisë së Mesme), *me punuar(ë)* në të folme kalimtare e në ndonjë cep të Toskërisë etj..

Ç’është e vërteta, me e zakonshme, sot për sot, është trajta e paskajores me **me**, *me pjesore të shkurtër*, por meqë trajtat *me pjesore* të cinguar a sidomos të zgjeruar do të jenë formëzuar ashtu më përpara gjatë kohëhapësirave të caktuara nëpër shekuj, madje, si të tilla, mund të ndeshen edhe si koine më vete, siç është *koinea epiko-kanunore e Veriut*, siç e theksonte A. Desnickaja (Shih *Studime I, ASHAK, Prishtinë, 1995 f. 147*), atëherë edhe ato duhen pasur në konsideratë gjatë analizave përkatëse. Ne, për arsye vendi dhe synimi që ka ky punim, këtu nuk do të ndalem më gjatë dhe më në thellësi rreth kësaj pike, e cila meriton analizim më të hollësishtëm dhe më fort i takon historisë së gjuhës si dhe studimeve dialektologjike, çka nuk është synimi ynë këtë rast, megjithatë, mbase ndonjë cekje a plotësim lidhur me këtë do të bëhet edhe në krerët vijues të këtij punimi. Qëllimi ynë është tani me prekë një dukuri aktuale, që ka të bëjë konkretisht me vlerësimin e qëndrimeve rreth një praktike në përgjithësi, por edhe të ndonjë gjuhëtarë me ndikim në veçanti. Është fjala për atë praktikë dhe ata gjuhëtarë, të cilët pa marrë parasysh vlerat e pazëvendësueshme që mund të kenë shprehjet e caktuara me paskajoren brenda tyre, në mbështetje të praktikës së deritashme (50 e sa vjeçare), si me thënë, të (in)doktrinuar për mos me prekë *normën (tabu) në fuqi(!)*, pa bërë seleksionime të nevojshme, *detyrohen*, mekanikisht, mos me i pranue ato vlera në standard, por me i anashkalue, duke i konsideruar si të paqena(!) ose parapëlqehet me i rikthye a riadresue prapë në dialekt (!).

Sidoqoftë, këtu kontestues del fakti se një veprim i tillë mekanicist, nga një numër i konsiderueshëm i studiuesve bashkëkohorë, mund të cilësohet sot si një veprim jo i urtë dhe që ndërlihet, si të thuash, me një keqkuptim të normës, ngase, siç e cekëm më sipër dhe, siç e thekson prof. R. Ismajli: “*idiomat nuk janë bazë e gjuhës letrare, prandaj kërkesa për inkuadrimin e tyre (në standard) nuk është diçka e veçantë*”. Kështu shikuar nga kjo pikëpamje edhe shpjegimi



i cekur më përpara i prof. Sh. Demirajt, del jo i plotë, por aq më tepër del kundërthënës a pjesërisht jo i kënaqshëm edhe mendimi i prof. Idriz Ajeti, i cili në referimin e tij në atë Konferencë (2002), si përgjigje ndaj një *kritikuasi* nga revista *Dardania sacra*, i cili, siç thotë prof. Idrizi, *vajton për dëbimin e trajtës së pashjtëlluar të paskajores me me*, profesori ynë i nderuar sqaron se nëse ajo trajtë (paskajorja), po e them edhe me fjalë të mia, nuk është e lejueshme (!) të përdoret në standard, ajo mund të përdoret, me liri të plotë, në *dialektin verior*, prej kah, kuptohet, nuk mund të *dëbohet dot*, duke dhënë një shpjegim parimisht shumë të drejtë dhe shumë me vend, por, jo pak kundërthënës, ngase kushtëzohet nga vetë rrethanat ekzistuese. Ai konstaton: *Duam të dihet e të mos harrohet se aq sa prej krijuesve kërkohet të zbatojnë normën e gjuhës standarde, po aq ata janë të lirë të shkruajnë në variantet e mëhershme ose në të folmen amtare* dhe përfundon me fjalët kuptimplota: *“Gegërshtja letrare është degë e rëndësishme e gjuhës sonë; ajo jo vetëm që nuk synohet të shrypet, por ajo në mënyrë sistematike do të kultivohet ashtu që brezat e sotëm dhe breznitë që do të vijnë të mundën lehtas ta shijojnë trashëgiminë kulturore e artistike të prodhuar në variantin letrar verior”*.

T'i kthehemi përsëri paskajores. Nuk dimë, me vetëdije apo jo, me një një veprim të tillë doktrinues lidhur me mospërfilljen e paskajores në standard, gjuhëtarët e caktuar, si prof. M. Çeliku, prof. I. Ajeti, prof. Sh. Demiraj e të tjerë, pasues të tyre, lidhur me këtë çështje, pa e njohur mirë realitetin, duke ia lënë gegërshtes atë vlerë si normë të saj, jo vetëm që lënë shteg hapur, por, njëherazi vihen në shërbim të të ushqyerit dhe kultivimit të një gjuhe letrare rivale a paralele geqe kundrejt asaj të letrarishtes së sotme. Një *“ndihmesë”* e tillë nuk do të ushqente vetëm një normë të panevojshme paralele, por do të prekte mbase jo për të mirë edhe në fushë të identitetit kombëtar!

Sido me qenë, do të thoshim se mendimi i prof. I. Ajeti, vërtet, shumë i qëlluar për t'u dëshiruar dhe gjithsesi i drejtë, mund të shërbejë si udhërrëfyes shumë i mbarë për të ardhmen e variantit letrar gegë, *tashu gjithnjë e më të ringjallur*, mirëpo, si të thuash, është ka kundërthënie të tejpashme për shkak e të rrethanave brenda e rreth saj, ngase ka mospërputhje me konceptet e njohura të diskutueshme aktuale në raportin: *gjuhë letrare geqe* ose të *“varianteve të shqipes së njësuar letrare kombëtare*, në anën tjetër, prandaj rreth kësaj tematike të paqartë mund të shtrohen një varg pyetjesh, ndër të cilat po

1) A mund të lihen anash, tani, jashtë standardit, shprehjet me vlerë idiomatike me paskajoren e mirëfilltë, duke ia lënë ato në prehër *një dialekti* a të *folmeje* aktualisht jo të normëzuar?

2) Si mund t'i adresohet, fundja, një varianti të *gjuhës letrare (geqe (!))*, i cili realisht ishte i “leçitur” (= faktikisht i përjashtuar) nga përdorimi standard, tash 50 e sa vjet?

3) Si mund të *kultivohet* normalisht ajo *gjuhë letrare* në të mirë për *brezat e tashëm e breznitë që vijnë*, kur dihet fare mirë se, sot për sot, ajo, institucionalisht, nuk mësohet askund?

4) Kur dihet, apo jo, se një gjuhë e tillë as si hije e letrarishtes nuk del e favorizuar dhe institucionalisht nuk ka as *drejtshkrim*, as *gramatikë*, as *fjalor normativ* të rekomanduar, shtylla këto të domosdoshme për çdo gjuhë shkrimi?

5) Kur dihet, siç e thekson Mehmet Çeliku, se *“koinea veriore edhe në nivelin e nënstandardit pushoi artificialisht dhe padrejtësisht së shkruari”* (Shih: *Çështje të shqipes standarde*, Tiranë 2000 f. 106)?

6) Kur dihet, gjithashtu se një variant i tillë nuk pati përkuqdesje as zhvillim normal për një kohë relativisht të gjatë, ngase, siç e thekson Niketa Stefa, *sot s'kena para nesh një gegnishte në lulëzim as si në vitin 1940, kur gjuha e Elbasanit si zgjidhje low court nuk ekziston ma, kur gegnishtja e ka humbur qendrën gjeografike të Shqipërisë?*

7) Gjithashtu, do të shtonim ne, kur dihet se *gegërshtja letrare* (bashkë me simbolin e saj *paskajoren me + pjesore*) në Shqipërinë e pas vitit 1944 filloi menjëherë të injorohet, kështu në vitin 1945 filloi të hiqet nga shtypi, në vitin 1946 nga librat shkollore dhe në vitin 1951 u bë heqja e saj me *Vendim qeverie*, fakt ky që sipas Leonardo Savoias, ishte *një vendim politik, i cili detyron përdorimin e një varianti të standardizuar të tipit toskë në Shqipëri* (Aty f. 42), por që, si i tillë, del i aminuar (=arsyuar shkencërisht) edhe në sesionet *shkencore të viteve 1951, 1952* (Fakte këto që dëshmohen katërcipërisht nga gjuha e anuar e Fjalorit serbokroatisht - shqip (1947) dhe e Fjalorit të gjuhës shqipe (1954), botime të Tiranës, si dhe nga shkrimet e njohura teorike-publistike të B. Becit, M. Elezit, Blendi Krajës, Ledi Shamkut etj.)?

8) Kur dihet, gjithashtu, se edhe në Kosovë (ish-Jugosllavi) pas Konsultës së Prishtinës më 1968, u hoq nga përdorimi gegnishtja, pasi u përqaftua me entuziazëm, jo pa të drejtë për rrethanat, gjuha letrare zyrtare e *vendit amë*, kuptohet *gjuha shtetërore* mbi bazë të toskërishtes (pa paskajoren me + pjesore), kur edhe nga krijuesit e punëtorët shkencorë, shkrimtarët e intelektu-

alët, përthyesit e publicistët etj. te ne e gjithandej, u kërkua që jo vetëm të manipulojnë tash e mbas vetëm me gjuhën e njësuar, por që edhe veprat e tyre të botuara më përpara t'i përkthehin në gjuhën e re të njësuar, pra, pa paskajore?

9) Kur nën bekimin e profesorëve të tyre, studentët tanë, bashkë me shumicën absolute të një armate të tërë arsimtarësh, nëpunësish e intelektualësh, ndër ta edhe autori i këtij vështrimi, sfidonin se kush e kush do ta fliste më mirë shqipen e unisuar (asfaltuar!?) sipas R. Ismajlit) pa paskajore, duke i bërë, si me thënë, "hit", në biçim të një kënge popullore, vargjet: *Fol shqipjo fol me mend / paskajoren mos e përmend(!)?...*

T'i rikthehemi tani temës në shqyrtim. Plotësisht pajtohemi me shpjegimin që e thekson prof. Mehmet Çeliku lidhur me mishërimin e paskajores në kohëhapësirën përkatëse të gjuhës sonë. Ai thotë "Paskajorja e pavarur (pikërisht) në funksion fjalie është rezultatë e konsolidimit të plotë dhe e përdorimit të gjerë të saj, në një shtrirje kohore shumë të gjatë në gjuhë" (Aty f. 91). Pra, duke e falenderuar profesorin për këtë konstatim-ndihmesë, po shtojmë, me guximin që na jep e drejta, se paskajorja pasi kishte mbështetje të thellë në natyrën e gjuhës shqipe, në sistemin e saj të ravijëzuar me shekuj, që nga thellësitë e kohës, ajo nuk u zhduk, ngase vazhonte të përdorej në gjuhën e familjes, në tregti e në komunikime të tjera, madje edhe në traditën e shkrimit për nevoja interne, por që vazhonte të përdorej, paksa ende, si këtu si atje, nga ndonjë krijues i fshehur. Pra ajo, në të vërtetë, nuk u zhduk nënvetëdijshëm asnjëherë, as në gjuhën kuvendore të **klasës dominante** te ne, e cila e formëzoi një gjuhë paksa elite praktike pa e përjashtuar paskajoren, gjithsesi geqe, po me mjaft trajta të normës së shqipes letrare të përbashkët, ngase ashtu ishte në parim edhe drejtshkrimi i gjuhës shqipe te ne (i cili nuk quhej i gegërishtes, por i gjuhës shqipe) deri në fund të viteve të '60-a (Shih edhe *Ortografia e gjuhës shqipe*, Beograd 1964). Nën këso kushtesh, ç'është e drejta, paskajorja del mjaft e dëmtuar dhe vazhdon të jetë e dëmtuar, sidomos në gjuhën e shkrimit. E kam fjalën, jo vetëm për 7 shfaqjet devijuese në *shqipen letrare* gjuhëzore konkretisht në librin *Paskajorja...* (f. 97), por edhe për shfaqje të tjera, prandaj pas gjithë kësaj rrëmujë ndaj paskajores, nuk janë të paktë ata që shtrajnë pyetjen: *A kishte me qenë më mirë që një formë e tillë, që është e pranishme në të ashtuquajturat gegnishte, edhe pse institucionalisht të panor-9.01.03, f 9), në Shkodër e gjithandej gegnishtja lokaliste e konzervuar, klasike (e në kujtesë: vatrë historike e pashuar sipas A. Klosit), në Krujë-Ti-*

*ranë-Durrës gegnishtja jozyrtare (e masës), në Malësi e Mirditë e gjithandej e këndeje gegnishtja (hije)rëndë (me shprehje epike-kanonore), në Kukës-Te-  
tovej - Gostivar - Kërçovë gegnishtja (e mesme) muzikale me zanore të  
shqephta, në Elbasan e gjithandej deri në Dibër etj. e përdëshirueshmja  
gegnishte e butë, siç e quan Kostaq Xoxa (Shih gazeta 55, 14.04.2004, f. 14)  
etj., për vlerat që ka, të inkuadrohet në kuadër të shqipes standarde? A s'është  
më mirë, po e përsërisim ne, që ajo të këndellet edhe në gjuhën e shkrimit dhe  
kjo këndelje të vijë në mënyrë institucionale, gjithsesi nën bekimin e shqipes  
standarde, duke e fituar të drejtën që i është mohuar, sesa të pritej një risistemi  
i një gjuhe letrare pangebërishte (term i S. Rizës) ende heterogjene, e cila edhe  
mund të bëhet homogjene a si një "gegnishte korrekte e ringjallur" nëse  
detyrohet, nga nevoja socio-lingustike, duke u pajisur ose duke i shfrytëzuar  
pikërisht vlerat e veta të injoruara nga standardi i sotëm dhe kështu për hir të  
shtrirjes më të gjerë që ka në masë, ajo të lëvizë përpara nga nënstandardi në  
standard, sepse, siç thuhet, fundi i fundit: *Gjuhën e maleve të Dibrës e marrin  
vesht edhe zogjt e maleve të Shkodrës*" (T. Kolgini), duke fituar ndoshta prestigj  
ndërgjegjor, gjithnjë e më në rritje të dalë në rivalitet a paralel me letrarshiten  
e sotme, vetëm e vetëm pse ndonjë gjuhëtar me ndikim i elitës së sotme nuk  
është në gjendje me e kuptue rolin e mbarë që mund ta luajë paskajorja bashkë  
me elemente të tjera në përsosjen e standardit të shqipes së sotme mbarëkom-  
bëtare (brenda vetë standardit) që është në të mirë edhe të toskëve edhe të  
gegëve dhe të kulturës mbarëshqiptare në përgjithësi?*

Kur është fjala te Konsulta e Prishtinës dhe pjesëmarrësit kosovarë në  
Kongresin e Drejtshkrimit, do të na lejohej ta bëjmë një digresion të vogël.  
Kombëtarisht, për mendimin tonë, intelektualët tanë (nga ish-Jugosllavia)  
vepruan drejt, madje edhe gjuhësisht mund të arsyetohej, kur kemi parasysh  
atë kohë, kur s'kishte mundësi për kurrfarë oponece a përplotësimi serioz pa  
hapur gërricje të mëdha brendagjuhësore që mund të cilësoheshin si skandale  
të papërballueshme shoqërore-politike për kohën. Por sipas një logjike  
burnnore (kanonore) vetëdëborëzimi i fatit i kosovarëve (shqiptarëve gegë në  
Jugosllavi me gjuhën e tyre geqe (më 1968) duhet të nxishte respekt e si rrjedhojë  
edhe lëshime të vetëkuptueshme në dobi të tyre nga vetë Qendra, por për çudi,  
atje nuk pati kurrfarë lëshimi as farë mëshire, për këtë pikë, ndaj gegërishtes,  
madje duke shfrytëzuar këtë deklarin vetëmohues të gjuhëtarëve gegërisht-  
folës nga Kosova, u ndrydh më lehtë kërkësë-dëshira e ndonjë gegërishtfolësi  
të atjeshëm që guxonte ta belbëzonte. Përkundrazi, pra, bashkë me paskajoren  
e pjesoren geqe të parahabilituar, katër vjet më vonë (pas Konsultës së Prisht-







2002), i cili ndonëse më përpara shihnte vështirësi morfologjike për disa raste lidhur me inkudrimin e paskajores me + pjesore, tani ai gjen mënyrën më të lehtë për ta inkorporuar atë, do me thënë, me anë të shprehjeve frazeologjike, kur thotë se “*fjalë- frazeologjizma e deri edhe disa modele fjalëformuese e togfjalësha do të merren prej andej jo sepse janë të këtij apo të atij dialekti, jo pse janë të këtij apo të atij autori, po sepse atyre ua ka nevojën shqipja standarde dhe sepse do të mund ta pasurojnë standardin ose të japin ngjyrimë të reja, qofshin edhe figurative*”. Edhe më qartë shprehet prof. Gjovalin Shkurtaj me fjalët: “*në mënyrë të veçantë duhet t’i qasemi pasurisë, larmisë dhe forcës shprehëse të leksikut e të frazeologjisë së krahinave të Veriut, të cilat duhen vlerësuar e vështuar kurdoherë si burime të freskëta dhe të prurjeve të domosdoshme për gjuhën letrare të përbashkët (Aty f.278), por .Petrit Kotri e Tefë Topalli, në anën tjetër, shprehin një propozim edhe më konkret dhe më me interes, por që kërkon kohë, shumë mirëkuptim e jo shumë mjete për t’u realizuar: “Në të gjitha universitetet shqiptare duhet të bëhet objekt studimi e krahasimi edhe gjuha e mjaft autorëve të shquar të letërsisë shqipe si Fishia, Koliqi, Camaj, Haxhiademi etj., nga pasuria gjuhësore e të cilëve ka çfarë të marrë standardi i sotëm, sidomos në fushën e leksikut, në frazeologji e në shumë mënyra të thëni. E nënvizojmë këtë, sepse na duket fatkeqësi që brezat e sotëm e kanë të vështirë (dhe nesër do ta kenë të pamundur) të arrijnë perceptimin artistik të krijimtarisë së shumë autorëve, për shkak të gjuhës... Kjo gjë do të na çonte drejt një përfshirjeje të natyrshme të disa elementeve të pasurisë së leksikut të gegërishtes në gjuhën standarde, duke bërë që të shkojmë drejt zgjidhjes së problemeve të ndryshme gjuhësore, si **ngritja e natyrshme e paskajores geqe në rrafshin e normës** etj., që mund të arrihet me pasqyrimin tekstual të gjuhës së letërsisë në të gjitha nivelet shkollore (Po aty f. 409)*”.

Po kësaj fryme i përket edhe kërkesa e Mehmet Çelikut, i cili, në një punim pak më të hershëm të tij, prekte këtë çështje, ku veç tjerash kërkonte me të drejtë “*tolerancën me afrimin e standardit me gegërishten letrare*”, ngase më parë synohet të afroheshin dy variante letrare gegërishtja letrare me toskërishten letrare, pas Kongresit të Drejtshkrimi dhe nga vitet e ardhshme konvergimi synon kryesisht afrimin e arsyeshëm dhe të mundshëm të standardit me **gegërishten letrare**” duke shtuar se “*gurra popullore, sidomos gegërishtja të pashfrytëzuara sa duhet për pasurimin e shqipes standarde do të vazhdojnë edhe më tej të sjellin prurje të reja*”, sepse, sipas tij, “*gjuha popullore nuk është shfrytëzuar sa duhet, sidomos thesari leksikor e frazeologjik verior dhe është, siç shprehet ai me këtë rast, për një qëndrim tjetër ndaj formave të pashtjelluara*

*të foljes* (ku ne duam ta kuptojmë domosdo edhe qëndrimin tolerant ndaj paskajoren me + pjesore) dhe përfundon duke arsyetuar tolerancën e tillë në përdorim se “*dy variantet do të përbënin dy mundësi të ndryshme shprehjeje, dy mjetet gramatikore do të shërbenin për një komunikim sa më të saktë e më të hollë* (Shih edhe te vepra: M. Çeliku, *Çështje të shqipes standarde*, Tiranë 2000). Natyrisht nga citatet e tilla të nxjerra nga veprat e sipërpërmendura të tij dhe të tjerëve, mund të nënkuptohet pa vështirësi se ky konvergim standardi s’ka se si të bëhet pa afruar dhe përhithur në gjirin e vet norma standarde gjithë nektarin e frazeologjizmeve e të shprehjeve të tjera me vlerë të gegërishtes, kuptohet të ngërthyera e të pajisura edhe me formën e paskajores, sepse fundi i fundit, siç imponon logjika, s’ka pasur as nuk do të ketë **gegërishte letrare** të vërtetë e të plotë pa paskajoren e saj karakteristike, e së këtejmi s’do të ketë as normë standarde të qëndrueshme pa i përfshirë vlerat kryesore karakteristike të të dy dialekteve, siç janë, b.f., rotacizmi (trajtat e rotacizuara) me plot muzikalitet për toskërishten dhe paskajorja me plot shprehje lapidare për gegërishten.

Me thënë të drejtën, ne kemi mendim mjaft të prerë mbi këtë çështje. Sipas nesh, edhe pse *rotacizmi*, si fenomen, ishte kohësisht i kufizuar në një periudhë të caktuar historike, pastaj pushoi së vepruari, sepse kryesisht me ardhjen e sllavëve e këndeje, siç thuhet, bashkëtingëllorja -n- nuk kalon tash më në -r-, si në kohë më të hershme, ndërsa *paskajorja* ka veprimësi të pandërprerë, ne nuk do të parapëlqënim që standardi mbarëkombëtar të jetë, qoftë pa trajta të rotacizuara, karakteristike të dialektit toskë (të përjetësuara nga gjuha e sotme letrare), qoftë pa trajta të paskajores geqe (ende të papërvetësuara). Andaj për ne do të jetë i papranueshëm në parim dhe faktikisht e çuajmë të paplotë çdo drejtshkrim, ku të mos jetë i përfshirë plotësisht rotacizmi siç ishte b.f. **Ortografia e gjuhës shqipe** (Beograd 1964) ashtu si edhe **Drejtshkrimi i gjuhës shqipe** (Tiranë 1973), pa përfshirjen e paskajores, ngase emërtimi **normë e gjuhës shqipe**, ka kuptim të përplotë vetëm atëherë kur përfshihen në të, bashkë me të tjera, edhe vlerat e të dyja këtyre komponenteve. Gjithsesi është me vend kërkesa që edhe lidhur me këto dukuri kërkohet masë. Duhet respektuar kriteret përkatëse. Fundja kërkesa jonë, në parim përputhet me një pjesë të mendimit që shpreh prof. Anastas Dodi, kur thekson se *gjuha letrare shqipe nuk paraqet një trajtë të kulluar, të pastër të dialektit bazë*, ngase për të bashkëpunimi **ndërdialektor** përbën një dukuri të zakonshme, sepse ajo ka *qenë dhe është e hapur për të thithur gjithë elementet strukturore e leksikore që i nevojiten asaj* (nga dialekti tjetër), të cilat hyjnë në marrëdhënie të reja me

elementet që ekzistojnë në gjuhë, duke u bërë kështu pikënisje për zhvillime të reja në gjuhën letrare, sepse gjuha letrare tani e ka të krijuar një sistem të vetin mbidialektor dhe bën një jetë të mëvetëshme (Shih: Studime 4 f.84), prandaj edhe kërkesa jonë lidhur me inkuadrimin e paskajores me + pjesore ka të bëjë pikërisht me këtë sistem mbidialektor e jo me mikrostrukturën e dialektit të toskërishtes. Madje kjo kërkesë jona nuk është diçka e pazakonshme, edhe pse shkon edhe më larg nga pikëpamja e politikës gjuhësore, ngase, siç jemi shprehur në një vend tjetër, është mirë që atë që e ka bërë Prishtina më 1968 (kujto: Konsultën gjuhësore të Prishtinës), kur symësheltas por me sytë e mendjes hapur u vendos që të ne të përdorej ajo normë e gjuhës letrare, e cila do të miratohej në Shqipëri, në njëfarë mënyre duhet ta bëjë Tirana tash, jo euforikisht, por me logjikë të shëndoshë, me interpretime shkencore e me gjakftohtësi, sepse duke ia bashkuar normës standarde disa elemente të rëndësishme të gegërishtes (kuptohet edhe të kosovarishtes dhe trevave të tjera gegërishtfolëse) që për ndonjë arsye më përpara kishin mbetur jashtë saj ose nuk njiheshin sa duhet, standardi do të fitonte shumë kombëtarisht e funksionalisht dhe nuk do të pësonte kurrnjë të keqe. Kështu po themi, ngase janë pjekur kushtet për një veprim të tillë madhor me interes kombëtar, sepse, tani kanë ndryshuar raportet dhe është e vërtetë se asnjëri sot nuk del haptazi kundër përdorimit të paskajores me + pjesore të shkurtër (kuptohet të ashtuqajtur të gegërishtes) në tri-katër nënfushat semantike që po i përsërisim disa herë, siç janë: përfaqësimi, shprehjet frazeologjike të një abstraksiioni të lartë, shprehjet me vlerë nga sfera e krijimtarisë letraro-artistike si dhe nga sinonimia në raste të caktuara, sidomos kur kemi të bëjmë me natyrën e tipizimeve përkatëse ose me thënie që e njomin kontekstin, sepse elementet e tilla gjithnjë e më tepër konsiderohen, siç janë me të vërtetë, pasuri e padiskutueshme gjuhësore e kulturore e gjuhës shqipe, edhe e toskërishtes. Edhe Ledi Shamku ka qëndrim mjaft kategorik në të mirë të këtij veprimi programor, kur thotë: "Në këto kushte Tirana zyrare duhet të marrë pajtë tërë përgjegjësitë e saj, jo vetëm me natyrë shkencore, por edhe politike – e për rrjedhojë historike..., ngase fanatizmi i mbrojtjes së "kalasë" së shqipes standarde, duke u ndryrë në llogorë e saj të brendshme dhe duke e shpërfillur ndërveprimin me zonat (gege) përreth, do të shpjegë me gjasë në rënie e kësaj "kalaje... Me fjalë të tjera, vazhdon ajo - një qëndrim i mëtejshëm fanatik i gjuhëtarëve shqiptarë, dashur pa dashur, do t'i shndërrojë ata në bashkautorë të secesionit gjuhësor" (Aty f. 13). Edhe studiuesi A. Klosi pasi rikujton se çështja për rishikimin e normës nuk është ngritur vetëm për Kosovën, por më gjerë, d.m.th. edhe për viset gege në

Shqipëri, jep mendim të prerë se "Reformimi dhe përmirësimi i standardit është i domosdoshëm, veçse me tryezën e gjerë, - ku do të merrnin pjesë, sipas tij, - përfaqësues të vërtetë të grupeve të interesit kulturor-arsimor- gjuhësor... nga njerëzit që kjo gjuhë u dhemb dhe jo nga ata që duan të ruajnë me çdo kusht kolltukët e shqepur të Akademisë". E thënë ndryshe, ky nuk ka besim në disa nga akademikët e sotëm, ngase ata tash më dhjeta vjet, duke e mbajtur amull normën e sotme, d.m.th. kryesisht me dominim të toskërishtes, nuk po bëjnë mirë, sepse po e zvarrisin këndelljen dhe kështu njëherazi po e dëmtojnë rrugëzgjidhjen e çështjes në mënyrë sa më të denjë. Me thënë të vërtetën, në kemi qëndrim paksa tjetër. Nuk duhet t'i përjashtojmë asesi akademikët tanë nga ky proces, po të kërkojmë nga ata që më esull të trajtojnë çështjen në diskutim. Edhe pse, vërtet, siç thuhet, toskërishtja letrare mund të gjëllojë pa paskajoren gege, në njërën anë, si edhe gegnishtja letrare mund të gjallnojë pa elemente të rotacizuara, në anën tjetër, lidhur me këtë të vërtetë, në jemi kategorik për mosndarje. Madje me një ndarje të tillë askush nuk duhet të jetë i kënaqur. Vetëm me të dyja këto (rastet e rotacizuara e paskajoria) në një normë, pa e përjashtuar asnjërin prej këtyre elementeve, norma përkatëse e letrarisht meriton të quhet me plot gojë normë e shqipes standarde. Aq më tepër, kur ka prova të forta se edhe paskajoria edhe trajtat e rotacizuara normalisht dhe për mrekulli mund të bashkëjetojnë në shqipen standarde, ashtu si edhe lidhorja e paskajoria, prandaj sforcimi i një bashkëjetese të tillë duhet përkrahur pa kurrfarë ngurrimi, ngase është në interesin e gjuhës shqipe dhe të kombit tonë, një dhe të bashkuar në një standard gjuhësor.

Besojmë se synimi ynë përputhet me mendimin e shprehur nga dr. Shefkije Islamaj, kur thekson se "Gjuha standarde shqipe si e kemi dhe të tillë si do ta bëjmë në rrugën e zhvillimit të saj, është dhe do të jetë gjuha e të gjithë shqiptarëve, do të jetë gjuha shqipe e pasuruar nga dy gurrat e saj të gjalla e nga shumë nëngurrat që vazhdojnë ta zgjerorin e përtërijnë e ta freskojnë substancën e strukturën e saj (Java 2.II.06, f. 31).

Sidoqoftë, ende mbesin mjaft gjëra të paqarta e ngurrime të tepruara nga individë të caktuar, mjerisht, jo pa ndikim, qoftë rreth përjashtimit të trajtave me rotacizëm, qoftë ato me paskajoren e mirëfilltë. Kishte dhe ende ka, pra, tendenca që ato shprehje karakteristike me paskajore të "përkthehen", duke u përshatur në gjuhën e sotme letrare me forma të tjera, qoftë edhe dosido, duke i injoruar trajtat nga origjina kinsë dialektore (!) që nuk i njihka standardi! Ndër ngurruesit e tillë mund ta ndeshim, mjerisht, edhe ndonjë gegërishtfolës, vetëmohues, adhures i flaktë a mbrojtës fanatik, ose, më mirë me thënë,

keqkuptues i standardit bashkëkohor. Madje, fatkeqësisht, individët e tillë mund të jenë edhe, mledhës të folklorit, frazeolog e gjuhëtarë, me emër e mbiemër, të punësuar në institucione profesionale, të cilët nuk dimë sa janë të vetëdijshëm se me një qëndrim të tillë shpërfillës ndaj paskajores e pengojnë jashtëzakonisht shumë mbarëvajtjen e kulturës gjuhësore të kombit tonë.

Natyrisht, jo njerëzit, por lajthitjet e tilla së shpejti shpresojmë, siç dëshirojmë, të mbesin *të kaluara, të harruara!*

## V

### A KA ARSYE TË HESHTET EDHE MË FUNKSIONI PËRFAQËSUES I PASKAJORES ME + PJESORE TË SHKURTËR

Nuk është vepruar mirë, për mendimin tonë, pse deri tani nuk është trajtuar më në hollësi dhe më me zë, raporti *dëftore / paskajore*, qoftë edhe sipas realitetit: *normë/sonormë*, me ç'rast funksioni përfaqësues i paskajores së mirëfilltë në gjuhën shqipe do të dilte shumë më i nëpërdukshëm në teksteve tona normëzuese. Dihet se pikërisht këtë fakt prof. Selman Riza ua shihte mungesë shkencore K. Cipos e Sh. Demirajt, të cilëve, siç thoshte ai, "*karakterin shkencor më së fortë ua ka komprometuar pikërisht operimi me dëftoren e tashme si të vetmen formë foljore bazale, duke theksuar se të vetmën formë themelore të një foljeje e përbën jo e tashmja e dëftores, por paskajorja (kuptohet: pjesorja e shkurtër e paskajores" N.V.) (Shih, S. Riza, Vepra 2, f. 287). Për ne që të dyja format përfaqësuese veta e parë njëjës e dëftores dhe sidomos paskajorja me + pjesore e shkurtër (kupto pjesorja), e cila dallohet me aftësi jo vetëm fjalëformuese, por edhe kohëformuese e formëformuese, bashkë me trajtën e së kryerës së thjeshtë, janë të domosdoshme në analiza morfologjike, ngase ato e përplotësojnë njëra-tjetrën (Shih: N. Veselaj, *Foljet më -O në gjuhën shqipe*, Prishtinë 2002, f.16).*

Lidhur me këtë, jemi borxhli ta themi të vërtetën se, si prof. Sh. Demiraj, ashtu edhe prof. M. Çeliku e të tjerë, në punimet e tyre shkencore, si shkencëtarë të vërtetë që janë, e cekin qartë dhe nuk e mohojnë funksionin përfaqësues "*të formës së paskajores të foljeve përkatëse*" (Shih. Sh. Demiraj, *Gramatika historike....* f. 1008), mirëpo nuk e praktikojnë në përditshmëri, së paku si fakt ndihmës, vetëm e vetëm për shkak se kjo formë nuk dalka e lejuar, respektivisht nuk dalka e pranuar nga norma letrare mbi bazë të toskërishtes(!). Pa marrë parasysh këtë të vërtetë të diskutueshme ose, më mirë me thënë, të keqkuptueshme(!), konstatojmë se dëshmia më e mirë është se trysnia e paskajores për këtë qëllim nuk ka pushuar asnjëherë, madje nuk është pa shtytje



edhe aktualisht dhe ky presion nuk është i një përmase të vogël. Veç tjerash, kemi parasysh edhe *rrefimin* për të ashtuquajturën "*shkelje*" me vetëdijë që detyrohet t'ia bëjë "normës" prof. Rahmi Memushaj, *shkelje* kjo, të cilën e arsyeton, me gojë të vet, po në atë Konferencë (2002). Ja si shprehet ai: *Lidhur me paskajoren, këtu u diskutua mirë problemi* (mbase duke e lënë variant të lirë a për mosfutjen e saj menjëherë në standard! N. V.), *por mua më del se nga pikëpamja e sistemit kjo formë nuk hyn në sistem* (ndoshta e ka fjalën për standardin mbi bazë të *toskërishtes* e jo për sistemin global të gjuhës shqipe, që e ka në koncept prof. Bokshi? N. V.), *mirëpo ka diçka tjetër* - thekson ai - *Duke shkruar një libër mësimor për studentët doja të përktheja foljet që ishin në paskajore, dhe i kam vënë sipas tipit me punue.* Kështu nuk dihet ecuria e procesit, sepse *praktika nganjëherë mund të japë zgjidhje që teoria nuk i pranon* (Aty f. 434). Veprimi i prof. Memushajt, tregon se nevoja për lejimin institucional a inkuadrimit e paskajores së mirëfilltë në normë nuk pritet, sidomos për nënfushën semantike të përfaqësimit, dhe në këtë punë Memushaj nuk është i vetmuar. Kështu kanë vepruar **praktikisht** në të kaluarën e po veprojnë normalisht, me sa dimë, siç i vërejmë, në raste, në shkrimet e tyre, sot e gjithë ditën, edhe shumë gjuhëtarë tanë të njohur, ithtarë të normës së sotme, si prof. L. Mlaku, prof. Koleç Topalli, prof. David Luka, prof. Gjovalin Shkurtaj, prof. A. Tirka, prof. I. Bajcinca (në disa raste lektorimi), Q. Murati (Shih *Trajtesa albanologjike*, Prishtinë 2005, 24), A. Konushevc, e plot e plot të tjerë, sidomos shkencëtarë të rinj me perspektivë, të cilët po e përdorin pikërisht paskajoren e mirëfilltë me + pjesore të shkurtë, si trajtë përfaqësuese, kundrejt barasvlerësve përkatës të gjuhëve të huaja. Gjithashtu, po këtë trajtë po e përdorin në analiza përkatëse shkencore e publicistike mjaft studiues e intelektualë, ndër ta janë edhe: Mehmet Elezi, N. Veselaj, Xhavit Beqiri, M. Gjevari, G. Berljolli F. Shehu, N. Lesi e të tjerë, duke argumentuar kështu se paskajoria mund të përdoret si rast i veçantë, pa u ndërlikuar domosdo me paradigmat e sintagmat e sistemit foljor të gegërishtes dhe nuk e lëndon po e plotëson në mënyrë të dukshme dhe cilësorisht normën e shqipes së sotme letrare. Gjithashtu, po e përdorin paskajoren, pothuajse normalisht mjaft intelektuale e pushtetarë andej e këndej, pa u larguar nga norma zyrtare, andaj një fakt i tillë nuk është mirë të heshet, por, gjithsesi, duhet të përligjet sa më parë nga standardologët tanë të sotëm.

C'është e vërteta, nuk është i vogël numri i gjuhëtarëve dhe i intelektualëve, si vendës ashtu edhe të huaj, të cilët normës së shqipes standarde ia shohin të metë jo të vogël, pikërisht, mospërfshirjen e paskajores me + pjesore në gjirin

e saj. Përveç reagimit të 11 rezervshprehësve vendës rreth zgjidhjes me mohim të paskajores, intelektualë e studiues të sprovuar si: Rexhep Ismajli, Tafil Kelmendi, Fadil Sulejmani, Mehmet Çeliku, Fadil Raka, Ardian Klosi, Pal Doçi, Tomor Osmani, Engjëll Sedaj, Avni Presheva e Mehmet Gjevari, të cituar në librin *Paskajoria çështje e shqipes standarde* (f.46-48), po i përmendim në vijim edhe 15 të tjerë vendës e dy të huaj, paraqitjet e të cilëve, për mendimin tonë, zgjojnë interes:

1) Ishte Tahir Kolgjini (Java, 6.04.'02, f.27) ai që ndër të parët paska paraqitur faktin se mungesa e paskajores edhe si trajtë përfaqësuese paraqet varfërimin e normës së shqipes, duke nënvizuar se "*Kur kemi ne forma të veçanta (si paskajoren) përse të mos i përdorim. A do të ishte e udhës me bojkotue, ose ma mirë të thomi, me leçitun një pjesë të shqipes? Në këtë mënyrë gjuha, në vend që të zgjanohet, tue lëshue dega, rrema e ngallore, vjen e kufizohet në një rreth të ngushtë.*"

2) Edhe Martin Camaj mendonte se është e pakuptueshme të refuzohen dy trajtat e pashjtelluara të foljes me paskajoren e tipit me pjesëzën me + pjesore (me punue) dhe pjesëzën me + pasë (qenë)+ pjesore: me pasë punue, duke formuar dy kohë: kohën e ardhme: kam me punue dhe kohën e ardhme të përparme: kam me pasë punue (sipas E. Sedaj).

3) Artan Haxhi të Hylli i dritës 2-3, '93 (Tiranë), del mjaft kategorik kur thekson se "*mungesa e infinitivit (të gegërishtes) e varfëroi dhe shembuj të këllillë të varfërimit të gjuhës (kombëtare) nuk dihen në botë.*"

4) Edhe Besnik Dizdari (Java, 21.11.'02 f. 11) thekson: "*gjithë kjo antishkencë* (mendon për forcën e pushtetit politik e letraro-intelektual të atëhershëm) *që toskërishtja letrare të jetë gjuha zyrtare e Shqipërisë dhe e quajti gjuhë të njësuar, p.sh. foljen anglisht: to be si trajtë përfaqësuese në shqip e shënon me barasvlerësin jam në vend me qenë, ndërsa atë të italishtes sapere di në vend me dije.*" Sipas tij një veprim i tillë ishte thejshet alergji ndaj paskajores që sa fort do ta pasuronte gjuhën shqipe.

5) Ardian Ndreca (Java, 9.01.'03, f. 11), duke folur me mllaf për padrejtësinë që i ishte bërë gegërishtes e lirisë së shprehjes në atë kohë thekson me ironi: *Duhe zhdukë (...)* deri edhe një mënyrë e foljes: *paskajoria ose infinitivi që të kujton lirinë... Si mund t' u linte në kambë infinitivi, kur çdo gjë në Shqipni ishte e kontrollueme prej policëve dhe spiujve të paguem ose vullnetarë, aq më tepër kur infinitivi si aspiratë ishte ndrydhë, mbytië zvogëlue e kufizue në një jetë që s' ishte ma (jeta) me jetue, d.m.th. jetoj pa skaj, por një (jetë) unë jetoj (me vështrësi), d.m.th. jetoj sot për nesër.* Në një burim tjetër, po ky autor.

pasi e quan moment fatal: përzanjen e paskajores prej sistemit të gjuhës shqipe, shpjegon se si forma sintetike, foljet me paskajore shprehin distancimin e veprimit prej subjektit që e kryen apo e pëson atë, veprim ky që në logjikë krijon mundësinë e formimit të konceptit, kurse ky i fundit asht hapi logjik që ban të mundun gjykimin, pra zbulimin e së vërtetës, ndërsa me veten e parë të dëftores nuk mund të kuptohet gjë rreth natyrës së një folje je dhe as nuk mund të ndërtohen kohët e mënyrat e tjera të foljeve (Shih: Java, 11.06.'05, f. 19).

6) Edhe Eugjen Mërlika (Java, 1.07.'04, f. 20) gjithashtu me ironi, madje sarkastike, prek këtë çështje me fjalët: *Lu dha edhe një formë "shkencore" vendimeve politike, duke arritur në marrëzinë e zhdukjes së paskajores, një mënyrë zgjedhimi të foljes që e hasim në të gjitha gjuhët e njohura të Europës, vetëm sepse toskërishtja nuk e kishte.*

7) Avdi Baleta, mëshon politikisht mjaft furishëm: *Infinitivin e foljes e ekzekutovan (...) që t'i shërbenin politikës së kolonizimit toskë edhe në fushën gjuhësore në hapësira gëra (Bota sot, 26.03.'2000, f.9).*

8) Edhe Skënder Buçpapaj shkon mjaft larg, ai konstaton se "mungesa e rehabilitimit të paskajores së shqipes nga gjuhëtarët tanë e ka shtuar edhe në shumë pëshjtjellimin, jo vetëm, në rastin konkret **zgjidh** (me zgjidhë) e **zgjedh** (me zgjedhë), por edhe në një mori përdorimesh të tjera të rrëmujshme të shqipes (Bota sot, 16.05.'2001, f.4).

9) Më gjerësisht e më shtuar se të gjithë të tjerët këtë temë e trajton Mehmet Elezi, në artikullin: **Paskajoria : gjuha shqipe** (botuar në gazetën 55, më 7 prill 2004 . f. 10-11), i cili pasi në titull e **barazon paskajoren me gjuhën shqipe**, fillon me pyetjen: *A kish arsye gjuhësore, pra, jopolitike me u sllije mënyra paskajore e foljes në themelet e standardizimit të gjuhës shqipe? (dhe e abstraktionit gramatikor në sistemin foljor të një gjuhe, Ajo përbën formën më përfaqësuese të foljes përkatëse. Kësajor asgjësimi artificial i paskajores shqipen e gjallë (konstaton ai) paskajoria ka mbijetuar plot jetësi. Sot e kësaj Po jo vetëm prej atyre. Ka pasur prijte që paskajoria të gjallojë edhe në toskërisht (Konica, Grameno)... Paskajoria gjindet edhe në disa këngë popul-përdorim shumë të gjerë, ashtu si dhe te simotrat e mëdha europiane (...). Asgjësimi i paskajores është asgjësimi i shumë vlerave artistike të papërsëritshme e të pazëvendësueshme në gjuhën shqipe, përfshi fjalë të urta e shprehje*

frazelogjike, madje, fuqia shprehëse e kësaj mënyre të foljes në poezinë shqipe, shkon deri në kufijtë e magjisë (...) Morali i studiuesit dhe morali njerëzor këshillojnë me e ripa skajimin të cilit i janë përmabajtur me fanatizëm (normëvënësit dhe pasuesit e tyre N.V.)... Standardi mund dhe duhet të rishikohet për të parë ku ka sjellë të mirë e ku është bërë pengesë e ku ka sjellë shtatërrim. Gjuha duhet lejuar të marrë frymë. Rrjedhat e kulluara, nga të gjitha trojet ku flitet shqipja, duhet të derdhen ne lumin e saj. Rregullat e standardit duhet të jenë gjithpërfshirëse për pasuritë e saj, jo përjashtuese. Problemi shikohet jo pse pësoi gegërishtja, po gjuha shqipe, degë të së cilës janë si gegërishtja edhe toskërishtja.

10) Punimi i M. Eleziti nuk mbeti pa jehonë, lidhur me këtë, Kostaq Xoxa, në mbështetje të kërkesave që shtron M. Elezi, konstaton: *Kundërshtarët për përmirësimin e standardit gjuhësor janë të mendimit se ky njësim (inkuadrimi i paskajores N.V.) është i papajtueshëm me strukturën, M. Elezi provon të kundërtën jo vetëm nëpërmjet këtij shkrimi, por edhe në shkrimet e tjera të tij. Pra, autori mendon se me këtë veprim praktik M. Eleziti i zhvlerëson kontaktimet e tilla përjashtuese, siç ishte edhe konstatimi i A. Dodit se gjoja "përpjekjet për ta inkadruar paskajoren e tipit me punue në sistemin e gjuhës letrare nuk patën sukses, sepse funksionet e saj i kryen kryesisht lidhoria si edhe në disa gjuhë të tjera (Shih. Letërsia shqipe dhe gjuha letrare, f. 227) dhe provon M. Elezi se inkuadrimi i paskajores së mirëfilltë është i mundshëm pa krijuar ndonjë vështirësi.*

11) Edhe Gjokë Vata (gazeta 55, 8.04.'04, f. 15) u bashkoi mendimeve të mësipërme, duke shtuar pyetjen: *Përse mos t'ia kthejmë sërish gegnishtes ( = shqipes letrare), ato që ia preu gërshana komuniste, fjala vjen, paskajoren, që asht guri themelor i gramatikave ma të përparume. Edhe sikur vërtet paskajoria të mos ishte e nevojshme, heqja e saj asht heqja e emnit folje...vetë fjala **infinitiv** e tregon si ma kryesoren e gramatikës".*

12) Po kështu, numri i rezervëshprehëve, ata që patëm rast t'i konsultonim, shkon gjatë, mirëpo ne tani po e dallojmë studiuesen Hava Shala - Qyqalla, e cila, veç tjerash, në një punim të saj shprehet mirë kur thotë se "me gjithë zëvendësimin e funksioneve të paskajores **me ba** me format foljore të lidhore, në shqipen e sotme letrare, ka disa fusha që nuk është shumë funksional ky zëvendësim dhe ndihet nevoja që të përdoret paskajoria me **me**, prandaj duke pasur parasysh frekuencën kaq të madhe të përdorimit të saj, sidomos në gjuhën e folur, si dhe sferat e ndryshme socio-kulturore, stilistike, artistike etj., ku ka nevojë të përdoret kjo formë, i bashkohem mendimit të atyre gjuhëtarëve,



të cilët duan që kjo formë të rishqyrtohet, të ripërpunohet ... edhe të integrohet në shqipen standarde (Shih: Seminari ... 21/2001, f. 473).

13) Gjithashtu edhe Shpëtim Këlmendi, me një ton mjaft fshikullues, me konstatimin se "mënjanimi i paskajores, aq e fuqishme dhe e domosdoshme, e cila i jep energji dhe pushtet ekspresiv gjuhës shqipe, është lënë mënjanim në mënyrë më të turpshme" (Java, 2.II.'06, f. 29), kërkon që t'i kthehet vlera e merituar kësaj forme në standardin e ardhshëm.

14) Edhe kërkesa, si ajo e Gazmend Berljollit (Shih: Java, 24.02.'05, f. 11) se "në bazë të standardit duhet me qenë paskajorja, mandej mbi atë bazë me rrjedhë natyrshëm tanë struktura e shqipes, tue ia nënshtrur tana trajtat dhe fenomenet gjuhësore" e të ngjashme nuk janë të panjohura e pa zë, sidomos në kohë të fundit te ne.

15) Po ashtu, tash, para dokohe, edhe Abdyl Sula, pasi tërheq vërejtjen se "kodofikimi i ngurtë i gjuhës letrare kryesisht mbi bazën njëdialektore e ka artificializuar dhe skematizuar atë dhe këto bashkë me prirjet joorganike modernizuese e intelektualizuese bëjnë që gjuha standarde të mbetet gjeografikisht e kufizuar për pjesën më të madhe të folësve, të mbetet më shumë gjuhë elite dhe mediatike, prandaj këto fakte ia zbehin vetë kësaj gjuhe rrënjët jetësore, venat e qelizat zhvillimore të saj", lidhur me paskajoren, të cilën e quan "çështje shumë të diskutueshme", shton: "mendimet e shprehura se përjashtimi i paskajores nga norma letrare nuk paraqet gjuhësisht ndonjë mangësi, pasi funksionet e saj i kryejnë lidhja dhe paskajorja e tipit për të punuar, nuk na duken plotësisht të motivuara... Paskajorja ka shprehësi më të madhe se ato, ngase funksionet e saj nuk përbushen plotësisht nga lidhja e paskajorja standarde e tipit për të punuar. Ajo del dendur në ligjërim edhe në funksion kushtor..." (Shih: Gjuha shqipe 1/2005, f. 74-76)

Sidoqoftë, po e përfundoj këtë pikë me mendimin e shprehur nga dy dashamirës të gjuhës shqipe, jo vendës:

1) Suedezi Ulman Ovisk, thekson: *Për gjuhën standarde mund të them se e ka një të metë të madhe ngase ka mungesë të paskajores, sepse paskajorja është element i të gjitha gjuhëve në Auropë* (Java, 26.08.'04, f. 20).

2) Albanologia amerikane Julli May - Kolgjini, pyet pak si me habi: *Pse mos me u përfshi paskajorja në standardin e shqipes. Është pusuri e kësaj gjuhe?!* (Java, 24.02.'05, f. 10).

Në kontekst të kësaj që u tha lypset theksuar edhe një fakt tjetër. Është e vërtetë se një numër jo aq i vogël gjuhëtarësh e intelektualësh, ndër ta edhe

ndonjëri i lartcituar prej nesh, po e shfrytëzojnë këtë zbrazëti që ka lënë heqja e paskajores me + pjesore e shkurtë nga norma, për me zënë shkas me kërkuje njëherazi rikthimin e nimit të gegërishtes letrare, me synim që të jetë kjo gjuhë (gegënishtja), madje edhe më e parapëlqyer dhe më e plotë nga vetë letrarishtja e sotme. Prandaj çështja e paskajores s'duhet mbajtur pezull me demagogji, me diskutime farse a me fjalë kalkulimesh të ndryshme, vetëm sa për të thënë diçka, si ajo shprehja: *më ka çue nana me la gojën*, që e citon për një rast tjetër prof. Emil Lafe, po duhet marrë këtë punë me seriozitetin e duhur, duke e zgjidhur problemin njëherë e përgjithmonë konkretisht, pa zvarritje.

Sido që të jetë, para se të kalojmë në kreun tjetër, po ritheksojmë se raporti *paskajore/dëftore (njëjësi i së tashëm dhe trajtat e së ardhmes)*, me sa dimë, mbetet çështje jo mjaft e studiuar ortologjikisht në gjuhësinë tonë.

Është e vërtetë se konceptet e togflalësive të tipit *me lënë pas dore (= e la pas dore)*, *me folë me mend për me zënë vend (= fol me mend që të zërë vend)* etj. si dhe shprehjet frazeologjike me paskajore, zakonisht a në të shumtën e rasteve, më natyrshëm korrespondojnë me ato të dëftores se me ato të lidhores, prandaj kërkesa për studime më të thelluara pikërisht rreth raportit *paskajore / dëftore*, del jo vetëm e qëlluar, por edhe e domosdoshme.

Madje edhe përdorimi i paskajores së mirëfilltë me + pjesore si trajtë përfaqësuese (pa e përjashtuar vetën e parë njëjës të dëftores), sidomos në stilin shkencor dhe në praktikën shkollore, siç e kemi theksuar edhe më përpara, as që duhet diskutuar, ngase përdorimi i tillë, së paku pragmatikisht, logjikisht e strukturisht, është fort i qëndrueshëm, mirëpo ne e bëmë këtë paraqitje edhe për një arsye tjetër, për të vënë në pah se pikërisht është *paskajorja me + pjesore e shkurtër* e jo me + pjesorja e zgjeruar, ajo trajtë, e cila del më e përligjur aktualisht në përdorim e sipër për funksionin e tillë përfaqësues.

Sidoqoftë, kjo çështje do parë edhe në aspekte të tjera si në fushën e fjalëformimit, në përdorimin praktik etj.



## VI

### NË CILËT TIPA TË FOLJEVE PIESORJA E SHKURTËR (EDHE SI GJYMTYRË E PASKAJORES) DHE NË CILËT AJO E LETRARËZUARA KANË MË TEPËR PËRPARËSI PËR FORMIMIN E EMRAVE TË VEPRUESIT?

Kur është fjala tek inkuadrimi i paskajores, duke mos u pajtuar me prirjen pa kufi që zgjidhjen ta japë spontanisht koha, mendojmë se kjo zgjidhje duhet përshpejtuar subjektivisht. Përshpejtimi duhet bërë nga nevoja që ndjehet. Po qysh mund të bëhet ai përshpejtim? Natyrisht duke i parë prirjet e caktuara dhe perspektivën e vulltshme në kohëhapësirën e sotme të sistemit foljor, por edhe të ardhmen e tij. Andaj kërkohet nga standardologët tanë që rreth përcaktimit të mënyrës për përfshirjen e saj në standard, të jenë më kreativë, më këmbëngulës, më të guximshëm dhe njëherazi edhe më mendjemprehtë. Për këtë, s'do mend, duhen shfrytëzuar nismat dhe rezultatet nga studimet jospërfaqësore që i janë bërë çështjes në fjalë. Njëherazi duhet ta dinë dhe ta kuptojnë të gjithë, siç është theksuar edhe nga të tjerë, se mungesa e paskajores në standard nuk duhet parë si nënçmim a mospërfillje e gegërishtes në kuptim të ngushtë të fjalës, por duhet konsideruar si dëmtim e varfërim i gjuhës shqipe mbarëkombëtare në përgjithësi, pra edhe i toskërishtes. Për mendimin tonë çështja e paskajores është, jo vetëm në rrugën e mirë të zgjidhjes me mirëkuptim, siç e kemi cekur në fillim të këtij vështrimi, por mund të jetë në fazën përfundimtare të zgjidhjes, nëse nuk pengohet arbitrarisht nga *ndonjë vranësirë e zezë, konfliktuozë* e dalë nga mendja e ndonjë linguisti a politikani fanatik e shkurt-pamës me influencë që ka mbetur ende i pozicionuar, siç po thuhet, në mbrojtjen *bunkeriste* të normës së sotme letrare të kuptuar si dogmë.

Sido që të jetë, ne, duke pasur bindje të plotë se çështja e zgjidhjes së paskajores me inkuadrim nuk ka të bëjë fare me re të tilla, as të zeza, as të përhitura, madje as të bardha, po ka të bëjë pikërisht me përsosjen e shqipes standarde, jo e parë ngushtësisht si toskërishte, por si gjuhë të mirëfilltë standarde *mbidialektore* mbarëkombëtare. Shprehemi kështu sepse kemi bindjen se një veprim i tillë do të shërbente për të mirë për të gjithë shqiptofolësit si

të Jugut, si të Veriut, si të Qendrës, si të Lindjes, si të Perëndimit edhe më gjërë, prandaj do të përmendim në vazhdim një *patent-zgjidhje të thjeshtë* lehtësuese, por të rëndësishme, e cila me këqyrë hollë e hollë, është e pranueshme dhe e vërtetueshme institucionalisht, nga vetë planëzuesit disenjues të letrarishies së sotme(!). Shtrohet pyetja, a është e mundur që një zgjidhje e tillë lehtësuese të ekzistojë? Madje a mund të jetë edhe aq e thjeshtë dhe e vërtetueshme institucionalisht?! Edhe këto pyetje kanë përgjigje. Me fjalë të tjera, me thënë të vërtetën, fillimisht, kur janë vënë bazat e strukturës së sotme të shqipes letrare, sot të ashtuquajtur *standarde* as që ka ekzistuar një problem i tillë, i cili ndërkohë, u krijua. Pra është e vërtetë, siç u tha, se nga *ligjërimi i një propagande të tillë* është krijuar aso pëlhure e përmjegullit para syve, saqë ka penguar dhe po pengon e po *pëshjtellon* edhe sot, saqë dikush-dikushi, mos me e pa rrugëzgjidhen ekzistuese parasysh?! Sidoqoftë, për një shkak a për një tjetër, si ta marrësh, problemi, që nuk ekzistonte, tash, 30 e sa vjet, ekziston dhe nuk është as aq i thjeshtë, por as aq i ndërlikuar, për t'u zgjidhur, nëse çështja plegnohet me seriozitetin e duhur.

Sido që të jetë, ne tash menjëherë, do të bëjmë fjalë konkretisht rreth kësaj zgjidhjeje ofruese ekzistuese. S'do mend, fillin e saj do ta kapim thjesht nga trajtat konkurruese të pjesores në suazë të paskajores në fjalë që janë: **paskajorja me + pjesore e shkurtër** (me mësue, me gjetë, me bë) dhe **paskajorja me + pjesore e toskëzuar** (me/ mësuar, me/ gjetur, me/ bërë). Pra, mbesin në trajtim trajtat: **pjesore e shkurtër**, në njërin anë (mësue, gjetë, bë) dhe **pjesore e toskëzuar (letrare) në kuadër të paskajores** (mësuar, gjetur, bërë), në anën tjetër, trajta këto, që në fjalëformim, që të dyja, njihen gjithandëj nga norma e sotme letrare si tema prodhuese fjalëformuese për emrat e vepruesit dhe për prejpesorë të tjerë si p.sh.: **mësue+s mësues, gjetë+s gjetës, gjetje, bërë+s bërës, bërje** andaj t'i zbërthejmë tani këto dy fakte ofruese paksa më në hollësi.

### 1) Pjesorja e shkurtër në funksion të temës fjalëformuese

Është e ditur se **pjesorja e shkurtër e paskajores së mirëfilltë**, e cila u përmend në funksion parësor përfaqësues, ka mbështetje në fjalëformim, ajo del qartë si temë e qëndrueshme prodhuese (shembulli: **mësue/s, gjetë/s**) dhe, po të shikohet hollë e hollë, ajo, nga ky aspekt del e legalizuar dhe e sanksionuar, jo vetëm në kodin e përgjithshëm të sistemit global të shqipes mbarëkombëtare, por edhe në suaza të *shqipes standarde* në bazë të letrarishies së sotme, kuptohet, në *fushën e fjalëformimit*. Në të vërtetë, ky fakt shihet qartë konkretisht te "**formimi i emrave prejpesorë të vepruesit me prapashitesën** -S

dhe prejpesorëve të tjerë", por edhe të ndonjë emri gjësendi konkret (teknik) etj. Është mënyrë e njohur brenda sistemit fjalëformues që si e tillë del e dokumentuar që nga burimet dhe hershme të shkrimit shqip. Nënkuptoet se kjo praktikë ishte e rrënjësuar thellë, si zgjidhje model, në atë sistem, shumë kohë, më përpara dokumentimit të të shkruarit shqip, përkatësisht shumë e shumë kohë para normëzimit të shqipes së sotme letrare. Siç e pamë nga paraqitjet e mëparshme në Konferencën e 2002-shit, kjo trajtë del e ofruar si gjymtyrë e paskajores me + pjesore e shkurtër, nga prof. R. Ismajli, e mbështetur edhe nga prof. B. Bokshi, po si mjet i përdorshëm konkret përfaqësues del në përdorim edhe nga prof. R. Memushaj, ngase vërtet, si e tillë, edhe ka traditë më të gjatë përdorimi, andaj, s'do mend, ofrohet si mënyra më e lehtë për t'u futur në shqipen standarde si gjymtyrë kryesore organike e paskajores së mirëfilltë. Edhe prof. Fadil Raka thekson se "**Format e pjesores së variantit të gegërishtes pjekë, shitë, hapë** (kundrejt pjekur, shitur, hapur) duhet të jenë shumë më funksionale, sepse shqiptohen më lehtë dhe njëkohësisht nuk prekin aspak strukturën leksikore e semantike të fjalës" (Shih Seminari ... 21/1 f. 166). Ç'është e vërteta, qëndrueshmëria e një veprimi të tillë fjalëformues (edhe për tpa të tjerë të foljeve) duket aktualisht jo vetëm tek emrat e vepruesit, por edhe të mbiemrat prejpesorë të nyjshëm me *-shëm* etj. dhe që një formë e tillë nuk prek për të keq aspak në drejtshkrimin e sotëm të shqipes standarde, as në rregullat leksikografike të saj, nuk do sqarim plotësues, ngase trajtat e tilla janë në përdorim të përditshëm standard, madje dalin të sanksionuara edhe në bazë të fjalorëve tanë normativë.

Pra, nuk del pa mbështetje propozimi që edhe *normëzimi i paskajores me, pra me pjesoren e shkurtër* në letrarishien e sotme, të pranohet, siç është thënë edhe më parë, si alternativë më e parapëlqyer lidhur me zgjidhjen përfundimtare të çështjes në shqyrtim.

### 2) Pjesorja e zgjeruar në funksion të temës fjalëformuese

Edhe pjesorja e toskëzuar si pjesë e paskajores me *me*, tipi *me punuar, me larë, me bërë(!)* etj. siç u cek më sipër (shembulli: **bërë/s**), e cila, duke pasur mbështetje të fortë në sistemin paradigmor të foljeve të shtjelluara dhe të pashtjelluara në letrarishien e sotme, që u propozua si e tillë nga prof. Emil Lafe, dhe u përkrah, në atë Konferencë, edhe nga E. Hysa, Rrahim Përçuku e të tjerë, ka gjithashtu mundësi për t'u inkuadruar në standard. Edhe kjo trajtë del e përdorur në burime të caktuara të hershme, e sanksionuar si temë fjalëformuese, por jo aq e shtrirë, e përgjithësuar dhe e përdorshme sa pjesorja

e shkurtër. Edhe kjo, pra, përdoret për formimin e disa tipave të emrave prejpjesorë të vepruesit mbi bazë foljore me prapashtesën -S, siç do të sqarohet konkretisht këtu më poshtë.

Çështje e vërteta, secila nga të dyja këto trajta: **paskajorja me + pjesore e shkurtër dhe paskajorja me + pjesore e toskëzuar** kanë përparësitë e veta, për të cilat tani nuk do të bëjmë fjalë në mënyrë të veçantë, ngase s'kemi çka t'u shtojmë në librin *Paskajorja çështje e shqipes standarde (f. 131 -- 142)*. Pra, edhe tani nuk kontestojmë zgjidhjen, qoftë me paskajoren me **me + pjesore të shkurtër**, qoftë me paskajoren me **me + pjesore të letrarëzuar** si p.sh.: *zënë me më vështrur* ndaj *zënë me më vështruar*; e kam gjetur ndaj e kam gjetur, kam bërë ndaj kam bërë etj., megjithatë gjatë përimimit dolën edhe çështje, të cilat s'janë theksuar në mënyrë të veçantë në atë burim, siç janë disa fikësimet të fjalëformimit, prandaj këtu do të theksohet edhe ndonjë hollësi tjetër me interes.

Të rikujtojmë edhe një herë faktin se në fushën e parë semantike, d.m.th., në funksion përfaqësimi sipas traditës dhe sot për sot, si rregull fjalëformues vjen në konsideratë në radhë të parë trajta e pjesores së paskajores me + pjesore e shkurtër (gege) dhe kjo vlen, en bloc, për të gjithë tipat e foljeve, ndërsa për dy-tri fushat e tjera varësisht nga rrethanat e burimet dokumentare të caktuara etj., mund të jenë të pranishme edhe forma të tjera heterogjene të pjesores së zgjeruar, qoftë të gegërishtes (disa variante: me prapashtesë zero, me prapashtesën -ë, -un, -en -m(ë) me variantet: *nun, mun*), qoftë ajo e toskërishtes, ta quajmë kushtëzimisht *homogene* me prapashtesën -ur dhe atë -ë (si në gegërishte), në tipa të veçantë.

Bësojmë se çështja, që sapo u cek, do të dalë edhe më e qartë pas konsultimit të dy fakteve të rëndësishme që dalin nga realiteti i shqipes së sotme letrare, siç janë:

- skema ku pjesorja e paskajores, sipas tipave të foljeve, del në funksion të temës prodhuese për formimin e emrave të vepruesit dhe
- rregulla fjalëformuese mbi këtë bazë, të cilat po i parashtrujmë më poshtë:

a) **Skema e raportit pjesore e paskajores si temë prodhuese dhe emri i vepruesit sipas tipave të foljeve**

Kjo skemë është sajuar sipas këtyre 7 rubrikave:

- numri rendor dhe fundorja e tipit të foljeve të caktuara,
- veta e parë e njëjësit të dëftores si trajtë përfaqësuese e foljes,
- paskajorja me + pjesore e shkurtër,
- emri i vepruesit në bazë të pjesores së shkurtër,

- trajtat jo të normëzuara gege të paskajores me + pjesore të zgjeruar,
- paskajorja me + pjesore e toskëzuar dhe
- emri i vepruesit mbi bazë të pjesores së toskërishtes (letrarishtes së sotme).

	1	2	3	4	5	6	7
1. -oj	mësoj	me mësuë	Mësues		me mësuën, me mësuem, me mësuën, me mësuem,	me mësuar	
	mbroj	me mbrojtë	mbrojtës		me mbrojtun, me mbrojtën	me mbrojtur	
2. -uaj	shkruaj	me shkruë	shkruies		me shkruemun, me shkruen, me shkruenun	me shkruar	
	shua	me shue	shues?		me shuem, me shuemun, me shuen, me shuenun	me shuar	shuars
	Rruaj	me rruëjtë	Rruajtës		me rruajtun, me rruajtën	me rruajtur	
3. -ej	shpërblej	me shpërblje	shpërbljes		me shpërbljem, me shpërbljemun, me shpërbljenun	me shpërblyer	
	Vërej	me vërejtë	vërejtës		me vërejtun, Me vërejtën	me vërejtur	
	blej	me ble	bles?		me blemë, me blemun, me blemun	me blerë	bleres
	mbrej	me mbrehë	mbrehës		me mbrehun, me mbrehën	me mbrehur	
4. -ij	shkrij	me shkri	shkris?		me shkrimë, me shkrimun, me shkrimun	me shkrire	shkrites
5. -uj	buj	me bujtë	Bujtës		me bujtun, me bujtën	me bujtur	
6. -ej	bëj	me bë	bes, bamës		me bamë, me bamun, me banun	me bërë	bëres
7. -y	fryj	me fry	frys?		me frymë, me frymun, me frymun	me fryrë	fryres
8. -uj	Laj	me la	las?		me lamë, me lamun, me lanun	me larë	larës
9. -y	Kryej	me krye	kryes?		me kryem, me kryemun, me kryemun	me kryer	kryeres
10. -iej	Ziej	me zie	zies?		me ziemë me ziemun, me zienë, me zienun	me zier	zieres
11. -në	Vë	me vënë	vënës		me vumë, me vu, me vunun	me vënë	vënës
	Jap	me dhënë	dhënës		me dhanun, me dhanën	me dhënë	dhënës
12.	Ngre	me ngritë	ngritës		me ngritun, me ngritën	me ngritur	
13.	Marr	me marrë	marrës		me marrun, me marrën	me marrë	marrës
	Mjet	me mjellë	mjellës		me mjellun, me mjellën	me mjellë	mjellës
14.	Mat	me matë	matës		me matun, me matën	me matur	
	Derh	me derdhë	derdhës		me derdhun, me derdhën	me derdhur	
	mpiks	me mpiksë	mpiksës		me mpiksun, me mpiksen	me mpiksuar	
	Pajis	me pajisë	pajisës		me pajisun, me pajisën	me pajisur	
	palos	me palosë	palosës		me palosun, me palosën	me palosur	
	radhit	me radhitë	radhitës		me radhitun, me radhitën	me radhitur	



**b) Paskajorja dhe rregullat përmblidhëse të formimit të emrave prej-  
pësorë të vepruesit në shqipen e sotme letrare.**

Nga skema e mësipërme del se emri i vepruesit, varësisht nga tipat e foljeve, formohet, kryesisht në bazë të pjesores së shkurtër geqe, por në raste edhe në bazë të pjesores së shqipes së sotme letrare (toskërishtes). Në vazhdim po japim tipat e foljeve dhe emrin përkatës të vepruesit, duke vënë theksin në trajtën e pjesores në funksion të temës prodhuese që njëherazi është edhe si *komponen* përbërës i paskajores me me:

1. Pjesorja e paskajores me + pjesore e shkurtër në përdorim normal përfshin këta tipa të foljeve:

a) foljet me zanore të tipit *-oj, -ej* dhe *-uaj* me mbaresë zero në pjesore, tipi: *mësoj me mësu* (mësues), *shpërblej me shpërblye* (shpërblyes), *shkruaj me shkru* (shkrues);

b) foljet vokalikë (të gjitha) me zgjerim të temës me *-t-, -jt-*, me prapashtesën *-ë* në pjesore, të cilat në letrarishten e sotme marrin prapashtesën temëformuese *-ur* (të paqëndrueshme), tipi: *mbroj me mbrojtë* (mbrojtës), *ruaj me ruajtë* (ruajtës), *vërej me vërejtë* (vërejtës), *mbaj me mbajtë* (mbajtës), *buj me bujtë* (bujtës), *ndri me ndrëtë* (ndrëtës) dhe *vetë me vajtë* (vajtës);

c) një grup i vogël foljesh me *-ej* të cilat e zgjerojnë pjesoren me një *-h-*epentetike + ë, siç është tipi: *mbrej me mprehë* (mprehës) si dhe

ç) të gjitha foljet me temë në bashkëtingëllore me prapashtesën inovuese *-ë*, e cila në letrarishten e sotme del në trajtën këtingëllore me prapashtesën *-matë* (matës), *derdh me derdhë* (derdhës), *mpiks me mpiksë* (mpiksës), *pajis me pajisë* (pajisës) dhe *radhit me radhitë* (radhitës).

2. Pjesorja e paskajores me + pjesore e tokëzuar (letrarishtes) si temë fjalëformuese e emrave të vepruesit, ka prijte të përdoret në këta tipa të foljeve:

a) foljet me togzanor me prapashtesën temëformuese *-r*, tipi: *shuaj shuar* (shuarës), *shuarës* (geg. shuej me shue shues), *ziej zier* me *zier!* zierës (geg. ziej me zie zies (!)), kryej kryer me kryer(!) kryerës (geg. kryej me krye kryes);

b) foljet me temë në zanore të tipit që e bëjnë pjesoren me prapashtesën temëformuese *-rë*, tipi: *fshij fshirë me fshirë(!) fshirës* (geg. fshij me fshirë fshis!), *bëj bërë me bërë(!) bërës* (geg. bëj me bë, bës bamës), *laj larë me larë(!) larës* (geg. laj me la las lamës), *blej blerë me blerë(!) blerës* (geg. blej me ble bles blemës) dhe *fryj fryrë me fryrë(!) fryrës* (geg. fryj me fry frys);

c) foljet me prapashtesën *-në* në pjesore (si në gegërishtes) tipi *dhënë* me *dhënë dhënës, lënë me lënë lënës*;

ç) foljet apofonike me prapashtesën *-ë* në pjesore (si në gegërishtes) tipi *marr* me *marrë marrës, vjel vjelë me vjelë vjelës*.

Nga skema dhe rregullat e formimit të prepjesorëve në cilësinë e emrave të vepruesit dalin çështje që kërkojnë sqarim, por ne do të ndalemi vetëm te disa që paraqesin interes:

1) Ç'është e vërteta, trajtat e zgjeruara (të panënvizuara, rubrika e pestë në skemë) të pjesores së gegërishtes me prapashtesat e paqëndrueshme: *-un, -më, -mun, -, -en, -n, -nun/-nen*, që më tepër i takojnë së kaluarës, por që mund të ndeshen ende në të folme a shkrime të veçanta edhe tashti, me thënë të drejtën, pothuaj që të gjitha në gjuhën e sotme letrare kanë evoluar ose e kanë të humbur konkurrencën, qoftë ndaj pjesores së shkurtër, qoftë ndaj trajtës së pjesores toske, e cila del e sanksionuar në normën letrare.

2) Kështu edhe pjesorja e paskajores me + pjesore e tokëzuar (hibride e letrarëzuar), sipas traditës, pra, ndeshet në nënfushat semantike të koncepteve infinitivale (me përfashtim të përfaqësimit për nevoja shkencore), sepse siç e pamë e ndeshnim edhe në dokumente të caktuara, si në vepra publicistike, ashtu edhe në vepra letrare e të tjera. Sa për këshëri, veç shembujve të cituar në veprën *Paskajorja...* (f. 141) po e cek faktin se në korrespondencën me toskët, poeti e atdhetari shkodran, Filip Shiroka, i ka përdorur këto trajta të paskajores me + pjesore e tokëzuar: *me prekur, me njohur, me çfaqur, me folur, me u përgjegjur* (Shih: Çajupi *Vepra* 5, botim i Prishtinës).

3) Sidoqoftë, në realitetin e sotëm, po përsërisim, pjesorja e paskajores me me e formës së toskërishtes për të gjitha trajtat e sjella me sipër prej nesh, si variante të pjesores së zgjeruar të gegërishtes, e ka të fituar konkurrencën, ndërsa vetëm për pjesoren e shkurtër të saj jo, siç janë trajtat me prapashtesë zero dhe ato me prapashtesën inovuese *-ë* (trajta të nënvizuara në rubrikën e tretë), prandaj kjo çështje që meriton trajtim të veçantë do të preket pak më në hollësi edhe në krerët vijues të këtij punimi.

4) Gjithsesi imponohet për t'u sqaruar pse emrat e vepruesit që e kanë temë fjalëformuese pjesoren e letrarishtes së sotme, nga tipat e foljeve që në letrarishten e sotme marrin prapashtesë-mbaresën *-rë*, përkatësisht *-r*, por që në gegërishtes ose kanë temë prodhuese pjesoren e shkurtër ose atë me prapashtesën *-më*, përkatësisht *-m*: *blerës* ndaj *bles, blemës, larës* ndaj *las, lamës, bërës* ndaj *bës (bas e bamës), fshirës* ndaj *fshis, i fshimë, fryrës* ndaj *fry* si dhe *shuarës* ndaj *shues* dhe *thyerës* ndaj *thyes* (që të dyja të regjistruara në FSHS), ndërsa te foljet e tjera trajta e pjesores së shkurtër (si temë fjalëformuese zero

dhe ato me prapashtesën inovuese -ë) mbi bazë të gegërishtes, del e pakontes-tueshme.

5) Është e vërtetë se sot për sot mund të konkurrojnë trajtat: shues a shuarës si thyes a thyerës e *bërë, bërje* ndaj *bëmë/bëma*. Sidoqoftë, në kontekste të caktuara sipas fjalorit normativ, më shumë del e favorizuar trajta mbi bazë të pjesores së letrarishtes së sotme, por ekziston një prirje tjetër që për komponentin e dytë të kompozitës si gazshues, ndaj gazshuarës, gurthyes ndaj gurthyerës të përdoret trajta me pjesore të shkurtër gjithashtu edhe ndajfoljet, mbiemrat e emrat e tipit përkatësisht: *-shëm, -shmëri* ta shfrytëzojnë si temë prodhuese pjesoren e shkurtër, si *bëshëm, i bëshëm bëshmëri, zieshëm, i zieshëm zieshmëri, shkrishëm, i shkrishëm shkrishmëri, shueshëm, i shueshëm shueshmëri* etj.

Sidoqoftë, këto dallime janë cikërrime kundrejt mundësisë së ofruar që zgjidhja e shkrimit të paskajores me **me** të bëhet sipas skemës dhe rregullave të mësipërme. Në të vërtetë, nëse zgjidhja e paskajores me + pjesore bëhet sipas kësaj formule, pra sipas rregullave nga prireja e sotme e fjalëformimit duket se del si një zgjidhje mjaft normale. Një përmjohje e tillë me përqafim do të na ndihmonte shumë që zgjidhja përfundimtare e paskajores të jetë alternativë më e pranueshme se çdo rrugëzgjidhje tjetër, sepse, siç u tha, trajtat e shënuara me përparësi (të nënvizuara në rubrikën e tretë dhe të shtatë në skemë), në fjalorin normativ të shqipes standarde mund të merren si trajta, të padiskutueshme normative, ngase kuptohet se janë të favorizuara nga sistemi fjalëformues i sotëm i shqipes standarde. Ç'është e vërteta, të dyja trajtat e mësipërme, të theksuara prej nesh: paskajorja me + pjesore e shkurtër dhe paskajorja me + pjesore e tokkëzuar, besojmë se nuk janë të papranueshme, sepse nuk prekin, aspak për keq, strukturën leksikore dhe semantike të fjalës e së këndejmi edhe të strukturës së shqipes standarde, prandaj edhe mund të sforcohen në përdorim praktik sipas destinimit të caktuar.

Fundja, të gjitha këto forma mund të konkurrojnë për konceptin e paskajores, por trajta *me + pjesore e shkurtër* mbetet më e qëndrueshme për ata tipa foljesh që shërbejnë si tema të qëndrueshme fjalëformuese për formimin e emrave të vepruesit dhe të ndajfoljeve e mbiemrave me *-shëm* e rrjedhjoave të tjera mbi këtë bazë si p.sh. *mësues mësuesi; ndëgjues, dëgjueshëm, i dëgjueshëm, dëgjueshmëri; bëshëm, i bëshëm bëshmëri*, e kështu me radhë. Po ashtu duhet të kihet në konsideratë se edhe trajta e pjesores së tokkëzuar për tipat e foljeve me *-r* e *-rë* e cila shërben edhe si temë prodhuese e emrit përkatës të vepruesit dhe të rrjedhjoave mbi këtë bazë, si p.sh: *shuar shuarës*

*i shuar shuarje, zier zierës i zier zierje, fryrë fryrës i fryrë fryrje* e kështu me radhë, por që ndeshet në konkurrencë potenciale me trajtat e gegërishtes si: e shueme e shuemja, e zieme e ziemja, e fryme e fryemja (fryma) etj..

Sido që të jetë, me parashtrimin tonë rreth përzgjedhjes së trajtës së caktuar të paskajores sipas tipave besojmë se i kemi bërë shërbesë të mirë zgjidhjes përfundimtare të çështjes së paskajores shqipe në shqyrtim dhe tani do të varet nga normëvënësit se sa do ta parapëlqejnë, shfrytëzojnë dhe sa do ta sendërtojnë në jetë këtë ndihmesë a përkujtesë modeste.

## VII

### SA PRIRET EVOLUTIVISHT SHKURTIMI I Pjesores së LETRARISHTES NË RAPORT ME SHTYTËSIT PËRKATËS TË NJË VEPRIMI TË TILLË?

Ndonëse faktorët e caktuar evolutivë dhe efektet e veprimeve të tyre do të trajtohen më dukshëm në kryeun e nëntë të këtij punimi, siç janë: *tema fjalëformuese e prejpjesorëve, forma e paskajores me me, ligjërimi i shumicës, kujtesa ndaj ish-shqipes letrare dhe dukuria e thjeshtëzimit a e shqiptimit më të lehtë*, ne, këtu, megjithatë, e pamë të arsyeshme vetëm sa t'i përmendim fillimisht këta faktorë ndikues, me qëllim për me pasë më të qartë lëndën që po e trajtojmë, e cila në njëfarë mënyrë del e ndërlidhur me faktorët e tillë. Pra, këtu do të bëjmë fjalë:

së pari, rreth raportit të pjesores së shkurtër ndaj pjesores së letrarishtes, ashtu edhe ndaj pjesoreve të zgjeruara të gegërishtes,

së dyti, rreth involvimit të pjesores në sistemin fjalëndërtues: fjalëformues, kohëformues dhe formëformues dhe

së treti, rreth përfshirjes së pjesores së shkurtër në kuadër të paskajores së mirëfilltë dhe të formave të tjera siinfinitivale.

#### **1. Raporti i pjesores së shkurtër ndaj pjesores së letrarishtes ashtu edhe ndaj pjesoreve të zgjeruara të gegërishtes.**

Siç dihet shqipja e sotme i ka të trashëguara në realitetin aktual gjuhësor këto tri variante kryesore të pjesores: një të toskërishtes (të normëzuar) dhe dy të gegërishtes (të panormëzuara: disa trajta të zgjeruara dhe një trajtë të shkurtër), si p.sh.:

1) tosk. *punuar, pëlqyer, matur, radhitur, pritur, blerë, pirë, shuar, nxënë, marrë* (trajtë e normëzuar);



2) geg. (trajta të zgjeruara): *punuem punuemun a punuen, pëlqyem a pëlqyemun pëlqyemen, matun maten, radhitun radhitën, pritun priten, blemë blemun blemun, pimë pimun pinun, shuem shuemun, shuenun, nxanun nxanen, marrun, marren;*

3) geg. (trajtë e shkurtër): *punue, pëlqye, matë, radhitë, pritë, ble, pi, shue, nxënë, marrë.*

Shikuar, pra, nga gjendja e sotme, siç është theksuar edhe më përpara, del e vërteta sheshazi, se, sot për sot, pjesorja e shkurtër qëndron në raport dallues më e mëkëmbur, si ndaj pjesores së gegërishtes në trajtën e zgjeruar (pika 2), ashtu edhe ndaj pjesores, gjithashtu të zgjeruar të letrarishtes së sotme (pika 1). Është e vërtetë se tipat e foljeve me prapashtesë-fundoret: *- uef-n/un)-ose -ye/nun ye/mun, -nen, -n/un, qoftë nga vetevoluimi në pjesore të shkurtër me prapashtesë zero (pika 3), qoftë nga zëvendësimi me formantet e normëzuara -ua/r, -ye/r, -ur (pika 1) të letrarishtes së sotme si p.sh.: a) punuëm punuemun, punuen punuenu = punue ose punuarë = punuar; b) pëlqyem, pëlqyemun, pëlqyenu = pëlqye ose pëlqyerë = pëlqyer; c) matun maten = matë ose maturë = matur - pa lënë gjë keq, mund të thuhet, se dalin të mënjanuara, pothuaj, tërësisht, jo vetëm në ligjërimin standard, por, në njëfarë mase, edhe në vetë gegërishten letrare, trajtë kjo, e cila në kohë të fundit, vërtet del mjaft e pasivizuar. Mirëpo, te tipat e foljeve të tjera që, në toskërishte dalin me prapashtesë fundoren: -rë e -r, p.sh. blerë, pirë, shuar në gegërishte dalin dy variante barasvlerësh 1): *ble (me ble); pi (me pi); shue (me shue)* dhe 2) me prapashtesë-fundorin barasvlerës -më e -m: (me) *blemë blemun; pimë pimun, shuem shuemun*. Lidhur me këtë mendojmë se lypset sqarim plotësues, sepse, pikërisht, trajtat me prapashtesë-nbarsësën zero të evoluar, pra (trajtat e shkurtër) edhe pse nuk përmenden si të normëzuara, ato, realisht, për nga funksioni, duhen konsideruar ashtu, të normëzuara, ngase formanti **zero** dhe ai në -Ë kanë mbetur të pambuluara si barasvlerës në krahasim me formantin -rë ose -r (pika 1) sikurse dalin trajtat me -më ose -m (pika 2), qoftë në ligjërimin e mirëfilltë dialektor (sidomos të elbasanishtes), qoftë edhe në vetë normën standarde në fushën e fjalëformimit, bashkë me trajtat e shkurtra të pjesoreve të tipave të tjerë. Prandaj themi se funksionalisht dalin si të normëzuara ose mund të konsiderohen si forma të pavarura dhe të legjitimuara në normën e shqipes standarde, kuptohet, për destinime të caktuara, siç do të qartësohet më mirë konstatimi ynë në nëntitullin vijues.*

## 2. Involvimi i pjesores në sistemin fjalëndërtues të shqipes

Me togfjalëshin *sistem fjalëndërtues të shqipes* kuptojmë përfshirjen e pjesores në fjalëformim, në kohëformim dhe në formëformim.

### 2.1. Involvimi i pjesores në fjalëformim

Siç e pamë në nëntitullin e caktuar të kreut të mëparshëm pikërisht nga kry variant i pjesores së shkurtër, por edhe të zgjeruar (më pak) të gegërishtes, dalin të përfutur prejpjesorët përkatës shumë veprues e prodhimtarë, siç janë emrat e vepruesit e prejpjesorë të tjerë. Krahaso: *punue (me punue); punues, punim, punesë, punueshëm, i punueshëm, e punueme/ e punuemia, të punuemit; pëlqye (me pëlqye): pëlqyes, pëlqim, pëlqesë, pëlqyeshëm, i pëlqyeshëm, e pëlqyeshme/ e pëlqyeshmja, i pëlqyeshmi, i pëlqyem, e pëlqyeme, të pëlqyemit; matë (me matë): matës, matje, i matshëm, e matshme, të matunit; radhitë (me radhitë) radhitës, radhitje, e radhitme të radhitunit; pritë (me pritë) pritës, pritë-à, pritje, e pritme, të pritunit e kështu me radhë.*

Ç'është e vërteta, jashtë *kësaj rregulle dalin pjesërisht* përfitimet nga foljet me prapashtesën -m e -më të gegërishtes: *shue shuem, krye krye(m), zie (zien), ble blemë, shkri shkrimë, bë (bamë), frye (fryem), pa (pamë), të cilat, korrespondojnë me pjesoret e letrarishtes (toskërishtes) të formuara me prapashtesat temëformuese -r dhe -rë: shuar, kryer, zier; blerë, shkrire, bërë, fryrë, parë, trajta këto që në normën e sotme dalin më të parapëlqyera, ngase janë të sanksionuara, sipas bazës dialektore të normës në fuqi, në përfaqje me trajtat e gegërishtes (ish-gegërishtes letrare mbi bazë të elbasanishtes). Thamë *pjesërisht*, ngase, përveç prejpjesorëve, që dalin mbi bazë të pjesores së toskërishtes (letrarishtes së sotme) si *shuarës, shuarje, i (e) shuar, e shuara, të shuarit; kryerës kryerje, i (e) kryer të kryerit; zierës zierje (i (e) zier të zierit; blerës blerje, i (e) blerë të blerit a të blerët; bërës, bërje, i (e) bërë të bërit; fryrës fryrje, i (e) fryrë të fryrët e të fryerit, parje të parët a të parit, e kështu me radhë, jo vetëm, në ligjërimin e përditshëm të gegërishtfolësve, por në raste edhe në gjuhën e shkrimit letrar standard, ndeshim prejpjesorët mbi bazë të pjesores së zgjeruar me -m, -më geqe, si: *shuemës, shuemeje, i shuem e shueme; kryemës, kryemeje, i kryem, (punë) e kryeme, e kryemja (emër) të kryemit; ziemje, zieshmëri, të ziemit; blemës, i blemë, e bleme, e blemja (emër) të blemit, të blemët; bëmës a bamës, bëmje, i bëshëm, bëmë të bëmit; pamës, i pamë, e pame (mb.), e pame, pamje (pikëpamje), e pame/ e pamja (emër) të pamit, të***

*pamët* e kështu me radhë, trajta këto, që edhe tani sipas normës në fuqi, edhe pse si raste, janë të lejuara të konkurrojnë për koncepte të caktuara, ndonëse subjektivisht nuk janë aq të parapëlqyera në strukturë, për arsyen që u tha më sipër, por njëherazi i ndeshim ligjërisht edhe në fjalëformim. Siç dihet, veç këtyre në fjalëformim paralelisht i ndeshim edhe përfitimet mbi bazë të pjesores së shkurtë, si *p.sh. shues i shueshëm shueshmëri; kryes i kryeshëm kryeshmëri, zies zieshëm i zieshëm zieshmëri, bles i bleshëm bleshmëri, bës (bas) i bëshëm bëshmëri, pas, i pashëm pashmëri etj.* trajta këto që nuk kanë barasvlerës formalë në letrarishten e sotme, por ne i cekëm si raste, ndonëse, jo të gjitha, mund t'i hasim në përdorim të përditshëm aktiv në tërë truallin shqipfolës. Pra, synimi ynë kryesor është për të treguar se në tipa të tjerë të foljeve përfitimet e tilla, sidomos mbi bazë të pjesores së shkurtë, mund të dalin plotësisht të pavarura dhe qëndrueshmëria e tyre s'mund të mohohet asesi, siç e pamë në kreun e mëparshëm.

Në vazhde të këtij konteksti do të na lejohet ta bëjmë një ndërmjetëz të vogël, që ka të bëjë pikërisht me raportin e prapashtesave **-m/-r** dhe **-më/-rë**.

Të vihet re përderisa në toskërishte mbiemri (emri) prejpesor i nyjshëm në tipa të caktuar del njëtrajtshëm, sa i përket gjinisë, në gegërishte del i dytrajtshëm, si: **i(e) shuar** ndaj i *shuem dhe e shueme*, **i (e) parë** ndaj i *pamë, e pame*, **i, (e) ardhur** ndaj *ardhun e ardhme*, **i (e) pëlqyer** ndaj i *pëlqyer dhe e pëlqyeme*, duke dhënë mundësi që, pa barasvlerës formalë identikë në toskërishte, trajta e gjinisë femërore e gegërishtes mund të emërohet dhe të shprehë koncepte të veçanta semantike, siç janë shembujt: *pinje, e pime; pamje, e pame; e vyeme e vyejma; e pëlqyeme e pëlqyemja, e ardhme e ardhmja, ardhmenia* (Sqarim: trajta *ardhmeri*, nga (e) ardhme+RI nuk është përfitim i toskërishtes, por i letrarishtes së sotme N. V.). Këto koncepte të veçanta i njeji norma e letrarishtes së sotme si, *p.sh. geg. pamje, e pame, tosk s'ka parje, e pare* (!) me atë kuptim, e ardhme ardhmeni, e bardhme etj., që në toskërishte nuk kanë trajta të veçanta me semantikë gjegjëse. Përndryshe, kur është fjala të dyshorët mbi bazë të pjesores së zgjeruar trajtat e toskërishtes (letrarishtes së sotme) për konceptin e njëjtë, dalin me konkurrencë të fituar.

Sidoqoftë, këtë ndërmjetëz ne e bëme me qëllim, jo vetëm sa me bë më të zbuluar një veçori të tillë fjalëformuese mjaft të veçantë që mbetet nën hije të modelit aq të aktivizuar të mbiemrave dhe emrave mbi bazë të pjesores së toskërishtes, sidomos pas anashkalimit të pjesores së gegërishtes në normën e shqipes së sotme letrare, por, aq më tepër, e patëm dhe e kemi për qëllim të tërheqim vëmendjen, a të rricekim faktin, se trajtat e pjesores së shqipes së sotme

letrare, sidomos ato me prapashtesën konservuese **-ur** i kanë pasivizuar madje edhe mënjanoar, pa lënë gjë keq, vetëm pjesoret e gegërishtes me prapashtesat në variantet: **-im, -n/im, -m/im**, për të cilat nuk besojmë se ka nevojë të ngulmojë kush me i rehabilitue, por jo edhe ato me prapashtesat **-m e -më**, edhe pse edhe këto dalin mjaft të goditura, jo vetëm me prapashtesën përkatëse të toskërishtes **-r / -rë**, por, edhe nga prapashtesa zero e vetë gegërishtes. Të vihet re se pikërisht trajtat e pjesoreve me prapashtesën zero dhe ato me **-ë të gegërishtes mbeten të paprekura fare**, andaj synimi ynë është për të nxjerrë më mirë në pah faktin se **trajtat e pjesores së shkurtër të gegërishtes letrare**, qoftë ato me prapashtesë zero si *shkue, pëlqye, di*, qoftë ato me prapashtesë-fundorin **-ë: matë, radhitë, mbajtë, përsëhendetë, ardhë** etj. **kanë mbetur të pazëvendësuara dhe të paatkuara nga trajtat e shqipes së sotme letrare**. më **-ur, -r, -rë**, në sistemin e fjalëformimit normëzues e së këtejmi edhe në leksikografinë normëzuese, prandaj këto trajta që janë të pakontestueshme në strukturën fjalëformuese, vihen në dukje dhe propozohen që të jenë të rehabilitueshme edhe në normën e shqipes standarde, sidomos kur është fjala për trajtat e pjesores në funksion të paskajores së mirëfilltë me me që njëherazi konsiderohen edhe si trajta përfaqëuese të foljes dhe si të tilla nuk duhen anatemuar, nëse ndeshen të përdorura edhe në ndonjë rast tjetër, përveç paskajores, edhe pse dihet se bien ndesh me normën në fuqi.

Përtë pasur më të qartë idenë tonë ende të pashprehur mirë, po japim në vazhdim shtrijën e pjesores së shqipes së normëzuar, së pari në funksion kohëndërtes dhe së dyti, në funksion formëndërtes, por duke e vënë në kllapa (përmbri) me qëllim edhe trajtën konkurruese të saj, *d.m.th., pjesoren e shkurtër të shqipes mbi bazë të ish-gegërishtes letrare*, e cila ende ruhet në kujtesë dhe, siç dihet, haset ende në përdorim të gjallë në ligjërim të përditshëm të shumica e shqipfolësve, edhe pse normativisht, tash sa vite, është e shpallur jashtë normës letrare(!).

## 2.2. Involvimi i pjesores në kohëformim

Siç dihet në strukturën paradigmore të foljes së shqipes, sipas mënyrave përkatëse, pjesorja (e letrarishtes si dhe ajo e shkurta e gegërishtes) del në funksion kohëndërtes, si vijon:

a) Mënyra dëftore

1) koha e kryer:

kam pasur (kam pasë), kam qenë (kam qenë), kam punuar (kam punue), kam larë (kam la);

- 2) më se e kryer:  
kisha pasur (kisha pasë), kisha qenë, kisha punuar (kisha punue),  
kisha larë (kisha la), isha larë (isha la);
- 3) e kryer e tejshkuar:  
pata pasur (pata pasë), pata qenë, pata punuar  
(pata punue), pata larë (pata la), qeshë larë (qeshë la);
- 4) e ardhme e sigurisë:  
kam për të pasur (kam për të pasë, kam me pasë), kam për të qenë  
(kam me qenë), kam për të punuar (kam për të punue, kam me punue),  
kam për të larë (kam për të la, kam me la), kam për t'u larë (kam për  
t'u la, kam me u la);
- 5) ardhme e së shkuarës e sigurisë:  
kisha për të pasur (kisha për të pasë, kisha me pasë), kisha për të  
qenë (kisha me qenë), kisha për të punuar (kisha për të punue, kisha  
me punue) kisha për të larë (kisha për të la, kisha me la) kisha për  
t'u larë (kisha për t'u la, kisha me u la);
- 6) e ardhme e përpame:  
do të kem pasur (do të kem pasë), do të kem qenë, do të kem punuar  
(do të kem punue), do të kem larë (do të kem la), do të jem larë (do të  
jem la);
- 7) e ardhme e përpame e së shkuarës:  
do të kisha pasur (do të kisha pasë), do të kisha qenë (do të kisha qenë),  
do të kisha punuar (do të kisha punue), do të kisha larë (do të kisha la),  
do të isha larë (do të isha la).

b) Mënyra habitore:

- 1) koha e kryer:  
paskam pasur (paskam pasë), paskam qenë (paskam qenë), paskam  
punuar (paskam punue), paskam larë (paskam la), qenkam larë  
(qenkam la);
- 2) më se e kryer:  
paskësja pasur (paskësja pasë), paskësja qenë, paskësja  
punuar (paskësja punue), paskësja larë (paskësja la), (qenkësja  
larë, qenkësja la), u paskësja larë (u paskësja la).

c) Mënyra lidhore:

- 1) koha e kryer:  
të kem pasur (të kem pasë), të kem qenë, të kem punuar  
(të kem punue), të kem larë (të kem la) të jam larë (të jem la);
- 2) më se e kryer:  
të kisha pasur (të kisha pasë, me pasë pasë), të kisha qenë (me pasë  
qenë), të kisha punuar (të kisha punue, me pasë punue),  
të kisha larë (të kisha la me pasë la) të isha larë (të isha la, me u pasë  
la).

ç) Mënyra dëshirore:

- 1) koha e kryer  
paça pasur (paça pasë), paça qenë, paça punuar (paça punue), paça  
larë (paça la), qofsha larë (qofsha la);

d) Mënyra (forma) përcjellore:

- 1) koha e tashme e vazhdimësisë:  
jam duke punuar (jam tue (duke) punue), jam duke larë (jam duke  
(tue) la), jam duke u larë (jam duke (tue) (u) la);
- 2) e pakryera e vazhdimësisë:  
isha duke punuar (isha tue (duke) punue), isha duke larë (isha tue  
(duke) la), isha duke u larë (isha tue (duke) u la),
- 3) e kryera e thjeshtë e vazhdimësisë (sipas prof. A. Zymberit):  
qeshë duke punuar (qeshë tue (duke) punue), qeshë duke larë (qeshë  
tue (duke) la, qeshë tue (duke) u la).

Sqarim: Janë, pra, 7 kohë të mënyrën dëftore, 2 të mënyrën habitore, 2 të lidhore, një e dëshirore dhe tri të përcjellore pohore, që gjithsej bëjnë 15 kohë analitike, mirëpo nëse këtij numri i shtohet e kryera e mënyrës kushtore: do të kisha punuar (do të kisha punue), e cila përkon me trajtën e kohës së ardhme të përpame të së shkuarës si dhe me trajtat e pjesores të implikuara në të tashmen e pacaktuar të habitores sintetike: punuakam (punuekam) /= punoka (variant i propozuar) e në të tashmën e caktuar po punuakam (po punueka) /= po punoka, si dhe në të pakryerën e pacaktuar punuakësja



(punokësha) / =punokësha dhe të në atë të caktuar po punokësha (po punokësha) = /po punokësha, atëherë edhe me këtë eptim përngjithës kohëndërtimi me pjesore rritet edhe për disa numra.

Sidoqoftë, të dhënat e mësipërme nuk janë pa interes, ndonëse qëllimi ynë kryesor nuk ishte të përcaktionim saktësisht numrin e kohëve analitike në të cilat merr pjesë pjesorja në funksion kohëndërtues, por të tërheqim vëmendjen në formën e pjesores geqe (të shënuar në kllapa) kundrejt asaj të letrarishtes së sotme toske, ngase format e tilla geqe në realitetin tonë gjuhësor, ta quajmë, me kushtëzim, *po ringjallen* (jo në trajtën e zgjeruar, po pikërisht në trajtën e shkurtë). Themi po ringjallen, ngase gjithnjë e më shpesh, siç e cekëm më sipër, po ndërkëmben me pjesoren e letrarishtes ose po përdoren në mënyrë të pavarur, jo vetëm, në ligjërimin e lirë, por në mjaft raste edhe në gjuhën e shkrimit, duke e bërë këtë pikë çështje të diskutueshme sipas raportit *normë/jonormë*, çështje kjo, që del e involvuar edhe në funksionin e pjesores edhe në formëndërtimin e disa kategorive të rëndësishme të foljes, siç është edhe paskajorja e disa forma të tjera që po i paraqisim në pikën vijuese.

### 2.3. Involvmi i pjesores në formëformim

Është e vërtetë se pjesorja del e përfshirë edhe në formimin e disa formave a togeve foljore që janë:

1) *paskajorja e mirëfilltë me + pjesore*, tipi **me pasë, me qenë, me punue, më la, me ardhë** etj.

2) *përcjellorja pohore, duke + pjesore*: duke pasur (tue pasë) etj.), por edhe *përcjellorja mohore a paskajorja mohore*: *pa + pjesore*: pa pasur (pa pasë) pa qenë, pa punuar (pa punue), pa ardhur (pa ardhë), pa larë (pa la) pa u larë (pa u la),

3) *paskajorja e dytë për të + pjesore* (a *për + gerundi a për + emër asnjansë*) ose *toгу i qëndrueshëm* tipi: për të pasur (për të pasë), për të punuar (për të punue), për të qenë, për të larë (për të la), për t' u larë (për t' u la);

4) *toгfjalëshat*: *me të punuar* (me të punuëm), *një të punuar* (një të punuëm) si dhe *së punuari* (së punuemi).

Si po shihet, veç rastit të parë, që ne e shënuam vetëm në trajtën e pjesores së shkurtër geqe, sepse norma e sotme letrare nuk e ka marrë parasysh, të tjerat janë të normëzuara me pjesoren e toskërishtes, por që në realitete (jashtë

norme) konkurrohen nga *trajtat gjegjëse të pjesores së shkurtër të gegërishtes* (në kllapa), me përjashtim të tri rasteve të fundit të togeve prej pjesore, ku pjesorja gjegjëse e gegërishtes del në trajtën e zgjeruar me prapashetën *-m*.

Ç'është e vërteta, e kam fjalën tani për pjesoren e shkurtër geqe, ajo duke marrë ushqim nga trajta e paskajores, si mënyrë a formë bazë përfaqësuese faktike e strukturës foljore, siç ishte dhe siç po argumentohet edhe në punimin tonë, që ishte, pra, e normëzuar në ish-shqipësi letrare mbi bazë të gegërishtes, por që edhe sot del në përdorim aktiv në gjuhën e masës shumicë, jo vetëm nuk del e *zhdukshme*, por domosdo, duke dalë në përdorim faktik, tregohet e gjallë dhe aktive, andaj edhe silltet e risillet në tryezën e bisedimeve të studiuesve për rivlerësim, prandaj lidhur me këtë shfaqje, ta quajmë, *evolutive*, kërkohet tolerancë nga normëvënësit e sotëm. Kështu po themi, se, siç kemi vërejtur këto trajta gjithnjë e më tepër në realitetin tonë gjuhësor prirën të rikthehen në përdorim të përditshëm normal dhe nuk është fjala për ndonjë cep të arealit verior, por për një prirje që ka gjurmë, pothuajse, në mbarë truallin shqipfolës, si në gjuhën e folur, ashtu edhe në gjuhën e shkruar. Pra, gjithnjë e më shumë ndeshim në trajta të tilla (me pjesore të shkurtër), qoftë *si trajta të vëçanta në funksion të paskajores me + pjesore*, qoftë *si pjesë përbërëse të kohëve analitike*, të formuara me pjesore a me paskajore, edhe pse siç dihet, bien ndesh me normën në fuqi. Shembuj ka mjaft, po i përmendim vetëm disa:

1. Kam pasë sukses, norma: *Kam pasur sukses* (Kam pasun sukses(!));
2. *la pata dredhë atij*, norma: *la pata dredhur atij* (*la pata dredhun atij*(!));
3. Matë e pa matë fjalët sollën shamatë, norma: *Matur e pa matur fjalët sollën shamatë* (Matun e pa matun fjalët sollën shamatë(!));
4. *Vështrua nga kjo anë*, norma *Vështruar nga kjo anë* (*Vështruem/un nga kjo anë*(!));
5. *Ku ka ra, nuk është vra*, norma: *Ku ka rënë, nuk është vranë* (Ku ka ramun nuk është vramun(!) ose Ku ka ranun nuk është vranun ose Ku ka ramë nuk është vramë(!)).

Prandaj, pasi çështja tashmë u rikthye në diskutim, lind pyetja a do të pësojnë evolim edhe trajtat e toskërishtes (letrarishtes së sotme) sikurse përsuan format e pjesoreve të zgjeruara të gegërishtes (Shih në shembujt e mësipërm pjesoret e fjalive në kllapa)?! Kjo çështje mbetet të ndiqet në të ardhmen, por nuk është pa gjurmë, sidomos në gjuhën e folur. Sidoqoftë, në fushën e fjalëformimit trajtat e shkurta të pjesores geqe, as që mund të kontestohen, d.m.th., mund të thuhet se ato faktikisht janë të normëzuara dhe

patjetër duhet të cilësohen si të tilla, pasi, ashtu-kështu, ato janë tema të domosdoshme prodhuese fjalformuese, andaj për rastet e *shkeljeve* të tilla të normës, në ligjërimin e lirë, ose edhe në të shkruar, siç janë shembujt e mësipërm, kërkohet të kihet kriter paksa më të butë, më tolerues.

Me fjalë të tjera, ka mendime që trajtat e tilla nuk duhen konsideruar si shkelje të rënda a neveritëse ndaj normës, aq sa duhen cilësuar b.f. deformimet e trajtave që bëhen me gjymtimin e fundoreve të pjesoreve, siç janë shembujt që po hasen, madje, edhe në shkrimet e *disa pendave* tona, jo të panjohura, siç janë lajthitjet: për të *punu* ose për të *punuë*, me *punu* ose me *punuë* në vend për të *punuar* ose me *punue* a me *punuar*; Me *mat* fjalën e me *hap* gojën: norma: *Mate* fjalën e *hape* gojën ose: *Me matë fjalën* e *me hapë gojen*. Trajtat e tilla, të konsideruara gjoja gegizma(!), d.m.th., pa prapashtesën -Ë si dhe ato me dyanorshin -UE, -YE të gjymtuara në -UE a -U ose -YË a -Y, kurrsesi nuk duhen toleruar, ngase janë kundër natyrës morfologjike të normëzimit të gjuhës shqipe, madje janë edhe kundër rregullës drejtshkrimore, të tashme, por edhe të asaj që ishte në fuqi në ish-shqipen letrare mbi bazë të gegërishtes. Në analogji me tipin e foljeve apofonike: *marrë, vjelë*, dalë etj. si rregull mund të vlejë a të arsyetohen edhe rastet që u cekën më sipër prej nesh, por edhe për trajtat me -un, -ue/m/un, -ye/m/un, që mund të ndeshen në rrethana të caktuara, por pa e cenuar të drejtën e tipizimeve përkatëse.

Sidoqoftë, le të ndiqet si do të duket e ardhmja dhe sa do t'u japë jetë dhe forsim trajtave të shkurtra të pjesores.

### 3. Format infinitivale dhe paskajorja

Pak më sipër u pa se veç *paskajores së mirëfilltë* me + pjesore disatrajtëshe siç u cek në kreun e mëparshëm si p.sh. me *punue*, me *punueun*, me *punuen* me *punuenun* etj., me nocione infinitivale formale paraqitet edhe e ashtuquajtura (sipas M. Domit) *paskajorja e dytë për të + pjesore*, edhe kjo del *disa* formëshe, siç do të trajtohet në vazhdim. Meqë *paskajorja e mirëfilltë* nuk njihet nga letrarishja e sotme, qëllimi ynë është që duke e trajtuar këtë pikë sipas raportit *normë/fjonormë* ndërmjet dy formave të paskajores: *paskajore e dytë /paskajore e mirëfilltë*, por edhe lidhore *paskajore e mirëfilltë*, synojmë me *dale* domosdo te objektivi përfundimtar yni që është: *normë / normë*. Kjo çështje ndërlihet patjetër dhe është e pashmangshme me praktikën gjuhësore a kulturën e gjuhës që ne këtu, nuk mund të ndalemi më gjatë, pasi sipas natyrës që ka punimi, më tepër vihen në pah gjëra paksa të përgjithshme me interes

praktik, pa përjashtuar edhe raste të domosdoshme me interes teorik, po megjithatë po e përcjellim interesimin tonë në vazhdim, ku do të trajtohet më në hollësi çështje të kësaj natyre..

Në gjuhën shqipe dalin këto tri trajta siinfinitivale, një në toskërishte dhe dy në gegërishte që bashkë me paskajoren e mirëfilltë, dalin gjithsej 4 trajta:

- 1) *tosk. për të dalë, për të punuar, për të matur (paskajore e dytë e normëzuar)*

- 2) *geg. për të dalë, për të punue, për të matë (variant jo i normëzuar)*

- 3) *" për me dalë, për me punue, për me matë (variant jo i normëzuar) dhe*

- 4) *geg. me dalë, me punue, me matë (paskajore e mirëfilltë, variant në prag të normëzimit).*

Të vihet re se vetëm në versionin e parë zyrtar pjesorja del në trajtën e zgjeruar, ndërsa në tri versionet e tjera në shëmbullin tonë, karakteristikë e gegërishtes. shfaqet në trajtën e shkurtër (e jo të zgjeruar). Edhe nga ky fakt del domethënia e qëllimit tonë që në gegërishte pjesorja e shkurtër gjithnjë del parësore. Sidoqoftë, *paskajorja e letrarishtes* (me funksione të kufizuara infinitivale) *për të + pjesore* ka mundur t'i zëvendësojë ose mund t'i zëvendësoante, në praktikën ligjërimore letrare, përveç trajtave të gegërishtes me pjesore të zgjeruar (*si: me dalun, për të dalun, me punuen/un a me punuen/nun, me matun a për me matun*) edhe dy trajtat e gegërishtes me pjesore të shkurtër nga pika 2) e 3), versionet: *për të dalë e për me dalë, për të punue e për me punue, për të matë e për me matë, por jo trajtën* nga pika 4): *me dalë, me punue, me matë*, e kështu me radhë, d.m.th. pa pjesëzen *për*, e cila është karakteristikë e fjalive qëllimore, sepse nocioni i paskajores së mirëfilltë *me + pjesore* (pa elementin *për*) është shumë më i gjerë dhe njëherazi shumë më i përcaktuar për nënfusha të caktuara semantike sesa është nocioni i paskajores së dytë, i cili dominohet, siç u tha, nga kuptimi qëllimor, madje edhe konceptet e trajtave të caktuara të paskajores së mirëfilltë, siç janë funksioni përfaqësues, ai kryefjalor, kundrinor e ai kallëzuesor etj. nuk përkohën as mesatarisht, qoftë në nuanca, qoftë në koncept semantik, me ato të paskajores pa pjesëzen *për* (me dalë /për me dalë, për të dalë). Ç'është e vërteta, paskajorja e dytë (qoftë me pjesore të toskëzuar, qoftë me pjesore të shkurtër): *për të punuar/për të punue, për me punue* (në ndërkëmbime të zakonshme që mund të hasen në jetën tonë gjuhësore) nuk mund t'i konkurrojnë paskajores së mirëfilltë, madje as formave të lidhore, ndërsa *paskajorja e mirëfilltë me punue mund t'i konkurrojë lidhore*, por secila ka karakteristikë të veçanta specifike që dallojnë nga njëra - tjetra. *Kështu paskajorja e mirëfilltë tregon*

zakonisht një veprim në proces që kryhet në të ardhmen, duke pasur si bazë momentin e ligjërimit ose një moment tjetër, pa u cekur koha, veta, numri dhe mënyra, që e bën shprehjen abstrakte e si rrjedhojë mungon a fshihet qëndrimi i folësit, ndërsa lidhja me format e saj tregon një veprim a një gjendje që dëshirohet, mund ose duhet të kryhet a duhet të ndodhë, pasi lidhet me një tjetër, më fort të karakterit momental po ashtu të së ardhmes, por edhe të së shkuarës, zakonisht me kuptim modal të mundshmërisë, por që në asnjë rast nuk mungon qëndrimi i folësit, ngase cekën (a nënkuptohen) domosdo koha, veta, numri edhe mënyra, tipi i zgjedhimit etj.

Sido që të jetë, kërkesa jonë për konsolidimin në shkrim, por edhe në të folur të pjesores së paskajores së mirëfilltë, d.m.th. të trajtës së shkurtë, e cila, siç doli nga analiza e mësipërme, jo vetëm në fjalëformim, por edhe në raste të tjera si në frazeologjizma etj. është e pazëvendësueshme dhe gjithsesi e ligjshme, duhet toleruar si prirje, pra, jo aq e qortueshme nga standardologët tanë, ngase kemi bindjen se toleranca lidhur me këtë pikë do të ndihmonte përfaqimin a zgjidhjen pa rezervë të paskajores me + pjesore në formën më të natyrshme. Pikërisht, kështu, për mendimin tonë, kjo çështje mund të konsiderohet e zgjidhur përfundimisht në normën e shqipes standarde. Të jemi më të qartë, lidhur me përfaqimin e kësaj zgjidhjeje, nuk lypset shumë punë, vetëm një interpretim më i drejtë, më tolerues nga studiuesit dhe një mirëkuptim më i madh me një marrëveshje burrishte nga intelektualët e ekspertët e normës standarde. Kështu për me qenë më e përkashme kjo tolerancë didaktikisht, studiuesit nuk duhet t'i marrin fillimisht shembujt më të vështirë për ilustrim, siç është, b.f., folja **me ba** (e cila edhe në vise të ndryshme të Gegnisë nuk del e theksuar njësoj me theksin hundor, por me variacione gjithnjë më të lehta shqiptimi: me ba (me theks më pak hundor), me ba, me be (me theks të lehtë hundor), me bo, me banun, me banen, me bamë, me bamun; **me bë**, me bërë / e bëme bëma ose folja **me punue** me punuemun etj., që i praktikojnë prof. Shaban Demiraj e disa të tjerë në punimet e tyre, por mund të merren, b.f., fillimisht, trajtat apofonike a metafonike, siç është vepruar në FGJSSH (sepse pjesorja është e njëjtë për të dy dialektet) si *me mjellë, me dalë, me marrë, me vjelë* - e pastaj edhe ato të afërta me to, si p.sh. *me djegë, me pjekë, me pasë, me folë, me ardhë, me thënë* (me thanë) etj. e më në fund edhe ato të tipit: *me bë (me ba), me punue, me shkue, me pëlqye, me dashtë*, e kështu me radhë. Në të vërtetë, sot për sot, nën ndikimin e letrarishtes së sotme hundoret e pjesoreve pa shenjë hundake, në paskajore, dalin të shënuara natyrshëm me -Ë, siç janë shembujt: *me thënë, me zënë, me bë, me lënë* etj.

Sidoqoftë, që të katër këta faktorë: *tema prejpjesore, paskajorja me + pjesore, ligjërimi i shumicës si dhe kujtesa ndaj ish-shqipes letrare*, më shumë ose më pak që të gjithë ndikojnë a do të ndikojnë në prirjen evolutive të shkurtimeve të pjesores së letrarishtes së sotme

Në të vërtetë, këtyre katër faktorëve xhitës në raport me pjesoren e shkurter do t'i rikthehemi në kreun e parafundit. Prandaj duke u mbështetur kryesisht në këto arsye nuk është pa vend që të kërkohet nga studiuesit, pa mohuar konceptet e paskajores së dytë, sidomos ato të lidhores, që të njihen më mirë veçoritë karakteristike të paskajores me **me**, e cila në interpretimet përkatëse mos të mbetet edhe më tutje e anashkaluar, po duhet të trajtohet bashkë me format e tjera dhe njëherazi shtrohet kërkesa, siç u tha, që shtyësit kryesorë të pjesores së shkurter të analizohen më në hollësi ndërlidhur me praktikën tonë gjuhësore, çështje këto që do të rimerren në shqyrtim prej nesh, në dy kërret vijues.



## VIII

### CILAT JANË DISA NGA VEÇORITË SPECIFIKE TË PASKAJORES SË MIRËFILLTË NË GJUHËN SHQIPE?

Pikërisht në të mirë të kërkesës për përfshirjen e paskajores në normën e shqipes standarde, në vijim, do të cekem a rriceken përmbledhtas disa nga veçoritë specifike, të veçanta, që ndërliohen me paskajoren e mirëfilltë, të cilat kanë të bëjnë kryesisht me përdorimin e saj në rrafshin sinkronik, çështje këto, për të cilat, me sa dimë, gjuhësia jonë nuk e ka dhënë ende as fjalën e vet ffilluese, madje as vijëzimet fillestare elaboruese.

Së pari, siç është konstatuar edhe më përpara, si edhe në këtë punim, paskajoren me + pjesore e ndeshim domosdo si trajtë përfaqësuese, edhe pse sot ajo qëndron (por faktikisht jo gjithherë) e struktur nën hijen e vetës së parë të dëftores a të trajtave të tjera të dëftores në kontekste të caktuara fjaliore e frazeologjike. Ç'është e vërteta, paskajorja me + pjesore (si e tashme konvencionale) del e pranishme në kujtesë si realie e pakontestueshme. Ajo në funksion përfaqësimit të foljes, qëndron e pashlyer në nënvetëdijen e shqipfolësve dhe sidomos të studiuesve me përvojë dhe me njohuri të gjuhëve të tjera, ngase ajo është mënjeluar nga norma letrare, kohësisht te ne jo më larg se para tridhjetë e sa vjetësh, Madje, siç u dëshmuar në ndonjë rast edhe në punimin tonë, ajo është përdorur dhe vazhdon të përdoret si mjet i domosdoshëm konkretizimi, sa herë që del e nevojshme për të qartësuar shkencërisht ndonjë çështje kyçe praktike a teorike, qoftë në krahasim me barasvlerësitë përkatëse të gjuhëve të huaja, qoftë për nevoja të brendshme të shqipes. Ajo vazhdon të përdoret si mjet ilustrues rreth sistemit foljor të shqipes edhe në raport drejt-fjalëformues që nënkupton ndikimin e saj, në veçanti, edhe strukturën fjalëformuese të preppjesorëve të shqipes.

Së dyti, del si element kyç në sistemin ligjërimor në bashkëjetesë të harmonishme me format e tjera sinonimike të foljeve me mënyra të ndryshme, por edhe me paskajoren e dytë, e cila ndonëse e fryrë dhe e propaganduar nga burimet relevante të shqipes standarde, pandërprerë, pesëdhjetë e sa vjet, deri

në ditët e sotme, siç është cekur më parë, në asnjërin nga funksionet themelore të paskajores, nuk mundi me e zëvendësuar as mesatarisht paskajoren e mirëfilltë parësore, siç është funksioni kryefjalor e ai i kundrinorit të drejtë, por plotësisht as në nënfusha të tjera. Pra, përkundër mospërfilljes paskajorja me + pjesore del ende si formë me mandat fuqplotë për konceptet e caktuara të pazëvendësuar me forma të tjera, por ajo është gjithnjë e gjallë dhe aktive, sidomos në ligjërimin masiv të shtresave tona shoqërore dhe në nënfushën e togfjalëshave të qëndrueshëm frazologjik e në sferën e krijimtarisë letrar-artistike si dhe në tipizime situatash e personazhesh edhe jashtë sferës letrar-artistike.

Së treti, me paskajore formohen mënyra dhe kohë të tjera të foljeve, prandaj mund të thuhet se me rigjallërimin e saj në normën standarde, konsolidimi i sistemit foljor të shqipes, por tërthorazi edhe ai emëror (kujto prejpesorët) do të jetë më i plotë. Është i drejtë konstatimi i studiuesve si ai i Martin Camajit, Mehmet Elezit e të tjerëve se me paskajoren krijohet kohë e mënyra të tjera shprehjeje të foljes që shqipja letrare, në gjendjen e sotme, nuk i njej(!) ose i ka shpallur të paqena(!) ose i ka përjashtuar a anashkaluar arbitrarisht. Sidoqoftë, nuk thuhet pa arsye se një arbitraritet i tillë në parim del shkencërisht i paqëndrueshëm dhe pa kuptim fare. Sipas tyre paskajoren e ndeshim në disa mënyra të foljes:

a) Ajo përdoret thjesht si dëftore dhe për këtë M. Elezi jep këtë shembull nga krijimtaria popullore:

Kur po hyn njeriu n'at kullë

Me kujtse se ka ndërre jetë (Vepra e cit. f. 97).

b) Veç kësaj paskajorja përdoret me krijue mënyrën kushtore me ndihmën e foljeve me pasë, me qenë ose pa to, si: *kisha me shkue, kisha me pasë me shkue; kisha me qenë; kisha me pasë qenë dhe për ilustrim, jepen këta shembuj:*

Me e pasë pa Behurin gjallë/Shpirti tutesh u kishte dalë;

Ju te ura nestra me ardhë/Kam me u vndue në vorr të gjallë;

Me dijte vashë sa fort të due /-Shet gjergjefin e më merr mue.

c) Ajo përdoret, siç thotë po ky autor, me krijue edhe mënyrën urdhërore në një trajtë të sjellshme, si p.sh.: *Me u çue burra!*

ç) Përdoret në fjali të varura me marrëdhënie kushtore, si p.sh.

Në daç me të ardhë duhet me ardhë me më vizitue.

Me punue më mirë, kisha me pasë pare më shumë etj.

Vërejtje: Kështu, autori, duke nxjerrë për ilustrim vargje të zgjedhura me këtë trajtë kryesisht nga krijimtaria popullore, nga epika dhe lirika jonë e pasur jep një gjykim kategorik, por të drejtë dhe fort të qëndrueshëm me këto fjale:

*Çdo rrekeje me e zëvendësue paskajoren e kësaj lirike me lidhoren ose me formën për të - është klithje e orkestrës, çakordim. Kjo lirike ose qëndron kështu siç është ose vdes. Asgjësimi i paskajores do të ishte asgjësimi i saj.*

Gjykim i tillë i M. Elezit s' do koment. Besoj se s' kanë se si të mos pajtohen, po të gjykojnë objektivisht e subjektivisht, edhe studiuesit e tjerë.

Së katërti, paskajorja përdoret me krijue disa kohë të së ardhmes së dëftores variantesh të ndryshme, qoftë në sinonimi me lidhoren, qoftë pjesërisht edhe me paskajoren e dytë. Po i përmendim këto raste:

a) Të ardhmen II të sigurisë të dëftores si për zgjedhimin vepror ashtu edhe për atë jovepror, ku paskajorja me + pjesore në shumicën absolute të shqip-folësve ose shkon barabar me të ose zë vendin e parë në raste përdorimi në krahasim me paskajoren e dytë.

Krahaso: *kam me dalë, kam me la /kam me u la, ndaj kam për të dalë, (kam për me dalë), kam për të larë, kam për me la / kam për t'u larë, kam për me u la* ose nuk e pranon fare paskajoren e dytë p.sh.:

Due me dalë (s' thuhet dot: Due për të dalë, por Dua të dal a do të dal!

Dëshiroj (kam dëshirë) me më ardhë, nëse do me të ardhë (jo Dëshiroj për të më ardhur, nëse do për të të ardhur!), por Dëshiroj të më vish, nëse do (që) të vij(?), madje del e barabartë e në raste ligjërimi edhe parësore në krahasim edhe me trajtat e lidhore, por jo vetëm në rastet kur krijohet kakofoni, si në shembullin e mësipërm, por edhe në raportin e njohur: **erdhme e domosdoshë ndaj së ardhmes së dëshirës**, kur bëhen dallime edhe në pikëpamje semantike, si p.sh.:

do të dal / due me dalë;

dua të laj /dua me la; do të lahem ose dua të lahem / dua me u la;

dëshiroj të shkoj / dëshiroj me shkue;

dua (dëshiroj) të të shoh / (dua) dëshiroj me të pa etj.

b) Edhe të ardhmen e të së shkuarës të sigurisë II të dëftores, përkatësisht të ardhmen e dytë të kushtores, ku paskajorja e mirëfilltë shkon pothuaj barabar ose, për arsye trashëgimie, zë vendin e parë ndaj formës së paskajores së dytë. Krahaso:

*Kisha me dalë, kisha me la / kisha me u la ndaj Kisha për të dalë, kisha për të larë, kisha për t'u larë, ngase edhe faktikisht ruan shtrirje më të gjerë gjeografike edhe sot e kësaj dite, në krahasim me formën tjetër, ndonëse si rezultat i propagandimit të normës*

në fuqi, në kontekste të caktuara ligjërimore, këto trajta mund të barazohen a të ndërëmbehen.

c) Edhe në të gjitha rastet e tjera pas foljeve modale, atyre aspekteore e të tjera, ku paskajorja e mirëfilltë përdoret me përparësi ndaj paskajores së dytë, edhe pse kjo e fundit, e rekomanduar sipas normës letrare në fuqi, për mendimin tonë, del fort artificiale, si:

*Kam ndërmend me dalë. ndaj Kam ndërmend për të dalë(!) ose*

*Në daç me të dashtë duhet të duash ose Në daç me të dashtë duhet me dashtë ndaj Në daç për të të dashur(!) duhet të duash(!) ose duhet për të dashur(!).*

Po japim edhe një shembull tjetër :

*Për atë çështje shkenca ende nuk është në gjendje me hedhë drite të mjaftueshme.*

Për atë çështje shkenca ende nuk është në gjendje të hedhë dritë të mjaftueshme

*Për atë çështje shkenca ende nuk është në gjendje për të hedhur(!) dritë të mjaftueshme.*

Të vihet re ngjashmëria shumë më e madhe e dy versioneve të para, ndaj versionit të tretë.

ç) Si nënpikë më vete po e përmendim edhe ndonjë shembull në dy versione edhe me trajtën e mbindërtuar: **me pasë, me pasë pasë :**

1) Si t' i kishte mendt, do t' i kishte mendt = Me i pasë mendt, kish me i pasë dhent, por edhe:

2) Si t' i kishte pasur mendt do t' i kishte pasur edhe dhent = Me i pasë pasë mendt kishte me i pasë pasë edhe dhent.

3) *Duhej të kishte pasur me shumë kujdes në sjelljet e tij = Duhej me pasë pasë me shumë kujdes në sjelljet e tij.*

4) *Duhej të kisha pasur me shumë fat për të mos u takuar me të = Duhej me pasë pasë me shumë fat për mos me u takue me të.*

Trajtat *me pasë pasë, edhe pse të pazbërthëra në letrarishten e sotme, (e cila e njuh vetëm paskajoren e dytë), pra, faktikisht nuk janë të paqena për sistemin tërësor të shqipes. Ato i kemi të pranishme në të folmet tona si trajta relativisht aktive, madje mund t' i ndeshim edhe në ligjërimin standard të përditshëm. Përdoren me destinim për të përcaktuar një moment përkatës kohor si b.f. *Me pas(ë) pasë me ardhë mirë kishë bë.* Andaj studiuesit kompetentë, këtë fakt, duhet ta kenë në dijeni dhe rastet e tilla t' i kanalizojnë si duhet, jo*

duke i mohuar, por duke ua dhënë vlerën dhe vendin që e meritojnë. Nuk insistohet prej nesh që patjetër të normëzohen menjëherë trajtat e tilla, por ato duhet të dihen dhe të vlerësohen drejt pa nënçmim, ngase, kur dihen e njihen, edhe këto si pasuri e sistemit foljor të shqipes që janë do ta zënë më me lehtësi vendin që e meritojnë në strukturën përkatëse të shqipes.

d) Për të treguar se në gegërishte dhe përgjithësisht trajtat me paskajoren me-pjesore dalin më të konsoliduara në shtratin e vet, se trajtat me *për të....* madje se edhe ato me lidhore, po japim dy shembuj që shkëputëm nga dy këngë tona të njohura:

1) Le të krahasohet, me vëmendje të shtuar, vargu c një këngë të njohur popullore (gege) të lartpërmendur me versionet e mundshme barasvlerëse (të normëzuara(!)):

*Pranvera ka nisë me dalë /dhe bylbylat po këndojnë.*

*Pranvera ka nisur për të dalë (!);*

*Pranvera (sa) nisi të dalë (?).*

Prandaj, nuk është vështirë të gjendet arsyeja pse versioni i parë me paskajoren e mirëfilltë del më parësor se dy versionet e tjera, t' i quajmë, sa me tënë, barasvlerëse, sepse është e pamundur në ligjërimin e përgjithshëm standard të përjashtohet ndikimi i gjallë i shprehjes popullore, siç është vargu i këngës: *Pranvera ka nisë me dalë*, pra, i ndërthurur me paskajoren e mirëfilltë.

2) Le të krahasohet gjithashtu refreni i një këngë të lehtë (hit) të njohur ndër ne e më gjerë me versionet e mundshme në letrarishten e sotme:

Ani ndashtë, ani ndashtë,

Çikat janë *me i dashtë*;

Pa çika të mira,

Zoti mos na lashtë!

Për t' u kuptuar më mirë teksti po japim njëherë fjalëpërfjalëshëm barasvlerës të përkatës në letrarishten e sotme, pastaj edhe tri versione me tekst të përpunuar po në letrarishten.

1. Ani s'ka gjë, ani s'ka gjë / vajzat janë për t' i dashur? Pa vajza të mira / Zoti mos na lëntë!

Siç po shihet teksti nuk humb vetëm nga rimiti, por çalon shumë edhe në pikëpamje të tjera.

2. Ja tani teksti i përshtatur a i përpunuar në letrarishten e sotme, në tri versione:

a) S'ka gjë, s'ka gjë, tani / çupat janë për dashuri/ Pa çupa të mira / mos na lër, oj Perëndi!



b) S'ka gjë, tani, moj xhan / gocat për t'i dashur janë / ku s'ka goca të mira / Zoti motin vranë!

c) Ani, s'ka gjë, s'thuhet kot / vashat duhen sot e mot / pa vasha të mira / mos na lerë o Zot!

Sado që u përpoqëm në tri versione t'i gjejmë barasvlerësit përkatës në letrarishten e sotme me përkthimin adekuat: **ani ndashtë** me *ani s'ka gjë, me i dashtë* me *për t'i dashur a duhen, për dashuri; çikat* me *çupat, gocat, vajzat, vashat; mos na lashtë* me *mos na lëntë, mos na lër?* - s'mund ta arrinin dot vlerat e originalit, prandaj për mendimin tonë shprehjet e tilla, siç ishte refreni në fjalë, s'duhen përkthyer as përshtatur prej shqipes në shqip, por ato duhen sqaruar, përrthithur e përjetuar ashtu siç janë, d.m.th. me paskajoren e elementet e tjera karakteristike.

dh) Ndonëse është cekur rrëshqitas më përpara, po japim si nënpikë më vete ndonjë shembull të fjalive: *me kallëzues të përbërë foljor, sifjali kallëzuesore ose sifjali kundrinore*, ku paskajorja e dytë del domosdo e përjashtuar nga konteksti:

*Filloi të frynte / Filloi me fry; Zuri të mëkëmbëj / Zuri me u mëkëmbë; Shtirej se (po) flinte. / Ai shtirej si me fjetë; Thuaji të vijë menjëherë. / Thuaji me ardhë menjëherë; Nuk lejon që t'i mohohet e drejta / Nuk lejon me iu mohue e drejta.*

Së pesti, paskajorja me + pjesore në shprehjet metaforike (frazeeologjike) siç janë rastet: *Është një lule me e prekë s'duron, Është trim hekur me bre dhe S'ka me hangër me dy lugë*, s'mund të zëvendësohet dot, jo vetëm me paskajoren e dytë, por aq lirishtem as me ndonjë trajtë të lidhore, ngase, bazuar në rregullat e normës pragmatike dhe të asaj stilistike, fjalët e tilla me paskajoren me + pjesore të shkurtër janë të pazbërthyeshme, sepse po të synohej "përkthimi" në një variant tjetër, fjalitë e tilla do të dilnin, siç u tha më sipër, jo vetëm artificiale, por edhe të bastarduara, d.m.th. të papranueshme për shumicën e shqipfolësve. Një rast i tillë mund të shihet, nëse i radhisim versionet e mundshme, sipas shembujve të lartpërmendur:

1) *Është një lule me e prekë s'duron.*

*Është një lule ta prekësh s'duron?*

*Është një lule për ta prekur s'duron (!)*

2) *Është trim hekur me bre.*

*Është trim (që) hekur bren?*

*Është trim hekur për të breër (!)*

ose

3) *S'ka me hangër me dy lugë.*  
*S'ka të hash me dy lugë (!)*  
*S'ka për të ngrënë me dy lugë (!)*

4) *Është asi mjeshtri: me ia pa syri, me ia dashtë zemra, me ia punue dora.*  
*Është asi mjeshtri atë që ia sheh syri dhe ia do zemra, ia puno dora.*

Sigurisht çdo shqipfolës e di se versionet me pikëpyetje (?), edhe pse gramatikisht mund të jenë të lejueshme, pa dyshim, e kanë të humbur kuptimin e mirëfilltë (metaforik) të shprehjes nga origjinali, ndërsa versionet me pikëçuditëse (!) s'di sa mund t'i pranojë logjika e humorit, se natyra e shprehjes normale e shqipes në gjendjen e sotme, nga këndi që e vështrime ne, jo se jo, prandaj shembullit të katërt nuk ia ndajmbathëm formën *me për të...* as me pikëçuditëse. Nga kjo del se shprehjet e versionit të parë, si me thënë, ndërjegjësisht, e themi me vetëdije të plotë, është dëm i madh mos me qenë të pranuar legalisht në gjirin e normës standarde dhe të mos përdoren shfrytëzohen pa ndruajtje sa herë që këtë e kërkon konteksti.

Së gjashti, fundi i fundit, vetëm ai që nuk jeton në djepat e shkrepit e natyrës së gjuhës sonë (!) nuk e kupton dallimin ndërmjet versioneve përkatëse me paskajore, sipas kësaj thënieje:

1. *Me çue një kashtë, me dalë gjashtëdhjetegjashë.*
2. *Çoje një kashtë të dalin gjashtëdhjetegjashë.*
3. *Çohet një kashtë me të dalë gjashtëdhjetegjashë.*
4. *Të çohet një kashtë për të dalë gjashtëdhjetegjashë.*
5. *Të çohet një kashtë për me dalë gjashtëdhjetegjashë.*

Sigurisht lexuesi duhet ta dijë se kuptimi i versionit të parë: **Me çue një kashtë, me dalë gjashtëdhjetegjashë** ka të bëjë me ndonjë komplikim të caktuar që nënkuptohet nga konteksti, shprehje kjo që, vetet, del me një abstraksion më të lartë në krahasim me versionet e tjera, që gjithsesi nga kjo pikëpamje mund të dalin me kuptimesi disi më të qartë ose, ndoshta, më të zbehur, por sa i përket abstraksionit gjithsesi më të reduktuar.

Së shtati, edhe në rastet e individualizimit të situatës ose të tipizimit të personazheve vendi i paskajores del i pazvëndësueshëm. Ja një shembull tipik:

*Im atë, dritë pastë, i cili ndërroi jetë në gusht të vitit 1951, shpesh na këshillonte, ne shkollarëve të rij, se për të arritur sukses në çdo punë me vlerë dhe sidomos në mjeshtrinë e të shkuarit shqip, duhen plotësuar këto tri kushte: kushti i parë, siç thoshte ai, është me dashjë, i dyti me dütë dhe i treti me mujtë. Së pari, pra, duhet ta duash me zëmër e shpirt gjuhën amtare, së dyti duhet ta mësosh e studiosh mirë e mirë atë dhe së treti, nëse i ke përmëshur të dyja kushtet e para, duhet të provosh ta sendërtosh e ta zbatosh me sukses atë dije e atë aftësi të fituar edhe me vepra të shkruara me talent.*

Pra, për hir të autenticitetit, trajtat e paskajores, të nënvizuara prej nesh, nuk mund të zëvendësohen dot me trajta të tjera, qofshin ato edhe të normëzuara: *dashur (për të dashur), dütur (për të dütur), mundur (për të mundur)*, ngase natyra e tipizimit do të cenohej, do të çakordohej harmonia e realies.

Së teti, është e vërtetë që shprehjet me paskajorje me + pjesore i karakterizon jo vetëm abstraksioni i lartë si veti, por edhe ekonomimi gjuhësor, ngase në shumë raste, siç mund të vërehet edhe nga disa shembuj ilustrues të paraqitur prej nesh, kjo del më kursimtare ndaj formave të tjera sinonimike. Po i cekim nja tri raste konkrete:

1) Nga *Pasqyra përmbledhëse e përshtatjes së foljeve - kallëzues në kohët përkatëse*, e paraqitur në dy rubrika, në *skemë-pasqyrën* e tekstit *Gjuha letrare shqipe për të gjithë* (Tiranë 1976, f. 165) shihet qartë një ekonomim i tillë. Kështu sipas kësaj pasqyreje të zgjidhja me lidhore, te rubrika e dytë në krahasim me zëvendësimin e mundshëm me paskajore, rezultati do të dilte 8 me 4, pa llogaritur ndryshimin sipas numrit dhe vetave:  $4 \times 6 = 24$  (ose 24 me 4), ndërsa po të mblulohej tërë koncepti me paskajoren e mirëfilltë raporti del 8 me 1 (ose 24 me 1), d.m.th., në dobi të paskajores me + pjesore. Këtë fakt harmonizimi në kuadër të foljeve të caktuara si *kallëzues* brenda fjalisë a periudhës përkatëse, sipas rubrikave *folja kallëzues* e *pjesës kryesore* në njëri anë dhe *folja kallëzues* e *pjesës nënrenditëse*, në anën tjetër, po e përmendim jo për të kundërshtuar normën në fuqi, por duke u pasqyruar e vërteta, atëherë do të kuptohen më me lehtësi shkaqet e "lajthitjeve" aq të rënda enorme të gegërishtfolësve, pikërisht lidhur me mosrespektimin e normës së tillë, në situata të caktuara. Është e vërtetë se me përdorimin a përligjjen e thënieve me paskajoren e mirëfilltë shprehja e gjuhës standarde, pa humbur gjë nga konteksti, do të dilte më me koncizitet stabil, ndërsa me lidhore shprehja ka më

shumë mundësi laryshie dhe që të dyja a të tria, me paskajoren e dytë, kur gërshtohen në kontekst e përbëjnë një mozaik shprehjesh gjithnjë e më të këndshëm dhe kjo mund të shërbejë si kapital i fortë kundërvënës edhe kundrejt konstrakteve të gjuhëve të huaja..

2) Në kontekst të asaj që u tha në pikën e mësipërme rreth ekonomimit gjuhësor, e shohim të arsyeshme të konstatojmë se koha e *ardhja* e *dëshirës* (do të dal) dhe e *ardhmja* e *sigurisë* (kam për të dalë), mund të mbluhesh në raste të caktuara me një trajtë të paskajores: **kam me dalë** dhe gjithashtu edhe e *ardhmja* e *së shkuarës*: *do të dilja* si dhe e *ardhmja* e *sigurisë*: *kisha për të dalë* mund të mbluhesh me trajtën e vetme të paskajores me **me: kisha me dalë**, pa lënë zbatësi kuptimore të dalluar brenda kontekstit, prandaj edhe nga ky kënd vërtetësohet se paskajorja me + pjesore mund të jetë e vetëmjaftueshme në kontekste të caktuara për të mbuluar koncepte të ndryshme, madje dhe të zëvendësojë dy a tri koncepte të përafërta të konstrakteve të tjera foljore.

3) Gjithashtu, edhe kohët e lidhore, siç janë koha e *pakryer* (të isha), e *kryera* (të kem qenë) dhe *më se e kryera* (të kisha qenë) konteksti lejon që këto të tria mund të zëvendësohen në raste me trajtën e paskajores me **me: më pasë qenë**, ndërsa paskajorja e dytë nuk mund të këmbëhet asesi me trajtat e tilla të lidhore. Krahaso vargjet e një kënge:

*Me pasë qenë si ti e mirë /  
s' duhen rruza, s' duhet lirë!*

Nënkuptohet se vargu i parë mund të vlejë për të gjitha vetat si të njëjtesit dhe të shumësit: *me pasë qenë: (unë , ti, ai ajo) si ti e mirë ose i mirë ose (ne, ju, ata ato) si ti të mirë*. Po të krahasohen versionet me lidhore: të kisha qenë (ose të isha ose të kem qenë) si ti e mirë, as s' due pare as s' due lirë... etj. etj. vetvetiu kuptohet se sa më me ekonomim dalin shprehjet me paskajore.

Së nënti, zgjon interes paraqitja e Mehmet Elezit, i cili lidhur me kohët e ardhme të paskajores siç është shembulli: **Dua me shkue** që në kuptim asnjans ka ngjyrim dëshire, shpjegon se në kontekst të caktuar po kjo trajtë *Dua me shkue* mund të mos ketë ngjyrim dëshire, kur veprimi i tillë kryhet pavarësisht nga vullneti. Madje dallon me të drejtë konceptet *due me shkue* ndaj *po due me shkue ose po due me shkue me (v)dekë* ndaj *due me deké / po due me deké = jam kah vdes*. Në të vërtetë, me të dyja këto forma tregohet një veprim që do të kryhet pavarësisht nga vullneti, po shembulli i dytë me **po** tregon se veprimi do të kryhet kohësisht *më shpejt*. Po ashtu edhe me dy shembuj të tjerë: *Jam kah due me shkue dhe jam kah po due me shkue* tregohet

një veprim i së ardhmes në prag të së kryerës, por me një largësi të ndryshme kohore. Edhe shembulli tjetër *qeshë kah due* me *shkue* ndaj *qeshë kah po due* me *shkue*, tregojnë dallime kohore të ndryshme të nuancuara.

Po të kësaj natyre janë edhe rastet: 1) *gati+ paskajore: gati me u rrëzue* që korrespondon me *barasvlerësin: gati u rrëzova*, (gati u rrëzove... etj.) si dhe 2) tipi: *qeshë tue plasë ose qeshë gati tue plasë*, si p.sh. Fola fola, *qeshë tue plasë ose qeshë kah plasi, por...*, koncept ky që përputhet me mënyrën atraktive po të gegërishtes: *Fola fola, desh kah plasa; ose Fola fola, gati plasa, ose Fola, fola gati me plasë ose Fola, fola desh me plasë*.

Pra në këtë mozaik shprehesh merr pjesë edhe paskajorja e mirëfilltë, e cila kërkon identitetin e vet specifik të merituar.

Me fjalë të tjera, edhe nga shembujt e mësipërm dëshkohet, jo vetëm funksioni kohëformues i pjesores edhe me disa kohë të reja (që nuk i njeh letrarishtja e sotme, por dëshkohet, njëherazi, se funksionet fjalëformuese (formëformuese) e të tjera të paskajores me + pjesore ende plotësisht nuk i janë të njohura opinionit të gjerë intelektual, madje, si duket, as qarqeve shkencore, dhe kjo për shkak të mospërfshirjes së paskajores në standard (!), prandaj në këtë drejtim do të duhej ndërmarrë, domosdo, hulumtime të duhura të mëtejme. Materiali si ai i Mehmet Elezit është i mirëseardhur dhe sigurisht do të sfidojë gramatikanët tanë, që çështjes së funksioneve të paskajores me + pjesore t'i rreken më me seriozitet të duhur, sidomos në analiza shkencore, kërkesë kjo e theksuar, me të drejtë, edhe si porosi nga prof. Shaban Demiraj.

Së dhjeti, që trajta e paskajores me + pjesore nuk është formë e brishtë, dëshkohet edhe me një fakt, mbase i vogël në dukje, por që thelbësisht nuk është aq i pa peshë. Pjesorja e paskajores ose paskajorja me + pjesore ndërkohë del aq e njëzuar organikisht me pjesëzën me aktualisht, saqë nuk lejon t'i futet ndërmjet as pjesëza mohuese **mos**, të cilën e lejojnë t'u hyjë në mes si paskajorja e dytë ashtu edhe lidhorja.

Krahaso: *mos me thënë; mos me folë;*  
*ndaj për të mos thënë; për të mos folur;*  
*ose (që) të mos thuash; që të mos flasësh.*

Madje, ky fakt vlen edhe për katër variante të tjera që ndeshet kjo formë në realitetin tonë gjuhësor: (*mos*) me *u punue*, (*mos*) me *pasë punue*, (*mos*) me *qenë punue*, ku elementi **me**, siç e thekson prof. Sh. Demiraj, nuk mund të veçohet prej tyre (pjesëve të tjera), sepse pjesa që mbetet ose ka një vlerë tjetër ose nuk ndeshet fare (Shih Gramatika historike ... f. 954).

Së njëmbëdhjeti, mendojmë se është me interes të rikeket me këtë rast edhe një fakt tjetër që lidhet me raportin kuptimor: **pjesore /paskajore me + pjesore**. Shqipja, siç dihet e ka vetëm *pjesoren e shkuar pjesore*, e cila përdoret me foljet joveprore, ndërsa e ka edhe paskajoren me + pjesore jashtë norme, e cila ka aftësi shprehëse ashtu si edhe lidhorja edhe për koncepte pjesore (joveprore), ashtu edhe për koncepte veprore dhe këtë fakt po e ilustrojmë me një shembull të njohur. Të vihet re theksimi a specifika e kallëzuesit përkatës:

- 1) Talenti *duhet kultivuar* (kallëzuesi është në pjesore dhe me kuptim pjesor)
- 2) Talenti *duhet me u kultivue* (kallëzuesi është në paskajore, por koncepti është pjesor).
- 3) Talentin *duhet me e kultivue* (kallëzuesi është në paskajore, por koncepti është vepror).
- 4) Talenti *duhet të kultivohet* (kallëzuesi është pjesor me folje këtë rast njëvetore).
- 5) Talentin *duhet ta kultivoj* (unë) (duhet ta kultivosh (ti), duhet ta kultivojë (ai ose ajo), duhet ta kultivojmë (ne), duhet ta kultivoni. (ju), duhet ta kultivojnë (ata ose ato), pra, kallëzuesi në lidhore ndryshon sipas vetës e numrit, ndërsa koncepti i kallëzuesit është vepror.

Prandaj, në shqipe, sipas normës, nuk është e rekomandueshme të thuhet: *Talentin duhet kultivuar*, por vetëm **Talenti duhet kultivuar** ose **Duhet kultivuar talenti**. Ndërsa, siç e pamë me paskajore janë të lejuara të dyja trajtat *Talentin duhet me e kultivue* dhe *Talenti duhet me u kultivue*, ashtu si edhe shprehja në lidhore: *Talentin duhet ta kultivoj* (ta kultivosh,...) ose *Talenti duhet të kultivohet*. Siç dihet dhe po shihet shprehja me paskajoren ndryshon nga trajtat e lidhore, ngase del e kursyer nga veta, numri, koha dhe gjedha zgjedhimore.

Së dymbëdhjeti, janë disa fjali të paplota që në letrarishten e sotme shprehen vetëm me emra. Edhe këta shembuj për nga kuptimi mund të ndërkëmbehen sinonimisht me paskajore, si p.sh., *Dita për punë, nata për pushim /Dita me punue, nata me pushue. Dasma me këngë e gëzim - vdekja me vaj e pikëllim? Dasma me këndue e me gëzue - vdekja me vajtue e pikëllue(!). Fëmija për lojë, plaku për pleqni/ Fëmija me luejtë, plaku me pleqne*, e kështu me radhë. Edhe të këta tipa të fjalive paskajorja e dytë nuk vjen aq e pëlqyeshme, madje edhe lidhorja nuk del fare e mbëshishme.



Së trembëdhjeti, është e vërtetë se paskajorja e pavarur a e mirëfillta del e lidhur organikisht me pjesësen paraprirëse **me** dhe pikërisht kjo trajtë-formë (me + pjesore) del si karakteristike e veçantë e paskajores së shqipës. Madje e marrë në parim kjo trajtë - formë del më e pashme dhe ndoshta më frekuentuese dhe më stabile në përdorim (në kontekste gegërishtfolëse, pa diskutim) në krahasim me trajtat e veçanta të lidhore e të dëftores, kur kemi parasysh trajtat e shumta të këtyre mënyrave që ndryshojnë sipas numrit, vetes, diatezës e kohës, së foljes së caktuar.

Së katërmëdhjeti, madje edhe përdorimi i rasteve me paskajore nuk është i barabartë as kundrejt trajtë-formave të përcjellores pohore e asaj mohore (privativiti), tipi duke (tue) + pjesore dhe pa + pjesore si dhe ndaj formave të tjera të foljeve të pashtjelluara. Pra, dallimi i paskajores me + pjesore del unikale në gjuhën shqipe, për sa i përket trajtë-formës formale kundrejt gjuhëve të tjera, madje edhe për sa i përket anës kuptimore e përbajtësore që mbulon ajo.

Së pesëmbëdhjeti, në realitetin tonë gjuhësor po përdoret shpesh paskajorja edhe në fjalitë pyetëse të tipit: A ka kush me folë? A ka me shtue kush? etj. Pothuajse çdo ditë e dëgjojmë nga shoqëruarit e autobusave urbanë, të ne, kur pyetën bashkudhëtarët: *A ka kush me zbritë? A ka me dalë kush?* dhe e informon njëherazi shoferin: *Ka zbritje a S'ka zbritje! Ka dalje a S'ka dalje!* Pra në raste të tilla nuk futen në përdorim as trajtat e dëftores as të tjera, por vetëm paskajorja edhe prejjesori. Ky është realiteti ynë.

Së gjashtëmbëdhjeti, edhe zbrëthimi i fjalive kryefjalore a kundrinore me përemër, mund të bëhet me paskajoren e mirëfilltë, madje në kontekste të caktuara barasvlerësia e tillë me paskajore del shumë atraktive e pa lënë keq ndonjë gjë për nga kuptimi. Le të krahasohen shembujt: *Kush duron, trashëgon ose Ai që duron trashëgon / Me durue, me trashëgue, Kush lufton fiton ose Ai që lufton fiton. / Me luftue, me fitue, Kush punon, gëzon ose Ai që punon gëzon / Me punue, me gëzue. Kush ha hudhra i vjen era gojës ose Ai që ha hudhra i vjen era gojës. / Me hangër hudhra i vjen era gojës, e kështu me radhë. Meqë kuptimi i pyetësit **kush**?, por edhe kuptimi i përemrit dëftor a dëftoro-lidhorit veta e tretë njëjës ai (që), njihet nga letrarishja e sotme, ne po ndalemi vetëm në të vënit në pah të kuptimisë së theks së fjali-periudha me paskajore, si shprehje, del më e përcaktuar kuptimisht se të tjerat. Në të vërtetë, me elementin e paskajores përshihet edhe kuptimi i pyetësit (dëftoro-lidhor) *kush*?, ashtu edhe ai i togut *ai që*, sepse më paskajore nënkuptohet se mbulohe elemente të pakufishmërisë së caktuar, por edhe konceptet e të gjithë vetorëve, si të numrit njëjës ashtu edhe të numrit shumës. Po e ilustruojmë këtë fakt vetëm me*

njërën nga shembujt e mësipërm: (Unë, ti, ai ajo, ne, ju ata ato) *Me punue, me gëzue* (= *Kush* (ose *Ai që*) punon - gëzon), prandaj kjo specifike duhet të njihet nga standardi i sotëm, sepse kështu do të pasurohej standardi, qoftë me shprehje sinonimike, qoftë me ngjyresa semantike.

Së shtatëmbëdhjeti, për të parë edhe më mirë largesën relative a specifike kuptimore të paskajores së dytë ndaj asaj të mirëfilltës do ta marrin sa për ilustrim vetëm një shembull konkret në variante të ndryshme, ku syri i vrojtuesit mund të vërejë më së miri raportin e këtyre dy formave. Gjithashtu mund të vihet re edhe raporti në krahasim me format e tjera të foljeve të pashtjelluara në ndërlidhje me barasvlerësit më të natyrshëm sipas trajtave të foljeve të shtjelluara variantesh përkatëse. Të vihet re, pra, bashkë me vërtetë-sinë e shprehjes përkatëse edhe ana formale e ndërtimit të konstrukteve të secilit version:

1. Për të vepruar kështu vullneti nuk duhet të mungojë.  
Që të veprosh ... (të veprohet) kështu vullneti nuk duhet të mungojë.
2. Me të vepruar kështu vullneti nuk do të mungojë.  
Posa të veprosh... (të veprohet) kështu vullneti nuk do të mungojë
3. Një të vepruar kështu vullneti nuk do të mungojë.  
(Posa të veprosh... (të veprohet) kështu vullneti nuk do të mungojë.
4. Së vepruari kështu vullneti nuk do të mungojë.  
Po të veprosh ... (të veprohet) kështu vullneti nuk do të mungojë.
5. Duke vepruar kështu vullneti nuk do të mungojë.  
Po të veprosh... (të veprohet) kështu vullneti nuk do të mungojë.
6. *Me veprue kështu vullneti nuk do të mungojë (nuk ka me mungue).*  
*Nëse vepron...* (veprohet) kështu vullneti nuk do të mungojë.
7. *Pa vepruar kështu vullneti do të mungojë (ka me mungue).*  
*Nëse nuk vepron...* (veprohet) kështu vullneti do të mungojë.

Nga shembujt e mësipërm mund të nxjerrim disa përfundime, ndonëse jo krejtësisht të padiskutueshme:

e para, të vihet re konstrukti i shembullit të parë me paskajoren e dytë, i cili ndryshon nga të gjithë shembujt e tjerë;

e dyta, shembulli i dytë dhe i tretë, kanë konstrukt të njëjtë në lidhore ashtu si edhe shembulli i katërt dhe ai i pesti, ndaj versionit përkatës me paskajore.

e treta, të vihet re se shembulli i gjashtë (paskajorja e mirëfilltë) pohore dhe paskajorja mohore (privativi) nuk kanë barasvlerësi me lidhore, si pesë

shembujt e mësipërm, po kanë barasvlerësi vetëm me trajtën përkatëse të dëftores;

e katërta, të vihet re ndryshimi i pjesëzave paraprirëse të foljeve të shtjelluara: që + lidhore (vetëm për paskajoren e dytë), posa + lidhore për dy format vazhduese, po + lidhore për shembujt e katërt dhe të pestë dhe nëse + dëftore për shembujt e gjashtë dhe të shtatë, d.m.th. për paskajoren pohore dhe atë mohore. Sidoqoftë, pa marrë parasysh faktin se përcjellorja duke + pjesore dhe togu së + emri i foljezuar, nuk kanë afri formale, ato në kontekst dolën me barasvlerës të njellojtë. Gjithashtu, edhe pse pjesëzat a fjalëzat paraprirëse mund të zëvendësohen me simotra të tjera, madje edhe të ndërkëmben njëra me tjetrën, ato në kontekste të caktuara, edhe në atë mënyrë japin për të kuptuar se veçoria e paskajores së mirëfilltë del me dallime të konsiderueshme, qoftë në krahasim me paskajoren e dytë, qoftë edhe ndaj formave të tjera.

Edhe nga ky këndvështrim, pra, del e mbëshihme kërkesa që paskajorja duhet të zërë vendin e vet në standard për koncepte të caktuara specifike, pa u ndarë sinonimisht nga format e tjera të pranuar nga norma e shqipes letrare në fuqi.

Së tetëmbëdhjeti, paskajorja del në sinonimi të plotë me tipin e fjalive infinitivale me pjesore të paraprirë nga folja modale gjysmëndihmëse e ngurtësuar *duhet* e *do* si dhe *lypset*. Psh. *Duhet dalë = Duhet me dalë; Kjo punë do marrë me seriozitet = Kjo punë duhet me u marrë me seriozitet. Lypset kryer (krye) detyrat me kohë = Lypset me i krye detyrat me kohë etj.*

Në të vërtetë, fjalitë e këtij tipi me pjesore që shprehin kuptim infinitival nga disa gjuhëtarë konsiderohen fjali me paskajoren mbase të kahershme, nga të cilat më vonë supozohet se do të ketë dalë paskajorja (e re) me *me*. Sidoqoftë, ne po e përmendim vetëm si një veçori specifike të paskajores së sotme, e cila kuptimisht e sinonimisht ndërkëmbet me formën tjetër gjeqjësë. Siç dihet, pjesorja edhe në këto raste, vetëm për vetëm, nuk motivohet si paskajore e vërtetë, siç ndodh me paskajoren *me + pjesore*. Këtë rast pjesëza *me* konsiderohet si formant i specializuar që e lidhur organikisht me pjesoren motivon kuptimin leksikor të paskajores së mirëfilltë, p.sh. forma: *me punue* vetvetiu ofron përveç konceptit të veprimt (punës), të punuarit edhe të formës përfaqësuese të foljes edhe kuptimin abstrakt të kufizuar brenda 8 vetave etj., ndërsa vetëm për vetëm pjesorja *punue*, veç kategorisë gramatikore në gjendjen e sotme nuk ofron, pothuajse asgjë, nga fusha semantike në kuptim të paskajores.

Së nëntëmbëdhjeti, pasi ne kemi vështirësi për të gjetur zëvendësim me trajtat e lejuara të normës së sotme të shqipes letrare për shprehjen zinxhir me paskajore, si p.sh. *Me dalë, me shëtitë, me u ajrue e me u freskue, me u kënaqë dhe me u kthye, me u la e me ra me fjetë*, prandaj kërkojmë ndihmën nga standardologët tanë e nga të tjerë. Për ne shprehja e tillë vargore (periudhë me fjali të nënrenditura), që nuk është aq e rrallë në kontekste të caktuara në ligjërimet tona, ka kuptim paksa abstrakt, por jo të pa cak, pasi, vlen për një kuptimsi gjithësesi të rrubullakësuar që mund të vlejë për të gjitha vetat njëjës e shumës (tetë sosh), kuptim ky me kufizim që s'dimë se si mund të mbulohet me forma e trajta të tjera të gjuhës së sotme letrare kaq natyrshëm, prandaj ne u detyruam të kërkojmë ndihmën përkatëse, në veçanti, nga sintaksologët tanë normëvënës. Gjithsesi për ne është me rëndësi se edhe ky fakt është një veçori karakteristike e paskajores së gjuhës shqipe që duhet studiuar më në thellësi e gjerësi dhe në përfaqje edhe me gjuhë të tjera.

Së njëzeti, së fundi, si veçori specifike të paskajores me + pjesore e shkurtër do të përmendim një fakt, për mendimin tonë, tejet me interes, që ndërlihdet me funksionin stabilizues, që luan kjo formë, indirekt e direkt, në planin e brendshëm paradigmor në strukturën foljore të shqipes. Për të kuptuar më mirë synimin tonë së pari po japim në vazhdim disa shembuj konkretë sipas tipave të foljeve, p.sh.

1) *bërtas (bërtitur) me bërtitë*, bërtitës bërtitje; *rrëshqas (rrëshqitur) me rrëshqitë*; rrëshqitës rrëshqitje rrëshqitshëm, i rrëshqitshëm i rrëshqitshëm; *buj (bujtur) me bujtë* bujtës bujtje (erdha bujtshëm, në të bujtshëm) bujt(t)ore, zbruj (zbrujtur) *me zbrujtë* zbrujtës zbrujtje i zbrujtshëm; *shes (shitur) me shitë*, me u shitë, shitem shitës shitje shit(t)ore; *zbres (zbritur) me zbritë*, me u zbritë, zbritem, zbritës, zbritje, i zbritshëm, e zbritshmja; *qes (qitur) me qitë*, me u qitë, qitës, qitje; *paraqes ( paraqitë, paraqitur) me paraqitë*, me u paraqitë, paraqitës, paraqitje; *pres (pritur) me pritë*, me u pritë, pritem, pritë, pritës, pritje, i pritshëm pritshmëri; *mirëpres (mirëpritur), me mirëpritë*, me u mirëpritë, mirëpritem, mirëpritës mirëpritje; *ngre (ngritur), me ngritë*, me u ngritë, ngritem, ngritës, ngritje, ngritshmëri; *vete vajtur me vajtë*, me u vajtë!, vajtës vajtje etj.

2) *shëtit a shëtis (shëtitur) me shëtitë*, me u shëtitë, shëtitem, shëtitës, shëtitje, i shëtitshëm; *çukit a çukis (çukitur) me çukitë*, me u çukitë, çukitem, çukitës, çukitje; *çud çudis (çuditur), me çuditë*, me u çuditë, çuditem, çuditës, çuditë, çuditje; *ndrit a ndris (ndritur), me ndritë*, me u ndritë, ndritem, ndrites, ndritje, ndritshëm, i ndritshëm, ndritshmëri etj.



3) *përu*d (përu*d*hur) **me përu**d*hë*, *me u përu*d*hë*, përu*d*hem, përu*d*hë*s* përu*d*hje; përu*l* (përu*l*ur) **me përu**lë, *me u përu*lë, përu*l*em, përu*l*ës, përu*l*je etj.

4) *mat* (matur) **me ma**të *me u ma*të, *matem*, *matës matje*, *i mats*hëm; *fikat* (fikatur), **me fika**të, *me u fika*të, *fikatem*, *fikatës*, *fikatje*; *ujdis* (ujdisur) **me ujd**isë, *me u ujd*isë, *ujdisem*, *ujdisës*, *ujdisje* etj.

5) *vij* (ardhur) **me ardh**ë *me u ardh*ë!, *ardhës ardhje*, *i ardh*shëm, *vdes vdekur me vdek*ë, *vdekës*, *vdekje*, *i vdek*shëm, *vdeksh*mëri etj.

Nga shembujt e mësipërm mund të nxjerrin këto konstatime:

e para, nga të gjithë shembujt shihet se kemi të bëjme me folje të tipit me temë në bashkëtingëllore që në letrarishten e sotme, në pjesore, marrin prapshitesën -UR, gjë që shihet edhe nga forma përkatëse e vënë në kllapa;

e dyta, pikërisht aktivizimi i paskajores së mirëfilltë në këtë strukturë ndihmon konsolidimin e trajtave me -it jo me -is, të vetes së parë të dëftores, siç janë shembujt nën 2, ashtu siç i parashihet edhe rregulla drejtshkrimore, ndonëse ka kërkesa për favorizimin e trajtës së dytë me -IS; përfundim ky që nuk favorizohet nga forma e paskajores (më saktë: nga pjesorja e paskajores së mirëfilltë);

e treta, fjalët e prejardhura (prejpjesorët), siç shihet nga shembujt e shënuar që të gjithë formohen nga pjesorja e shkurtër, jo nga trajta e zgjeruar me -UR, madje nuk del asnjë rast e që fjala e prejardhur të përftohet as nga veta I-rë e njëjësit të dëftores, sidomos kjo shihet qartë nga shembujt nën 1) dhe 5); e katërta, edhe të shembujt nën 3) dhe 4) kuptohet se fjalët e prejardhura janë përfutur po nga pjesorja e shkurtër e jo nga forma të tjera dhe

e pesta, që për mendimin tonë, del si fakt më kryesor ndër kryesorë është: **që të gjithë këta prejpjesorë që paraqesin model të qëndrueshëm fjalëformues janë formuar padyshim nën ndikimin e paskajores së mirëfilltë.**

Ky konstatim vlen edhe për të gjithë tipat e foljeve të sistemit foljor të shqipes, ndonëse mund të ketë edhe ndonjë përjashtim anësor, por jo i përmasave të gjera. Duhet ta kemi parasysh faktin se kuptimi i paskajores, ndaj njëjësit të dëftores si trajtë përfaqësuese qëndronte në të kaluarën, por që qëndron edhe sot shumë më me ndikim, kur kemi parasysh natyrën e gjuhës shqipe, sepse vetë forma e paskajores me pjesore të shkurtër shqiptohet më lehtë ndaj paskajores me pjesore të zgjeruar, prandaj supozojmë se edhe ky fakt do të ndikojë që edhe në të ardhmen ky evolim do të prekë gjithnjë e më dallueshëm edhe pjesoren e zgjeruar të pjesores së letrarishtes së sotme.

Ç'është e vërteta, edhe mbi bazën e njëjësit të dëftores mund të jetë e formuar ndonjë fjalë e prejardhur, si kamës e ndonjë tjetër, ashtu si edhe mbi bazë të pjesores së zgjeruar me -UR (-geg. -UN) si p.sh. i matur, maturi (geg. i matun, matuni), por prodhueshmëria dhe veprueshmëria e tyre për nga gjerësia e nënfushave të mbuluara nuk mund të krahasohet me formimet mbi bazë të pjesores së shkurtër, e ndihmuar dhe e motivuar, siç u cek më sipër, edhe nga paskajorja e mirëfilltë, me + pjesore të shkurtër, goftë drejtpërdrejt, goftë tërthorazi.

Si përfundim, të këtij kreu, po theksojmë se përveç tipareve të paskajores të cekura në burime të caktuara edhe gjatë punimit tonë, nga aspekti i sinkronizimit, mund të ketë edhe të tjera, si p.sh. ndërsa me paskajoren e mirëfilltë mund të zëvendësohen plotësisht të gjitha rastet me formën e paskajores së dytë, me paskajoren e dytë si dhe me format e lidhore nuk mund të zëvendësohen të gjitha konceptet e shprehura me paskajoren e mirëfilltë. Për këtë po mjaftohemi me sjelljen e shembullit: **Me ba dekën si me le**, shprehje kjo, e cila, siç theksohet nga B. Kraja "e ka shoqëruar dhe frymëzuar popullin tonë nëpër shekuj në luftën e tij të mbijetesës për kah identiteti dhe vetëdija kombëtare, në gjuhën e sotme letrare nuk mund të përkthehet dot". Po këtë shembull dhe një tjetër i cek edhe A.Sula dhe konstaton se "toskëzimi për hir të standardit" si p.sh. *E bën vdekjen si të lindë(!)* ndaj **E bën dekën si me le**, nuk tingëlton natyrshëm, madje e ka të zbehur shprehësinë si dhe ngjyrimin burimor" (Shih: *Gjuha shqipe 1/2005, f. 76*). Andaj rastet e shprehjeve dhe të frazeologjive të tilla që karakterizohen me paskajoren e mirëfilltë është mëkat i pafalsëhmë të mbesin edhe më jashtë standardit, d.m.th. të mbesin të pashfrytëzuara ose të "përkthehen", sepse shprehjet e tilla origjinale e njomin kontekstin në rast të caktuara, pra vetëm e vetëm ashtu si janë të thadruara në bashkësinë e caktuar folëse.

Sidoqoftë, këtu u përmendën disa nga veçoritë karakteristike të paskajores së mirëfilltë të gjuhës shqipe (me + pjesore e shkurtër), të cilat bashkë me veçori e motivime të tjera duhen pasur parasysh me rastin e gjykitimit rreth integritimit, apo jo, të kësaj forme në shqipen standarde, me ç'rast bie në sy, pikërisht, pjesorja e shkurtër si gjymtyrë organike e pandarë e paskajores së mirëfilltë, andaj kësaj gjymtyrë të paskajores, po edhe si një formë formalisht të pavarur, do t'i kushtojmë trajtim pak më të hollësishtëm në kreun vijues.



## IX

### A ËSHTË Pjesorja e shkurtër një siçelës, Magjik potencial, veç tjerash, edhe për Zgjidhjen e paskajores me me?

Për të dalë përgjigjia më e qartë lidhur me pyetjen e shtruar në këtë krye të punimit tonë: a mund të shërbejë pjesorja e shkurtër një siçelës magjik potencial, veç tjerash, edhe për zgjidhjen e paskajores me me, apo jo, do të bëjmë fjalë:

së pari, për ekzistimin a përligjjen e pjesores së shkurtër, jo vetëm në shqipen ligjërimore, por edhe në atë letrare, të pranuar plotësisht ose pjesërisht, por vetëkuptueshëm, brenda normës letrare,

së dyti, për disa fakte dëshmuese se pjesorja e shkurtër del e stimuluar nga kujtesa e pashlyer masive ndaj normës së ish-shqipes letrare, por edhe nga dukuria e evoluimit gjuhësor analog në raportin pjesore e zgjeruar/pjesore e shkurtër,

së treti, rreth procesit evolutiv të theksuar që mbetet të ndiqet, së katërti, për një shembull tipik lajthitjeje në interpretim, si pasojë e shkaktuar nga mënjanimi i pjesores (gege) nga norma letrare dhe

së pesti, rreth konstatimit përfundimtar, shprehur me bindjen se pjesorja e shkurtër, vërtet, mund të shërbejë, një siçelës magjik potencial, veç tjerash, edhe për zgjidhjen e problemit të paskajores me me në shqipen standarde.

#### A) Cilat janë faktet kryesore për ekzistimin a përligjjen e pjesores së shkurtër në shqipen letrare dhe atë ligjërimore?

Puna e kërkon që t'i përmendim, madje edhe t'i përsërisim përmbledhtas disa nga faktet kryesore që dihen, por edhe ato që nuk njihen aq mirë, edhe pse mund të jenë cekur në ndonjë rast më përpara, pastaj do të përpiqemi ta përplotësojmë tekstin me lëndë të re të nevojshme me qëllim për me dalë të synimi ynë që është shprehur në vetë titullin e këtij kreu, d.m.th., del, apo jo,

122

funkzioni i pjesores së shkurtër një siçelës magjik, për zgjidhjen e disa çështjeve të hapura të sistemit foljor e emëror të gjuhës sonë, siç është edhe paskajorja e mirëfilltë?

Kërkojmë bashkëshoqërim nga lexuesit e nderuar, që të mbajnë qëndrim për të gjitha konstatimet që do të shtrohen në analizë të punimit tonë rreth fakteve që dëshmojnë ekzistimin a përligjjen e pjesores së shkurtër në shqipen letrare, madje edhe atë ligjërimore, në mënyrë që lënda të jetë më e përkapshme dhe e mirëkuptueshme. Kështu po themi se, siç dihet, shqipja e sotme letrare (norma e saj) në masë të madhe është e paqartë rreth kësaj pike, pasi, pothuaj, nuk e njih një formë të tillë, prandaj kërkojmë që argumentet tona të ekspozuara këtu, të ndiqen me vemendje të shtuar, sepse kemi të bëjmë me një lëndë që kërkon jo vetëm mirëkuptim, siç u cek, por edhe mbështetje e vlerësim të drejtë.

Së pari, që edhe letrarishnja e sotme e një faktikisht (por jo plotësisht) pjesoren e shkurtër po sjellim faktin se në *Drejtskkrimin e gjuhës shqipe* (1973, f. 55) pranohet si rregull se një pjesë e foljeve apofonike ato me temë në **-I, -II** dhe **-rr** në pjesore marrin një **-Ë** fundore si p.sh. *dal, dalë, vjel vjelë, mjel mjellë, mbjell mbjellë, sjell sjellë, marr marrë, shtjerr shtjerrë, nxjerr nxjerrë* etj., po ashtu shkruhen me **-ë** fundore edhe pjesoret e disa foljeve të parregullta si: *jap dhënë, ha ngrënë, jam qenë, them thënë, vë vënë, zë zënë* etj. Këtë fakt po e përmendim, sepse trajta e tillë (veç si përfitim asimilues i kompleksit përkatës fundor) mund të cilësohet edhe si prapashtesë e mëvetëshme, ngase në burime të caktuara, po këta shembuj, mund t'i ndeshim me prapashtesë të zgjeruar si p.sh. *dalun, marrun a marrur, dhënun, vumë (vënuem) etj.* (Shih veç gjuhës së shkrimtarëve të vjetër e të tjerë edhe Fjalorin e K. Kristoforidhit, po edhe shembuj nga letërsia popullore), prandaj kjo **-Ë**-fundore, mund të konsiderohet funksionalisht si një prapashtesë inovuese e pandarë e pjesores së shkurtër, siç do të shohim më poshtë, ngase ashtu del e cilësuar në tipa të tjerë të foljeve. Kjo është arsyeja që ne e shënuam si fakt të parë se letrarishnja me një rregull të tillë drejtskkrimor në fakt (ndonëse jo plotësisht) e *njeh të normëzuar përdorimin e pjesores së shkurtër për tipa të caktuar të foljeve*. Por sa mund të merret ky fakt edhe si një veprim analogjik a rrugë e trasuar edhe për tipat e foljeve të tjera apofonike dhe të tjera, sidomos ato me temë në bashkëtingëllore në normën e shqipes së sotme letrare, mbetet të sqarohet, ngase kjo dukuri nuk është pa gjurmë

Së dyti, është fakt se në të katër kohët e habitores veçohet pjesorja e shkurtër, **qoftë në gegërishte, qoftë në toskërishte**, siç e vëren edhe prof. I. Ajeti. Kjo

123



Fjalor, p.sh. ndeshim edhe shembullin *u mbulue vajza që ka kuptimin*: me u fejue, *u laknue këmisha*, që d.m.th. *këmisha me u shkye, me u bë copë - copë*. Fjalori si faktologji do të kështu me radhë. Mirëpo pasi lënda e këtij Fjalori si faktologji do të përmendet edhe më poshtë, nuk po japim shembuj të tjerë.

Së gjashti, mbështetemi në kuptesën e pashlyer ndër breza shqipfolësish, ngase po këtë formë të shkurtër ish - shqipja letrare mbi bazë të gegërishtes e pati kishte të normëzuar shumë e shumë dhjetëvjetësia pandërprerë, madje e pati kishte të normëzuar edhe me vendime udhëzuese qeveritare mbi bazë të rekomandimeve të sforcuar edhe me vendime udhëzuese qeveritare mbi bazë të rekomandimeve të Komisionit Letrar të Shkodrës, por edhe me përkrahje zyrtare gjatë gjithë të Komisionit Letrar të Shkodrës, por edhe me përkrahje zyrtare gjatë gjithë periudhës së Pavarësisë. Dihet se para se të mënjanohet, para tridhjetë e sa vjetësh nga norma e shqipes së sotme letrare, pjesorja e shkurtër ishte trajtë e normëzuar.

Së shtati, mbështetemi në ligjin universal që ka të bëjë me evoluimin si prirje në raportin *pjesore e zgjeruar / pjesore e shkurtër*. Pra, kemi të bëjmë me prirjen për thjeshtëzimin e trajtave të zgjeruara, duke u mbështetur, në ligjin e evoluimit, d.m.th., në përzgjedhjen e trajtës më të thjeshtë, më të shkurtër a më me lehtësi shqiptimi.

Meqë për të pesë pikë-faktet e para, pak a shumë, mund të konsiderohet se janë gjëra të ditura ose është bërë fjalë, madje, në raste, edhe mjaft hollësisht edhe në kërret përkatës të këtij punimi, nuk e shohim të arsyeshme të ndalemi edhe më, ndërsa për dy pikë-faktet e fundit (pikat gjashtë dhe shtatë), pasi organikisht e kuptimisht dalin si çështje të ndërlidhura njëra me tjetrën, si një tërësi komplekse e pandarë, e shohim të arsyeshme të japim edhe ndonjë sqarim në vijim.

## B) Disa fakte dëshmuese që pjesorja e shkurtër del e stimuloar nga kujtesa e pashlyer ndaj normës së ish-shqipes letrare dhe nga dukuria e evoluimit gjuhësor

Është e vërtetë, se për një brez të tërë shqipfolësish del ende e pashlyer kujtesa kolektive ndaj ish-normës letrare që lidhet ngushtësisht me sendërtimin e dukurisë së evoluimit të trajtës së zgjeruar të pjesores në trajtë të thjeshtë, ngase ashtu ishte në të vërtetë edhe si trajtë e normëzuar, e cila përligjet edhe nga pikëpamja e shqiptimit më të lehtë. E kemi fjalën edhe për grafim më të shkurtër të trajtës së pjesores, duke i shndërruar prapashtesat e gjata a të

dyfishuara foljore, në prapashtesa të thjeshta: qoftë në prapashtesën zero, qoftë në prapashtesën inovuese -Ë. Ja, pra, disa fakte konkrete.

E para, ndërsa në gramatikën e J. Rrotës dhe të D. Sheperit që respektonin traditën, pjesoret e gegërishtes në paskajoren karakteristike i ndeshim në trajtën e zgjeruar si p.sh. *me bam, me mbetun, me u quejtun, me emnuem* etj. (Shih edhe Th. Dhima te *Seminar...* 23/1, f. 286, në gramatikën e O. Muderrizit (1944) e ndeshim vetëm në trajtën e shkurtër: **me besue, me vlerësue, me paditë, me palosë, me shkri, me zbardhë** etj.

E dyta, po ashtu pjesoren e shkurtër e ndeshim edhe në shkrimet e prof. A. Xhuvanit, botime të viteve 1953, 1956. Sa për ilustrim, po shënojmë vetëm dy fjalë, ku përdoren normalisht pjesoret e shkurta (të letrarishtes geqe të asaj kohe, ndonëse ishte e goditur nga norma e ditës):

1) *Duheshin ndreqë, rregullue e vu në vend edhe disa gjana të tjera*.

2) *Gjuha shqipe duhet përdorë e shkruue sa ma pastër, tue nxjerrë jashtë gjithë fjalët e hueja*.

Kuptohet, prof. A. Xhuvanit, më tepër si individ i privilegjuar, ende ia botonin punimet me paskajoren me + pjesore të shkurte.

E treta, edhe në *Ortografinë gjuhës shqipe* (Beograd 1964) manipulohej vetëm me pjesoren e shkurtër, qoftë në kuadër të paskajores, qoftë si rast i veçantë. Aty, veç tjerash, hasim këto trajta të pjesores: *shitë, shëtitë, përgatitë, llomotitë*, përkatësisht të paskajores: *me pre, me pritë, me ardhë, me ditjë, me pi, me djejë, me pjekë, me shkruue, me lye, me zie* etj.

E katërta, nga fusha e letërsisë artistike shkëputëm një tre shembuj vargjeshe nga sonetet e hershme të prof. E. Gjerqekut:

1) Se do ta puthi dritën e bardhë

(...)

Dhe presim ngadalë Agimin *me ardhë*.

2) Mbaje (...) lëkurën njerëzore

Se me t'ujkut asht lehtë *me ndrrue*

E të thelpnës në dredha e lajka *zbukurue*.

3) Mesnatë, Unë e kanga ime jemi *nda*

(...)

Dikush erdh në dritare. U zgjova *me pa*.

Le t'i shikojmë edhe një herë me vëmendje trajtat e shkurta të pjesoreve të përdorura në sonetet e prof. E. Gjerqekut, në përfaqje me trajtat e zgjeruara përkatëse të gegërishtes të përdorura, sipas shembujve të mësipërm, por edhe



në krahasim me formën letrare e hibride (paskajore e toskëzuar), me ato të paskajores së dytë të tipit *me për të...* të letrarishtes së sotme si dhe me lidhoren barasvlerëse:

- 1) *me ardhë*: me ardhun, me ardhen; ardhur (me ardhur) për të ardhur, që të vijë;
- 2) *me ndërrue*: me ndërruem me ndërruemun, me ndërruenuin, me ndërruen; ndërruar (me ndërruar), për ta ndërruar, që ta ndërrosh;
- 3) *zbukurue*: zbukuruem, zbukuruemun, zbkuruenun, zbkuruenen; zbkuruar;
- 4) *jemi nda*: jemi ndam(ë), jemi ndamun, jemi ndanun, jemi ndanen; jemi ndarë;
- 5) *me pa*: me pamë, me pamun, me panun, me panen, parë (me parë!), për ta parë, që ta shoh.

Pra, nga shembujt e mësipërm pa hyrë në motivime të tjera, duke u mbështetur në arsyen e ekonomisë gjuhësor a të dukurisë së evoluimit në dobi të trajtës më të shkurtër, më të thjeshtë a më të lehtë për shqiptim etj., shihet se pjesorja e shkurtër a paskajorja me **me** e gegërishtes, në të vërtetë, nuk shpreh aspak ndryshim kuptimi me format e rasteve të tjera me alomorfet e zgjeruara, veçse ka favor vetëm pse është më e shkurtër se trajtat e tjera, qoftë geqe, qoftë të toskërishtes a të letrarishtes së sotme.

E pesta, nga sa u tha, duhet theksuar, se ish-norma letrare zyrtare e gjuhës shqipe në periudhën para Kongresit të Drejtshkrimit, duket se e kishte të përfunduar evoluimin e trajtave të pjesoreve të zgjeruara të gegërishtes, përkatësisht të shqipes letrare të asaj kohe, por ky evoluim e kishte zanafiljen më të hershme, siç del nga burimet e caktuara, siç do të cekem tash fill:

a) Prof. Idriz Ajeti konstaton se një dukuri e tillë kishte shenja që te Buzuku, ngase në veprën e tij e ndeshim të dyja këto trajta të pjesores: *ngjallunë* (me *ngjallunë*) dhe atë të shkurtër *ngjallë* (**me ngjallë**), ndonëse, po sipas këtij autori në *shkrimet e autorëve të vjetër dhe në disa të folme format e infinitivit*, pra të pjesores së infinitivit, dalin *fytyrë-plota* (d.m.th. të zgjeruara N.V.). Te Buzuku ndeshim: *me shteguon, me bamun, me dalun* etj. (Shih I. Ajeti, *Studime ...III*, f. 190), po kështu edhe folja *me pasë* e të tjera dilnin: *tue pasunë ardhunë, tue pasunë shkuom*, por që shekuj më vonë këto pjesore në krijimtarinë popullore dhe në letërsinë artistike do të dilnin gjithnjë e më shpesh në trajtën e shkurtër: *tue pasë ardhë, tue pasë shkue* (!) = *tue ardhë, tue shkue, sikurse: kish pasë marrë, kish pasë dalë*, madje në normën e sotme, njihet trajta

e shkurtër e foljes me pasë: **pasë** (ndaj *pasur*), në kohët e mbindërtuara: *kam pasë punuar* a *kam pasë punue, kisha pasë punuar* a *kisha pasë punue, pata pasë punuar* a *pata pasë punue dhe paskësha pasë punuar* a *paskësha pasë punue*. çka na jep për të kuptuar se dukuria e tillë evolutive e thjeshtëzimit ishte e pranishme që herët në gjuhën tonë dhe gjithnjë vinte duke e shtuar trezen e vepimit, dukuri kjo që në raste vazhdon edhe sot e kësaj dite.

b) Ky evoluim del i pranishëm edhe në materialin i përfshirë në Fjalorin e K. Kristoforidhit (1904), i vjelë dhe gatitur nga gjysma e shekullit XIX. Aty, veç ndonjë rasti me paskajore të mirëfilltë si: *muj me ba, mundem me ba*, etj. me pjesore të shkurtër, qoftë të pashoqëruara, qoftë të shoqëruara me trajtat gjegjëse të zgjeruara, numri i shembujve është relativisht i madh. Sa mundëm me vërejtë, vetëm në kohët analitike trajtat e pjesores së shkurtër kalojnë numrin tridhjetë. Zakonisht mbizotërojnë shembujt mbi bazë të foljes me temë në bashkëtingëllore që marrin parësorisht rapshtesën inovuese -Ë, ndaj parapashitesave alomorfe -UR(ë) a -UN(ë), p.sh. *mbështjellë, dëlirë, varë, vdarë vdiërë, t'hollë, shqierrë, ndërë, por edhe kalbë e kalbunë, mardhë, mardhunë* (g.), *mardhurë* (t); *ngjallë, ngjallunë* (g.), *ngjallurë* (t); *marrë, marrunë* (g) *marrurë* (t); *pkjë, pjekunë* (g), *pkjekurë* (t) *mbarsë, mbarsunë* (g), *mbarsurë* (t) etj. Nuk dimë K. Kristoforidhi, duke i shënuar veçan dhe duke u dhënë vendin e parë, të ndarë me presje, trajtave të shkurtra, si te shembujt e mësipërm, pati vizion apo jo, që trajta e parë (pjesorja e shkurtër) kishte prirje me dalë si trajtë përfaqësuese për të dy format e tjera të zgjeruara: geqe e toske? Sidoqoftë, edhe kjo dukuri si fakt mund të na shërbejë si prirje me vlerë që ia vlen të kihet parasysh tash për tash dhe në perspektivë. Është interesant se prej foljeve më -O- fundore, vetëm në dy raste del e shënuar pjesorja: rroj g. *rruem*, t. *rruarë* si dhe *pranoj* vetëm g. *pranuem*, as këtu as në asnjë rast tjetër nuk e del e shënuar ndonjë pjesore me prapashitesën -UA/R, tipi prodhimtar e veprues i letrarishtes së sotme: punoj *punuar*. Kurse te rastet e foljeve me -Ej e me zanore, pothuajse rregullisht dalin të shënuara pjesoret përkatëse si p.sh. pëlqej (me pëlqye) - t. pëlqyerë, g. pëlquem e pëlqom ose shaj (me sha) g.sham, t. sharë ose pi (me pi) g. pim, t. pirë, e kështu me radhë. Me fjalë të tjera veç foljeve me -r e -rë të toskërishtes ose -m e -më të gegërishtes, tek të gjithë tipat e tjerë të foljeve shihet efekti jo i vogël i evoluimit, por jo aq si në burime të tjera të mëvonshme, sidomos në gegërishtë.

c) Në Fjalorin e Bashkimit (1908) si dhe në atë të Gazullit (1941) trajtat me pjesore, më drejt të paskajores me pjesore të shkurtër dalin plotësisht të evoluara, si p.sh: *me ardhë, me goditë, me matë, me bajtë; me fye, me pi, me*

shkëlqye, me punue, me gri etj. Çka do të thotë se në dialektin e gegërishtes, sidomos në ligjërimin shkrodranisht, *përkatësisht në gjuhën e shkrimit zyrtar të kohës* ky asimilim mund të thuhet se kishte përfunduar, ndonëse në të folme gjithandej mund të gjëlloin ende format me pjesore të zgjeruar varantesh të ndryshme.

ç) Për mos me rëndue punimin do të themi vetëm pak fjalët për Periudhën e Pavarësisë deri në vitet '50. Në këtë periudhë, siç dihet, ishte në fuqi, si gjuhë letrare, sipas rekomadimeve të Komisionit Letrar të Shkodrës (1916-1917), gegnishtja kryesisht mbi bazë të dialektit të Elbasanit, madje pikërisht kjo gjuhë e Shqipnisë së Mesme (elbasanishtja) ishte sforcuar, por jo urdhëruar, edhe me vendime udhëzuese kongresesh e qeverish (1920, 1923, 1935, 1944). Siç dihet edhe në gjuhën e shkrimtarëve toskë të periudhës së Pavarësisë, kur zyrtarisht mbizotëronte dialekti gegë (elbasanishtja), rreth kësaj pike kishte mjaft laryshi, por megjithatë si në gjuhën e pushtetarëve të kohës, ashtu edhe në shkrimet e tyre përgjithësisht mbizotëronin trajtat e shkurta të pjesores, sidomos të atyre mbi temë në bashkëtingëllore, ndërsa sa i përket paskajores ajo dilte, pothuajse plotësisht në formën e mirëfilltë me prapashtesë zero ose me prapashtesën -E, por edhe në trajtën me -m e -më, barsvlerëse ndaj foljeve më -r e -rë të toskërishtes, tipi shkueu (me shkueu) shkuar, bam bërë (me bam(ë)). Kjo normë praktikohje edhe gjatë Luftës II Botërore. Mirëpo, siç dihet, pas përfundimit të asaj lufte, si me thënë, u bë një rikthim a përförim në përdorimin e trajtave të zgjeruara të pjesores së toskërishtes. Madje në vitin 1952 u bë anashkalimi i paskajores geqe me + pjesore, në mënyrë institucionale, ngase është i njohur fakti se që në vitin 1951, me vendim qeverie u kërkua (u urdhërua) që të hiqej gegërishtja dhe të vendosej ose të sforcohjej toskërishtja si gjuhë zyrtare (publike) dhe me këtë vendim faktikisht. u bë edhe *anashkalimi i paskajores me + pjesore, njëherazi edhe i pjesores geqe*.

d) Të shohim tashmi si pasqyrohet çështja në shqyrtim në **Fjalorin e gjuhës shqipe** (1954). Aty (në këtë Fjalor) përkundër vendimit të sipërcekur qeveritar, ndeshim mjaft shembuj konkretë me paskajore dhe me pjesore të shkurtër geqe. Madje shembuj të tillë hasim në numër të konsiderueshëm. Shtrohet pyetja si ndodhi kjo? A ishte e mundur që hartuesit e Fjalorit në atë kohë të vepronin në mospërputhshmëri me vendimin përmbartes (ekzekutues) qeveritar të vitit 1951, i cili *qe tumirë, si me thënë*, shkencërisht edhe nga konferencat politike-gjuhësore të vitit 1952, kur pjesorja e shkurtër bashkë me paskajoren geqe(!), siç u tha, dilnin të mënjanuara? Kur edhe në **Shënime për përdorimin e fjalorit** pohohej shprehimisht se ky Fjalor "*është punuar në bazë të*

*toskërishtes... te foljet e parregullta, janë dhënë të shumtën e herës, vetëm trajtat e toskërishtes... Për fjalët e trajtat sinonime përkufizimi jepet në fjalën që përdoret më shumë a në atë që i përket dialektit toskërisht (Shih FGJSH (1954, f. V, VI)?*

Përgjigjen, për pyetjen që e shtuam më sipër, na japin vetë hartuesit e këtij Fjalorit të parë përshkrues normativ (K.Cipo (kryetar komisioni), E. Çabej, A. Krajni, O. Myderrizi, anëtarë si dhe A. Xhuvani bashkëpunëtor). Ja si arsyetohen ata, po në atë burim: "*Format e gegërishtes, për të mos e ngarkuar shumë vëllimin, janë dhënë vetëm për raste kur ka ndonjë ndryshim kuptimi a për fjalët kryesore e për të tjerat jo* (Aty f. V). Është me interes të theksohet, pra, e vërteta, se hartuesit mjaft kuptime të pambuluara a fjalë kryesore nga gegërishtja, patën në konsideratë rreth paskajores me **me**, përkatësisht të pjesores së shkurtër të anashkaluar (shkencërisht(!) nga e ashtuquajtura: *normë e shqipes së some letrare*. Kështu në atë fjalor dalin të shënuara afro njëzet raste të shprehura me paskajoren me + pjesore. Me fjalë të tjera, ngase ato shprehje të gegërishtes ishin të pambuluara me elemente të toskërishtes hartuesit me në krye prof. K. Cipun, si me thënë, u detyruan, si shkencëtarë të vërtetë që ishin, ta përdorin paskajoren e mirëfilltë, si p.sh.: *lypi priftin me u ligjue, s'asht punë me luejt, merr me dalë po s'mundet, me u rrekëlve, me hjekë, mos me shkue, me shkue, do me thanë, ku po don me dalë, nuk do me thanë gjë, me iu kapë majës, me iu ngjitë, me iu qepë, me e ba lamë, me mëshi nga faqja e dheut e ndonjë tjetër*. Gjithashtu, janë afro 40 raste që pjesorja e shkurtër, qoftë, vetëm për vetëm, qoftë edhe në kohë analitike del e përdorur brenda tekstit përkatës sgarues. Përveç foljeve apofonike me temë më -I, -ll e -rr që përputhen edhe me drejshkrimin e letrarishtes së some, në këtë burim ndeshim edhe mjaft shembuj të pjesores së shkurtër me prapashtesën -E, si p.sh.: *dridhë, djergë, shpjerë, zhdredhë, shpërdredhë, raditë, trokitë, rrëshqitë, mbretë, le edhe lerë, pasë edhe pasur etj.* madje edhe një rast me pjesore me -UN *përdjegun* (në vend, siç do të pritim: *përdjegur a përdjegë*). Ç'është e drejta, numri i pjesoreve të shkurta në kohët e përbëra është edhe më i madh, ja disa shembuj: *na kanë kalue disa gabime, asht lënue moti për borë, e kam kalue tifon, e ka derdhë linë, kam graçue, i ka zhigmue shpia, i ka gjimue shumë kësaj pune, më janë stërqitë* (pejdahe N.V.) *minjt, ka lëshue shi i madh, e kam mbretë* (lënduar) *kambën, e kam folë* (fejuje) *gikën, e ka gjue rrufeja etj.* Pra, kur kemi parasysh rastet që u cekën me paskajore me + pjesore si dhe shembujt e tjerë me pjesore (të shkurtër) del se pjesorja e shkurtër zinte ndërgjegjësisht vend të konsiderueshëm në atë burim. Po veç rasteve të sipërcekura të tipit u



*mbulue, u muguillue* etj., ka edhe raste të tjera, që funksioni i pjesores së zgjeruar geqe të jetë shtrirë edhe në funksion të emrit a të mbiemrit të nyjshëm prejpesorë, siç janë tipat: *u shtuem e ushueme, i shuemi e shuemja; e shtrueme e shtruemja, e shkueme e shkuemja* etj. Nga shembujt e tillë, që u futën në fjalorin e parë shpjegues normëzues, kuptohet inkluzivisht se hartuesit nuk ishin për zhdukjen e paskajores dhe as të pjesores së gegërishtes, por ishin për inkorporimin e tyre nga norma e shqipes letrare për koncepte të pambuluara në nënfusha të caktuara semantike.

Le të dihet, siç mund të dihet, se këto koncepte, qoftë me folje, qoftë me emra e mbiemra prejpesorë, që gjeten vend në Fjalorin e '54-shit, mjerisht, pothuajse, tërësisht u mënjanuan (mbeten të papërfshira!) në fjalorët shpjegues normativë që pasuan pas Kongresit të Drejtshkrimit (1972)?! Sa ishte i drejtë një veprim i tillë, që vetëm për shkak të pjesores së shkurtër të mos shpreheshin me dhjeta e qinda koncepte të tilla në gjuhën letrare? Përgjigja, me marrë me mend, nuk duhet asesi me dalë pohuese. Aq më keq, kur dihet, ç'është e vërteta, se ato koncepte a të ngjashme me to në gjuhën e folur (geqe) ende shprehen ose përftohen për ditë, atëherë një lëshim i tillë del edhe më me pasojë. Prandaj a s'është më mirë që ato të përligjen, së paku tani, në burime të reja, duke e mundësuar inkudrimin e pjesores së shkurtër në normën e shqipes standarde, bashkë me paskajoren me + pjesore? Si të thuash, arsyetimin shkencor, për të shpëtuar çka mund të shpëtohet, qoftë si **fjalë kryesore**, qoftë si **shprehje me ndryshim kuptimi**, na e kanë lënë të gatshëm vetë hartuesit e Fjalorit të gjuhës shqipe (1954), siç u cek më sipër. Arsyetimi i tillë me bazë të thellë shkencore teorike e praktike, patjetër, duhet të vlejë, pra, edhe për sot e për nesër, ngase është i parëzueshëm.

dh) Është me interes të ceket se edhe në *Konkluzionet* e mbledhjes së parë të Komisionit të gjuhëtarëve për *ortografinë e gjuhës shqipe* në ish-Jugosllavi, të mbajtur në Prishtinë, nëntor 1952, ndër të tjera përkrahet normëzimi i trajtës së shkurtër të pjesores. Aty thuhej se janë të drejta trajtat: *kam shkue* jo *kam shkuem*, *kam folë*, jo *kam folun*, *kam ndejtë* jo *kam ndejtun*, madje ceket pjesorja *këndue* dhe paskajoret: *me lëvrue*, *me lëshue*, *me lëvdue*. Po kjo rrugë ndiqet edhe në *Ortografinë e gjuhës shqipe* (1964), ku bashkë me grupin e foljeve apofonike më **-ll** e **-rr** (*dal dalë me dalë, vjell vjellë me vjellë, marr marrë me marrë*), që e bëjnë pjesoren me prapashtesën **-Ë**, ashtu si edhe pjesoret si: *dhënë, ngrënë, thënë, vënë, zënë* etj. (shih *Drejtskrimi i gjuhës shqipe* (1973, f. 55) futen edhe foljet më **-r**, **-k**, **-g** e **-dh**: si p.sh. *var me varë, pjek me pjekë, ndjek me ndjekë, djeg me djegë, rrjedh me rrjedhë, vjedh me*

*vjedhë, hjedh me hjedhë*, ngase edhe të këto në të kryerën e thjeshtë përfohej-o-: *var vora, pjek poqa, djeg dogja, vjedh vodha* e kështu me radhë, sikurse shembujt e normëzuar në letrarishten e sotme: *vjell vola vjellë, vjell volla, vjellë, marr mora marrë* etj. Andaj themi se vetë kujtesa kolektive ndaj ish normës letrare (që nga Fjalori i K. Kristoforidhir deri në Fjalorin e gjuhës shqipe 1954) krijon vështirësi për përvetësimin e normës së letrarishtes së sotme, jo vetëm për brezin e vjetër, por edhe atë të ri, ngase tani edhe foljet apofonike me **-r**, **-k**-**g** e **-dh** marrin rapashtesën **-UR**, *varur, ndjekur, djegur, vjedhur*.

e) Prof. Idriz Ajeti, (Vepra e cit. f. 190) *palën e foljeve me formantin -Ë* (që të jetër e quajnë prapashtesë inovuese) i quan folje *me formantin zero*, ngase **Ë**-ja fundore, si konstaton me vend ai - *është përfutur nga asimilimi i formantit nazal bashkë me likuidet përkatëse që ndeshen në kategorinë e përmendur verbale: -ln(ë)(ë), ll(n)ë e -rn(ë) (rr) në shqipe, si p.sh. dal - daln - dalë, nxjerr -nxjerr nxjerrë dhe shpjegon më tutje: Në pjesën më të madhe të gegërishtes formanti zero zë të shtrihet në participat e kategorive foljore në konsonant: djeg djegë, pjek pjekë, vjedh vjedhë etj. me anë të veprimit të analogjisë, me particip të shkurtër dalin edhe ato folje që përfundojnë me vokal: pi (me pi) (shoh) pa (me pa); me formant të shkurtër participor shfaqen edhe foljet e -n -konjugacionit: shaj sha (me sha), ndaj nda (me nda); shkoj shkue (me shkue), shkruaj shkruë (me shkruë), paguaj pague (me pague).*

Sidoqoftë, pra, edhe nga këta shembuj vërtetohet se gjendja para Kongresit të Drejtshkrimit kishte arritur në atë shkallë që të konkurronin në shqipen standarde në anën e gegërishtes, si trajtë përfaqësuese kryesisht trajta e shkurtër e pjesores ndaj paskajores së zgjeruar të toskërishtes, ngase trajta e shkurtër dilte fituese ndaj trajtave të tjera të zgjeruara të gegërishtes, të cilat kishin pësuar nga evolucioni. Pa marrë parasysh faktin se edhe pjesorja e zgjeruar e toskërishtes dilte e prekur nga një fenomen i tillë, norma pas kongresiane përzgjedh dhe e sforcoi vetëm pjesoren e zgjeruar të toskërishtes, e cila u emërtua tani si *pjesore e letrarishtes kombëtare* fitoi edhe në prestigj. Le të vlerësohet, pra, sa ishte i drejtë një veprim i tillë, për atë pikë, kur nuk u përfill fare dukuria e ekonomimit gjuhësor që lidhet edhe me shqiptimin më të lehtë, formën më të shkurtër a më të thjeshtë shkrimore etj., siç ishte edhe përhapja më e gjerë e asaj forme në kohëhapësirën shqipfolëse si dhe nuk u mor parasysh as fakti (tejet i rëndësishëm) se shumë shprehje-koncepte të formëzuara frazeologjike mbeten të pambuluara me përjashtimin e saj nga norma e shqipes letrare?!



ë) Është e vërtetë se edhe pas Kongresit të Drejtshkrimimit (1972) pati raste që në dobi të trajtës së shkurtër të bëjë fjalë ndonjë studiues a intelektual nga Qendra. Këtu po përmendim prof. Mehmet Çelikut, i cili kur merr në shqyrtim parafjalën prejpjesore në kristalizim e sipër **përfshirë**, e cila del edhe në trajtën e shkurtër **përfshi**, autori shprehet në dobi të trajtës së shkurtër. *Për mendimin e shkurtër përfshi, autori shprehet në dobi të trajtës së shkurtër. Për mendimin tonë - thotë profesori - më e parapëlqyer duhet të jetë trajta përfshi. Të krahasohet me trajtën e shkurtër të parafjalës falë.* Pra, ndër këto dy forma përfshirë e përfshi), thotë ai: *do të parapëlqenim të dytën përfshi, sepse takohet më shpesh... dhe sepse është më e shkurtër.*

f) Në të vërtetë, letrarishtja e sotme jo vetëm rastin *falë* (si pjesore e shkurtër) që e ka të pranuar në funksion parafjale, por ka edhe raste të tjera. Kështu e ka të pranuar edhe pjesoren e shkurtër *pasë*, si komponent kohëndërtues, siç u cek edhe më sipër, në kohët e mbindërtuara si p.sh.: kam *pasë* punuar, pata *pasë* punuar, kisha *pasë* punuar ose shprehjen *do pasë parasasysh*, etj..

g) Po i pëmendim vetëm dy thënie popullore nga realiteti ynë gjuhësor, ndonëse nuk ka mbëhi, pasi e vërteta duket sheshit, në të cilat shihet se folja në gjuhën popullore përdoret vetëm në trajtën e shkurtër, kuptohet, sidomos në kuadër të paskajores:

- 1) S' po muj me të **ardhë**, se kam me të **ba** përrallë.
- 2) Kam **ardhë** me **ndejtë**, e, jo me më **rrejtë**.

Nuk jemi në dijeni që trajtat e pjesores së zgjeruar të gegërishtes të përdoren ende në këngë lahutash, për hir ritmi, apo jo, ndërsa në ligjërimin e përditshëm zakonisht trajtat e zgjeruara, pothuaj, janë hequr nga përdorimi.

gj) Këtë vështirësi lidhur me respektimin e normës rreth pjesoreve të caktuara, e vëren edhe studiuesi i ri Rrahman Paçarizi lidhur me përvetësimin e foljes *këqyrë* me *këqyrë* me origjinë geqe në standard, ngase sipas tij paraqet vështirësi shqiptimi pikërisht për prapashtesën -UR (këqyrrur) të shqipes letrare (toskërishtes), ashtu si edhe në raste të tjera që paraqet prapashtesa -UA/R (tipi punuar), siç thotë ai "është vështirë për ta shqiptuar kam këqyrrur" kundrejt trajtës kam *qayrë*, shqiptimi i së cilës me -E do të kishte ngarkesë më të vogël psikologjike se ajo me -UR ose -UN etj. Me fjalët të tjera, edhe pse nuk shprehet aq qartë, siç del nga ky reagim i tij, ky autor e konsideron më të udhës që foljet e tilla të marrin prapashtesë-mbaresën -ë. Pra, ky autor parapëlqen që tipi i foljeve me -UR me marrë prapashtesën -Ë: *këqyrë* ndaj

*këqyrrur*, ndërsa tipi i foljeve me -UE ndaj -UA/R me marrë prapashtesën zero: *mësue* ndaj *mësuar* (Shih *Seminari* 23/1 f.155).

h) Nga shtypi i ditës po jap dy shembuj nga gazeta *Bota sot*, ku teksti është në letrarishite, ndërsa vetëm pjesoret dalin të shkurtëra: 1) *Thënie ... që ka zgjedhë e përkthye* N. G. (2.10.'05, f. 28), 2) *kemi pasë një lidhje rajonale; kanë përdorë ilaçin...* (06.12.'05, f. 26), përndryshe në tekste të gegërishtes, pothuajse në të gjitha rastet pjesorja del rregullisht në trajtën e shkurtër.

### C) Prirja e theksuar evolutive mbetet në ndiqet

Prandaj, duke i pasur parasasysh këto të dhëna, që ndonjëra u përsërit disa herë me qëllim, ngase ishte e mbëshishme, mendojmë ne, se e drejta e përdorimit të pjesores së shkurtër, së paku, një herë për njëherë, si variant i lirë, si pjesë organike e paskajores me + pjesore të shkurtë të gegërishtes, s'bën të kundërshtohet, por ndoshta një përdorim të tillë të pjesores së shkurtër duhet toleruar edhe në nënfusha të tjera semantike. Ç'është e vërteta, me fjalët e fundit duam të theksojmë se kërkesa jonë u drejtohet korrektorëve të sotëm, që, nëse ndeshin në përdorim eventualisht pjesoren e shkurtër të gegërishtes në rrethana të caktuara, mos ta konsiderojnë *en bloc* si element fort të qortueshëm dhe neveritës për normën, por le ta cilësojnë si një zhvillim a prirje normale drejt thjeshtëzimit, e ndikuar nga dukuria e evoluimit. Pra, në radhë të parë, duhet parë si përfitim i procesit të thjeshtëzimit gjuhësor, që shkon në dobi të ekonomimit, si trajta më të shkurtra a më të thjeshta shkrimore e shqiptimore. Andaj, duhet t'i mundësohet pjesores së shkurtër në rrethana të caktuara të gënjërojnë në konkurrencë të lirë me pjesoren e toskërishtes edhe në gjuhën e shkrimit letrar.

Pra, po përsërisim jo vetëm në kuadër të paskajores, por edhe në ndonjë nënfushë tjetër, sidomos në raste tipizimi, trajta e shkurtër e pjesores duhet toleruar, edhe në tekste që ndjekin normën, ngase trajta e tillë, për mendimin tonë, do të ketë përkapje e zhvillim të pranueshëm në perspektivë, ngase vjen e nxitur jo vetëm nga trajta e të folmeve (popullore) geqe e më gjerë, por edhe nga ligji i evoluimit që gjithnjë e më zëshëm supozohet se do të prekë theksueshëm, ndoshta së shpejti, edhe toskërishten. Dihet se pjesorja e shkurtë është dukuri e ngulitur që ka mbështetje në fjalëformim dhe njëherazi ashtu del e shënuar edhe në leksikografinë normative të gjuhës sonë, ku ajo zë vend të padiskutueshëm. Ka raste, gjithashtu, që ka përdorim normal edhe në kohëformim e formëformim të sistemit foljor të shqipe, siç e pamë më sipër,

por edhe me tamam zë vend në kuadër të shprehjeve frazeologjike e idiomave të caktuara me kuptimësi të rrumbullakësuar.

Sidoqoftë, normëvënësit duhet ta dinë se prirjet e caktuara, si kjo që u cek prej nesh, kur janë të prirura nga nevoja gjuhësore ato ndoshta mund të pengohen a të ngadalësohen përkohësisht nga forcat rezistuese, por nuk mund të frenohen gjatë e përgjithmonë. Megjithatë, kërkesa jonë nuk është aq kategorike. Tani për tani, ne, sugjerojmë një mundësi që ka gjasa me ndodhë. Njëherazi, stardologëve tanë, duam t'ua rikujtojmë të vërtetën se nuk është bërë mirë atëherë që u përjashtua nga norma pjesorja e shkurtër *en bloc* bashkë me paskajoren e mirëfilltë.

Gjithashtu duam të tërheqim vërejtjen se do të bëhej, edhe më keq sot, nëse normëvënësit e caktuar vazhdojnë ende fushatën kundër rivlerësimit të paskajores, përkatësisht të pjesores së shkurtë. Mbese, nga propaganda e organizuar, te disa gjuhëtarë, zgjidhja e këtij problemi ka mbetur ende si njeje e fortë, saqë ajo njeje-xhungë duket si me qenë e pazbërthyeshme. S'do mend, se për fat, paskajorja nuk është gur i hedhur në pus, që njëqind të mençur s'mund ta nxjerrin, po ajo, siç dihet, është fjalë-formë e koncept, që mund të rehabilitohet a të *nxirret nga pasi* pa u zhytur e lagur askush nga përdoruesit. Po paçka dikuj a një grupi, jo aq formal, kjo dukuri u ka kaluar në pasion, andaj përgjigjen me arsyetimin në biçim të shprehjes së sarhoshëve, *mos të ngucet norma fare*, ngase **qysh po e dimë, njashtu mirë po e pimë!**, sepse sipas tyre riinkuadrimi i paskajores *nxirka punë*, andaj studiesit(!) s'duan t'ua dalë punë!? Nga personat e tillë as që ka nevojë të kërkohet me ngulm që *mos ta pinë atë qysh po e dimë!*, por kërkohet nga ata që, së paku, mos të pengojnë përpjekjet e një numri gjithnjë në rritje të gjuhëtarëve, intelektualëve dhe dashamirësve të njëzimit dhe përsosjes së normës së gjuhës shqipe, të cilët jo vetëm se ia kanë gjetur fillin e zgjidhjes kësaj xhungë, por, po japin edhe prova të gjalla, konkrete se si mund të zgjidhet praktikisht ajo dhe pa telashe.

Të jemi më të qartë, kemi bindjen se me inkuadrimin e formës së **paskajores me + pjesore të shkurtër** (përkatësisht të **pjesores së shkurtë**) në standard shumë lajthitje e gafe të natyrave të ndryshme, madje edhe shumë interpretime *joshkencore*(!), për mendimin tonë, do të përmirësoheshin më me lehtësi. Nuk është fjala më vetëm për përjashtimin e paskajores, por edhe për gafe interpretimi siç është edhe ky që do të përmendet tashti fill.

### Ç) Një lajthitje tipike në interpretim e shkaktuar nga mënjanimi arbitrar i pjesores së shkurtër nga norma letrare

Është e ditur se emrat e vepruesit me prapashtesën **-S**, të tipit **ngrohës, shitës, ardhës** si dhe emrat e vendshërbesave me prapashtesën **-TORE**, tipi **ngrohtores, shitore, janë formuar nga tema e pjesores përkatëse+prapashtesa e caktuar**, por kontestues del fakti se në burime të caktuara normative, interpretimi i formimit të tyre, nuk jepet si duhet, ngase shpjegohet, b.f., se emrat e tipit **ngrohës, shitës, ardhës** dalin nga pjesorja e shkurtuar(!) e toskërishtes *ngrohur, shitur, ardhur, pra nga rrënjë-temat: ngroh- shit- ardh-*, duke dalë e zhdukshme prapashtesa **-UR**, prandaj edhe prapashtesa e emrit shënohet me **-ËS**:(!) **ngrohËS, shitËS ardhËS** (Shih edhe te: *Gjuha letrare shqipe për të gjithë*, Tiranë 1976, f. 211), dhe jo, siç është e vërteta, se emrat e tillë konkretisht, dihet se që kur e ku kanë lindur, janë formuar vërtet nga rrënja, fakt ky që nuk del kontestues, por është më drejt të thuhet se fjalët e tilla janë formuar jo nga rrënja *ngroh-, shit-, ardh-*, po nga tema, që ishte në të vërtetë pjesorja e shkurtë e gegërishtes *ngrohë-, shitë-, ardhë-*, natyrisht edhe nën ndikimin e pamohueshëm të paskajores **me ngrohë, me shitë, me ardhë** + prapashtesa **-S**: *ngrohëS shitëS, ardhëS*. Po kështu janë formuar edhe emrat më **-TORE**, në mënyrë të rregullt si **ngrohore** (= objekti (për) me ngrohë) ashtu edhe **shitore** (= lokali (për) me shitë): *ngrohë+TORE ngroh(ë)toore ngrohore*, ndërsa edhe trajta **shitore** del e formuar rregullisht nga pjesorja e shkurtër *shitë-* e ndikuar natyrisht edhe nga paskajorja **me shitë**, po sipas këtij zhvillimi: *shitë+TORE shit(ë)toore shi(t)toore shitore*. Në të mirë të mendimit tonë del fakti se kur u formuan këto fjalë te ne dhe në mbarë trojet shqipfolëse ishte i lejueshëm normativisht përdorimi i **pjesores së shkurtë**, përkatësisht, përdorej normalisht **paskajorja me + pjesore e shkurtë**, e cila normativisht ishte në fuqi dhe shërbente edhe si trajtë përfaqësuese e foljes, formë kjo që pa dyshim atëherë, si gjedhe e qëndrueshme emërformuese, kishte ndikim dhe favORIZIM edhe më të madh të drejtpërdrejtë në fjalëformim.

Ç'është e vërteta, ne, pa hyrë në diskutim se a janë formuar si kalke nga serbishtja *shitës e shitore, ngrohës e ngrohore*, e ku ta dimë, vërtetojmë se emrat e tipave në fjalë janë formuar mbi bazë të pjesores së shkurtë (me prapashtes-fundoren **-ë**), analogjikisht sikurse tipi i emërtimeve mbi bazë të pjesores shqipe (gege e toske) tipi: *nxënë nxënë, dhënë dhënë, thënë thënë*;



marrë marrës po edhe atyre pjesoreve geqe, me prapashtesë zero (model ky që nuk kontestohet në asnjë nga burimet tona normëzuese), tipi: mësue (me mësue) mësues, pëlqye (me pëlqye) pëlqyes, përkatësisht ngrohë (me ngrohë) ngrohës, shitë (me shitë) shitës, ardhë (me ardhë) ardhës etj.

Pra, sidoqoftë, çdo mendjktjellët, besoj se e di, se përfitimet e tilla nuk kanë zanafillë tash e tridhjetë e sa vjet, kur u formëzua norma e shqipes së sotme letrare e njësuar, e cila e mori në konsideratë vetëm pjesoren e toskërishtes, por janë formuar edhe para kësaj kohe. Është për të ardhur keq, që disa studiues tanë, jo se nuk i dinë këto fakte, po për shkak të praktikës së imponuar dirigjiste reth heqjes a zhdukjes së pjesores së gegërishtes(!), janë të detyruar që në interpretimet e tyre trajtat e pjesores së shkurtër, për tipa të caktuara, të mos i përmendin fare, andaj edhe detyrohen të përmendin a të shpifin termin **pjesore e shkurtuar(!)**, vetëm e vetëm pse trajta e pjesores së toskërishtes del e pranuar (tash e tridhjetë vjet) si trajtë e vetme e normëzuar. Vërtet, është absurd, për t'i qaditur edhe njohësit e thjeshtë të shqipes standarde e jo vetëm specialistët e fjalëformimit të gjuhës shqipe, nëse nuk pohohen faktet e tilla si lajthitje?! Me fjalë të tjera, kërkohet esullim dhe mos të mbrohet më me kokëfortësi, interpretimi jo i qëndrueshëm i pjesores së shkurtuar(!), ngase interpretimet jo shkencore reth fjalëformimit, duke mohuar të kaluarën, nuk i shërbejnë aspak për të mirë mbarrëvajtjes së shqipes standarde

Fundi i fundit, kur pranohet, domosdo, se për formimet e tipit **mësues, shërbyes** si temë fjalëformuese ka shërbyer dhe shërben e do të shërbejë në vazhdimësi si temë prodhuese gjithësi pjesorja e ish-shqipes letrare mbi bazë të gegërishtes, pse të mos pranohet kjo e vërtetë edhe të shembujt e mësipërm me temë në bashkëtingëllore, siç janë shembujt: **ngrohës, shitës, ardhës; ngrohore, shitore etj?!** Dihet mirëfilli se te ne, ku po thuhet se është shtrati i lindjes së temave **shitës shitore ngrohës ngrohore** e të ngjashme, kurrë nuk kemi pasur pjesore me -UR, po, siç dihet, kishim në përdorim forma të tjera prapashtesore të pjesores(!), por në fjalëformim pa mëdyshe ishte a dilte e specifikuar shumë herët si temë prodhuese gjithësi pjesorja e shkurtër. Lidhur me këtë ka mundësi që fare lehtë të përmirësohet edhe më mirë edhe një anomali tjetër. Është fjala, kur si prapashtesa "karakteristike të gegërishtes:" cilësohen formantet e shpifura joekzistuese: **-ues, -yes**, ngase në të vërtetë prapashtesa të tilla kurrë s'ka pasur gëgnishtja. Në rastet e tilla, siç dihet, prapashtesë e mirëfilltë del vetëm fundorja **-S** e jo formantet e tilla, ngase togu përkatës: **-ue -ye** është pjesë përbërëse e pjesores, formë kjo e cila këtë rast shërben si temë prodhuese fjalëformuese, prandaj siç shprehen drejt rastet

me prapashtesën **-shëm** (jo nga **-ue/shëm, -ye/shëm**) si bie fjala: i *trishue/shëm, i punue/shëm, i besue/shëm, i pëlqyeshëm, i shkëlqyeshëm etj.*, ashtu duhet të shprehohet edhe rastet emra a mbiemra mbi të njëjtën temë prodhuese fjalëformuese, me prapashtesën **-S**: *trishue/s, punue/s, besue/s, pëlqy/s, shkëlqy/es*, e kështu me radhë. Në të vërtetë, anomali të ngjashme, si ne, vëren studiuesi Shezai Rrokaj, tek interpretimi jo i drejtë lidhur me formimin e mbiemrave me prapashtesën **-shëm**. Në burimet tona normative, vëren autori gjoja "formohen mbiemra edhe nga foljet me temë në **-UA/j**, p.sh. *bluaj - i blueshëm, shkruaj - i shkrueshëm*", d.m.th., me zhdukjen e togut **-ua**-përpara prapashtesës **-shëm**. Dhe lidhur me këtë ai shprehet kështu: "*Këtu nuk mund të flitet për bjerje të togut -ua-* (dhe shndërrimin në **-UE-**), por çështja qëndron tjetërkund: pasi pjesorja geqe nuk u pranua në standardin letrar, formimet e reja më **-shëm** mbi këtë bazë, veç atyre që ishin shënuar si të nomëzuara në FGJSH 1954 që domosdo interpretoheshin si krijime nga pjesorja geqe me **-UE**, atëherë për përfitimet e reja, doli interpretimi i tillë arbitrar, pra jo shkencor. Ç'është e vërteta, shpjegon autori: *Fjalët që do të krijoheshin më vonë në shqipen standarde, me prapashtesën -shëm (e cila mbeti vetëm si formim potencial) ishin produkt i nevojës që ka shqipja për këtë mënyrë fjalëformimi, e cila nuk kishte gje gjegjësën e saj në toskërishte. Ato i detyrohen memorjes së freskët kolektive, pranisë së madhe të tyre në gegërisht (në trashëgiminë e shkruar letrare etj.) dhe, sidomos, gjëllimit në gjuhën e folur dialektore si dhe veprimi të analogjisë"* (Shih: *Gjuha shqipe* 1/2005, f. 37).

Gjithsesi me rinjohjen e ripërfshirjen e pjesores së shkurtër në normën e shqipes standarde anomali të tillë në interpretim do të eliminoheshin vetvetiu.

## D) Si konstatim përfundimtar

U ndalëm paksa, me qëllim, në lajthitjen e mësipërme, e cila, mjerisht nuk është rast i vetmuar i diskutueshëm, për me ridalë më i përkapshëm problemi që e shtruum kalimthi pak më sipër dhe të japim konstatimin përfundimtar lidhur me pyetjen e shtruar në titullin e këtij kreu. Të jemi më të qartë. Po përsërisim propozimin tonë që përdorimi i pjesores së shkurtër në shqipen standarde, edhe nëse ndeshet jashtë sferës së fjalëformimit, mos të cilësohet si *herezi a shkelje e rëndë e neveritëse e normës letrare*, por duhet të pranohet si një veprim normal evolutiv a si prirje e zhvillimit në kuadër të shqipes standarde, dukuri kjo që gjithnjë e më tepër do të jetë më e shprehur. Po shtoj edhe këtë se pranimi i një evolucioni të tillë të foljet më **-oj** dhe **-ej** (nga **\*-onj**,



\*-enj), që ishte karakteristikë evoluiumi e gegërishtes, siç dihet, ka dhënë rezultate të pakrahasueshme, ashtu pandehim se mund të ndodhë edhe me fundorët e pjesoreve të toskërishtes, nëse një rrugëzgjdhje e tillë hapet e pranohet institucionalisht. Me fjalë të tjera, hë për hë, kërkohet që mos të frenohet prirja evoluese që prapashtesat e zgjeruara si ato të pjesores gege: *n/hun, -m /mun*, por edhe ato *-ur, -r, -rë* e toskërishtes mos t'i ikin prirjes shkallë-shkallë të thjeshtësimit në -ë ose në prapashtesë zero. Madje, nuk duhet harruar e vërteta, se deri para 30 vjetësh trajta e shkurtër ishte njëra nga trajtat e normëzuara, më prodhimtare e vepruese, jo vetëm në fjalëformim. Themi kështu, ngase e kemi bindjen që, vërtet, pjesorja e shkurtër e paskajores mund të jetë në të ardhmen e afërme njëfarë *siçelësi magjik* potencial me perspektivë për konsolidimin dhe për zgjidhjen më me lehtësi të mjaft çështjeve të hapura të sistemit foljor të shqipes standarde, siç është edhe paskajorja me + pjesore. Me një veprim të tillë aspak nuk kontestohen formimet ekzistuese mbi bazë të pjesores së letrarishtes. Dihet mirëfilli bashkëzistenca e harmonishme në mes të mbiemrave i (e) *punuar* dhe i *punueshëm* e *punueshme* ose e *punuemelja*, e *ardhur*, e *ardhshme* a e *ardhme* ose e *vyer*, e *vyeshme* a e *vyeme* e shqipes së sotme letrare.

Sido që ka me qenë, siç shprehej në ndonjë rast, prof A. Xhuvani, studiuesit, nuk duhet, njëherë për njëherë, t'i gjykojnë a t'i marrin shumë për keq përfitimt me pjesore të shkurtër, siç u tha, prandaj hulumtimi i mëtejshëm në këtë drejtim do të sillte rezultate edhe më me interes, po ai hulumtim do të bëhej më me kompetencë e do të ishte edhe më i motivueshëm dhe do të kishte edhe më shumë sukses, nëse paskajorja me + pjesore e shkurtër paraprakisht të jetë futur në gjirin e strukturës foljore brenda standardit, andaj na mban shpresa se ndërkohë, pa zvarritje, do të konfirmohet si konkluzion (me shkrim) kjo zgjidhje e ju vetëm me gojë, siç është bërë në Konferencën shkencore të 2002-shit, sepse paskajorja nuk duhet të mbetet në fokus rrugëzgjdhjeje, por ajo duhet të konsiderohet si çështje e zgjidhur, *njëherëpërgjithmonë* S'kemi iluzion me një inkuadrim të tillë në kuadër të normës së shqipes standarde do të poshonte çdo diskutim për përsosjen e standardit, por jemi të bindur se me një veprim të tillë standardi i mëtejshëm do të ketë ecje edhe më të mbarë.

## X

### DEL, APO JO, I PAKUPTIMSHËM VEPRIMI I MËTEJSHËM INJORUES DHE SAKRIFIKUES NDAJ PASKAJORES I NDONJË VETËMOHUESI GEGËRISHTFOLËS?

Nga krejt kjo që u tha deri këtu, jepet për t'u kuptuar katërcipërisht se paskajorja me + pjesore gjithsesi meriton respekt më të madh, jo vetëm që të mos pengohet më, siç u tha nga faktorët kompetentë në atë Konferencë (2002), por ajo duhet me u favorizue për me zënë vendin e merituar pikërisht në gjirin e normës së shqipes standarde, zhvillimi i së cilës është përherë në proces progresiv, ngase, siç e thotë prof. Fadil Raka, me një veprim (inkuadrim) të tillë do të pushonin "*polemikat e mëdha e të pandërprera* treth *përjashtimit arbitrar të paskajores gege nga norma e shqipes së sotme letrare*, prandaj *mendojmë se mund të arsyetohet kërkimi i rrugëve për gjetjen e një kompromisi rreth paskajores që do të ishte në dobi të vetë normës letrare*" (Shih: *Letërsia shqipe dhe gjuha letrare*, f. 166), prandaj s'dimë si mund të cilësohen arsytet e disa mospërfillësve gegërishtfolës ndaj saj. Të tillët, ndonëse gjithnjë më të vetmuar, nuk dimë pse jetojnë ende nën eufori kundër ose shprehin rezervë me elemente alergjie, ndaj paskajores? Nëse e kanë me ndonjë qëllim taktik ose me gjithë mend mendojnë ashtu, nuk mund ta dimë. Sidoqoftë, personat e tillë mund të cilësohen, sot për sot, si *pengues ordinerë të kërkimit të rrugës më të lehtë dhe më të drejtë rreth gjetjes së kompromisit* për zgjidhjen e çështjes së paskajores, siç e thotë prof. Fadil Raka.

Në të vërtetë, ne, nga fundi i këtij kreu do t'i kthehemi kësaj dukurie, jo të pëlqyeshme me kundëragumente, ndërsa tani ftojme mospërfillësit e tillë dhe lexuesit e nderuar që së bashku me ne, t'i përcjellim disa mendime të studiuësve tanë të njohur bashkë dhe disa fakte të tjera plotësuese, të cilat, me siguri, do të na ndihmonin që kjo çështje, vijëzimi dhe *rrugëzgjdhja e saj* të kuptohen edhe më mirë.

Së pari, ta kemi të qartë se, nëse dikur njihej jo sa duhet ky problem ose nuk ka pasur mundësi të zbardhej më mirë kjo çështje për shkak të klimave të

paþrshtatshme ideopolitike e t  t ra q  mbret ronin at her , tani koha ka ndryshuar. Andaj vazhdimi i p rjashtimit mtejsh m i paskajores n  jet n ton  t  p rditshme (n  gjuh n letrare t  n jzuar) nuk mund t  jet  i pranuesh m dhe i arsytuesh m n  asnj  m nyr , ngase, veç tjerash, bie ndesh me vet  parimin e ligjesis  gjuh sore n  kuptim t  formzimit t  n j  gjuhe standarde gjith komb tare bashk kohore, sepse, siç e thot  Shezai Rrokaj, "Ajo q  quhet norm  (standarde) nuk mund t' i kund rvihet norm s s  gjuh s mbar komb tare q  n  themel ka parimin e komunikimit dhe t  t  kuptuarit n  shqip. Midis tyre ekziston n j  ecejak i pand rprer  me prirje afruese dhe jo ndarje e ngurt  me prirje p rjashtimore. K to dy norma hapen ndaj n jra-tjertres (Shih: Norbert Jokli 2003, Shkod r, f. 164), prandaj, siç e kemi theksuar edhe gjetiu, kur p rdorimi i saj n  n nfushat semantike t  shqipes si, b.f., n  l min e p rfaq simit, n  shprehjet frazeologjike si dhe n  sfer n letrare-artistike etj., por edhe n  shprehje sinonimike,  sht  i pakontestuesh m, at her  p rdorimi i form s s  till  assesi nuk mund t  mohohet as n  standardin e gjuh s komb tare.

S  dyti, nuk dim  arsyen, pse b het gjith  ky ngurrim lidhur me (ri)futjen n  standard t  form s s  till , e cila, p rkund r gjykimit q  t  mbetet jasht  norm s, tashm  d shmohet pa kurrfar  m dysheje se po ndeshet n  p rdorim t  p rditsh m, madje edhe n  burime q  ndjekin standardin. K t  p rdorim t  saj p rgjith sisht e d shmon edhe prof. Xhevat Lloshi me konstatimin se "mbetet n j  c shnje e tradit s s  gjat  e ashtuquajtura paskajore e geg rishtes me+ pjesore, e cila nd rfutet edhe sot n  tekste q  ndjekin norm n"(Shih: Stilistika e pragmatika, Tiran  1999, f. 76), por nuk  sht  aq kategorik sa prof. Gjovalin Shkurtaj, i cili, si me th n , pak t rthorazi, por m shon me qyt  e pret me sopat  t mprehur me fjal t: "Kur thyerjet e norm s shpeshtohen (k tu duam t  n nkuptohet sidomos paskajorja N.V.) dhe fillojn  t  ngjiten deri n  shtrates e p rdoruesve p rgjith sisht t  kujdeshh m t  gjuh s, at her  norm v n esve u bie detyra t' i p rfillin k tu prurje, t' i konsiderojn  ato, n  mos tjet r, si trokitje n  dyert e norm s, prandaj mendoj se do t  ishte m  mir  q  t  gjith  sa jemi gjuh tar  shqiptar  t' i hapim m  mir  syt  e vesh t dhe t  p rfillim m  mir  edhe trokitjet n  dyert e norm s (Shih: N. Jokli, Shkod r, 2003, f.164). Prandaj, n  p rputhje me sa u tha, do t  shtonim ne, trokitjet e paskajores s  mirefillt  tashm   sht  dashur t  d gjoen, n  m nyr  q  t  mos mbetet askush n  t  n jtin grup me vesh nlesh t dhe mendjemejgulluarit, t  cil t kan  mbetur amull, duke mos e çar  kok n p r mbar vajtjen dhe k ndelljen e shqipes standarde mbar komb tare!?"

S  treti, mos, vall , disa ortolog  tan  t  njohur, por edhe ndonj  rrahgjoks p r dije ortologjike, edhe pse po i p rmedin n  referimet e tyre si mb shtje disa shemb llytra t  caktuara t  kultur s e t  gjuh s son , po harrojn  se pik risht disa nga m simet e porosit  e eruditiv -vizionar  t  njohur, si t  Faik edhe aktualisht n  t  kthyerit mbar  dhe n  t  kuptuarit m  me lehtisi t  nevoj s rastesisht a p r shkak t  ndonj  nxitimi, siç theksohet n  "50 vjet studime t  ndonj  bot kuptimi t  ngusht  e ku me dit  se pse, kan  mbetur jasht  standardit, siç  sht  edhe paskajorja e shqipes?"

1) Intelektuali erudit Faik Konica, i cili, edhe pse c shntje e gjuh s nuk i konsideronte thjesht si c shntje t  filologjis , por edhe si c shntje t  rendit komb tar, ishte kund r atyre q  "kllasin gjindarm rin  n  fush  t  mendjes", q  n  vitin 1897 lidhur me letrarishten e shqipes theksonte: Si e vetmja udh dalje q   sht  edhe m  praktikja, do t' ishte p rpilimi i n j  gramatike (kupto: edhe rregullat e drejtshkrimit N. V.) n  t  cil n, duke ndjekur n j  metod  racionale dhe shkencore p rtej bashk jetes s paralele t  t  dy dialekteve, do t  p rshiheshin t  gjitha elementet (kryesore) dialektale, k shtu do t  krijohet n j  gjuh  letrare e shkruar e p rbashk t p r t  gjith  shqiptar t, ngase c shntja k tu nuk  sht  p r t  zhdukur geg rishten ose tosk rishten ... n  m nyr  q  t  arrihet n j lloj unjimsimi dialektor, sepse t  p rpiqesh t  ndryshosh gjuh n e n j  popullit do t  thot  t  ndryshosh karakterin dhe t  prishish personalitetin e tij (Shih F. Konica, Vepra 1, Prishtin , 1995, f. 208-209). Me fjal t t  tjera, sipas rrethanave t  sotme mund t  thuhet se ai kishte mendimin se as tosk rishtja as geg rishtja vet m p r vet m nuk mund t  quhet gjuh  letrare komb tare, por standardi i p rbashk t duhet t  dal , siç dihet, nga inkorporimi i vlerave m  t  r nd sishme e t  domosdoshme nga t  dy dialektet, mendim ky q  dilte i shprehur edhe m  p rpara m  1881 nga dietari poliendrik Sami Frash ri, i cili ishte po p r n j  gjuh  (letrare): shqip t  pandame e t  n jjet  ku gjith  dialektat  do t  gjenden t  gjitha t  bashkuara e t  p rzjera".

2) Edhe prof. Selman Riza ishte p r n j  gjuh  standarde konvencionale: me sht  n  p rdorim fjal t dhe shprehjet q  gjinden n  secilin dialekt t  shqipes, pra, elemente t  p rzgjedhura t  n jrit dhe t  tjetrit dialekt, ngase njajtësia e shqipes p rbahet prej t  gjitha p rbashk sinave t  gegnishtes e t  tosknishtes shka p rmban rregull n... dhe p r k t  ide mbrohet me fjal t e N. Resultit "Gjuha konvencionale nuk asht çorb ... Çorb  do t  ishte sikur t  p rdorëshin



pa kurrfarë kriteri e pa dallim trajta toskërishte e gegërishte si asht e ëshir" (Shih S. Riza, Vepra 1/96 f. 121 e 180), prandaj shtrohet pyetja: Në normën e sotme të shqipes letrare në fuqi a është vepruar ashtu, me tamam, siç porositin këta eruditë, apo jo?

Sidoqoftë, ne duke pasur bindje se pikërisht për temën në shqyrtim nuk është vepruar plotësisht drejt, po përipiqemi, personalisht e bashkë me shokë, me gjetë mbështetje në kritere të shëndosha për zgjidhjen si duhet të kësaj çështjeje për mos me lejuje *pele-mele* a mos me bë, siç thuhet te ne, : *çorbë e çervish pa tlynë e pa mish* me gjuhën standarde. Fundja, nuk është mirë me ia lënë në dorë punët e zgjidhjes stihisë, ngase forma e paskajores, e cila bën pjesë ndër elementet kryesore të pasurimit jo vetëm të gegërishtes, po me gjerë, po përsëris, është duke u përdorur aktualisht këndej e gjithandej.

3) Prof. A. Kostallari, i cili relativisht më vonë, kur paskajorja ndodhej përgjithësisht e rrëgjuar në gjuhën zyrtare, iu bashkangjit nismës për njësimin institucional të gjuhës letrare kombëtare, por që doli organizativisht si më i merituari, pak para e sidomos gjatë *finishit* (!) të sendërzimit të saj, në fjalën e mbylljes së Kongresit të Drejtshkrimit (1972) pati deklaruar se "Nga pikëpamja e studimeve më të thelluara, studimet në fushën e morfologjisë ende nuk kanë filluar", dhe porosiste: "pa hequr dorë nga detyrat e historisë së gjuhës, ajo (gjuhësisë jonë N.V.) duhet të merret me marrëdhëniet midis gjuhës letrare e dialekteve të para në gjendjen e sotme, ashtu edhe në *prirjet e zhvillimit*" dhe në shkrime të tjera, ta quajmë, të epokës së tij(!), nënvizonte: "përpjekjet tona shkencore teorike dhe praktike do të bëhen kurdoherë më të gjalla, duke mos harruar asnjëherë se në jetën e gjuhës sonë *norma dhe antinorma* bashkëjetojnë e luftojnë për njëra-tjetrën" prandaj "gjuhësisë (shqiptare) i del detyrë me shumë përgjegjësi t'i kuptojë drejt *prirjet e këtu zhvillimi*, t'i njohë rrymat më të dukshme si edhe proceset që zhvillohen në thellësi *në tërë sistemin e gjuhës* dhe të ndihmojë që *gjuha jonë letrare kombëtare* të nxjerrë prej tyre përfitime sa më të mëdha për t'u bërë më e pasur, më e fuqishme e më e zhvërdjellë", ndërsa "në raste kur tiparet e veçanta, nën kushtet e një divergjence të fuqishme gjuhësore, për arsye gjuhësore e jashtëgjuhësore mund të mos i nënshtrohen strukturës, atëherë i drejtohen *sistemit*, i cili ka qeliza të zbrazëta, mundësi ende të pashfrytëzuara" dhe kështu "*fjalët e shprehjet dialektore integrohen në strukturën e gjuhës letrare*."

Prandaj, siç na pati sugjeruar edhe ne, profesori i nderuar, në këtë mënyrë mund të gjendet edhe rruga e zgjidhjes së paskajores, ngase nëse ka vështirësi me u futë menjëherë në strukturën e ngushtë të toskërishtes, ajo si pasuri e

vlërë e pakontestueshme gjuhësore e mbarë shqipes, siç është, do t'i drejtohet *sistemit tërësor*, kodit të gjuhës mbarëkombëtare, i cili, pasi e ka në sistem do ta përcjellë e do ta bëjë, patjetër të integrueshme, duke e përcjellë atë nga sistemi në strukturën përkatëse jo të toskërishtes, por në strukturën më të gjerë a në makrosistemin e *gjuhës letrare mbarëkombëtare* e së këndejmi, pra, menjëherë kjo formë del si element legjitim edhe në *shqipen standarde (sui generis)*. Përndryshe për mos aktivizimin e paskajores me + pjesore në strukturën e sotme letrare ai edhe disa të tjerë, qoftë *meritën* (!) (*aferim* për vetmohim!), qoftë *fajin*(?) (pa mashalla për *ban* në dëm të vetvetes!), si ta marrësh, jo pa fakte, ua mveshnin kolegëve gegë, të cilët në shkrimet e tyre vetë *kishin hequr dorë* atëherë, mbase nga servilizmi i tepruar, i cili edhe tani, mjerisht, mekanikisht po vazhdon po me atë avaz, d.m.th., tani pa kurrfarë presioni vazhdojnë të heqin dorë, vetvetiu, nga një formë e tillë?! Vlen të theksohet se ortologu ynë, veterani i arsimit kosovar, Mehmet Gjevori, me sa dimë, është i vetmi ndër intelektualët tanë, i cili pranon se çështja e paskajores ka mbetur pa u trajtuar si duhet edhe për shkak se "askujt ndër ne nuk i ka shkuar ndërmend me trajtue këtë temë në Konsultën e Prishtinës, por edhe më vonë gjatë periudhën kalimtare, deri në Kongresin e Drejtshkrimit, sa ishte në diskutim publik *Projekti i rregullave të drejtshkrimit të shqipes* (1967) (Shih artikullin, M. Gjevori, "Pasurimi, përsosja dhe pastërtia e gjuhës - parim themelor i standardit të shqipes, botuar në gazetën *Koha ditore*, 11.09. 2005, f. 11).

Sidoqoftë, nëse dikur dikush nuk e ka parë të arsyeshme, *nuk i ka shkuar ndërmend* ose nuk e ka kuptuar gjendjen reale si dhe vlerat e paskajores si duhet ose nuk ka pasur guxim a ndoshta dikush ka vepruar ashtu me vetëdije, ngase, siç thuhet, në aso rrethanash, ka lejuar me bë një *gjnah* të vogël për me fitue një sevap të madh (njëzimin e shqipes letrare), tani, kur kanë ndryshuar raportet, kur nuk është drojë se shqiptja standarde me këtë element plus do të humbiste përkrahjen e aparatues pushtetore a prestigjin që gëzon etj. dhe kur tani nuk ka ndrojtje nga asimilimi dhe pasoja të tjera, s'ka arsye të mos kërkohet zgjidhja e problemit në fjalë sa më shpejt e drejt.

Sëkatërti tani për tani, në mungesë të ndonjë autoriteti të ri të këohës në Qendër, s'kemi nevojë as të qajmë e të vajtojmë, as të shajmë e ta fajësojmë dikë tjetër, por na mbetet të punojmë vetë dhe të shpresojmë që shkencëtarët tanë të sotëm standardistë, të cilët nuk janë të pazot dhe nuk na mungojnë, sidomos ndonjë i moshuar a ndonjë poltron-servil ndaj tabusë së ngulitur, do të çlirohen nga retë e zeza të fanatizmit bunkerist për të na treguar, jo siç



shprehet Ardian Ndreca, "rishtas rrugën që duhet me ndjekun", por zgjidhjen e çështjeve si kjo ta shohin e përkrahin në rrugën ku jemi duke ecur, duke sforcuar bazamanetin e shtratit të gjykimit tonë për normën standarde kombëtare pa kthim mbrapa, ngase tashmë një rrugë të tillë e kemi të piketuar dhe të trasuar mjaft mirë, por duhet ta përsosim me elemente, siç është paskajorja e ndonjë element tjetër të rëndësishëm nga dialekti tjetër, sepse elementet e tilla janë të domosdoshme dhe e begatojnë normën standarde.

Së pesti, duke mos u pajtuar me mendimin e atyre gjuhëtarëve të cilët propagandojnë se gjoja "trajtat e kryqëzuara të gegërishtes nuk ngjizen, nuk përshatën me inدت e gjuhës standarde", andaj nuk mund të bëhen shortime, sepse do të bëhej lesh e li dhe standardi, si do të shtonim ne, do të bëhej sipas biçimit: *pele - mele a çorbë e çervish pa tlynë e pa mish*, shprehje këto e të ngjashme me to, shpesh të thëna kuturu, e quajmë jo pa vend mendimin e shprehur nga Mehmet Elezi, i cili në polemikë me gjuhëtarët e tillë, mbron të kundërtën (Shih: Mehmet Elezi, "Gjuha shqipe në bunker?", Tiranë 2005.) Sipas tij "teoria e mospërshatjes është një bombë tymëse që pëshëjtjellon", ngase për *shartime* e *lesh* e *li* mund të flitet vetëm kur është fjala për dy gjuhë të ndryshme e jo për shqipen, e cila është një gjuhë dhe **vetëm një** me dy dialekte, që përbëhet nga një mish, i njëjti gjak, nga të njëjtat inde, të cilat nuk janë aq të largta, prandaj aludimi për teori të mushkës (thënie ironike Gj. Fishes), d.m.th., përzjerje shtërpe mekanike, është një spekulim i paqëndrueshëm, sepse, ç'është e drejta, "nuk është vështirë me u kuptue se përzjerja mbarë e mbrapsht e dialekteve pa kriter, për çka qortone GJ. Fisha, është krejt tjetër, ndërsa bashkëveprimi ndër dialektor për të thithur me kriteret të përcaktuara shkencërisht çdo vlerë që ka secili dialekt, është krejt tjetër. **Vetëm padija dhe keqdashja mund t'i ngatërronjë dy gjera kaq të ndryshme** (Aty f. 125)-nënvizon dhe ngulmon autori duke theksuar se "me ça hullinë duhet fuqia shprehëse e të dy dialekteve të harmonizuara në një", prandaj, si do të thoshim ne, me një bashkëveprim të tillë me kriteret të dëshmuara shkencërisht nuk mund të lihet vend as për *shartime* mushke, as për *lesh* e *li* në arallëk dhe as për *pele-mele* në mendje e gjoje memecësh në ligjërimin standard. Mehmet Elezi si intelektual i dëshmuar, si të keqen edhe të mirën rreth kësaj çështjeje i sheh mjaft thellë. *Gjuha shqipe e standardizuar* - thekson ai -, megjithë të metat e mëdha është një vlerë kombëtare, por tani në kushtet e sotme "standardi gjuhësor duhet rivlerësuar për t'u ndrequr e përsosur... Si mund t'i lejojnë vetes disa akademikë me mbrojtje me fanatizëm vendime për të cilat shkenca nuk ka folur lirshëm, edhe pse në kushtet e atëherëshme mund të lexohen si

shprehje intelektuale e një vetëdije të lartë kombëtare, por si një e keqe më e mirë (Mbase si e keqe më e vogël, siç thuhet ndër ne, ndaj të këqijave të tjera që mund të ishin edhe më me pasoja). Sidoqoftë, ngulmon autori: "këmbisha e hekurt që iu mvesh gjuhës i duhet hequr... Rregullat e standardit duhet të jenë gjithëpërfshirëse për çdo vlerë të gegërishtes e të toskërishtes, për çdo vlerë të shqipes... Pasuritë e pafundme të gjuhës shqipe në gegërisht duhet t'i kthehen pronarit të ligjshëm që quhet Kombi Shqiptar, t'i kthehen me platformën shkencore e jo me anarki, ngase vështirë të thuash, cila është më shkatërruese mungesa e lirisë a liria e anarkisë, andaj ndreqjet e përmirësimet duhen institucionalizuar...".

Po shtojmë, këtë rast, se me disa mendime e masa konkrete zbatimi që i propozon dhe i sendërzon M. Elezit dhe jo vetëm të atij, që po dalin sheshazi në masë të konsiderueshme tani, rreth zgjidhjes së problemit në fjalë, s'kemi se si të mos pajtohemi edhe ne, pasi atë kërkesë e patëm shtruar botërisht, para dhjetë e sa vjetësh në Konferencën shkencore *Gjuha letrare kombëtare dhe bota shqiptare sot*, në Tiranë (1992).

Së gjashti, pajtohemi gjithashtu edhe me mendimin e Ardian Vehbiut (Pavarësia, 21.08.'04, 15), i cili veç tjerash shprehet se A. Kostallari nuk mund t'i mohohet erudicioni i gjerë as kompetenca e pashoqe në lëmin e socio-linguistikës dhe të planifikimit gjuhësor... Standardi i shqipes nuk është as i përkryer as i dështuar por një instrument i vyer në duart e të gjithë atyre që duan ta ruajnë unitetin politik, madje edhe unitetin kulturor të shqiptarëve. **Vetë traditua kulturore geqe** do të mund të ringjallet për bukur, jo vetëm duke u lëvruar drejt përdrejt dhe krahas shqipes normative, por edhe duke vazhduar të integrohet gjerësisht në standard, ashtu si edhe po veprohet nga shqipshkruesit më në zë, nuk ka asnjë pengesë objektive për këtë proces emancipimi, i cili do t'i sjellë Shqipërisë të shekullit XXI atë çka kultura demokratike shpresohet t'i sjellë". Me fjalë të tjera, çdo kohë krijon njerëzit e vet dhe vlera do t'u jepet në radhë të parë për suksesin e tyre të realizuar për atë periudhë, por për të pasur famë më të madhe njerëzit e tillë duhet të lënë shtigjet hapur drejt një perspektive të mbarë.

Së shtati, tani do të përpiqemi që shkurtimisht fare të përgjigjemi në pyetjen: Pse këmbëngulim për zgjidhjen e çështjes së paskajores me integrim dhe pse të mos pajtohemi me praktikën e 5-6 dekadave të heqjes zyrtare të saj, pa mohuar të vërtetën se gjuha letrare edhe pa këtë formë ka pasur dhe ka ecje të mbarë, madje ka prova se mungesa e saj, sidomos në veprimtarinë shtetërore

e publike a në stilin zyrtar-administrativ e publicistik, vërtet, nuk vërehet se le zbrazëti të dukshme?

Megjithatë, ne, pa mohuar dhe pa cenuar pra *ecjen e mbarë* ndërkohë të shqipes letrare të njësuar, sidomos në stilin zyrtar-publistik, këmbëngulim, ashtu si një pjesë e konsiderueshme e studiuesve dhe e intelektualëve sot, se ajo normë lypset rishikuar e përsosur. Ekziston bindja se po ta kishte pasur në gjirin e vet paskajoren e ndonjë element tjetër të gegërishtes me kohë, norma e sotme letrare në tërësi, sigurisht do të kishte pasur edhe më shumë suksese, do të kishte me pasë edhe më shumë normalitet dhe nuk do të kishte lënë kurrfarë lëshimi mbra pa nuk do të kishte lënë vend për ankesa as në stilin zyrtar e administrativ të të gjitha niveleve dhe as në rrafshet e tjera, prej më të ultave deri më të lartat. Dhe për këtë ka argumente të forta, shumica e të cilave tashmë nuk janë të panjohura dhe të pathëna edhe publikisht. E themi me plot bindje se po të mos ishte mënjohur ky element nga shqipja letrare, shkollat tona të të gjitha niveleve dhe të të gjitha trevave, më me lehtësi do ta kishin përvetësuar. Tash më, normën standarde, ngase kështu si është, pa u përsosur e njomur me elemente të domosdoshme, siç është edhe paskajorja, druajmë se mund të cilësohet si normë me të meta që, pale, a meriton me u quejtë **normë e shqipes standarde mbarëkombëtare**. Dihet se çdo qenie e gjallë ashtu edhe gjuha jonë bashkë me ne, edhe aktualisht bën ecje përpara, por në fushë të kulturës, nuk thuhet kot se mund të ndodhin edhe vendnumrime edhe ngecje në pika të caktuara. Ne si popull, si komb, më duket se i kemi provuar edhe ecjet edhe ngecjet, sidomos në sferën e politikës së përgjithshme, që këto të dytat (ngecjet) nuk do të dëshironim t'i riprovojmë në të ardhmen për shkak të plogështisë subjektive të njëzëve tanë.

Së treti, është e vërtetë se nga fundi i viteve të '60-a, të shekullit të kaluar, kur te ne, nën rrethanat e atëhershme, sidomos jashtëgjuhësore, është përfaqur, jo pa arsye, gjuha letrare e njësuar, është menduar, siç e thekson prof Idriz Ajeti atëherë, se *gjuha letrare që asht në përdorim në Shqipëri nuk asht tasknishte, por e njomur me gegnishte, çka përputhet me evolimin e vet gjuhës dhe e pasunon atë*", prandaj, sipas tij, *me atë gjuhë mundemi me fillue menjëherë ngapak me ndonjë emision përkrye radios etj.* (Shih: I. Ajeti, *Zani i rinisë* 11/67). Sigurisht, atëherë është menduar, ndoshta nga shumëkushi, se në atë *njomësi* mermin pjesë më shumë gegizma, pra edhe paskajorja ose nuk është ditur aq për vlerat e saj. Madje mbase nuk është ditur aq botërisht një e vërtetë tjetër, siç e thekson prof. Bahri Beci se "Shteti i ri demokratik shqiptar i pas Lufës (LDB) nuk e kishte parë problemin e shqipes standarde si çështje

148

*të një shteti me problem kombëtar të pazgjidhur" (Seminari/19, f.19),* madje as në Kongresin në fjalë, nuk është pasur parasysh problemi i tillë gjithpërfshirës gjuhësor, (pra edhe i trevave jashtë Shqipërisë administrative), prandaj, sot për sot, moskorrigjimi i një lëshimi të tillë që solli ndrydheje e varfërim shpirtëror dhe njëfarë zvetnimi kombëtar, është i pajustificueshëm, sepse siç e thekson M. Elezi: "nuk është koha me flijue Rozafa të tjera në emër të një ideje të vjetër" (*Bota sot*, 23 qershor 2002), por është koha, siç e thekson Artan Haxhi "të mos pajtohemi vetëm me konstatime, me vërejtje, por ato mendime e propozime t'i vëmë në jetë në mënyrë që të mos ecet pa një perspektivë të qartë, në mënyrë që gjuhën standarde të ngremë në një nivel të atillë që ajo të përmbushë e të plotësojë nevojat jo vetëm të shoqërisë së sotme shqiptare, por edhe të perspektivës (Konferenca ... 2002, f. 154). Prandaj del shumë i bazuar mendimi i prof. Rexhep Ismajlit, i cili lidhur me aktualitetin e sotëm rreth standardit gjuhësor, thekson: *Përgjigje nuk mund të jetë as fortifikimi në lagëme mbrojtëse (të disa elementeve të normës së sotme) e as sulmi ndaj gjerave që kanë ndodhur në të kaluarën, po zhvillimi dhe hulumtimi për mundësitë e zgjerimit sa më të madh të aftësive të shqipes, çka nënkupton shfrytëzimin maksimal të thesarëve të saj dhe mbi të gjitha, zgjerimin e aftësive tona komunikative, për sa më shumë hapësirë e variatete të shqipes, duke i dhënë krah parimit të stabilitetit elastik në funksionimin e gjuhës standarde (Shih: Java, 5.05.'05, f.3).*

Së nënti, sidoqoftë, me inkuadrimin e paskajores mund dhe duhet të kuptohet, sot për sot e në të ardhmen, jo vetëm se do t'i ofrohet *njomësi* dhe *madhe shqipes standarde*, siç shprehej atëherë prof. Idriz Ajeti, por edhe do të ndihmohej shumë që shprehja e saj të jetë gjithsesi më masive, më e plotë dhe gjithsesi më e përsosur e më lapidare edhe më me perspektivë. Për këtë qëllim jo papim në vazhdim disa shembuj, dhe nga krahasimi i tyre sipas tipave të fjalive sipas llojit e kuptimit si dhe shprehjeve frazeologjike, kërkohet nga shqipfolësit e caktuar, në veçanti nga specialistët, t'i dallojnë sa është e mundur këto tri realitete:

1. *shprehjet sinonimike të barasvlershme,*
2. *shprehjet me nuanca të dalluara stilistike dhe*
3. *thëniet sinonimike, me koncepte të dalluara semantike,*

të cilat gjithsesi janë a duhet të jenë të lejueshme, normativisht jo të përjashtueshme nga standardi gjuhësor, sepse, nuk e përmbysin, po e përsosin shprehjen e gjuhës shqipe dhe janë të domosdoshme në kontekste të caktuara. Ja disa shembuj:



- a) 1) Me u marrë me punë të mira, veç të mira ka me pasë (Fjali dëftore)  
Duke e marrë më punë të mira vetëm të mira do të ketë.  
Po u more me punë të mira vetëm të mira do të kesh.
- 2) - A me dalë nesër? - Me dalë, po si! (Fjali pyetëse + Fjali urdhërore)  
- A të dal (të dalë, të dalim, të dalin) nesër? - Dil (dilin, të dalin), posi!?
- 3) Dëshiroj me të pa! ( Fjali dëshirore nxitëse)  
Dëshiroj të të shoh!
- 4) Nuk mundem me hedhë mbas shpine.  
Nuk mund të (ta, t'i...) hedh pas shpine.  
5) Si ndodhi me e humbë arsyen? (Fjali pyetëse)  
Si ndodhi që e humbe (humbi ...) arsyen?
- b) 1) Është bërë *mos me hançër as qentë!*  
Është bërë që mos ta hanë as qentë(!)!
- 2) Është një lule *me prekë s'duron.*  
Është një lule ta prekësh s'duron(!).
- 3) Është puna: *mos me u mërzitë.*  
Është puna që të mos mërzitem (mërzitësh, mërzitet; mërzitemi, mërziteni, mërziten)?  
Është puna për të mos u mërzitur(!)
- c) 1) *Me dalë fjala* nga dhëmballa e merr vesh tërë mëhalla.  
Doli fjala nga dhëmballa e mori vesh tërë mëhalla.  
2) *Mos me folë me thumba* se kthehen me plumba.  
Mos fol (folni...) me thumba se të (ju ...) kthehen me plumba.  
3) *Me folë me mend e me rend fjala* ka me zënë vend.  
Po fola (fole, foli, folëm, folët, folën) me mend e me rend fjala ka për të zënë (do të zërë!) vend.  
4) *Me lënë vesin* me u pjekë deri në vorr ka me të ndjekë.  
Po e lë vesin të të pjiqet deri në varr ai s'do të hiqet.
- ç) 1) Hasmin me plasë - mbarësi me pasë.  
Mbarësi nëse ke - hasmin për dhe!  
2) Të mirën me gjetë - mbarësi në jetë  
Të mirën (po) gjete me urtësi - në jetë do të kesh mbarësi!

Nuk po japim shembuj të tjerë, ngase konsiderojmë se edhe këta janë të mjaftueshëm sa për të ilustruar me fakte atë që thamë më sipër lidhur me shprehjen lapidare me paskajore (ku zakonisht nuk përcaktohet as veta as numri dhe kuptimi i fytyruar gjithsesi sfidon) ndaj atyre me lidhore ose mënyrë tjetër

(ku koha, veta dhe numri dalin të përcaktuar, por kuptimi i fytyruar abstrakt, pothuajse, nuk sfidon fare ose konteksti për abstraksion të lartë kërkon formulim tjetër). Jemi të vetëdijshëm se nuk është punë aq e lehtë për t'i bërë këto dallime për ata lexues që nuk kanë parapërgatitje të mjaftueshme gjuhësore ose nuk e kanë të ravijëzuar në koncept paskajoren dhe funksionet e saj, prandaj edhe paracaktuam sfidën si më sipër. Sidoqoftë, në shembujt e mësipërm kërkohet që të gjykohet: sa ishte i drejtë apo jo, dhe sa i dëmshëm injorimi i deritashëm, po, nëse vazhdohet, edhe pastashëm i shprehjeve përkatëse lapidare me paskajore. Me fjalë të tjera, del i saktë konstatimi se *me zhdrukjen e formave të caktuara, siç është në gjuhën tonë paskajorja, gjuha letrare do të humbasë idioma e të thëna karakteristike të pakompenzueshme* dhe në njëfarë mënyre me një akt të tillë, mundësohet të krijohen edhe zhgënjime e pakënaqësi më të mëdha dhe së këtejmi mund të implikohen edhe probleme identiteti në kuadër të gjenisë së bashkësisë së caktuar folëse.

Së dhjeti, dikush mund të thotë se vetëm varianti i letrarishtes mjafton sipas shembujve të mësipërm. Mbase për dikë edhe vërtet mjaftuaka(!). Mirëpo shrohet pyetja: kur i kemi dy duar, pse mos t'u fusim në përdorim të dyja, kur i kemi dy sy, pse mos të shikojmë me të dy, madje edhe me të tre e me të katërt e të pestë, pra edhe me sytë e mendjes, me sytë e zemrës si dhe me sytë e shpirtit, kur këtë mundësi e kënaqësi na ofron struktura e gjuhës sonë amtare, si e zoja e vetvetes e cila e ka të mbrujtur atë gatëse hyjnore nga e sofrat magjike e shpisi së vet pa pasur nevojë me dalë me lypë hua gjetiu.

Sigurisht ai që nuk i ka ose nuk i ndjen në sistemin e vet ligjërimor të dyja format duhet ta vrasë pak mendjen dhe, së paku, t'i mirëkuptojë e mos t'i pengojë a nënçmtojë ata që i kanë në sistemin e tyre ligjërimor të dyja (a të tria) këto formë-koncepte, të cilat mund të përdoren dhe mund t'i shfrytëzohen për qëllime të caktuara, qoftë për nevoja të *sinonimisë së barasvlershme*, qoftë për nevoja të *nuancimit stilistik* (sinonimik) ose edhe për të shprehur edhe koncepte a *ngyryme të ndryshme semantike*. Në këtë kontekst, mjaft provokativ por pozitiv, për mendimin tonë, na duket konstatimi i Ardian Ndreçës, kur thotë se *"derisa të bahet fjalë për koncepte që e kanë burimin tek empiria, pra tek eksperiencia e shqisave, gjuha e sotme (letrare) shqipe e përballon disi stresin dhe u përgjigjet nevojave komunikative, por kur bahet fjalë për realitete që i tejkalojnë shqisat tona, atëherë standardi tregon vorfiminë e tij strukturale. Kjo vjen mbasi gjuhës së sotme i asht tha loza e mendimit të pastër, i asht heqë mundësia me mendue nëpërmjet krijimit të vazhdueshëm të termave abstraktë si ata që përfshin paskajorja* (Shih: Java, 16.06.'05, f. 19).





zgjerohet a përplotësohet, duke kërkuar mbështetje e duke marrë ushqim pikërisht nga sistemi i tërësisëm i gjuhës shqipe, siç është vepruar, b.f., me pranimin e formave të pjesores së gegërishtes në fjaleformim, tipi *mësue mësues* etj., edhe pse toskërishtja si edhe gegërishtja i kishin trajtat gjegjëse mbi bazë të njëjësiti të deftores, tipi *mësonj mësonjës / mësoj mësojs*. Refuzuesit e tillë nuk e vrasin mendjen fare, siç mësonte prof. A. Kostallari dhe, siç e shpjegon ortologjia bashkëkohore, se asnjë element i caktuar me vlerë nuk mund të jetë i mospranuar nga sistemin global në strukturën e gjuhës përkatëse letrare (standard). Është dukuri e njohur në sociolinguistikë e pragmatikë, siç u cek më sipër, se dialekti bazë në rrethana të caktuara, po përsërisim, *ka detyrim me përfshi në gjirin e vet, domosdo të gjitha vlerat e dialekteve dhe të të folmeve të caktuara nga mikrosistet e strukturat përkatëse*. Nuk bën me lënë jashtë norme asnjë vlerë inventive të krijuesve të caktuar e jo më ndonjëherë nga vlerat themelore të shumicës së bashkësisë folëse, e cila i nevojitet gjithësesi asaj gjuhe, përkatësisht vetë asaj norme.

4) Del fare i pabazuar edhe arsyetimi tjetër se gjoja shqipja letrare duhej sakrifikuar pjesoren e vet bashkë me paskajoren (e gegërishtes), ashtu siç e ka sakrifikuar, b.f., serbishtja pjesoren (jo paskajoren) për hir të njëjimit të gjuhës letrare(!). Siç dihet, çdo gjuhë ka dhe e ruan natyrën e vet. Shqipja s'ka nevojë t'i shkojë pas e të marrë *yrnek* sakrifikimi as nga serbishtja, as nga greqishtja, as italishtja etj., kur dihet e vërteta, se pesha e pjesores së serbishtes dhe e gjuhëve të tjera nuk mund të krahasohen as për së afërmi me peshën e pjesores dhe sidomos të paskajores së gegërishtes (më drejt: paskajores së gjuhës shqipe).

5) Lidhur me refuzimin e paskajores së mirëfilltë nuk duhet shfrytëzuar a keqinterpretuar respektin me vend që kanë shprehur për toskërishten letrare Luigj Gurakuqi, Aleksandër Xhuvani e të tjerë, ngase dihet se çfarë gjuhe përdoren ata gjatë tërë krijimtarisë së tyre.

6) Edhe arsyetimi, i thënë kuturo, se inkuadrimi i paskajores sot *nxirka punë*, mund të kuptohet dy mënyrash: e para, mos të shpohet e vërteta rreth padrejtësisë që i është bërë gegërishtes me atë mënjanim dhe e dyta, d.m.th. *nxirka punë* për shkencën (!), për politikën gjuhësore etj.. Arsyetimi i dytë jo vetëm që del si një arsyetim edhe më i pabazë, po mund të cilësohet edhe si një absurd, si një arsyetim dembelësh(!). Sidoqoftë, detyra e shkencëtarit është të hulumtojë vazhdimisht për përsosjen e standardit të gjuhës së tij, duke shfrytëzuar çdo mënyrë e metodologji që i sjell rezultate, ngase, jo nga

mospuna, po nga puna dalin edhe zgjidhjet më të drejta, më shkencore, më të qëndrueshme dhe më me perspektivë.

7) Dëgjohen edhe konstatimet si, gjoja, inkuadrimi i paskajores me + pjesore në standard praktikisht "*ndreqka pak e prishka shumë*", kontatim ky që dikush mund ta cilësojë me të drejtë si: "*fjalë në hava*"(?!), ashtu si edhe konstatimin tjetër, se, gjoja, *kërkesa për inkuadrimin e paskajores*, u konsideruaka si *nostalgji (!)*, e aq më tepër edhe *si mohim i të arriturave që u bënë me njësimin e normës letrare në Kongresin e Drejtshkrimit, por edhe në zbatimin 30 vjet të kësaj norme (!?)*.

8) Nuk qëndron as konstatimi tjetër, kinse, zëvendësimi i paskajores me lidhore në shqipen e sotme, në çdo rast qenka *risim*, kurse sinonimia me paskajoren në konkurrencë lojale qenka *kthim në vjetërsi*, ngase "*shqipja nuk duhet të mbetet me "vjetërsinë e saj" (!)*, thua se nuk dihet e vërteta që po del gjithnjë më e qartë sheshazi, se sakrifikimi i paskajores me + pjesore (të cilën prof. S. Riza e quante "*paskajore të re*", ndërsa prof. Çabej "*dukuri risimi*", d.m.th. pa e *ngjyru*e me *vjetërsi*), nuk ishte i nevojshëm as i domosdoshëm as atëherë, e aq më tepër sot, kur dihet se edhe lidhoria edhe paskajorja në shqipe (edhe pse kanë pësuar riorganizime) për nga *vjetërsia*, sipas dokumentimit, kanë, pothuaj, një moshë bashkëjetese të përbashkët, të harmonishme. Sidoqoftë, çdo dashamirës gjuhe e di se këto dy forma nuk përjashtojnë njëra-tjetrën në përdorim normal, prandaj aq më tepër duhet ditur se një gjykimi i tillë refuzues bie ndesh edhe me konstatimin me vend se "*përdorimi që do të mohonte burimin e vet do të çonte në bjerrjen e asaj gjuhe (Q. Murati)*. E thënë ndryshe, mohimi i vlerave të paskajores do të çonte jo vetëm në varfërimin e gjuhës, por edhe në sakatimin e identitetit të saj, ose të bashkësisë që e flet atë, pasi nuk është fjala për ndërrimin e vlerave më të dobëta e zëvendësimin e tyre me vlera më të forta, më cilësore, por është fjala, siç e tha dikush, për piranimi, asgjësim vlerash.

9) Pra, veç raportit *risim/vjetërsi* që del i paqëndrueshëm, por edhe konstatimi tjetër se gjoja inkuadrimi i paskajores bëka kthesë mbrapa, gjë që është absurditet të mendohet ashtu. Pra, nuk është e vërtetë se me inkuadrimin e paskajores në shqipen standarde u bëka kthesë mbrapa, përkundrazi, me inkuadrimin e saj ajo (letrarishtja) do të bëjë ecje edhe më të sigurt përpara. Paskajorja (pjesorja e shkurter) nuk është plaçkë që për ta marrë duhet me kthye mbrapa normën, ajo është vlerë që ecën bashkë dhe e shoqëron vepresin (përdoruesin e gjuhës), madje ajo paraprin, sipas ligjit të evolimit, andaj s'është kthyer mbrapa që ta marrësh, ngase atë e ke përkrash gjithnjë në çdo



proces ligjërimi, por duhet ta aktivizosh me rend e me vend, sa herë që i duhet kontekstit. Për fat, ajo faktikisht nuk ndeshet e struktur në muze që ta nxjerrësh prej andej. Ajo, siç dihet, ka hapësirë të lirë veprimi ndër pëdoruesit, prandaj nuk mund të quhet *plaçkë e hedhur* e asgjësuar. *Ç'është e vërteta, kthim prapa a përmbyse ka pësuar shqipja letrare për këtë pikë, atëherë, kur nuk është përfillur pjesorja e shkurtër bashkë me paskajoren e mirëfilltë, duke u përzgjedhur e rekomanduar vetëm pjesorja e zgjeruar e një dialekti, në kundërshtim me procesin evolutiv rreth thjeshtëzimit të gjuhës, sipas trajtës më të shkurtër, sipas shqiptimit më të lehtë, sipas përdorimit më të gjerë e masiv në kohëhapësirë etj.*

10) Për ne del i papranueshëm edhe mendimi i një gjuhëtari tjetër, po gegërishtfolës, me ndikim, i cili shprehet se gjoja inkuadrimi i paskajores me + pjesore, vërtet, "nuk do të ishte i nevojshëm sa kohë që *shqipja ka kaq shumë mundësi për ndërtime me foljet modale dhe foljet aspektore*", thua se formimet me paskajore në *gjuhën shqipe* nuk paskan trashëgimi e fizionomi edhe me folje aspektore e modale, madje më të formëzuar në realitet se vetë sishoqet e tjera të përmendura konkurruese, madje edhe përdorim më të gjatë masiv dhe normativ, andaj, shtrohet pyetja pse t'i mohohet e drejta e konkurrencës lojale formës së tillë, e cila nuk është rast i shpifur spontan, por është një realie e ngulitur thellë në kohëhapësirën e gjëllimit të sistemit ligjërimor të gjuhës shqipe?! Kur është fjala te konkurrenca a bashkëjetesa e paskajores së mirëfilltë me forma të tjera po rikujtojmë të vërtetën se paskajores, pa hyrë në kontekste sintaksore, i është mohuar konkurrenca vetëm me këto kohë të njohura foljore:

së pari, me të *tashmen e pacaktuar të dëftores: punoj / me punue*, si trajtë përfaqësuese dhe lidhur me këtë praktikë, A. Sula konstaton me të drejtë se "kjo formë (njëjesi i dëftores) nuk është e njëjtë as gramatikisht as kuptimisht (me paskajoren e mirëfilltë), por vihet thjesht për t'iu shmangur përdorimit të paskajores së gegërishtes, meqë ajo është përjashtuar nga norma letrare" (Art. i cit. f. 75);

së dyti, me të *ardhmen e sigurisë: kam për të punuar kam me punue*, me të cilën bashkëjeton, madje në shumë kontekste shënon përparësi ndaj trajtës *standarde* edhe në gjendjen e sotme, sidomos në shprehje idiomatike frazeologjike;

së treti, me të *ardhmen e së shkuarës së sigurisë të dëftores: kisha për të punuar kisha me punue* dhe lidhur me këtë vlen konstatiimi i mësipërm dhe

së katërti, me të *ardhmen e përparme të së shkuarës: do të kisha punuar do të kisha me punue*, e cila është edhe e njëtrajtshme me të kryerën e kushtores dhe kjo si dhe rasti i parë nuk mbulohej me paskajoren e dytë.

Siç po shihet paskajorja nuk ka ndeshje konkurrimi me trajtat e thjeshta të lidhores, por me ato të dëftores, dhe në rastin e fundit edhe me një trajtë të kushtores.

11) Edhe më për habi dhe për të mos e besuar, madje edhe për të ardhur keq, është mendimi kategorik i një autoriteti tjetër gjuhësor, i cili shprehet "forma *gege në gjuhën standarde po, po jo të tipit të paskajores, e cila do të krijonte një pele - mele, rrëmujë, lesh e l'*" (!). Thamë mos me besue se personat e tillë, me influencë, me një mohim të tillë të prerë, dëshmojnë këmbëkrye, se do të kenë rënë aq thellë në humbellën e *bunkerizimit* nga ndikimi i timit propagandistik disa vjeçar rreth kësaj çështjeje, sa që ndoshta mekanikisht, pavetëdijshëm, vazhdojnë të mbesin jo vetëm me fjalë, por edhe me punë, viktimë e asaj propagande. Dihet fort mirë, siç, deklaroi në një intervistë prof. Idriz Ajeti, se "gjuha standarde nuk është e dhënë si e tillë njëherë e mirë për gjithmonë: zhvillimi i saj nuk ka karakter statik, por ka një karakter dinamik dhe (...) në mirë të përsosjes së gjuhës standarde mund të kërkohej që për ndonjë propozim të debatohet dhe në fund të miratohet përfundimisht" (Shih *Riindja*", 31 dhjetor 2004 f. 11).

12) Edhe kritika që i drejtohet përmbajtjes së Kumtesës së Komisionit të ASHAK-ut, sidomos pikës që ka të bëjë me rehabilitimin e *ndonjë trajte të gegërishtes*, siç është paskajorja, së paku, si *varietet i lirë*, nuk qëndron fare. Personat e tillë gegërishtfolës s'duhet të harrojnë të vërtetën, se pikërisht paskajorja është ajo *çështja*, për të cilën prof. I. Ajeti thotë se është debatuar e po debatohet mjaft gjatë dhe si rrjedhojë i një diskutimi të tillë në *fund propozimi përkatës* mund të miratohet përfundimisht. Nuk dimë ku e marrin atë guxim intelektual e gjuhësor kritikuesit e tillë me u konfrontue me tezat e profesionistëve të atij Komisioni, pa u njohur mirë e më për së afërmi me problemet e caktuara, kur dihet se Kumtesa e tillë do të jetë hartuar dhe publikuar edhe me konsultimin, bekimin si dhe nënshkrimin e gjuhëtarëve më të njohur të truallit tonë, madje ajo është në pajtim edhe me diskutimet nga Konferenca shkencore "Shqipja standarde dhe shoqëria shqiptare sot", Tiranë 2002, ku mbizotëroi, siç e pamë në kreun e parë të këtij punimi, propozim-zgjidhja e mënjëhershme, që përdorimi i paskajores mund të përdoret pa pengesa si variant i lirë e pastaj koha do ta tregojë nevojën për normëzimin e saj, apo jo.



13) Një argument tjetër se gjoja shqipja ashtu si disa gjuhë të Ballkanit, siç janë greqishtja, bullgarishtja, maqedonishtja, rumanishtja e serbishtja (pjesërisht) e ka të zhdukur paskajoren, vërtet del i paqëndrueshëm. Ç'është e vërteta, gjuha shqipe në tërësi, me shikue shtruar, nuk është prekur aq shumë nga dukuria e zhdukjes së paskajores së rindërtuar dhe zëvendësimit të saj me lidhore, prandaj heshtja e një fakti të tillë nuk mund të arsyetojë anashkalimin e paskajores nga norma e letrarishtes së sotme. Ç'është e drejta, për zhdukjen totale të paskajores në gjendjen e sotme të shqipes as që mund të bëhet fjalë. Siç dihet, shqipja përveç paskajores së mirëfilltë analitike me + pjesore që e kishte të normëzuar para treshjetë e sa vjetësh, ajo ka të normëzuar edhe tani paskajoren e dytë që e njeh norma e sotme, andaj konstatimi i mësipërm nga kjo pikë lypset rishikuar. Pra nuk qëndron shkencërisht arsyetimi se gjoja zhdukja e paskajores nga standardi del si proces legal në gjuhën shqipe, vetëm pse, ashtu paska pasë ndodhur edhe në gjuhë të tjera të popujve të Ballkanit(!) dhe një dukuri e tillë e paska pasë prekur edhe një pjesë të një dialekti të gjuhës shqipe(!). Themi kështu se Prof.. I. Ajeti: konstaton se vërtet, në pjesën *toske të gjuhës shqipe* infinitivi është zëvendësuar me konjuktivin, por që *vise-vise paralelisht me këtë haset edhe infinitivi* (Shih: Studime...III f. 190), do me thënë se *vise-vise ndeshet paralelisht edhe infinitivi* dhe kur kemi parasysh përhapjen e infinitiv në viset e tjera, geografikisht e numerikisht shumë herë më të mëdha, kjo formë (paskajorja me + pjesore) del me plotë gojën se meriton të quhet *formë e gjuhës shqipe* e jo karakteristikë e *disa të folmeve gegë*(!).

14) Edhe arsyetimi që dëgjohet nga disa individët të caktuar gegërishtfolës, të cilët e përdorin paskajoren e mirëfilltë në ligjërimin e përditshëm, por jo në gjuhën e shkrimit, ngase, siç thonë ata, tanimë janë mësuar pa të, është i paqëndrueshëm për vetë faktin se, është kërkesë e ligjshme dhe e natyrshme, që gjuha e shkrimit duhet t'i afrohet sa ka mundësi gjuhës së folur, gjuhës së masës së gjerë e jo gjuhës së shkrimit të ndonjë individi që i injoron elementet themelore të gjuhës së masës së vet (!). Individit krijues (shkrimtari, studiuesi), vetëm duke e përpunuar gjuhën e masës, mund t'i afrohet përdoruesit dhe në këtë mënyrë mund ta kryejë misionin dhe të arrijë popullaritetin e dukur e jo duke përfshijtur elementet themelore të saj, ndonëse, dihet se në paraqitje të caktuara është i lejueshëm përdorimi i normës së elitës zyrtare, varësisht nga rrethanat, prandaj krijuesit janë të lirë me futë në përdorim paskajoren ose jo, por kurrsesi nuk duhet ta injorojnë atë. *Ka ardhur koha* shkruan Ledi Shamku, *kur gjithçka lidhet me shqipjen, me të tashmen dhe ardhmerinë e saj, të kapërcjë sinorët akademikë, duke u shndërrua në shumatorë të mendimit*

*evolutiv, të shqetësimit kulturor dhe të ndjeshmërisë qytetare gjithnjë në rritje, sepse, po sipas saj janë dy faktorë që kërkojnë mirëkuptim: afrimi i pozicioneve studiues / përdorues si dhe mjekimi i shqipes me profesionalizëm, ngase në këtë mënyrë jepet ndihmesë "për të hapur shqipen letrare pa fobie paragjykimje dhe për të kryer operacione delikate të hapjes pa rrezikuar në thelb thyerjen e sistemit tërësor të saj"* (Art. i cit. f. 12). Prandaj qëndrimi pasiv i gjuhëtarëve të tillë, sidomos gegërishtfolës ndaj faktorëve të sapocukur, dhe në veçanti ai rreth *shëndoshjes* së normës në fuqi, vërtet, del fare pa kuptim.

15) Edhe arsyetimi tjetër se nëse dikush (nga gegët) do ta përdorte në gjuhën e shkrimit paskajoren e mirëfilltë, do të krijonte reaksion tek toskët, të cilët, siç po thuhet, assesi nuk do ta përdorin atë, prandaj kjo ndasi do të mjaftonte që mos ta kemi një gjuhë të njëzuar, për mendimin tonë është shqetësim fort i pazabazë. Nëse shkruesit gegë e përdorin paskajoren me vend e me rend, sepse ndjejnë nevojë për të, atëherë do t'u mundësohej edhe toskërishtfolësve ta përdorin atë pa vështirësi, së paku për hir të realitetit e rrethanave që diktojnë. Studiuesi tiranas Shpëtim Këlmendi me konstatimin se "*edhe jugorët që banojnë në Tiranë po e përdorin tashmë gjerësisht paskajoren*" (Shih Java, 9.02.20056, f. 26. na jep për ta kuptuar të vërtetën e jetësisë dhe të gjallërisë së paskajores, që përkundër ndalesës institucionale ajo në mënyrë të kulturuar, pa farë dirigjimi, del e pranuar edhe nga toskërishtfolësit e caktuar. Fundi i fundit, sido që të jetë, ne nuk njohim asnjë krijues toskë, madje as ndonjë gazetar të mirë ose politikan me perspektivë, që do ta injoronte me aq fanatizëm paskajoren si po bëjnë disa vetëmohues gegë. Në të vërtetë, nuk besojmë se mund të jetë ndonjë person toskë i formuar intelektualisht e njerëzishit dhe që ka marrëdhënie me gegët ose që merret me punë të përbashkët me ta që mos ta përvetësonte paskajoren në rast se konteksti ia imponon të nevojshme, ngase edhe me atë formë çdo shqipfolës, çdo krijues, madje çdo individ, do ta ndjente veten më të pasur dhe sigurisht më me identitetit shqiptari dhe gjithsesi edhe më të kompletuar intelektualisht.

16) Dikush po e hedh parullën demagogjike se edhe të gjuhët e njohura të Europës (frëngjishtja, italishtja etj.) duket një prirje që më fort të përdoret lidhorea se paskajorja. Prirje mbase mund të ketë, por zhdukje të paskajores assesi nuk mund të ketë kurrën e kurrës në ato gjuhë. Këtë e themi me bindje të plotë, ngase s' mund të zhduket tërë historia e gjuhëve, të gjalla përkatëse, sidomos kur është fjala te nënfushat e caktuara semantike, ashtu si edhe i kemi cekur që vlejnjë edhe për gjuhën shqipe, siç janë: funksioni përfaqësor, involvimi i saj brenda thënieve të caktuara lapidare (frazeologjike), lënda e

skalitur në sferën letraro-artistike, madje as përdorimi i saj në fushën e sinonimisë etj. Prandaj arsyetimi i tillë demagogjik nuk i përgjigjet realitetit dhe s' mund të merret si arsyetim për mosaktivizimin e paskajores në shqipen standarde.

17) Po dëgjoen edhe mendime se ndryshime, plotësime të normës mund të bëhen vetëm me konsensus të plotë të të gjithë pjesëmarrësve në komisionet përkatëse, andaj, nëse një anëtar nuk do të pajtohej, qoftë edhe pa ndonjë arsye, atëherë paskajorja nuk do të inkudrohej në normën standarde! Një konstatim i tillë vetvetiu tingëllon si një politikë e mbrapshtë e së kaluarës moniste. Lidhur me çështjen në diskutim s' është i nevojshëm kurrfarë konsensusi, ngase një kusht i tillë mund të jetë fort pengues, përçarës, primitiv dhe i pakuptimtë. Kur është fjala të kërkesa e drejtë e bazuar në ligjësi, s' ka nevojë të kërkohet konsensus. Konsensusi mund të zbatohet mbase për çështje drejtshkrimore e ku ta dimë, por jo për gjëra kaq madhore. E drejta e gjuhës me paskajore asesi nuk mund të mohohet, ngase është e drejtë historike, e drejtë etnogeografike dhe e drejtë etike-komunikuese e bashkësisë disa milionshe që jetojnë në trojet e veta, qoftë brenda, qoftë jashtë Shqipërisë së sotme administrative dhe presin realisht që me *vendin amë dhe ndërmjet tyre* mos me pasë më vijë të zezë kufidarëse.

18) Fatkeqësisht, ka mendime që paskajorja, të cilësohet si një pykë që do të çante, gjoja, sajesisn: *gjuhë e sotme letrare*, e cila është njëzuar aq harmonishëm me elemente të toskërishtes e të gegërishtes, sa që me një pykëzim të tillë do të bëhej copë e grimë! Edhe ky absurditet nuk mund të durohet dot më nga askush. Nuk duam të diskutojmë sa është i vërtetë, apo jo, fakti që po përfilltet se toskërishtja ka marrë nga gegërishtja vetëm aq sa i është dashur asaj për ta standardizuar vetveten, prandaj për elemente të tjera tani s' do t' ia dijë?! Ne, pa hyrë në polemika *fjalamujtëse me syleshët e truqepurit* (sajesa të Ardian Klosit), paskajoren nuk e shohim si pykë përçarëse, përkundrazi, ne e shohim si një ilaç relaksues për të gjithë, edhe për *kokëbetonët* (sajesisë e Robert Shvarcit) në radhë të parë gegërishtfolës që ndeshen ende në poste kyçe, qoftë mbase edhe në kabinetet e Qendrës ose në redaksitë e instituteve të caktuara profesionale botuese, të mediave etj. Me një qëndrim të tillë ata kanë penguar e po pengojnë jashtzakonisht shumë edhe sot e gjithë ditën, që çështja në fjalë, *si problemi më madhor i shqipes standarde (M. Çeliku)*, të mos marrë zgjidhje të duhur, të shpejtë dhe të drejtë.

19) Edhe planëzuesit e sotëm të politikës gjuhësore bëjnë gafe të ngjashme, kur shprehin dyshim, siç mund të shprehemi figurativisht, se po u lejua të

rrjedhë lirshëm rubineti i paskajores, atëherë do të *ngulfytej* (bllokohej) turbina e liqenit akumulues të toskërishtes dhe me një veprim të tillë do të vërshhej tërë shqipja standarde me gegizma të panormëzuar. Ne mendojmë se tanimë një rubinet i tillë mund të quhet i hapur dhe vërshimi i tillë, ta quajmë edhe ne ashtu, gjithnjë e më shumë po e bën të veten, por norma e shqipes standarde nuk u trand dhe as që ndjeu ndonjëfarë tronditje fatale turbulluese që do t' i sillte *ngulfytje* me pasoja aq të rënda sa mendohej nga skeptikët. Ka mjaft prova që vërtetojnë se rrjedha e rubinetit të paskajores bashkë me lëfytet e tjera në ujën e akumuluar të liqenit të tillë të gjuhës letrare shqipe, do të shtojnë cilësinë e kthjellësisë, do të mbushin edhe më përplot basenet dhe kështu do t' u japin fuqi më të madhe hidrocentraleve për me ushqye më mirë poçet e mendjeve të studiuesve e intelektualëve, kudo që ndodhen ata e sidomos të atyre që punojnë në vatrat e normës së shqipes standarde. Madje në këtu rrethana jemi të bindur se edhe toskërishtfolëse dashamirës të gjuhës së njëzuar të etshëm për dritë do t' u bëhej shërbim më i mirë, më i nevojshëm dhe i domosdoshëm. Gjithsesi gjithkuj do të shtoej dritëpamje më e madhe, ngase kemi bindje të plotë se kur është në pyetje dhe të kuptohet si duhet interesi i përgjithshëm kombëtar, si vlonjati, korçari, permetari e gjithandej mbarë Toskëria, do të jenë më të lumtur, kur gjuha letrare kombëtare do të bëhej më e lehtëpranueshme edhe për tiranasit, elbasanasit, durrësakët e gjithkëndej për kukësjanët e shkodoranët, por njëherazi do të jenë edhe më të kënaqur, kur dihet se me paskajoren do të joshen, veç tjerash edhe shpirtërisht, edhe shqiptarët e trevave jashtë kufijve të Shqipërisë së sotme administrative, të cilët kanë luftuar dhe luftojnë, madje edhe me vetëmohim e me shumë sakrifica, vetëm e vetëm ta kenë gjuhën e njëzuar të përbahkët me *vendin amë*, Shqipërinë. Dhe, siç dihet, ata nuk janë pak. Le të rikujtohen këtë rast banorët e Kosovës, të Luginës së Preshevës e gjithandej në Serbi, viset shqiptare të Malit të Zi si dhe viset shqiptare të Maqedonisë, të cilët që nga lindja e kanë të ravijëzuar paskajoren në sistemin e tyre ligjërimor të trashëguar *den baba den*.

20) Edhe arsyetimi se gjoja në disa vepra të shkrimtarëve toskë që mbahen për mostër gjuhë(!), edhe pse nuk është ashtu, si të L. Poradecit, F. S. Nolit, e ku ta dimë, nuk ndeshet paskajorja, nuk është kurrfarë argumenti relevant. Në të vërtetë, edhe pse ne nuk do të befashoheshim që në veprat e Mitrush Kutelit, J. Xoxës, I. Kadaresë, D. Agollit etj., shkrimtarë nga Jugu, të mos përdorej fare paskajorja, megjithatë ata, siç dihet, në opusin e krijimeve të tyre, kanë gjetur raste (ndonëse jo sa do të duhej) që ta fusin në përdorin pikërisht edhe paskajoren gege (të përjashtuar nga standardi). Përkundrazi, për ne do të dilte



befasues dhe i papranueshëm fakti, nëse, bie fjala, në shkrimet e Martin Camajit, të Esad Mekulit, të Hevzi Nelësi, të Sabri Hamitit, Visar Zhitit, Pjetër Arbnorit, Nazmi Rrahmanit e të tjerëve, të mos e ndeshim paskajoren edhe në ato raste kur trajtojnë tema nga Veriu. Mungesa e një trajte të tillë, në veprat e shkrimtarëve që trajtojnë jetën tipike të veriorëve, për mendimin tonë, do të konsiderohej si gabim i rëndë. Gabime të tilla mjerisht ndeshin, si me thënë, për çdo ditë edhe në disa reportazhe të gazetareve tanë ende të papërvojë, si andej, si këndej, të cilët, mund të konsiderohen si viktimë e keqkuptimit të normës, sepse pragmatikisht e stilistikisht s'ka normë që mund ta përjashtojë gjuhën e trevave të caktuara të personave (personazheve) që pasqyrojnë realitetin e tillë gjuhësor. Në këtë kontekst, duhet kuptuar e vërteta, se nuk është i ndaluar përpunimi i gjuhës varësisht nga stilit përkatës në tipizime, por edhe këtu lypset masë. Është mjeshtri e detyrë e krijuesit që të thithë e përthithë nektarin e karakteristikave themelore të realitetit gjuhësor të trevave të caktuara, varësisht nga tema që e ka në shqyrtim.

21) Edhe një argument tjetër që po thuhet nga refuzuesit se gjoja me kërkesën për inkuadrimin e paskajores në cenojmë dinjitetin gjuhësor jo vetëm të E. Çabejt, A. Kostallarit (toskë), por edhe të K. Cipos, M. Domit, Jup Kasttratit (gegë) etj. në praninë dhe bekimin e të cilëve që mënjanoar paskajorja, nuk është i qëndrueshëm aspak. Me thënë të vërtetën, asnjëri prej tyre nuk e ka trajtuar paskajoren e vlerat e saj si rast të veçantë në rrafshin sinkronik, pa ndërlidhur me paradigmat e sistemit foljor të gegërishtes, në raport me normën standarde. Me sa dimë, ata të gjithë ishin *en bloc* për një gjuhë letrare të njësuar shqipe dhe atë e arritën me e kurorëzue me sukses, me të mirat, por edhe me ndonjë pikë të diskutueshme që ka mbetur, por që ka mundësi të përmirësohet nga të tjerët. Jam i sigurt se po të ishin sot, sidomos A. Kostallari do ta bekonin pa rezervë edhe paskajoren në kuadër të shqipes standarde. Këtë po e themi me bindje e përgjegjësi të plotë, ngase, si student në studimet pasuniversitare, kemi pasur rast t'i pyesnim, profesorët e nderuar, pikërisht për këtë çështje dhe të dëgjonim mendimet e tyre, të cilat paksa i kemi bërë të njohura publikisht (Shih: Paskajorja ... f. 60, 92), po kjo nuk do të thotë se nga  $\frac{1}{4}$  e përgjegjësisë për asgjësimin e paskajores geqe, mund të shkarkohet prof. Çabej, siç e thotë Ardian Klosi (Shih gazeta *Shekulli* dhe *K. ditore*, 18.I.06 f. 13), madje një përgjegjësi të tillë në përqindje edhe më të madhe për këtë punë, mund të themi me plot gojë e kishin edhe prof. M. Domi e sidomos A. Kostallari. Prof. M. Domi na pati thënë se paskajoren geqe e kemi lënë në hije e nuk e kemi asgjësuar (!). Sido që të jetë, vërtet përgjegjësia u takon, por edhe të tjerëve që

nuk patën guxim ose nuk e panë të arsyeshme të reagonin, në kohën e duhur, për këtë pikë, me argumente, që nuk i kishin të panjohura.

22) Edhe droja e shprehur nga ndonjë individ se gjoja me kërkesën për inkuadrimin e paskajores, mos vallë, mund të luhatet keqas uniteti politik e kulturor i shqiptarëve i arritur me njëzimin e shqipes standarde pa këtë formë, nuk ka bazë reale. Në të vërtetë, ne mendojmë dhe kemi bindjen se një inkuadrim i tillë pa dyshim do ta bënte edhe më cilësor atë unitet. Vetvetiu, me inkuadrimin e paskajores në standard, kërkesa për ringjalljen e gegërishtes si gjuhë paralele a rivale zyrtare, duke zënë si shkas pikërisht mungesën e paskajores, do të pushonte ose do të ishte e shprehur më me butësi dhe më me mirëkuptim, ngase atëherë, rivalëzimi nga çdo palë do të dilte, vërtet, i pakuptimtë. Lidhur me këtë janë dhënë mjaft arsytetime në pikat e mësipërme, prandaj nuk e shohim të arsyeshme të ripërmendim a të riparafranojmë në mënyrë të veçantë ndo-njërin nga faktet e sipërcelura.

23) Gjithashtu edhe arsytimi me vërejtje-kërcënim se propozimi për inkuadrimin e paskajores, është aq *shkelje e rëndë e etikës gjuhësore*, saqë jo vetëm do të bojkotohet propozuesi nga refuzuesit në poste kyçe, por do të etiketohet si një varmihës i normës së njësuar letrare dhe do të ketë edhe pasoja të tjera të pa parashikueshme, ne do ta quanim veprim jo të drejtë dhe fort primitiv, edhe pse pasojat e tilla i kemi ndjerë jo pak edhe ne me mosbotimin e dorëshkrimeve tona etj. Edhe ky fakt tregon sa vështirë është, që në shoqërinë jo demokratike, të preken temat tabu, siç është norma e sotme letrare në fuqi edhe kur kërkohet konkretisht jo përmbysja, po përplotësimi a përmirësimi i saj! Për hir të së vërtetës duhet të jemi të gatshëm me u ballafaqo edhe me pasoja e masa të ndryshme primitive.

24) Për ndonjë vetmohues gegërishtfolës, i cili ende nuk bashkohet me ata (gjuhëtarët gegë e të tjerë) që ndejnë dhembje si shumica e shqipfolësve veriorë për sakrificimin pa nevojë të paskajores, kemi një këshillë - porosi kolegjale: le ta studiojë më në hollësi dhe thellësi këtë çështje, sepse

së pari, zëvendësimi i konceptit të paskajores së mirëfilltë nuk bëhet, siç e thotë dikush, **me të tashmen e lidhoret me pjesëzen do: do të punoj**, sepse, po e theksojmë "*pjesëza do shërben për të formuar trajtat e kohës së ardhme të mënyrës dëftore (e ardhmja, e ardhmja e së shkuarës, e ardhmja e përparme dhe e ardhmja e përparme e së shkuarës) dhe të mënyrës kushtore (e tashmja dhe e kryera), por me forma e elemente të tjera, madje jo plotësisht, siç është sqaruar edhe në këtë punim. Është tjetër gjë, nëse trajta e lidhoret del e involvuar në fjalëndërtimin e trajtave të caktuara të mënyrave të tjera,*



madje është fakt se pikërisht pjesëza do prirret të elidojë pjesëzën të karakter-istike të lidhore në kohët e sapocëkura: do punoj, do punoja, do kem punuar nga kisha punuar, jo në të folmet e gegërishtes, po në të folmet e toskërishtes (shqipës standarde);

së dyti, le të dihet më mirë se paskajorja a "prapavendosja" e saj, nuk e pengon mbarëvajtjen e gjuhës letrare, përkundrazi inkuadrimi i saj në standard do të shmangte shumë përdorime të gabuara, qoftë nga zhvillimet e brendshme të "vetvetishme", qoftë nga fryma e sintaksës së huaj dhe do të shërbente vërtet si një "element lehtësues" në komunikimin mbarëshqiptar;

së treti, mbasi dihet fort mirë se gjuha (norma standarde) domosdo është e hapur, zhvillohet pandërprerë, madje edhe pasurohet edhe me shtimin e mjeteve të ndryshme gjuhësore, e në këtë kuadër edhe me "shtimin e përdorimit të ndërtimeve me forma të pashtjelluara" etj. etj., atëherë studiuesi përkatës në vend që të bëhet vetmohues, do të bënte mirë që t'i rishikonte dhe korrigjonte disa konstatime të veta që i ka pranuar si të arrira nga të tjerët, pa u bërë vetë verifikimin e duhur paraprakisht, të cilat koha e sotme objektivisht i ka bërë shumë të diskutueshme ose të paqëndrueshme.

25) Së fundi, ka mendime se me një kërkesë të tillë rreth integritit të paskajores gjoja ne po topisim veprimtarinë e miqve të gjuhës shqipe si dhe shoqatave përkatëse që punojnë pastrur në mbrojtjen e normës së shqipes së sotme. Ne mendojmë të kundërtën. Nëse shprehet frikë nga ballfaqimi me çështjen e paskajores, atëherë mund të shtohet dyshimi, siç u tha më sipër, se aty, vallë, mos fshehet ndonjë padrejtësi?! Andaj, pikërisht inkuadrimi i paskajores në normën e shqipes standarde, duke sqaruar gjërat, do të ndihmonte punën e shoqatave e të miqve të gjuhës shqipe, sepse me përqafimin e një formë të tillë në konkurrencë lojale do të *ngritej* më lartë prestigji i normës standarde dhe njëherazi do të rritej motivimi që një normë e tillë të mësohet edhe më me dëshirë e vullnet të shtuar. S' do mend se edhe shoqatave e caktuara si dhe miqt e dashamirët e shqipes standarde do të kenë më shumë sukses, nëse *popullit shumicë* që përfaqësojnë, pa e rrezikuar fare *popullin pakicë*?, ia bëjnë më të lehtë përvetësimin e gjuhës zyrtare, me inkuadrimin e paskajores në normën standarde.

Nga kreu këto që u thanë në këto 25 pika, duke mos përfshijtur edhe fakte të tjera që janë përmendur gjatë shtjellimit edhe të këtij punimi, por edhe të tjera, që i mbajmë si rezervë në kujtesë, lind pyetja: Si shpjegohet, atëherë, qëndrimi jo i drejtë i studiuesve të tillë gegërishtfolës ndaj paskajores, sidomos tani, kur e vërteta po del sheshazi dhe po kuptohet gjithnjë e më qartë?!

Është i njohur fakti se nga sugjestionimi i fortë mund të bëhet shpërlarje turr. Pikëpamja mund të doktrinohet a të shndërrohet në botëkuptim. Megjithatë edhe botëkuptimi mund të revidohet, por me shumë vështirësi. Nuk thuhet kot: një shprehje një vështirësi një çshprehje dhjetë vështirësi. Ç'është e drejta, ne do të dëshironim që ndërkohe mospërfillësit e paskajores me + pjesore, sidomos gjuhëtarët tanë gegërishtfolës, do të kenë gjetur forcë për të ndryshuar qëndrimet e tyre dhe këtë do ta kenë bërë për hir të trysnisë së brendshme intelektuale, por edhe për respekt të realitetit objektiv shkencor, madje edhe për hir të interesit të përgjithshëm kombëtar. Nuk do të dëshironim që ndonjëri nga këta të mbetet, edhe më, viktimë fare e panevojshme e një praktike të ngallmuar dikur me kryq korrektes të ndonjë joprofesionisti të gjuhës në faza të caktuara të përmjegullta të historisë, kur mbizotëronte praktika e zgjidhjeve dhe e veprimeve dirigjiste, vërtet, *alla partizançe*(!).

Gjithsesi me pranimin e paskajores me + pjesore, ku nënkuptohet edhe pjesorja e shkurtër, në gjirin e vet, shqipja standarde do të bëhet më e pasur dhe më e fortë, natyrisht edhe më për zemër për të gjithë shqiptarët, ngase çdo shqipfolës me të, do të bëhet më i pasur gjuhësisht dhe do të ketë mundësi më të mëdha me shprehë, jo vetëm thënie të barasvlershme sinonimike, e shpreheje me nuanca stilistike, por edhe koncepte të ndryshme semantike të pambuluara plotësisht me trajta të tjera. E thamë *ka mundësi*, se fundi i fundit ihtarë e letrarishtes së sotme as që janë të detyruar me i futë me zor në sistemin e tyre ligjërimor e aq më tepër në atë shkrimor, trajtat me paskajore, por, në anën tjetër ata ndërgjegjësisht duhet ta fitojnë bindjen se nuk duhet as t'i frenojnë ose t'i nënçmojnë shprehjet e tilla të përdorura me vend nga të tjerët. Sigurisht të pajisur edhe me këtë formë studiuesit dhe shippërdoruesit, siç u tha, do të jenë më të pasur gjuhësisht, por edhe do ta kenë më lehtë të ballafaqohen me sfidat që u dalin në raporte komunikimi edhe me gjuhët e caktuara evropiane e të tjera, të cilat e kanë këtë formë, e cila ka barasvlerësi të plotë me paskajoren me + pjesore të gjuhës sonë e jo me paskajoren e dytë.

Fundi i fundit, me një inkuadrim të tillë, qoftë edhe si një variant i lirë, do të shpëtonin me fytyrë (të paskuqur) mjaft intelektualë tanë, madje profesorë e akademikë, të cilëve pa dashtas po u shpëtojnë trajta të paskajores në paraqitje të caktuara zyrtare. Me fjalë të tjera, dikush po skuqet (pa nevojë) dhe po e ndjen veten inferior, pse po e përdor paskajoren padashtas, e nuk po çan kokën, për lajhtitje të rënda (kujto shfaqjet devijuese) të shkakutara nga mënjanimi arbitrar i saj!?

Si përfundim, po e themi me plotë gojë: *është fat që gjuha shqipe ka tashmë një gjuhë të përbashkët letrare të njësuar, të mbështetur nga tri shtyllat kryesore themelore të institucionalizuara, që janë: drejtshkrimi, gramatika dhe fjalori përshkrues normativ, por shqipja është edhe më me fat të bardhë që e ka edhe paskajoren e mirëfilltë, të cilën nëse e fut nën krahët e saj, sigurisht standardi kombëtar, do ta bëjë sforcimin e krahut të djathtë të tij, ngase do të ketë edhe më shumë ogurbardhësi, dhe tri shtyllat themelore të veta do të ketë mundësi që t'i plotësojë e përsosë dhe t'i kompletojë me material të rinuar nga burimet e truallit të vet, prandaj po e përmbylim këtë punim me konstatimin që dihet se standardologët tanë gjithësesi nga emërtimi i vendit të punës dhe postin që e gëzojnë, kanë detyrim që një dorë mendije ta mbajnë në ruajtjen e standardit të sanksionuar, por dorën tjetër, patjetër duhet ta përdorin për hapjen e shtigjeve për pasurimin, përplotësimin e përsosjen e atij standardi me vlera të reja, ngase vetëm në këtë mënyrë ai standard do të jetë ndërgjegjësishëm në pranueshëm, politikisht më i përqafoeshëm dhe kombëtarisht më i integrueshëm dhe kështu e vetëm kështu letrarishtja e tillë meriton të quhet: *normë e qëndrueshme e shqipes standarde mbarëkombëtare*.*

Për mendimin tonë, është bërë një lëshim me pasoja, pse në Konferencën shkencore "Gjuha standade shqipe dhe shoqëria shqiptare sot", Tiranë (2002), nuk është futur në konkluzionin me shkrim, së paku, si pikë e veçantë, ashtu siç nënkuptohet nga diskutimet nga ai tubim ku dilte jo i qortueshëm përdorimi i paskajores me + pjesore, hë për hë, si variant i lirë, ngase një konkluzion i tillë do të kishte nxitur jo vetëm diskutime serioze të niveluara, për mbase edhe kundër, por në fund të fundit, kishte me i dhënë orientim të drejtë çështjes, duke nxitur kuadrat përkatës, të cilët deri tash do t'i kishin formuluar edhe rregullat se kur e ku mund të jetë e lirë dhe ku ka si detyrim me u përdorë në standard një formë a mënyrë e tillë.

Me një veprim të tillë, d.m.th., me përshirjen institucionale në standard të tërë thesarit leksiko-frazologjik ndërthurur edhe me paskajore - pjesoren karakteristike gege nuk do të pasurohej e përsosje vetëm norma, por do të ndihmohej cilësorisht integrimi faktik shpirtëror mbarëkombëtar si dhe do të pasqyrohej më dinjitetshëm një pjekuri admiruese shoqërore - politike e popullit tonë. Për këtë duhet të jemi të sigurt.

## P ë r m b y l l j e

Në përmbyllje të punimit e shohim të arsyeshme të ndalemi shkurtimisht në ritheksimin e katër çështjeve, siç janë: e para, grupimi i gjuhëtarëve sipas pikëpamjes së tyre rreth zgjidhjes së paskajores me + pjesore, e dyta, konstatimet si përgjigje në pyetjet e shtruara në krerët përkatës të këtij punimi, e treta, opinioni përmbledhës a përsiatje rreth dobisë së normëzimit të paskajores me + pjesore në standard dhe e katërta, përfundimi me theksim të risimeve më të dalluara që dolën nga kjo analizë sipas krerëve përkatës.

### 1. Rreth qëndrimit të gjuhëtarëve

Nga këndvështrimi ynë lidhur me zgjidhjen e çështjes së paskajores në raport me normën e shqipes standarde mund të dallohen pesë opinione a grupe gjuhëtarësh e intelektualësh:

Grupin e parë e përbëjnë disa gjuhëtarë dikur uniformë, tani gjithnjë në numër më të paktë, të cilët ende mbrojnë atë qëndrimin, si me thënë, alla partizanë, se paskajorja me + pjesore duhet zhdukur nga përdorimi, jo vetëm në gjuhën letrare, por përgjithësisht, deri edhe në sferën letraro-artistike, ngase nocionet e saj i mbuluaka tërësisht lidhorja. Pra, kërkohet atëherë e dëshirohet edhe sot që kjo formë të shpallet e paqenë për standardin.

Grupi i dytë i gjuhëtarëve dhe intelektualëve dallon nga i pari, ngase nuk e mohojnë përdorimin e paskajores në arenën verior, por mbesin, gjithësesi, në pozita mbrojtëse të normës pa këtë formë, ngase nocionet e paskajores përveç lidhore i mbuluaka funksionalisht edhe paskajorja e dytë, tipi me *për të ...* Këta gjuhëtarë nuk e shohin të nevojshëm inkuadrimin e paskajores në standard, por nuk janë as kundër përdorimit të saj në nënstandardin e gegërishtes.

Grupi i tretë i gjuhëtarëve dhe intelektualëve dallon nga dy grupet e para për tolerancë, ngase pa mohuar mbulimin sinonimik të nocioneve të paskajores me + pjesore nga lidhorja, paskajorja e dytë dhe forma të tjera, nuk janë kundër përdorimit të saj në standard, për nënfusha të caktuara semantike, por atë përdorim e tolerojnë vetëm si *variant të lirë*, d.m.th., pa e përshirë, hë për hë,



në planëzim normëzues, me arsyetimin se, gjoja, një element i tillë nuk ka ende përdorim të mjaftueshëm a shtrirje të gjerë në ligjërimin standard ((1)), prandaj ia lënë kohës që ajo ta bëjë punën e saj, e pastaj, nëse tregohet e nevojshme, mund të futet në planëzimin standard. Pra, nuk janë as për përjashtimin e saj nga standardi as për futjen e saj, hë për hë, në standard.

Grupi i katërt, dallon nga i treti, sepse këta gjuhëtarë i kategorizon guximi bashkuar me kompetencën shkencore, siç do të thoshte prof. Egerem Çabej, andaj këta pa zvarritje e bëjnë menjëherë inkuadrimin e paskajores me + pjesore të shkurtër në shkrimet e tyre që e ndjekin normën, duke i dalluar këto nënfusha semantike, që janë: *përfaqësimi, thënie frazeologjike të një abstraksioni të lartë, sfera letraro-artistike dhe sinonimia*, nënfusha këto, të cilat logjikisht, pragmatikisht dhe stilistikisht nuk dalin të diskutueshme. Pra, siç veprojnë edhe vetë, rekomandojnë futjen e mënjehershme të paskajores në standard, por si rast të veçantë, d.m.th., pa e ndërlikuar, domosdo, me paradigmat e strukturës foljore mbi bazë të gegërishtes.

Grupi i pestë i gjuhëtarëve dhe intelektualëve zgjidhjen e paskajores e praktikojnë sikur grupi i katërt, por shkojnë edhe më tej. I tharët e këtij grupi po e përdorin aq lirshëm paskajoren, sa që nuk e ndajnë fare nga sintagmat e paradigmat e gegërishtes, dhe në këtë mënyrë cysin, jo pa efekt, ringjalljen a përpunimin e normës së ish-shqipes letrare në bazë të gegërishtes, ku paskajorja konsiderohej me të të drejtë, si një shtyllë kurriore e asaj strukture. Pra ky grup, duke shfrytëzuar refuzimin e paskajores në standard, merr si pretekst edhe vlerat e saj dhe i jep udhë lirie të pavarur gegërishtes letrare.

## 2. Përgjigjet shkurt në pyetjet e shtruara në titujt e krerëve përkatës

Lidhur me pyetjet e shtruara në dhjetë krerët përkatës të këtij punimi do të përpiqemi të përgjigjemi shkurt në këto dhjetë pika:

Së pari, ka, apo jo, ndryshim qëndrimi rreth integritit të paskajores me + pjesore në shqipen standarde, mundemi me thënë, ka, madje pikërisht është një pjesë e caktuar gjuhëtarësh, të cilët edhe pse ishin disenjues dhe nënshkrues të deklaratës së Kongresit të Drejtshkrimit të vitit 1972, kanë ndryshuar qëndrim dhe ky fakt gëzon. Madje nga goja e tyre doli se nuk janë kundër që paskajorja të përdoret si *variant i lirë* e pastaj me kohë mund të bëhet edhe

përfshirja e saj në standard, por ndonjëri prej tyre ende ka mbetur në pozicione të vjetra, d.m.th., për mospërfilljen e paskajores.

Së dyti, shprehet rezervë rreth vetëmjaftueshmërisë për zëvendësimin e paskajores me + pjesore, qoftë me format e lidhore, qoftë me atë të paskajores së dytë. Në realitet nga analiza del se asnjëra nga këto dy forma nuk mund ta zëvendësojë, vetëmpërvetëm, as mjaftueshëm tërë nocionin e paskajores me + pjesore në shqipe, madje as të dyja bashkë, ngase nocioni i paskajores paraqitet më i gjerë, andaj edhe ka sinonimi më të gjerë e të harmonishme edhe me komponente të tjera gjuhësore.

Së treti, drejtohet gjithi në disa kundërtënie serioze ndaj realitetit, sidomos rreth propozim-zgjidhjes së ofruar që paskajorja e dytë, për të gjitha nocionet ta zëvendësojë paskajoren e mirëfilltë në të ardhmen(!), kundërtënie këto që janë të stërmëshura me paqëndrueshmeri parimore e lëndore, prandaj kërkohet më tepër mirëkuptimi e tolerancë rreth raportit *paskajore e mirëfilltë / paskajore e dytë dhe formave të tjera sinonimike*, me synimin që të përkrahet inkuadrimi i paskajores së mirëfilltë, ngase një veprim i tillë do t'i sillte vetëm të mira standardit të sotëm, i cili gjithsesi duhet të përplotësohet në të gjitha rrafshet kryesore të tij, pra, edhe me formën e paskajores me+pjesore, pa e atakuar seriozisht bazën e vet.

Së katërti, rekomandimi që vlerat e paskajores t'i përcillen ose t'i lihen në përdorim vetëm dialektit të gegërishtes, por jo shqipes standarde, në analizë del si një praktikë jo e drejtë dhe jo frytdhënëse, madje mund të cilësohet edhe si një veprim i dëmshëm për mbarëvajtjen e shqipes standarde mbarëkombëtare, andaj duke kundërshtuar praktikën e tillë tash e pesë dekada, njëherazi arsyetohet qëndrimi për përfshirjen e domosdoshme të paskajores me + pjesore në normën e shqipes standarde, siç janë edhe frazeologjizmat e shprehjet e tjera me vlerë të pajisura edhe me këtë formë, ngase ajo (paskajorja) realisht është duke bashkëjetuar mjaft harmonishëm me pjesët e tjera sinonimike në gjuhën e masës shumicë.

Së pesti, për të parën herë paksa më tejdukshëm se asnjëherë më parë, vihet në pah funksioni përfaqësues i paskajores me + pjesore. Pikërisht në këtë pikë del raporti *paskajore/mënyra dëftore dhe* në veçanti dalin reagimet e gjuhëtarëve dhe të intelektualëve të caktuar, të cilët duke ia cilësuar si të metë standardit të sotëm mospërfshirjen e paskajores në planin përfaqësuesor e përmbajtësor, shprehin njëherazi nevojën dhe arsyeshmërinë për inkuadrimin e saj në normën e shqipes standarde.



Së gjashti, në sistemin fjalëformues të shqipes letrare *pjesorja e shkurtër*, ndonëse e mënjeluar nga norma e shqipes së sotme letrare, si me thënë, *zbulohet si patent-zgjidhje* ekzistuese plotësuere edhe për çështjen e paskajores me + pjesore. Fakt ky, i cili pamohueshëm ndihmon në përkapjen më me lehtësi të zgjidhjes së çështjes në shqyrtim. Pikërisht është fjala për *rregullën e formimit të emrave prejpjesorë të vepruesit* dhe të prejpjesorëve të tjerë, sipas tipave të foljeve përkatëse, ngase pjesorja e shkurtër zakonisht shërben si temë prodhuese dhe kjo ilustron me skemën përkatëse si dhe me rregullat e caktuara fjalëformuese që dalin mbi këtë bazë, rregulla këto të sanksionuara edhe në burimet leksikografike të shqipes së sotme letrare. Ndonëse sipas këtij rregulli pjesorja e shkurtër e gegërishtes del me përparësi të dukshme, megjithatë në disa tipa të foljeve, siç janë ato me -r e -rë edhe pjesorja e letrarishtes (toskërishtes) shërben si temë prodhuese për formimin e prejpjesorëve përkatës. Pra, në këtë kuadër, sidoqoftë, ofrohet zgjidhje lehtësuere rreth trajtës së pjesores, si pjesë përbërëse e paskajores me **me**, e cila, si të thuash, ashtu e shkurtër del mbizotëruese dhe ka si me thënë, mëkimin nga vetë struktura fjalëformuese dhe leksikografike e shqipes standarde.

Së shtati, për të dhënë përgjigje të duhur se sa priret evolutivisht shkurtimi i pjesores së letrarishtes në raport me shtytësit e një veprimi të tillë, u trajtua mjaft shtruar raporti i pjesores së letrarishtes ndaj pjesoreve të gegërishtes, pastaj u panë edhe trajta përkatëse të pjesores të involvuar në sistemin fjalëndërtes (fjalëformues, kohëformues e formëformues) si dhe implikimi i saj edhe në raportin përkatës: *format infinitivale / paskajore*.

Së teti, në mënyrë të veçantë u cekën disa nga veçoritë specifike të paskajores së mirëfilltë, në gjuhën shqipe në rrafshin horizontal, që vërtet del si një risim në gjuhësinë tonë, ngase, me sa dimë, deri më tani, këto veçori specifike, në asnjë burim normativ të deritashëm, nuk dalin të trajtuara kaq hollësisht.

Së nënti, pyetja që pjesorja e shkurtër geqe, a mundet me shërbye një *siçelës magjik* potencial, apo jo, për konsolidimin dhe zgjidhjen e disa çështjeve të hapura të sistemit foljor të shqipes, siç është edhe paskajorja me **me**, nga analiza del me përgjigje pozitive. Kjo përgjigje vjen pasi merren në konsideratë shtytësit kryesorë me ndikim rreth kësaj dukurie, siç janë: 1) pjesorja e shkurtër e pranuar në standard për ndonjë tip foljesh, 2) pjesorja si temë fjalëformuese, 3) pjesorja si segment i domosdoshëm organik i paskajores me **me**, 4) pjesorja e shkurtër aktualisht në përdorim nga shumica shqipfolëse, 5) kujtesa kolektive ende e gjallë ndaj ish-shqipes letrare, kur pjesorja e shkurtër ishte e normëzuar si dhe 6) përputhshmëria me dukurinë e thjeshtësimi (evoluimit), përkatësisht

të ekonomimit gjuhësor me anë të shkurtimit të trajtave për lehtësi shqiptimi etj.

Nga përthellimi i mëtejme lidhur me pjesoren rezultoi se, vërtet, pjesorja e shkurtër, del një *siçelës magjik potencial*, i cili ndihmon gjithësesi në konsolidimin dhe në zgjidhjen e çështjeve të hapura të sistemit foljor të shqipes dhe shtron nevojën për një qëndrim më tolerues rreth trajtës së shkurtër (geqe) në përgjithësi, e cila me prapashtesën e evoluar zero ose me prapashtesën inovuese -ë, jo vetëm lehtëson inkuadrimin e *paskajores me pjesore të shkurtër* në normë pa pengesa, por ndihmon edhe për zgjidhjen e ndonjë çështjeje tjetër problemore nga nënfusha semantike, fjalëformuese etj. Në të mirë të kësaj pririjeje a shfaqjeje evolutive (rreth pjesores së shkurtër) si në fjalëformim ashtu edhe në leksikografi, në punim u ekspozuan mjaft fakte me shembuj konkretë, prandaj mendohet që çështja e inkuadrimit të paskajores në standard duhet bërë sa më parë institucionalisht, sepse do të jetë në të mirë edhe të vetë normës.

Së dhjeti, veç tjerash, ceket një dukuri e pamirë e disa gjuhëtarëve, ndonëse gegërishtfolës, të cilët kanë mbetur, ende si mbështetës fanatik të normës në fuqi, pa paskajoren me + pjesore, përkatësisht shprehen kundër pjesores së shkurtër (geqe). Këta gjuhëtarë, duke u shprehur për mos rikthimin e paskajores në standard, gjoja se me një veprim të tillë do të dëmtohej njësimi i normës së shqipes standarde etj., kanë mbetur ende peng të një praktike të tejkaluar dhe me një qëndrim të tillë dalin jo largpamës, ngase mbase naivisht ushqejnë kërkesën për një normë të re paralele mbi bazë të gegërishtes, duke zënë si shkas pikërisht mungesën e vlerave të paskajores dhe njëherazi bien ndesh me faktin e pakundërshtueshëm se, sot për sot, pragmatikisht, logjikisht, stilistikisht e shpirtërisht mohimi i paskajores në shqipen standarde do të thotë edhe pengesë e pajustificueshme që i bëhet mbarëvajtjes së shqipes standarde në tërësi.

Është e vërtetë, se tani edhe klima politike, shoqërore e krijuese ka ndryshuar shumë në dobi të demokratizimit e të tolerancës në përgjithësi, prandaj është bërë e mundshme edhe vërtetësia në mënyrë normale pa mitizim, edhe mëdyshja se është më mirë, apo jo, të bëhet inkuadrimi i paskajores me **me**, duhet të hiqet nga rendi i ditës. Inkuadrimi i paskajores duhet të bëhet dhe të arsyetohet në emër të përsosjes së normës së shqipes srtandarde.

### 3. Përsiatje rreth dobisë së inkuadrimit të paskajores me + pjesore në standard

Ne, në pamundësi që në përmbyllje t'i ripërmendim a përsërisim të gjitha ato arsye brenda - e jashtëgjuhësore në dobi të normëzimit të paskajores me + pjesore në standard, tani do të mjaftohemi që në disa pika, pa e ndjekur radhën sipas temave të trajtuara në krerët përkatës të punimit, t'i përmbledhim disa prej atyre fakteve, të cilësuaa subjektivisht si më të motivueshmet dhe si më të nëpërdikshmet, por, simethënjë, ato opsione do të përpiqemi t'i shprehim me një parafrazim, sadokudo, të ri:

E para, për hir të përplotnësisë së normës standarde kërkesa për zgjidhjen e paskajores si një problem i hapur normativisht i gjuhës shqipe, aktualisht del fort e arsyeshme. Ajo (paskajorja) duke qenë e cilësuar, me të drejtë, se ishte si një "shtyllë kurrizore" e organizmit të shqipes, jo vetëm në bazë të ish-gegërishtes letrare, por edhe sipas kodit të shqipes mbarëkombëtare në përgjithësi, pasi nocioni i saj nuk del i mbuluar plotësisht as me lidhore as me paskajoren e dytë, andaj me të drejtë kërkohet që gjithsesi t'i rikthehet, deriduku, ai rol që e kishte dhe sa më parë në normën standarde. Aq më tepër ai rehabilitim duhet bërë pa zvarritje, sepse sipas një numri mjaft të madh studiuesish, intelektualësh e dashamirësish të shqipes standarde, vërtetohet se inkuadrimi i saj nuk bie ndesh aspak me praktikën e deritashme pozitive të bazës së shqipes së sotme letrare, por ka të bëjë, në radhë të parë, me përsosjen a përplotnësinë e asaj baze, e cila tashmë gëzon mandatin si përfaqësuese e shqipes standarde.

E dyta, edhe sipas trajtimit vertikal e horizontal të etnolgjikës gjuhësore, paskajorja mund të shërbejë, pa diskutim, si një hallkë a mjet ndërlidhës me shumë interes, mbase më i rëndësishmi, i shqipes së sotme letrare për të ndërlidhur të sotmen me burimet e së kaluarës disa shekujlore të shkruara e të pashkruara në gegërishte që njohën rritje suksesive, të cilat rastësisht a paradoksisht normativisht ishin të lëna pas dore, pa të drejtë, pothuajse, tash e gjysmë shekulli, por që kanë filluar të rilindin me sukses tash disa vite.

E treta, duke u mbështetur në parimin e mirënjohur të përfshirjes në standard të të gjitha vlerave themelore të gjuhës kombëtare si tërësi, kërkesa për rikthimin e paskajores në strukturën e shqipes standarde, si veçori karakteristike e gegërishtes, del si kërkesë e ligjshme. Kjo formë mendohet, jo pa bazë, se mund t'u shërbejë studiuesve e dashamirësve të gjuhës sonë, si një *kallauz*

(siçelës magjik potencial) për të hapur drynat e dyerve si dhe krahet e dritareve të kulturës së thesarit tonë të një ane dikur të ndritur e tash jo aq të ndriçuar nga rrezet e diellit të simbolit kombëtar, simbol ky ende i gjallë dhe me vlera të pakufishme. Me një veprim të tillë fitohet bindja se ndërkohë shpirtërisht e mendësisht, do ta pasurohet e do të formësohet tërësia kulturore e gjuhësore e genes sonë kombëtare me tërë hijeshinë e gjallërinë e saj.

E katërta, edhe trajtimi sipas raportit ndërgjuhësor do të ndihmonte që kjo formë për përkthyesit dhe interpretët, të shërbejë dhe të dalë si ndihmë e pakompenzueshme me interes, jo vetëm si mjet konkret lehtësues për të nxënë gjuhët kryesore europiane e të tjera që e kanë këtë formë, por, njëherazi, çdo shqipfolësi do t'i ndihmonte që më me lehtësi të përkthente lëndë të gjuhës së vet në gjuhë të huaja. Pra, në këtë mënyrë edhe me këtë formë plus gjuha jonë do të fitonte prestigj më të madh si brendapërbrenda bashkësisë së vet folëse, por edhe në raport ndaj gjuhëve të huaja.

E pesta, nisur nga parimi sociopolitik, sociopedagogjik dhe sidomos ai socio-psikologjik, posa të kuptohen më mirë vlerat e vërteta ta kësaj forme, atëherë, inkuadrimi i saj në normë do të përshpejtonë ndërgjegjësish nxënien e përvetësimin më me vullnet e më me lehtësi të vet normës së rinuar, sepse vetvetiu të pajisurit me sinonimi bashkimi e dashurie më të madhe të shprehjeve të nevojshme ndërmjet atdhedashësve të të gjitha trevave tona (veriore e jugore, qendrore, lindore e perëndimore), do të sillte mirëkuptim më të madh, ngase paskajorja është pasuri që do të joshte edhe shprehjen edhe dijen, edhe shpirtin e çdo shqiptari. Vërtet, do të shtohet, mbase, për dikë, ndonjë formë paralelizmi e sinonimie ndaj ngurtëzimit të normëzimit të sotëm, por gjithkush e di se me dy sy shihet më mirë dhe më harmonishëm, me dy krahe mbahesh më i fortë, andaj edhe me dy e më shumë shprehje sinonimike mozaiku i shprehjes së shqipes do të dalë më i pasur, më shëndetshëm dhe më joshës stilistikisht, po edhe më funksional semantikisht.

E gjashta, edhe në fushën e shprehjes së fjalës së bukur, me inkuadrimin e saj, fjala poetike, do ta ketë më të lehtë për ta përqafuar e stolisur mendësinë poetike me ngjyresa që vetëm shpirti shqiptar mund t'i kuptojë. Shqipshqiponja me emblemëzijoshen simbol në faqen fushëkuqe edhe pse ka dy krerë, ajo ka një mendjesi. Ka një zemër të madhe që ushqehet me ngrohësi rreze-drite nga të dy arterjet ushqyese, toske e geqe. Ajo në të vërtetë ka një trup të vetëm me një shpirt broror, që del i mishëruar fort me një ideal strumbullar, andaj *dykrenarja jonë*: me dy thith-sqepthit e saj, dhe me dy doçkë kanxhëfortaket e veta, duke u mbështetur në intuitë e mençuri ka me mujt me



nxjerrë më me lehtësi nga thelli dhe me zbritë nga lartësitë qiellore thesarin ushqyes lëndor që i përket këtij shpirti bror, kësaj dhe vetëm kësaj bote kombëtare, por që e pasuron dhe stolis me vlera edhe kopshtin e fushës hyjnore gjithënjëzore. Kështu në të ardhmen po ky komb pa vijë të zezë kufindarëse, do të mundet me mëkue më lirshëm ndër breza nektarin e mjalitit gjuhësor, kulturor e patriotik, si nga lulishta tokësore e nëntokësore, ashtu edhe nga lulet e brezares hyjnore të mbiqielit e nënqielit të mbarë truallit shqipfolës, njësoj, si nga Veriu, si nga Jugu, si nga Qendra, si nga Lindja e Perëndimi, ngase vetëm gjuha dhe flamuri ynë i bashkon dhe i jep shpirt brezave të këtij frymimi deri në amshim dhe e bën gjuhën tonë yll të pashuar në orbitën e historisë botërore.

E shtata, me futjen a përfaqimin e saj në normën standarde, do të bëhet më e pranueshme barazpesha e komponenteve gjuhësore dhe s' do të linte më vend për ankesa rreth favorizimit më të madh të njërit krah të simbolit shqipshqiponjë ndaj krahut tjetër, që, tani për tani, është një e vërtetë e lehtëdukshme. Me krahtë të harmonishëm fortakë shqipo-shqiponja do të fluturonte më me lehtësi në orbitën e vet dhe do të ishte më e sigurt në ecejake mbi mjegullat e zeza të majave brorore, ku duhet ta tresë tej e tutje pluhurin dhe tymin e injorancës si dhe ndotjen nga fanatizmi përçarës, i cili duhet zhgjurur rrënjësisht nga nëntoka e trojeve të mendjes së sonë.

E teta, sipas parimit të stardologjisë bashkëkohore me inkuadrimin e paskajores, do të bëhet më i shëndetshëm gjykimi, sepse duke u bërë korigjimi i një lëshimi transparent madhor, do të kthehet mbarë standardi, ngase asnjë normë (artificiale), qoftë e quajtur edhe *normë standarde*, nuk bën t' i kundërvihet aq prerazi kodit të përgjithshëm gjuhësor, duke ia përjashtuar arbitrarisht vlerat e caktuara aq të mëdha, siç është paskajorja, madje duke i lënë të pambuluar plotësisht nocionet e caktuara me trajta zëvendësuese ndërkomunikuese e të tjera, siç është bërë me anashkalimin në fjalë. Siç po dëshmohet me prova dita-ditës, me mënjanimin e formës së paskajores, u mohua mundësia e disa shprehjeve lapidare, qoftë me sinonimi të barasvlerëshme a të nuancuara, qoftë me sinonimi me koncepte të dalluara semantike. Andaj po të shikohet nga ky aspekt mungesa e një formë të tillë ndjehet sot edhe nga vetë struktura e shqipes letrare, strukturë kjo, e cila duke u pajisur me veshën e vet të natyrshme ndërdialektore si ka hije, do ta gëzonte më me zemërgjerësi dhe do ta bënte më me të përkapshëm si edhe më kuptimplotë emërtimin: *shqipe standarde mbarëkombëtare*.

E nënta, edhe sa i përket rrënjëzimit gjenealogjik dhe rigjenerues me inkuadrimin e paskajores, sipas historianëve dialektologë, jo vetëm do të

sforcoheshin rrënjët e tringut gjeneologjik të shqipes mbi dy shtyllat e forta: gegërishte e toskërishte, por, me një veprim të tillë, veç sforcimit të deje të tringut me ushqim të ri, edhe degët e rrembat e saj do të freskoheshin me frymëmarrje të re dhe do të stoliseshin më mirë se anjëherë më parë, me lulëzim për të dhënë fryte të reja, jo vetëm në një anë, por në të gjitha anët e kurorës së spektrit ylberor dyfish të pruarur e të pandarë të gjuhës shqipe.

E dhjeta, kur është fjala te masiviteti dhe perspektiva, me inkuadrimin e paskajores me + pjesore, kjo gjuhë kombëtare, do të ishte me bazë disi më të gjerë dhe shumë më të fortë të mëkuar gjeografikisht, që do t' i shërbente qenies kombëtare për me i përballue më mirë e më me lehtësi sfidat, çfarëdoqofshin ato, në rrugëtimin e saj të mëtejshëm nëpër shtigje e brigje, rreshta e diskutra, vështirësi këto me të cilat mund të ballafaqohet gjatë shekujve të ardhshëm, ngase asnjë rrugë e së ardhmes edhe pse dëshirohet e pritët të jetë e ndritshme nuk del e shtruar me lule pa gjemba.

Kemi bindjen se nga rumbullakësimi i përgjigjeve të dhjetë krerëve të këtij punimi mund të rezultojë konkluzioni i përsëritur disa herë se e pajisur edhe me këtë element themelor *norma e njësuar e shqipes standarde për mbarë bashkësinë shqipfolëse, do të jetë ndërregjigjësisht edhe më e pranueshme, politikisht edhe më e përfaqësueshme dhe kombëtarisht edhe më e integrueshme*.

#### 4. Përfundim

Në përfundim të punimit, bashkë me përmbajtjen po i theksojmë, në dhjetë pika, disa nga risimet më të spikatura që dolin nga analiza e këtij vështrimi:

1. Paskajorja si dallimi më i rëndësishëm në raport *shqipja standarde / gegërishtja letrare*, me tepër se asnjë herë më parë, ishte në fokus të diskutimit në Konferencën shkencore *Shqipja standarde dhe shoqëria shqiptare sot*, mbajtur në Tiranë, nëntor 2002. Edhe pse ajo si çështje e hapur nuk u zgjidh me rekomandimin me shkrim për integrimin e saj të plotë në normën standarde, megjithatë mund të thuhet se me fjalë e qëndrime iu ndez drita e gjelbërt *për përdorim të rregullt, njëherë për një herë, si një variant i lirë*, në mënyrë që të mos pengohet më në rrugëtimin dhe integrimin e saj me kohë brenda shqipes standarde. Me fjalë të tjera, ndonëse, ende ka rezistencë nga mbrojtësit me fanatizëm të normës në fuqi lidhur me mohimin e nevojës së kësaj forme, është e vërtetë se për të parën herë faktorë të rëndësishëm me ndikim të qarqeve gjuhësore të shqipes standarde kësaj forme i dhanë liri të plotë përdorimi, por



megjithatë, siç u tha, ajo mbetet ende jashtë planëzimit gjuhësor brenda normës standarde.

2. Dihet se paskajorja me + pjesore nuk është përfshirë në normën letrare me arsyetimin se gjoja konceptet e saj i plotëson pa lënë gjë mangut: *lidhorja* (trajtat e lidhore) si dhe *paskajorja e dytë e tipit për të + pjesore*, mirëpo, tani, siç po e tregon koha, siç del edhe nga analiza nga ky punim, konstatimet e tilla dalin jo të plota dhe se në vetvete kanë kundërtënie jo të vogla, sepse të gjitha funksionet e paskajores (12 e sa) nuk mund të mbuloen as me trajtat e lidhore as me ato të paskajores së dytë, madje as nga të dyja bashkë, por me një sinonimi më të gjerë të harmonishme që del nga konteksti në kuadrë të kodit të shqipes mbarekombëtare, prandaj edhe doli kërkesa e ligjshme se mënjanimi i saj nga norma lypset rishikuar.

3. Është e para herë që në një vështrim të tillë vihen në pah kundërtënie serioze ndaj realitetit lidhur me kërkesë-propozimin që paskajorja e dytë të sforcohet për të zëvendësuar plotësisht nocionet e paskajores së mirëfilltë. Propozim-prognozi i tillë, në punim cilësohet tejet i diskutueshëm dhe me argumente të shumta si me thënë, hidhet poshtë si i parealizueshëm, sidomos, tani, kur kërkesa për rehabilitimin e paskajores së mirëfilltë, gjithnjë e më shumë, ka përkrahës seriozë.

4. Përdorimi i paskajores në nënfusha semantike, siç është fusha e shprehjeve të një abstraksioni të lartë si dhe atyre nga sfera letraro-artistike etj. sidomos me pjesoren e shkurtër, kërkohet mos t'i referohen më, si deri tani, vetëm gjuhës letrare të gegërishtes si nënvariant, por ato për vlerat që shprehin duhet të përfshihen, doemos, në shqipen standarde, pëmdryshe, nëse nuk veprohet kështu, nuk do të ketë mundësi të përthithet gjithëkombëtarisht nektari i vlerave që ka në vetvete paskajorja. Pra, është e para herë që në këtë vështrim theksohet më përnjëmend kërkesa që thënie frazeologjike dhe shprehjet karakteristike me vlerë nga sfera letraro-artistike (tipizimet etj.), këmbëngulësisht, duhet të inkuadrohen originalisht në shqipen standarde.

5. Në mënyrë të veçantë në këtë vështrim u trajtua funksioni përfaqësues i formës së paskajores, e cila del zakonisht në trajtën *me + pjesore të shkurtër*, madje në mënyrë të veçantë u theksua nevoja e sqarimit të raportit *paskajore / e tashme e dëftore* si trajta përfaqësuese. Shtrohet, pra, çështja që raporti *paskajore / dëftore*, të jetë objekt trajtimi në punime të veçanta dhe më të thelluara. Është e vërtetë se mjaft gjuhëtarë vendës dhe të huaj mungesën e paskajores në funksion përfaqësuesi ia cekin si të metë jo të vogël normës së sotme letrare dhe kërkojnë me këmbëngulje inkuadrimin e saj si sergment të

domosdoshëm. Një trysni e tillë nuk duket e pabazuar, prandaj pikërisht kjo nevojë e ngutshme jep për t'u kuptuar se duhet bërë sa më parë integrimi i paskajores me + pjesore në standardin e shqipes. Pra, më tepër se në çdo burim tjetër në këtë vështrim përmbledhen mendimet e adhuruesve të formës së paskajores me + pjesore, duke vënë theksin mbi nevojën e inkuadrimit të kësaj formë, pra, edhe si trajtë përfaqësuese plotësuese në shqipen standarde.

6. Për të parën herë ilustrohet me fakte se patent-zgjidhja lehtësuese për çështjen e paskajores qëndron në sistemin fjalëformues të shqipes standarde, më drejt në pjesoren e shkurtër të paskajores. Është e vërtetë se për shumicën e tipave të foljeve pjesorja e shkurtër geqe dhe më pak ajo e letrarëzuar, shërben si temë fjalëformuese për formimin e emrave të vepruesit dhe prej pjesorëve të tjerë, siç është sanksionuar edhe në fjalorët tanë normativë të shqipes së sotme letrare. Gjithsesi duke respektuar të dyja format konkurruese të paskajores: me + pjesore të shkurtër dhe me + pjesore e toskëzuar, ndër lidhur, pra, me tipat e foljeve përkatëse, varësisht nga roli i tyre si tema prodhuese, dalin edhe rregullat e zgjidhjes. Por, gjithsesi, pjesorja e shkurtër si temë prodhuese fjalëformuese fiton përparësi ndaj pjesores së toskëzuar për shumicën e tipave të foljeve, megjithatë ka prirje që ato të bashkëjetojnë a t'i ndajnë funksionet sipas tipave të caktuar të foljeve, e si rrjedhojë edhe të prejpesorëve që dalin sipas kësaj mënyre fjalëformuese. Në punim u dha **Skema e raportit pjesore e paskajores si temë prodhuese dhe emri i vepruesit sipas tipave të foljeve si dhe Paskajorja dhe rregullat përmbledhëse të formimit të emrave prejpesorë të vepruesit në shqipen e sotme letrare**, që është risi për gjuhësinë tonë për këtë pikë.

7. Për t'u përgjigjur në pyetjen se a priret evolutivisht shkurtimi i pjesores së letrarishtes, dhe cilët janë shtytësit e një veprimi të tillë, së pari u trajtua raporti pjesore e letrarishtes ndaj pjesorëve të gegërishtes, pastaj involvimi a pjesëmarrja e pjesores përkatëse në fjalëndërtim (fjalëformim, kohëformim dhe formëformim) dhe në fund u trajtua edhe *raporti i formave infinitivale ndaj paskajores me + pjesore në gjuhën shqipe*

8. Në mënyrë të veçantë u paraqiten sheshazi disa nga veçoritë specifike të paskajores me + pjesore në rrafshin horizontal në gjuhën shqipe, duke u vënë në pah në disa pika mjaft gjëra që më parë, me sa dimë, jo vetëm se nuk janë trajtuar në këtë mënyrë, por nuk ishin aq të njohura as të sistemuara në gjuhësinë shqiptare.

9. Pa mohuar mundësinë e ofruar me të ashtuquajtur *patent-zgjidhjen* e pjesshme lehtësuese, të përmendur në kërret e mëparshëm dhe sidomos në të

shtatin, në këtë krye të punimit, bëhet fjalë më në hollësi, pothuajse, vetëm për pjesoren e shkurtër të shqipes (ish-shqipes letrare mbi bazë të gegërishtes), e cila mund të shërbejë një *siçelës magjik potencial* për konsolidimin, përplotësimin dhe zgjidhjen e çështjeve të hapura të sistemit foljor të shqipes dhe sidomos lidhur me inkuadrimin më me lehtësi të paskajores me + pjesore në normën standarde.

10. Duke mos u pajtuar me disa gjuhëtarë gegërishtfolës, të cilët vazhdojnë ende me mospërfilljen a injorimin e formës së paskajores së mirëfilltë, theksohet dobia që i sjell shqipes standarde në veçanti dhe shqipes mbarë-kombëtare në përgjithësi, inkuadrimi i paskajores në fjalë, andaj jo vetëm se nuk duhet penguar as teorikisht as praktikisht nga askush paskajorja e mirëfilltë, por forma e tillë, lypset favorizuar për të zënë vendin e merituar në gjirin e normës standarde dhe për këtë janë dhënë mjaft kundërgjegjësi ndaj mospërfillësve gegërishtfolës.

Zgjidhja e paskajores me integrim do të shërbente gjithësesi edhe si një akt balancues në mes arealeve kryesore shqipfolëse veri-jug e lindje-perëndim, por njëherazi do të cilësohej edhe si një akt pajtues i zemrave të bashkëkombësve, ngase duke u përsosur norma e shqipes standarde me forma strukturore, siç është paskajorja, vetvetiu largon nevojën për krijimin e një gjuhë tjetër paralele a rivale (gege) kundrejt shqipes standarde (tani kryesisht mbi bazë të toskërishtes) duke shfrytëzuar pikërisht vlerat e anashkaluara të paskajores.

Sidoqoftë, në të gjitha temat e trajtuara në kërret e veçantë të këtij punimi, krahas ritrajtimit të fakteve të njohura, u ekspozuan a vunë në pah mjaft fakte të reja lidhur me temën bosht të këtij vështrimi. Deri në fund u përkrah dukuria evolutive e *pjesores së shkurtër* në të mirë të mbarëvajtjes së normës së shqipes standarde mbarëkombëtare. U ndriçua edhe më mirë, roli i kësaj trajte (pjesores së shkurtër) edhe si pjesë organike e paskajores së mirëfilltë të shqipes.

Me fjalë të tjera pjesëmarrja e pjesores e shtrirë edhe në funksione fjalëformuese, formëformuese e kohëformuese zgjidh mjaft çështje të rëndësishme të gjuhësisë sonë, por në veçanti ndihmon zgjidhjen pa pasoja të *paskajores me pjesore* dhe me një zgjidhje të tillë, d.m.th., me inkuadrimin e saj në normën standarde, njëzimi i shqipes standarde do të jetë ndërjegjësisht edhe më i pranueshëm, politikisht më i përfaqësueshëm e kombëtarisht edhe më i integrueshëm për tërë bashkësinë tonë shqipfolëse.

## Literatura:

Përveç revistave, gazetave e burimeve të tjera të cekura në shënime brendi; tekstist janë konsultuar posaqërisht edhe këto vepra:

ASHAK, *Studime* 1-11.

Besim Bokshi, *Pjesorja e shqipes*, ASHAK, Prishtinë 1998.

*Fjalori i gjuhës shqipe*, Tiranë 1954.

*Fjalori i shqipes së sotme*, Tiranë 2002.

*Gramatika e gjuhës shqipe* 1, 2, Tiranë 2002

*Gramatika praktike e gjuhës shqipe* (M. Çeliku, M. Karapinjalli R. Stringa), Tiranë, 1998,

Idriz Ajeti, *Studime gjuhësore në fushë të shqipes* 1-5, (sidomos III), Prishtinë 1985

*Gjuha letrare shqipe për të gjithë*, Tiranë 1976.

Konferenca shkencore, *Shqipja standarde dhe shoqëria shqiptare sot*.

ASHSH, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë 2003.

*Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe*, 20-25 nëntor 1972, Tiranë 1974.

*Letërsia shqipe dhe gjuha letrare*, ASHAK, Prishtinë 1998.

Mehmet Çeliku, *Çështje të shqipes standarde*, Tiranë 20001; *Format e pashtjelluara të foljes në gjuhën e sotme shqipe*, Tiranë 2000

Mehmet Elezi, *Gjuha shqipe në bunker?*, Tiranë 2004.

Nuhi Veselaj, *Çështje të shqipes standarde në fushë të leksikut dhe*

*të fjalëfoprmimit I*, Rilindja, Prishtinë 1997.; *Paskajorja*

*çështje e shqipes standarde*, Dardania sacra, Prishtinë 2000;

*Foljet më -O- në gjuhën shqipe*, Dardania sacra, Prishtinë 2002.

Norbert Jokli ( *albanolog i shquar austriak*), Shkodër 2003.

*50 vjet studime albanologjike*, IAP, Prishtinë 2004.

Selman Riza, *Vepra I - 4*, ASHAK, Prishtinë.

*Standardi gjuhësor dhe kultura e gjuhës* (Q. Murati), IAP, Prishtinë 2004.

Shaban Demiraj, *Gramatika historike e gjuhës shqipe*, Prishtinë 1988.

Xhevat Lloshi, *Stilistika dhe pragmatika*, Tiranë 1999.